# RAPORT I AUDITIMIT
**(Auditim Përputhshmërie)**

## "AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA" TIRANË

**MAJ, 2020**

# RAPORT AUDITIMI

*(Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara)*


| NR | PËRMBAJTJA | Faqe |
|---|---|---|
| I<br>II | **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**<br>**Hyrje (Të dhëna mbi Projektraportine auditimit)**<br>**Përshkrimi i auditimit** | 3<br>3-6 |
| III | ***Drejtimet e auditimit***<br><br>***1***. *Struktura organizative dhe vlerësimi i kapaciteteve njerëzore;*<br><br>***2***. *Korrespodencat zyrtare me Autoritetet Kontraktore për bashkërendimi e punës për mbledhjen e përpunimin e të dhënave për prokurimet publike;*<br>***3***. *Unifikimi i specifikimeve teknike për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj;*<br>***4.*** *Zhvillimi i procedurave për prokurimet e përqendruara për mallra dhe shërbimeve deri në shpalljen e fituesit;*<br>***5***. *Shqyrtimi i ankesave të operatorëve ekonomikë deri në shpalljen e njoftimit të fituesit.*<br>***6.*** *Monitorimi i zbatimit të kontratave nga Autoritetet Kontraktore. Hartimi i raporteve të monitorimit nga DPPP, për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës.* | 6-111<br><br>6-14<br><br>14-16<br><br>17-26<br>26-108<br><br>108<br><br>108-111 |
| IV | **Gjetjet dhe rekomandimet** | 111-128 |
| V | **Opinioni i auditimit** | 135 |
| V | **Dokumente shoqëruese** | |

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Nga auditimi u konstatua:

-Janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në lidhje me hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në kundërshtim me ligjin e Prokurimit Publik të reflektuara me dëm ekonomik rreth 200 milion lekë;

-Janë konstatuar parregullsi në lidhje me mos përgatitjen e unifikimit të kritereve të veçanta të kualifikimit per të gjitha kontratat e mallrave dhe të shërbimeve që janë prokuruar për llogari të Autoriteteve Kontraktore të reflektuara me mospërdorimin e fondeve buxhetore me efektivitet dhe me ekonomicitet që, shkojnë në vlerën rreth 207,191,000 lekë lekë;

-Është konstatuar se, për një pjesë të konsiderueshme të fondeve buxhetore në vlerën rreth 1,353,000,000 lekë nuk është arritur efiçenca dhe efikasiteti i procedurave të prokurimit, duke mos përmbushur kështu, qëllimin e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006.

- Është konstatuar se nga instanca e larta mosrespektimt të akteve ligjore e nënligjore që rrgullojnë organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, etj.

****

## III. Hyrje

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1037/1, datë 23.12.2019 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 23.12.2019 deri në datë 28.02.2020, në subjektin Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara (ABP) Tiranë, u krye auditimi i përputhshmërisë me objekt "Vlerësimi nëse aktivitetet dhe informacionet e raportuara janë, në cdo aspekt material në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, Tiranë".

Grupi i Auditimit me përbërje:

1. B. A., Përgjegjës Grupi
2. E. K., Auditues i Parë
3. P. R., Auditues i Parë

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi përputhshmërinë e aktivitetit të Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara (këtu e në vazhdim ABP) Tiranë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e parimeve të transparencës, argumentimit, në përputhje me kërkesat e ligjit për prokurimet publike, aktet nënligjore në zbatim të tij si edhe bazës ligjore që rregullon e aktivitetin e institucionit.

***a)Titulli.*** **"**Raporti Përfundimtar i Auditimit të Përputhshmërisë në Agjencinë e Blerjeve të Përqëndruara (ABP)

***b)Marrësi.*** Ky raport i adresohet Drejtorit të Përgjithshëm të ABP, Zj. E. N.

## METODOLOGJIA DHE OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

***a)Objektivat dhe qëllimi i auditimit:***

Objektivi i auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për zbatimin korrekt dhe me paanshmëri të Ligjit për Prokurimin Publik në veprimtarine e Agjencise së Blerjeve të Përqendruara në lidhje me zbatimin e parimeve të transparencës, argumentimit, në përputhje me kërkesat e ligjit për prokurimet publike.
Vlerësimi nëse aktivitetet dhe informacionet e raportuara, në të gjitha aspektet materiale, janë në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e te cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Raportimi i devijacioneve ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.
Auditimi jonë ka për qëllim ***promovimin e transparencës*** duke ofruar raporte te besueshme mbi vlerësimin e aktivitetit të Agjencise së Blerjeve të Përqëndruara në respektim të kuadrit ligjor rregullator në fuqi dhe të drejtave të subjekteve të ndryshëm ankimues.

*Gjithashtu auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim* promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë *(sipas ISSAI 400, p 18).*
***Qëllimi i auditimit*** është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet e Agjencisë se Blerjeve të Përqëndruara janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e te cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Qëllimi i auditimit është të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale.
Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, ne synojmë të japim një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.
Çështjet të cilat do të trajtohen në këtë projekt, lidhen me auditimin mbi strukturat organizative dhe vlerësimi i kapaciteteve njerëzore; korrespondencat zyrtare me AK për bashkërendimin e punës për mbledhjen e përpunimin e të dhënave për prokurimin publik, përllogaritja e fondit limit, unifikimi i specifikimeve teknike si dhe auditimin e prokurimit të fondeve publike etj.

***b) Identifikimi i çështjes:***

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara është krijuar me vendimit nr.81 datë 14.02.2018 të Këshillit të Ministrave "*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara"* si dhe në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik"* i ndryshuar si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, në vijim "Agjencia" ose "ABP", organizohet dhe funksionon si institucion qendror, person juridik publik, buxhetor, në varësi të Ministrit të Brendshëm.
Misioni i Agjencisë si organ qendror blerës, i autorizuar me vendim të Këshillit të Ministrave, është kryerja e procedurave të prokurimit të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të kryeministrisë, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit dhe të ministrave të linjës, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve, të përcaktuara në aktin nënligjor përkatës. Përjashtimisht, Agjencia mund të zhvillojë procedurë prokurimi edhe kur kërkohet nga një autoritet ose një grup autoritetesh kontraktore, për mallra ose shërbime, që nuk i janë ngarkuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
Agjencia drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e saj dhe përgjigjet para Ministrit të Brendshëm. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë emërohet, lirohet ose shkarkohet nga Ministri i Brendshëm

Referuar çështjeve të audituara të cilësuar më sipër, objektivi kryesor *është dhënia e një opinioni nëse* nga strukturat përkatëse të këtij institucioni: janë zbatuar detyrimet që rrjedhin nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, mbi shqyrtimin e vendimeve të marra lidhur me proceduar e prokurimit.

***c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:***

Drejtimi i ABP së është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

***d) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:***

Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (ISSAI 4100 dhe 4200 [1]) vlerësimit nëse vendimet e ABP, janë në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Audituesit në këtë Projektraport duhet të shprehin konkluzionin dhe një opinion mbi çështjen që është nën këtë auditim.

***e)Kriteret e vlerësimit***.

Kushtetuta e Shqipërisë, neni 162 163

Ligji nr 154/2014, datë 27.11.2014 "Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

Rregullore e procedurave të auditimit në KLSH, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.107, datë 08.8.2017,

Vendimi nr.81 datë 14.02.2018 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara",

Vendimit nr.82 datë 14.02.2018 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara";

Urdhëri i Kryeministrit nr.46 datë 09.03.2018 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara".

***f)Standardet e auditimit*** të aplikuara në kryerjen e punës janë:

Auditimi u bazua në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit Publik (ISSAI).

ISSAI 100 (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*) që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi.

ISSAI 4000 "Standarti i Auditimit të Përputhshmërisë"

ISSAI 4100 *"Standardi i Audititmit të Përputhshmërisë për auditime të performuara veçmas nga Auditimi i Pasqyrave Financiare"*.

ISSAI n 10 Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI t, si dhe ISSAI 30 Kodi Etikës.

***d)Subjekti i audituar:***

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, në vijim "Agjencia" ose "ABP", organizohet dhe funksionon si institucion qendror, person juridik publik, buxhetor, në varësi të Ministrit të Brendshëm.

Misioni i Agjencisë si organ qendror blerës, i autorizuar me vendim të Këshillit të Ministrave, është kryerja e procedurave të prokurimit të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të kryeministrisë, ministrive, institucioneve

---

[1] **1.ISSAI 4100 –** *Objektivi i audituesve në një auditim pnrputhshmërie nshtn tn japn siguri tn arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çnshtjeje tn veçantn nshtn në pnrputhje, në tn gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bnhet lidhur me çnshtje tn veçanta.*

**2.ISSAI 4200 -** *Objektivi i audituesve në një auditim pnrputhshmërie nshtn tn japn siguri tn arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çnshtjeje tn veçantn nshtn në pnrputhje, në tn gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare*

në varësi të Kryeministrit dhe të ministrave të linjës, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve, të përcaktuara në aktin nënligjor përkatës. Përjashtimisht, Agjencia mund të zhvillojë procedurë prokurimi edhe kur kërkohet nga një autoritet ose një grup autoritetesh kontraktore, për mallra ose shërbime, që nuk i janë ngarkuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë janë ato të përcaktuara në vendimet nr.81 datë 14.02.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara" dhe nr.82 datë 14.02.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara", të Këshillit të Ministrave;

**PËRSHKRIMI AUDITIMIT**

**1. Informacioni i përgjithshëm:**

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, në vijim "Agjencia" ose "ABP", organizohet dhe funksionon si institucion qendror, person juridik publik, buxhetor, në varësi të Ministrit të Brendshëm.
Misioni i Agjencisë si organ qendror blerës, i autorizuar me vendim të Këshillit të Ministrave, është kryerja e procedurave të prokurimit të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të kryeministrisë, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit dhe të ministrave të linjës, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve, të përcaktuara në aktin nënligjor përkatës. Përjashtimisht, Agjencia mund të zhvillojë procedurë prokurimi edhe kur kërkohet nga një autoritet ose një grup autoritetesh kontraktore, për mallra ose shërbime, që nuk i janë ngarkuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë janë ato të përcaktuara në vendimet nr.81 datë 14.02.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara" dhe nr.82 datë 14.02.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara", të Këshillit të Ministrave;

**2. Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit:**

Objekt i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi përputhshmërisë e veprimtarisë së subjektit me kuadrin rregullator në fuqi.
Qëllimi i auditimit: Garantimi i sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të ABP së, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të përdorimit të fondeve buxhetore.
Fushëveprimi i auditimit: Vlerësimi i aktivitetit të ABP së me qëllim dhënien e opinionit, shtrirë sipas drejtimeve të programit të auditimit. Janë audituar dokumentacionet dhe të dhënat në lidhje me subjektin për periudhën 01.01.2017 – 31.12.2019, si dhe janë audituar me përzgjedhje vendimet e marra nga ABP si dhe shqyrtimi i ankesave të paraqitura në ldhje me zhvillimin e procedurave të prokurimit të zhvilluara në periudhën 01.01.2017 – 31.12.2019.

********

**III. DREJTIMET E AUDITIMIT:**

**1. Organizimi dhe funksionimi i Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, struktura organizative dhe vlerësimi i kapaciteteve njerëzore**

**1.1.Mbi organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara**

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara është krijuar, organizohet dhe funksionon sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.81 datë 14.02.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara".
Referuar pikës 1 të këtij vendimi, Agjencia organizohet dhe funksionon si institucion qendror, person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit të Brendshëm, si dhe referuar pikës 3, Agjencia ka buxhetin e vet, i cili është pjesë e buxhetit të Ministrisë së Brendshme.
Për më tepër, në pikën 8 të këtij vendimi, parashikohet që shërbimet mbështetëse dhe ato të buxhetit e të financës për Agjencinë realizohen nga strukturat përgjegjëse për këto funksione në Ministrinë e Brendshme.
Mirëpo, rezulton se Ministria e Brendshme ka parashikuar për Agjencinë si institucion varësie, vetëm fonde për pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të punonjësve të Agjencisë, por në asnjë nga vitet e audituara 2018, 2019 dhe as për vitet 2020, 2021 dhe 2022, nuk janë parashikuar fonde nga buxheti i shtetit, për shpenzime apo investime për këtë institucion. Referuar shkresës nr.10502prot. datë 31.12.2019 "Për detajimin e buxhetit për vitet 2020-2022" të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme, drejtuar Njësisë Shpenzuese Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, rezultojnë të miratuara vetëm fonde buxhetore për shpenzime personeli (artikulli 600 dhe 601).
Në këtë aspekt, rezulton se nga ana e strukturave përgjegjëse për funksionet mbështetëse në Ministrinë e Brendshme, duke filluar në rend hierarkie nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme, nuk është zbatuar përcaktimi i aktit nënligjor VKM 81/2018, që Agjencia organizohet dhe funksionon si institucion buxhetor, përderisa kësaj Agjencie nuk i është akorduar pjesa e saj nga fondet buxhetore të Ministrisë së Brendshme, për shpenzime korente dhe kapitale.
Agjencia e Blerjeve të Përqendruara është një institucion i krijuar rishtazi në vitin 2018, si nevojë e reformimit dhe kalimit në një nivel më të lartë organizimi institucional sesa ish-Drejtoria e Përgjithshme e Prokurimeve të Përqendruara, e cila ishte pjesë e strukturës organizative të Ministrisë së Brendshme, e në këtë kuadër, Agjencia nuk duhet të vazhdojë të funksionojë si një drejtori pjesë e strukturës së ministrisë, pasi Agjencia është krijuar që të funksionojë si institucion qëndror buxhetor, në varësi të ministrit.
Nga ana tjetër, struktura organizative e Agjencisë e miratuar me Urdhërin e Kryeministrit nr.46 datë 09.03.2018 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara", përcakton organizimin e këtij institucioni në 4 drejtori dhe sektorë përkatës, por asnjë drejtori apo sektor që të ketë përgjegjësi dhe detyra të shërbimeve mbështetëse, të mirëmbajtjes, të menaxhimit të burimeve njerëzore, të trajtimit të aspekteve ekonomike-financiare të institucionit, të funksionimit të sistemit financiar dhe kontrollit të brendshëm nëpërmjet komponentëve të tij, etj.
Shërbimet mbështetëse për Agjencinë nuk arrihen të ofrohen në kohën e duhur ose nuk ofrohen aspak nga strukturat përgjegjëse për këto shërbime në ministri, pasi rezulton se:
- të gjitha praktikat për plotësimin e vendeve vakante të punës, janë hartuar nga vet Agjencia (Drejtori i Përgjithshëm dhe një Drejtor Drejtorie), jo nga shërbimet mbështetëse të ministrisë;
- kontratat individuale të punës së punonjësve hartohen nga vet Agjencia (Drejtori i Përgjithshëm);
- praktikat e pagesave të blerjes së standardeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, kryhen nga shërbimet mbështetëse të ministrisë, por me vonesa të theksuara;
- praktikat e pagesave të publikimit të njoftimeve të kontratave në gazeta të huaja, për procedurat mbi kufirin e lartë monetar (ndërkombëtare) sic përcaktohet në LPP, kryhen nga shërbimet mbështetëse të ministrisë, por me vonesa të theksuara; etj.

Agjencisë i janë vënë në dispozicion 6 zyra për 25 vende pune, në godinën e Ministrisë së Brendshme. Zyrat janë të mbingarkuara me punonjës dhe dokumentacion që nuk mund të arkivohet, sepse nuk ka zyrë të vecantë për protokollin dhe as arkivë të vecantë për ruajtjen e dokumentacionit (dokumentat ruhen në një dhomë në bodrum, bashkë me mostra / kampione mallrash të paraqitura në procedura prokurimi), zyra e titullarit nuk ka paradhomë dhe ndodhet brenda të njëjtit ambient

me zyrën me 5 punonjës. Aktualisht, Agjencia është në kushtet e pamundësisë së plotësimit të vendeve vakante të punës, sepse nuk ka zyra dhe vende pune për akomodimin e 7 punonjësve të rinj.

Domosdoshmëri në këtë aspekt është ndryshimi i strukturës organizative të Agjencisë, duke shtuar një drejtori të shërbimeve mbështetëse brenda Agjencisë, për kryerjen e të gjithë aktivitetit që lidhet me shërbimet mbështetëse, të mirëmbajtjes, të menaxhimit të burimeve njerëzore, të trajtimit të aspekteve ekonomike-financiare të institucionit, të funksionimit të sistemit financiar dhe kontrollit të brendshëm nëpërmjet komponentëve të tij, etj.

Nga ana tjetër, vlerësohet i nevojshëm akomodimi i punonjësve të Agjencisë në më shumë zyra për punonjësit brenda ministrisë, zyrë për protokoll, për arkivë, etj, deri në akomodimin në një godinë më vete. Vënia në dispozicion e ambienteve të përshtatshme për të gjithë stafin e Agjencisë, merr rëndësi nisur nga veprimtaria e Agjencisë, e cila është e bazuar në punën në grup, njësi prokurimi, komision vlerësimi të ofertave, grup shqyrtimi ankesa, grup monitorimi, etj. Për shkak të mungesës së zyrave të përshtatshme dhe mbingarkesës me punonjës të sektorëve dhe drejtorive të ndryshme në të njëjtin ambient, ulet produktiviteti dhe shfrytëzimi optimal i kohës së punës.

Ky ndryshim në strukturën organizative, gjen mbështetje edhe në Ligjin nr.90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", i ndryshuar, në parimet e organizimit dhe funksionimit të administratës shtetërore, e konkretisht: parimit të qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësive (ndarja dhe caktimi i funksioneve dhe detyrave administrative, ndërmjet organeve, institucioneve dhe njësive administrative, duhet të jenë specifike, të shmangin mbivendosjen, të jenë transparente dhe të bëhen publike në mënyrë të përshtatshme) si dhe parimit të ekonomisë, efiçencës dhe efektivitetit (caktimi dhe shpërndarja e përgjegjësive, si dhe organizimi i administratës shtetërore duhet të sigurojnë efektivitetin në kryerjen e funksioneve dhe detyrave, efiçencën në arritjen e objektivave të politikave të miratuara, si dhe ekonominë në përdorimin e të mirave dhe fondeve publike) .

Agjencia, si organ qendror blerës, i autorizuar me vendim të Këshillit të Ministrave, ka si mision kryerjen e procedurave të prokurimit të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve të përcaktuara në aktin nënligjor përkatës. Aktualisht, marrëdhëniet e punës së drejtorit të Përgjithshëm dhe të punonjësve të Agjencisë rregullohen sipas dispozitave të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar. Por, nisur nga detyrat dhe përgjegjësitë që i janë ngarkuar Agjencisë dhe punonjësve të saj, duhet që këta të fundit të bëhen pjesë e shërbimit civil, në përputhje me ligjin 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, i cili ndër të tjera garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil, të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike.

**1.2. Struktura organizative dhe vlerësimi i kapaciteteve njerëzore.**

-Mbështetur në ligjin nr. 9000, datë 30.01.2003, *"Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"*, ligjin nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, të ndryshuar si dhe në ligjin nr. 90/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"*është nxjerrë urdhëri nr. 46, datë 09.03.2018, mbi bazën e të cilit është bërë struktura, organika, organizimi i brendshëm i Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara, të pasqyruar në Rregulloren e Brendshme me nr. 594/1 prot., datë 16.04.2019 "Për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara (ABP)"", të miratuar nga Ministri ,rregullore me të cilën institucioni ka funksionuar në vijimësi. Nga përmbajtja e rregullores së Brendshme, rezulton se janë evidentuar qëllimi, misioni dhe veprimtaria si dhe detyrat kryesore që duhet të përmbushë institucioni, si pjesë e administratës shtetërore, në varësi të Ministrisë së Brendshme. Gjithashtu në këtë rregullore janë evidentuar detyrat specifike që duhet të kryejë secili prej pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm, Sekretarit të Drejtorit të Përgjithshëm, Drejtorit të Drejtorisë së Standarteve dhe Monitorimit të Cilësisë, Përgjegjësit të

Sektorit të Standarteve dhe Analizës në Drejtorinë e Standarteve dhe Monitorimit të Cilsësisë, Specialistit në Sektorin e Standarteve dhe Analizës në Drejtorinë e Standarteve dhe Monitorimit të Cilësisë, Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kontratave në Drejtorinë e Standarteve dhe Monitorimit të Cilsësisë, Specialist i Sektorit të Monitorimit të Kontratave në Drejtorinë e Standarteve dhe Monitorimit të Cilsësisë, Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit të Prokurimeve, Koordinator i Drejtorisë së Zhvillimit të Prokurimeve, Drejtor i Drejtorisë Teknike, Përgjegjës i Sektorit të Përpunimit të Mallrave dhe Shërbimeve të Posaçme në Drejtorinë Teknike, Specialist i Sektorit të Përpunimit të Mallrave dhe Shërbimeve të Posaçme në Drejtorinë Teknike, Drejtor i Drejtorisë së Shqyrtimit të Ankesave të Prokurimeve të Përqëndruara, Specialist i Drejtorisë së Shqyrtimit të Ankesave të Prokurimeve të Përqëndruara.

Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se për vitin 2017, deri në muajin mars 2018, e emërtuar për atë periudhë si Drejtoria e Përgjithshme e Prokurimeve të Përqëndruara është organizuar dhe ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin nr. 162, datë 05.10.2017, të Kryeministrit "*Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës të Ministrisë së Brendshme*" me 32 punonjës. Për këtë periudhë, Drejtoria ka funksionuar me 7 punonjës. Nga muaji mars 2018 e në vazhdim, Agjecia e Blerjeve të Përqëndruara është organizuar dhe ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit Nr.46, datë 09.03.2018 për krijimin e Strukturës dhe organikës së Agjensisë me 32 punonjës. Numri i punonjësve për vitin 2018 ështëtë paraqitura në tabelën nr.1.

*Tabela nr.1*

| Nr | Plotësimi strukturës dhe organikes ne fund te vitit 2018 | Plan | Fakt | Dif.F/Pl. |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Drejtor Përgjithshëm | 1 | 1 | |
| | Sekretar | 1 | 0 | -1 |
| 2 | Drejtor i Drejtorisë së Standarteve dhe Monitorimit të Cilësisë | 1 | 1 | |
| | Përgjegjës i Sektorit të Standarteve dhe Analizës | 1 | 1 | |
| | Specialist në Sektorin e Standarteve dhe Analizës | 2 | 2 | |
| | Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kontratave | 1 | 0 | -1 |
| | Specialist në Sektorin e Monitorimit të Kontratave | 2 | 2 | |
| | Drejtoria e Standarteve dhe Monitorimit të Cilësisë | 7 | 6 | -1 |
| 3 | Drejtor i Drejtorisë Teknike | 1 | 0 | -1 |
| | Përgjegjës i Sektorit të Përpunimit të Mallrave | 1 | 1 | |
| | Specialist në Sektorin e Përpunimit të Mallrave | 2 | 2 | |
| | Përgjegjës i Sektorit të Përpunimit të Shërbimeve | 1 | 1 | |
| | Specialist në Sektorin e Përpunimit të Shërbimeve | 2 | 1 | -1 |
| | Përgjegjës i Sektorit të Përpunimit të Mallrave e Shërbimeve të Posaçme | 1 | 1 | |
| | Specialist në Sektorin e Përpunimit të Mallrave e Shërbimeve të Posaçme | 2 | 1 | -1 |
| | Drejtoria Teknike | 10 | 7 | -3 |
| 4 | Drejtor i Drejtorisë së Shqyrtimit të Ankesave | 1 | 0 | -1 |
| | Specialist në Drejtorinë e Shqyrtimit të Ankesave | 4 | 3 | -1 |
| | Drejtoria e Shqyrtimit të Ankesave | 5 | 3 | -2 |
| 5 | Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit të Prokurimeve | 1 | 0 | -1 |
| | Koordinator në Drejtorinë e Zhvillimit të Prokurimeve | 7 | 2 | -5 |
| | Drejtoria e Zhvillimit të Prokurimeve | 8 | 2 | -6 |
| | **TOTALI** | **32** | **19** | **-13** |

Numri i punonjësve për vitin 2019 është i paraqitur në tabelën nr.2.

*Tabela nr.2*

| Nr | Pozicioni i punës | Plotësuar | Vakant |
|---|---|---|---|
| 1 | Drejtor i Përgjithshëm | X | |
| 2 | Sekretar i Drejtorit të Përgjithshëm | | X |
| 3 | Drejtor i Drejtorisë Teknike | X | |
| 4 | Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit të Prokurimeve | X | |
| 5 | Drejtor i Drejtorisë së Standardeve dhe Monitorimit të Cilësisë | X | |
| 6 | Drejtor i Drejtorisë së Shqyrtimit të Ankesave | X | |
| 7 | Përgjegjës i Sektorit të Përpunimit të Mallrave - Drejtoria Teknike | X | |
| 8 | Specialist – Sektori i Përpunimit të Mallrave - Drejtoria Teknike | X | |
| 9 | Specialist – Sektori i Përpunimit të Mallrave - Drejtoria Teknike | | X |
| 10 | Përgjegjës i Sektorit të Përpunimit të Shërbimeve - Drejtoria Teknike | X | |
| 11 | Specialist – Sektori i Përpunimit të Shërbimeve - Drejtoria Teknike | X | |
| 12 | Specialist – Sektori i Përpunimit të Shërbimeve - Drejtoria Teknike | X | |
| 13 | Përgjegjës i Sektorit të Përpunimit të Mallrave e Shërbimeve të Posacme - Drejtoria Teknike | | X |
| 14 | Specialist – Sektori i Përpunimit të Mallrave e Shërbimeve të Posacme - Drejtoria Teknike | X | |
| 15 | Specialist – Sektori i Përpunimit të Mallrave e Shërbimeve të Posacme - Drejtoria Teknike | X | |
| 16 | Koordinator – Drejtoria e Zhvillimit të Prokurimeve | X | |
| 17 | Koordinator – Drejtoria e Zhvillimit të Prokurimeve | X | |
| 18 | Koordinator – Drejtoria e Zhvillimit të Prokurimeve | X | |
| 19 | Koordinator – Drejtoria e Zhvillimit të Prokurimeve | X | |
| 20 | Koordinator – Drejtoria e Zhvillimit të Prokurimeve | X | |
| 21 | Koordinator – Drejtoria e Zhvillimit të Prokurimeve | | X |
| 22 | Koordinator – Drejtoria e Zhvillimit të Prokurimeve | | X |
| 23 | Përgjegjës i Sektorit të Standardeve dhe Analizës - Drejtoria e Standardeve dhe Monitorimit të Cilësisë | | X |
| 24 | Specialist - Sektori i Standardeve dhe Analizës - Drejtoria e Standardeve dhe Monitorimit të Cilësisë | X | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 25 | Specialist - Sektori i Standardeve dhe Analizës - Drejtoria e Standardeve dhe Monitorimit të Cilësisë | X | |
| 26 | Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kontratave - Drejtoria e Standardeve dhe Monitorimit të Cilësisë | X | |
| 27 | Specialist - Sektori i Monitorimit të Kontratave - Drejtoria e Standardeve dhe Monitorimit të Cilësisë | X | |
| 28 | Specialist - Sektori i Monitorimit të Kontratave - Drejtoria e Standardeve dhe Monitorimit të Cilësisë | X | |
| 29 | Specialist – Drejtoria e Shqyrtimit të Ankesave | X | |
| 30 | Specialist – Drejtoria e Shqyrtimit të Ankesave | X | |
| 31 | Specialist – Drejtoria e Shqyrtimit të Ankesave | X | |
| 32 | Specialist - Drejtoria e Shqyrtimit të Ankesave | | X |
| | **TOTALI** | **25** | **7** |

ABP është e organizuar në 4 Drejtori dhe në 5 Sektorë, gjithsej 32 punonjës. Nga auditimi rezulton se struktura është ngritur sipas miratimit. Agjensia drejtohet nga Drejtori I Përgjithshëm dhe nga 4 drejtori me 5 sektorë dhe konkretisht:
-Drejtoria e Standarteve dhe Monitorimit të Cilësisë në përbërje të së cilës janë Sektori I Standarteve dhe I Analizës si dhe sektori I Monitorimit të kontratave.
-Drejtoria e Zhvillimit të Prokurimeve pa Sektorë
-Drejtoria Teknike me tre Sektorë në varësi siç janë: Sektori I Përpunimit të Mallrave, Sektori I Përpunimit të Shërbimeve dhe Sektori I Përpunimit të Mallrave dhe Shërbimeve të posaçme.
-Drejtoria e shqyrtimit të Ankesave të Prokurimeve të Përqëndruara pa Sektorë.

Nga auditimi I strukturës organizative, respektimi I saj, funksionimi I sistemit financiar dhe kontrollit të brendshëm nëpërmjet komponentëve të tij, rezultoi se:

-Agjensia e Blerjeve të Përqëndruara ka të miratuar në strukturë 32 punonjës.Nga auditimi mbi plotësimin e organikës së Agjencisë rezultoi se deri në fund të vitit 2018, ishte e plotësuar në masën afro 60 %, pra 13 punonjës më pak. Konkretisht nuk ishin plotësuar 3 pozicione drejtorësh, si ai i Drejtorit të Drejtorisë Teknike, Drejtorit të Drejtorisë së Shqyrtimit të Ankesave, si dhe posti i Drejtorit të Drejtorisë së Zhvillimit të Prokurimeve. Nuk ishin plotësuar: 1 pozicion pune përgjegjës sektori, 8 pozicione pune specialistësh e koordinatorësh, si dhe pozicioni i sekretarit të Drejtorit të Përgjithshëm. Deri më 16.04.2019, Agjencia ka funksionuar pa një Rregullore të Brendshme të hartuar prej saj dhe të miratuar nga Ministri. Regullorja e Brendshme është miratuar me Urdhërin nr.365, datë 16.04.2019. Rregullorja është hartuar nga Agjencia dhe është miratuar nga Ministri I Brendshëm mbështetur në pikën 7 të VKM-së nr.81, datë 14.02.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjensisë së Blerjeve të Përqëndruara". Nga përmbajtja e rregullores së Brendshme, rezulton se janë evidentuar qëllimi, misioni dhe veprimtaria si dhe detyrat kryesore që duhet të përmbushë institucioni, si pjesë e administratës shtetërore, në varësi të Ministrisë së Brendshme. Gjithashtu në këtë rregullore janë evidentuar detyrat specifike që duhet të kryejë secili prej pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, si detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm, Sekretarit të Drejtorit të Përgjithshëm, Drejtorit të Drejtorisë së Standarteve dhe Monitorimit të Cilësisë, Përgjegjësit të Sektorit të Standarteve dhe Analizës në Drejtorinë e Standarteve dhe Monitorimit të Cilsësisë, Specialistit në Sektorin e Standarteve dhe Analizës në Drejtorinë e Standarteve dhe Monitorimit të Cilësisë, Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kontratave në Drejtorinë e Standarteve dhe Monitorimit të Cilsësisë, Specialist i Sektorit të Monitorimit të Kontratave në Drejtorinë e Standarteve dhe Monitorimit të Cilsësisë, Drejtor i

Drejtorisë së Zhvillimit të Prokurimeve, Koordinator i Drejtorisë së Zhvillimit të Prokurimeve, Drejtor i Drejtorisë Teknike, Përgjegjës i Sektorit të Përpunimit të Mallrave dhe Shërbimeve të Posaçme në Drejtorinë Teknike, Specialist i Sektorit të Përpunimit të Mallrave dhe Shërbimeve të Posaçme në Drejtorinë Teknike, Drejtor i Drejtorisë së Shqyrtimit të Ankesave të Prokurimeve të Përqëndruara, Specialist i Drejtorisë së Shqyrtimit të Ankesave të Prokurimeve të Përqëndruara.

Gjatë muajit janar 2019, me urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm nr.251, datë 24.01.2019, është ngritur komisioni *"Ad-Hoc"* dhe është filluar procedura për plotësimin e vendeve të lira të punës për plotësimin e strukturës dhe organikës.

Janë zhvilluar 3 proçedura për plotësimin e vendeve vakante për vitin 2019. Për ndjekjen e procedurave të plotësimit të vendeve të lira të punës në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara, është ngarkuar Komisioni "*Ad-Hoc*", i përbërë nga:

1. Drejtor i Përgjithshëm i ABP-së
2. Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit të Prokurimeve në ABP
3. Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Brendshme.

Në fazën e parë të konkurimit janë plotësuar këto pozicione pune:

- Për vendin vakant të Drejtorit të Drejtorisë së Shqyrtimit të Ankesave, është nënshkruar kontrata individuale e punës me datë 05.03.2019, me kandidatin me profil Jurist.
- Për vendin vakant Koordinator në Drejtorinë e Zhvillimit të Prokurimeve, u nënshkrua kontrata individuale e punës me datë 01.04.2019, me kandidatin me profil Ing.Mekanik.
- Për vendin vakant "Asistent/e e Drejtorit të Përgjithshëm në ABP", me datë 04.03.2019 është lidhur kontrata individuale e punës me punonjësen me profil "Gazetare" – Master shkencor "Marrëdhënie me publikun".

*Procedura e dytë e plotësimit të vendeve vakante të punës në ABP për vitin 2019.*

**I.** Me Urdhër të Brendshëm nr.867 prot., datë 15.05.2019 *"Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara"* të Drejtorit të Përgjithshëm të ABP-së, janë zhvilluar procedurat për plotësimin e 9 (nëntë) vendeve të lira të punës në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara, për pozicionet dhe numrin, si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **1.** | Specialist/e, Sektori i Përpunimit të Mallrave e Shërbimeve të Posacme | 1 (një) |
| **2.** | Specialist/e, Sektori i Standardeve dhe Analizës | 1 (një) |
| **3.** | Përgjegjës/e, Sektori i Përpunimit të Shërbimeve | 1 (një) |
| **4.** | Përgjegjës/e, Sektori i Përpunimit të Mallrave e Shërbimeve të Posacme | 1 (një) |
| **5.** | Koordinator/e, Drejtoria e Zhvillimit të Prokurimeve | 5(pesë) |

Në përfundim të procesit të verifikimit të kandidaturave, janë shpallur fitues:

- Për vendin vakant Koordinator në Drejtorinë e Zhvillimit të Prokurimeve, është nënshkruar kontrata individuale e punës më datë 30.07.2019, me kandidatin me profil Ing.Tekstil.
- Për vendin vakant Specialist në Sektorin e Standardeve dhe Analizës, në Drejtorinë e Standardeve dhe Monitorimit të Cilësisë, është nënshkruar kontrata individuale e punës më datë 20.09.2019, me kandidatin me profil Informatikë Ekonomike.

*Procedura e tretë e plotësimit të vendeve vakante të punës në ABP për vitin 2019.*

**I.** Me Urdhër të Brendshëm nr.1849 prot., datë 12.11.2019 *"Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara"* të Drejtorit të Përgjithshëm të ABP-së, janë zhvilluar procedurat për plotësimin e 10 (dhjetë) vendeve të lira të punës në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara, për pozicionet dhe numrin, si vijon:

| | | |
|---|---|---|
| **1.** | Koordinator/e, Drejtoria e Zhvillimit të Prokurimeve | 4 (katër) |
| **2.** | Përgjegjës/e Sektori, Drejtoria Teknike | 2 (dy) |
| **3.** | Përgjegjës/e, Sektori i Standardeve dhe Analizës, Drejtoria e Standardeve | |

| | | |
|---|---|---|
| | dhe Monitorimit të Cilësisë | 1 (një) |
| **4.** | Specialist/e, Drejtoria Teknike | 1 (një) |
| **5.** | Specialist/e, Drejtoria e Standardeve dhe Monitorimit të Cilësisë | 2 (dy) |

Në përfundim të procesit të verifikimit të kandidaturave të suksesshme, janë njoftuar **6 (gjashtë)** kandidatë për tu paraqitur me qëllim nënshkrimin e kontratës individuale të punës, e konkretisht:

- Për vendin vakant Specialist në Sektorin e Standardeve dhe Analizës, në Drejtorinë e Standardeve dhe Monitorimit të Cilësisë, është nënshkruar kontrata individuale e punës me datë 11.12.2019, me kandidatin me profil Inxhinier Matematike - Fizike.
- Për vendin vakant Specialist në Sektorin e Monitorimit të Kontratave, në Drejtorinë e Standardeve dhe Monitorimit të Cilësisë, është nënshkruar kontrata individuale e punës më datë 11.12.2019, me kandidatin me profil Ekonomist.
- Për vendin vakant Koordinator në Drejtorinë e Zhvillimit të Prokurimeve, është nënshkruar kontrata individuale e punës më datë 11.12.2019, me kandidatin në profil Kimist Ushqimor.
- Për vendin vakant Koordinator në Drejtorinë e Zhvillimit të Prokurimeve, është nënshkruar kontrata individuale e punës me datë 16.12.2019, me kandidatin në profil Ekonomist.
- Për vendin vakant "Specialist" në Sektorin e Përpunimit të Mallrave dhe Shërbimeve të Posaçme, në Drejtorinë Teknike, është nënshkruar kontrata individuale e punës më datë 11.12.2019, me kandidatin në profil Informatikan i specializuar në Ekonomi.
- Për vendin vakant "Specialist" në Sektorin e Përpunimit të Mallrave, në Drejtorinë Teknike, është nënshkruar kontrata individuale e punës me datë 16.12.2019, me kandidatin në profil Jurist.

-Organika nuk është plotësuar me 7 punonjës nga të cilët: 1 Sekretar I Drejtorit të Përgjithshëm, 1 Specialist Sektori I Përpunimit të Mallrave-Drejtoria Teknike, 1 Përgjegjës Sektori I përpunimit të mallrave e shërbimeve të posaçme-Drejtoria Teknike, 1 Kordinator Drejtoria e Zhvillimit të Prokurimeve, 1 Kordinator Drejtoria e Zhvillimit të Prokurimeve, 1 Përgjegjës i Sektorit të Standardeve dhe Analizës - Drejtoria e Standardeve dhe Monitorimit të Cilësisë, 1 Specialist - Drejtoria e Shqyrtimit të Ankesave.

Mosplotësimi I organikës së miratuar sipar Urdhrit të Kryeministrit nr.46, datë 09.03.2018 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjensisë së Blerjeve të Përqëndruara"perbën risk për mosrealizim të objektivave dhe të detyrave që ka kjo Agjensi.

Nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, gjatë vitit 2019 janë publikuar 3 njoftime për plotësimin e vendeve të lira të punës.
Pozicione pune vakante më datë 31.12.2019, janë gjithsej 7 :

| | | |
|---|---|---|
| **1.** | Koordinator – Drejtoria e Zhvillimit të Prokurimeve | 2(dy) |
| **2.** | Përgjegjës i Sektorit të Përpunimit të Mallrave e Shërbimeve të Posacme - Drejtoria Teknike | 1(një) |
| **3.** | Përgjegjës i Sektorit të Standardeve dhe Analizës - Drejtoria e Standardeve dhe Monitorimit të Cilësisë | 1(një) |
| **4.** | Specialist – Sektori i Përpunimit të Mallrave - Drejtoria Teknike | 1(një) |
| **5.** | Specialist - Drejtoria e Shqyrtimit të Ankesave | 1(një) |
| **6.** | Sekretar i Drejtorit të Përgjithshëm | 1(një) |

**2. Korrespodencat zyrtare me Autoritetet Kontraktore për bashkërendimi e punës për mbledhjen e përpunimin e të dhënave për prokurimet publike. Respektimi i afateve kohore për dërgimin nga Autoritetet Kontraktore të të dhënat teknike e sasiore dhe fondin përkatës, për mallrat e shërbimet përkatëse**

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, organizohet dhe funksionon si institucion qendror, person juridik publik, buxhetor, në varësi të Ministrit të Brendshëm. Misioni i Agjencisë si organ qendror blerës, i autorizuar me vendim të Këshillit të Ministrave, është kryerja e procedurave të prokurimit të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të kryeministrisë, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit dhe të ministrave të linjës, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve, të përcaktuara në aktin nënligjor përkatës. Përjashtimisht, Agjencia mund të zhvillojë procedurë prokurimi edhe kur kërkohet nga një autoritet ose një grup autoritetesh kontraktore, për mallra ose shërbime, që nuk i janë ngarkuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë janë ato të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.81 datë 14.02.2018 "*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara*" dhe vendimit KM nr.82 datë 14.02.2018 "*Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara*", të Këshillit të Ministrave. Referuar rregullores se Agjencise se Blerjeve te Perqendruara e miratuar nga Ministri i Brendshem me urdhrin nr.365 datë 16.04.2019 "*Per miratimin e rregullores per metodat e brendshme të punes dhe per sjelljen e personelit te agjencise se blerjeve të përqendruara*" Drejtoria Teknike ka për detyrë të propozoje tek Drejtori i Përgjithshëm, dërgimin e njoftimit në Agjencinë e Prokurimit Publik, të autoriteteve kontraktore të cilat paraqesin kërkesat për prokurim, përtej afateve të përcaktuara në njoftimet e ABP-së ose pas publikimit të procedures. Përgatitja dhe administrimi i korrespodencën me autoritetet kontraktore, kryhet nga specialistët e sektorit gjatë mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për prokurimet publike që zhvillon ABP-ja si organ qendror blerës, për praktikat e caktuara nga eprorët.

Per vitin 2017 referuar kërkesave të ligjit për PP si dhe VKM nr.28 datë 14.01.2015 "*Për ngarkimin e Ministrisë së Punësve të Brendshme, si organ blerës për kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrisve dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime*" Ministra e Brendshme, drejtoria e Prokurimeve të Përqëndruara me shkresën nr.88 datë 20.01.2017 si dhe shkresën nr 88/1 datë 23.01.2017 ka dërguar kerkesën për dërgimin e të dhënave teknike, sasiore si dhe fondet përkatëse për procedurat që do të zhvillohen në mënyrë të përqëndruar, drejtuar intitucioneve përkatëse, per nje afat deri ne 31 janar te vitit 2017. Drejtoria e Prokrime të Përqëndruara ka kryer gjithësej 37 procedura prokurimi në vlerën 3,830,740,684 lekë për llogari të autoriteteve të përcaktuara ne VKM nr 28 datë 14.01.2015. Nga auditimi për vitn 2017 konstatoi se përsa i përket grumbullitmit të të dhënave teknike, sasiore dhe fondit përkatës për tu prokuruar nga DPP, Autoritetet Kontraktuore (AK) nuk kanë respektuar afatin e dërgimit të kërkesave për prokurimin brenda datën 31.01.2017 referuar VKM nr.28 datë 14.01.2015, veprim i ky i cilli për pasojë ka sjell vonesa ne kryerjen e procedurave te prokurimit nga Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara per llogari te institucioneve.
Grupi auditimit konstatoi se, nga ana e DBP edhe pse Autoritetet Kontraktuore nuk i kanë sjell të dhenat teknike, sasiore si dhe fondet përkatëse për nevojat e tyre apo rastet kur ka pasur vonesa, nuk ka derguar asnje njoftim, tek Agjencia e Prokurimit Publik.

Për vitin 2018 – 2019, referuar kërkesave të ligjit për PP, VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te PP" i ndryshuar dhe VKM nr.82 datë 14.02.2018 "Për ngarkimin e ABP për kryerjen e procedurave të prokurimit të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrive të linjës...", ABP për vitin 2018 ka kryer 33 procedura prokurimi ne vlerën 1,557,707,046 lekë dhe për vitin 2019 janë kryer 93 procedura prokurimi ne vlerën 5,892,723,876 lekë për llogari të autoritetve te përcaktuara ne VKM e sipërpërmendur.
Nga auditimi për vitn 2018 konstatoi se përsa i përket grumbullitmit të të dhënave teknike, sasiore dhe fondit përkatës për tu prokuruar nga APB, Autoritetet Kontraktuore (AK) nuk kanë respektuar afatin e dërgimit të kërkesave për prokurimin brenda datën 28.02.2018 referuar VKM 82 datë 14.02.2018. Gjithashtu konstatohet se nga ana e APB nuk janë marrë masat e duhura dhe nuk është

dërguar në APP njoftimi për AK të cilat nuk kanë respektuar afatet, sic parashikohet në pikën 4 dhe 5 e VKM nr.82, datë 14.02.2018 "Për ngarkimin e ABP për kryerjen e procedurave të prokurimit..." si dhe rekomandimet e APP dërguar ne AK me shkresën nr.2368, datë 20.02.2018

Për vitin 2019 ABP në zbatim të VKM 52/2018, i ndryshuar, në cilësinë e Organit Qëndror Blerës, ka njoftuar të gjitha autoritetet kontraktuore zbatuese të këtij vendimi me shkresen nr.41 datë 09.01.2019, njoftimin për dërgimin sa më shpejt por jo më vonë se data 15 Janar 2019, të të dhënave tëknike dhe sasiore si dhe fondet përkatëse për mallrat dhe shërbimet që do të prokurohen nëpërmjët Marrëveshjes Kuadër ose Kontraës Publike, për secilin nga objektet e prokurimit.
Grupi auditimit konstatoi se edhe për vitin 2019, autoritet kontraktuore lidhur me dërgimin e kërkesave mbi të dhënat teknike, sasiore dhe fondet përkatëse të cilat do të prokurohen , nuk kanë respektuar afatin kohor të përcaktuar nga organi qëndror blerës. Mosrespektimi i afateve mbi dërgimin e të dhenave të sipërpërmendura nuk është respektuar nga këto autoritet kontraktuaore për procedurat e prokurimit si më poshtë vijon:

- *Blerje materiale të ndryshme për pastrim;*
- *Blerje Tonera;*
- *Blerje Karburanti, përvec vajgurit JET A1;*
- *Blerje pajisjesh laboraterike;*
- *Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi;*
- *Shërbime mirëmbajtje dhe lyerje ndërtesash;*
- *Sigurim automjetesh.*

Disa prej autoriteteve kontraktuore të cilët kanë dërguar kërkesat e tyre ne lidhje me përcaktimet teknike, sasiore dhe fondet përkatëse janë si me poshtë vijon:
1.Ministria e Drejtesisë , ka dërguar kërkesën pranë ABP, me email me datë 17.01.2019;
2.Ministria e Financës dhe Ekonomise, ka dërguar kërkesën pranë ABP, në rruge shkresore me shkresën nr.214 datë 21.01.2019;
3.Drejtoria e Përgjitshme e Doganave, ka dërguar kërkesen pranë ABP me shkresën nr.204 datë 21.07.2019;
4.Ministria e Mbrojtjes , ka dërguar kërkesën pranë ABP me shkresën nr.210 datë 21.01.2019;
5.Ministria e Shëndetësis ë dhe Mbrojtjes Sociale, ka dërguar kërkesën pranë ABP me shkresën nr. 256 datë 25.01.2016;
6.Ministria e Brendshme ka dërguar kërkesën ne menyre elektronike, me datë 07.02.2019;
7.Qendra Kombetare e Biznesit, ka dërguar kërkesën pranë ABP me shkresën nr.320 atë 08.02.2019;
8.Ministria e Infrastruktures dhe Energjisë ka dërguar kërkesën pranë ABP, në rruge elektronike më datë 04.03.2019;
9.Agjencia Kombetare e Barnave dhe Pajisjeve Mjeksore ka dërguar kërkesën pranë ABP në rruge elektronike më datë 04.03.2019;
10.Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), ka dërguar kërkesën pranë ABP ne mënyre elektronike më datë 22.01.2019..............etj.

Nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara me shkresën nr.458 datë 06.03.2019 si dhe me shkresën nr.1848 datë 12.11.2019 i është drejtuar Agjencise së Prokurimit Publik, mbi informimin e vonesave nga Autoritetet Kontraktuore mbi dergimin e te dhenave teknike, sasiore si dhe percaktimin e fondit përkatës për secilen nga procedurat e prokurimit, afat i cili nuk duhet të tejkalonte datën 15 janar të vitit 2019.

Sa i përkët kërkesave të paraqitura nga AK sipas VKM nr.82, datë 14.02.2019, për kryerjen nga ABP e procedurave të prokurimit publik grupi i auditimit konstatoi se ABP kërkesat e AK, nuk i ka të regjistruara te gjitha dhe të evidentuara në një "Database" ne forme e një regjistri, në të cilin

të kryej regjistrimin e të dhënave kryesore që kërkon një procedure prokurimi, i cili ti shërbeje për grupin kërkesave sipas objektit të njëjtë të prokurimit dhe fondit total të objektit të prokurimit, në mënyrë që ABP të realizoje në kohe dhe me eficence procesin e prokurimit në ndihmë të AK, duke realizuar kështu misionin dhe përgjegjësitë e ABP për të cilën është krijuar, në zbatim kjo të kërkesave të përcaktuara në nenin 2 pikat vijuese të VKM nr.914 datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të PP" i ndryhuar dhe VKM nr.82 datë 14.02.2014 "Për ngarkimin e ABP për kryerjen e procedurave të prokurimit të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive, institucioneve ne varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës.."*

*Në lidhje me këtë gjetje e pasqyruara edhe në Projekt Raportin e Auditimit, ABP ka paraqitur observacione si me poshtë:*

*Në lidhje me këtë konstatim, ju sqarojmë se me Urdhërin e Brendshëm nr.10357/7prot. datë 06.05.2019 "Për miratimin e "Plan Veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit për periudhën Janar – Dhjetor 2018, në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara" të titullarit të ABP-së, në pikën 3 të tij, është përcaktuar si vijon:*
*"3. Krijuar dhe përfunduar baza e të dhënave "Database" në format rregjistri në "excel" për procedurat e zhvilluara në vitin 2018 nga organi qendror blerës ABP.*
*Nga muaji Janar 2019 e në vijim, është krijuar dhe përditësohet baza e të dhënave "Database" në format rregjistri në "excel", për procedurat që do të zhvillohen gjatë vitit 2019 nga organi qendror blerës ABP. Kjo "Database" shërben për rregjistrimin dhe evidentimin e kërkesave për prokurim, të dërguara nga autoritetet kontraktore, si dhe evidentimin e fazave kryesore nëpërmjet të cilave kalon një procedurë prokurimi deri në finalizimin e saj (me realizim ose anulim), ku përfshihen edhe të dhënat e formatit elektronik të rregjistrit të parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike. Në këtë "Database" janë përfshirë disa të dhëna, të cilat përditësohen nga strukturat përgjegjëse në vazhdimësi, e konkretisht:*

*a) Objekti i prokurimit, ndarja në Lote, informacion nëse është Kontratë Publike apo Marrëveshje Kuadër, si dhe afati ose kohëzgjatja e tyre;*
*b) Autoritetet Kontraktore që kanë dërguar kërkesë për prokurim, data dhe mënyra e dërgimit të kërkesës në ABP (e-mail, shkresë zyrtare);*
*c) Fondi limit i dërguar nga secili autoritet kontraktor, per secilin Lot ose objekt prokurimi, si dhe fondi total i parashikuar për cdo procedurë prokurimi;*
*d) Numri dhe data e urdhërit të prokurimit, emrat e anëtarëve të njësisë së prokurimit, emrat e anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, emrat e anëtarëve të komisionit të shqyrtimit të ankesave;*
*e) Ankesat për dokumentat e tenderit dhe informacion nëse janë marrë parasysh për ndryshimin e DST; ankesat për vlerësimin e ofertave dhe informacion nëse janë marrë parasysh për ri-vlerësimin e ofertave; ankesat në KPP, informacion mbi vendimmarrjen dhe zbatimin e vendimeve të KPP-së;*
*f) Data e publikimit të procedurës, data e zhvillimit të procedurës, data e vlerësimit të ofertave, data e paraqitjes së ankesave në ABP dhe KPP, data e publikimit të njoftimit të fituesit ose anullimit, data e lidhjes së marrëveshjes kuadër, data e dërgimit të autorizimit për lidhje kontrate në autoritetet kontraktore, data e formularit të njoftimit të kontratës së nënshkruar;*
*g) Emrat e ofertuesve pjesëmarrës dhe vlerat përkatëse të ofertave, për cdo Lot ose procedurë prokurimi, emrat e ofertuesve të kualifikuar dhe renditja e tyre, emrat e ofertuesve të skualifikuar, emrat e ofertuesve fitues.*

*Struktura përgjegjëse: Personat përgjegjës për prokurimin anëtarë të njësive të prokurimit, Drejtoria e Zhvillimit të Prokurimeve, Drejtoria e Shqyrtimit të Ankesave.*
*Afati i përcaktuar: Krijuar baza e të dhënave që nga muaji Janar 2019 dhe përditësimi në vazhdimësi. "*

*Përsa më sipër, po ju vendosim në dispozicion "Database" në format rregjistri në "excel" për procedurat e zhvilluara në vitin 2018 dhe në vitin 2019, nga organi qendror blerës ABP (format elektronik).*

*Nga shqyrtimi i këtyre observacioneve dolem me konkluzionin se, këto observacione qendrojne pjeserisht pasi ABP në muajin janar 2019, ka krijuar një data-basë ne forme e një regjistri elektronik për regjistrimin e të gjitha kërkesat e ardhura nga Autoritetet Kontraktore. Por në këtë data-basë nuk janë regjistruar dhe evidentuar plotësisht të gjitha detajet dhe statistikat e prokurimit si, referencat e shkresave të ardhura nga AK, objektin e prokurimit, fondin limit, formën e prokurimit, etj*

**3. Unifikimi i specifikimeve teknike për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, përllogaritja e fondit limit dhe përcaktimi i të dhënave sasiore për mallrat dhe shërbimet, që do të prokurohen, para publikimit të tenderit**

Në zbatim të VKM-së nr. 82, datë 14.02.2018, "Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime", i ndryshuar, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës, ngarkohet të zhvillojë prokurimin e fondeve buxhetore, me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrisë e të ministrive të linjës, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, është krijuar me VKM-në nr. 81 datë 14.02.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara".

Drejtoria e Standardeve dhe Monitorimit të Cilësisë, (DSMC), pjesë e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, e cila bazuar në pikën 6 të VKM-së nr. 82/2018, i ndryshuar, si dhe referuar Rregullores "Për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara (ABP)", bën unifikimin e specifikimeve teknike për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendas a të huaj, e të hartojë katalogët e standardeve, të cilët miratohen me urdhër të ministrit të Brendshëm. Gjithashtu, DSMC bën unifikimin e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve me specifikime teknike të unifikuara.

- **Për vitin 2017**, ish-Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara, ka bërë unifikimin e çmimeve për njësi nëpërmjetë testimit të tregut bazuar në specifikimet teknike të unifikuara, për disa procedura prokurimi, konkretisht për:

1. **"**Blerje pajisje elektronike dhe telekomunikacioni". Në këtë procedurë prokurimi janë përfshirë pajisje si: UPS; Skanera, Projektor, Fotokopje, Printera, Sëitch dhe Router). Testimi i tregut është bërë bazuar në Specifikimet Teknike "Pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për përdorim zyre", të hartuara nga Agjencia Kombëtare e Shoqerisë së Informacionit (AKSHI), në dhjetor të vitit 2016.
2. "Blerje materialesh të ndryshme për pastrim" (gjithësej 137 artikuj);
3. "Blerje uniformash, veshmbathjesh dhe elementesh të tjera, përbërëse të tyre" (gjithësej 88 artikuj);
4. "Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash" (gjithësej 79 artikuj);
5. "Blerje pjesësh ndërrimi për automjete, për shërbimet profilaktike, përveç filtrave të automjeteve", ndarë në 3 (tre) Lote:

- Blerje goma për automjete (gjithësej 355 artikuj);

- Blerje bateri për automjete (gjithësej 36 artikuj);
- Blerje Vajra lubrifikant (gjithësej 75 artikuj);

**6.** "Sigurim automjetesh", ndarë në 2 (dy) Lote:

- Loti I. "Sigurim të detyrueshëm të mjeteve motorrike TPL"
- Loti II. "Sigurim kasko të mjeteve motorrike".

**7.** "Blerje tonerash" (gjithësej 540 artikuj);

**8.** "Blerje materialesh kancelarie", ndarë në 2 (dy) Lote:

- Loti I. "Blerje kancelari" (gjithësej 353 artikuj);
- Loti II. "Blerje letër" (gjithësej 30 artikuj).

➢ Për 6 – mujorin e parë të vitit 2018, nga ish-Drejtoria e Përgjithshme e Prokurimeve të Përqendruara, është vepruar si më poshtë:

**1)** Në lidhje me objektin e prokurimit "**Sigurim automjetesh**", është ngritur grupi i punës për testimin e tregut me urdhrin e titullarit nr. 1590 prot. datë 28.12.2017. Në informacionin e paraqitur nga grupi i punës titullarit, me memon nr. 1590/1 prot. datë 25.01.2018, (dhe relacion) është miratuar nga ky i fundit unifikimi i çmimeve për njësi, bazuar në specifikimet teknike të unifikuara për këtë objekt prokurimi. Kjo procedure prokurimi është ndarë në 2 (dy) Lote:

- Loti I. "Sigurim të detyrueshëm të mjeteve motorrike TPL"
- Loti II. "Sigurim kasko të mjeteve motorrike".

Gjatë testimit të tregut është mbajtur komunikimi edhe me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, i cili është autoritetet që miraton rregullat për përcaktimin e kushteve të përgjithshme të sigurimit të detyrueshëm dhe nivelin e rezervave teknike dhe provigjoneve. Nga ky autoritet është vendosur në dispozicion baza ligjore Vendimi i AMF-së nr. 25, datë 30.03.2017 "Për miratimin e tabelës së primit të rrezikut për përllogaritjen e provigjoneve teknike për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik për dëmet qe u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti", ku në pikën 1 ka vendosur: "*Miratimin e tabelës së primit të rrezikut për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësisë së pronarit të mjetit motorik për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti për kontratat TPL të sigurimit, tabela 1 bashkëlidhur këtij vendimi.".*

**2)** Në lidhje me objektin e prokurimit "Blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike", është ngritur grupi i punës për testimin e tregut, me urdhrin e titullarit nr. 1586 prot. datë 28.12.2017. Në informacionin e paraqitur nga grupi i punës titullarit, me memon nr. 1586/4 prot. datë 23.03.2018, (dhe relacion) është miratuar nga ky i fundit rishikimi i specifikimeve teknike të unifikuara dhe unifikimi i çmimeve për njësi, për këtë objekt prokurimi. Kjo procedure prokurimi është ndarë në 3 (tre) Lote:

- Blerje goma për automjete (gjithësej 309 artikuj);
- Blerje bateri për automjete (gjithësej 36 artikuj);
- Blerje Vajra lubrifikant (gjithësej 51 artikuj).

Për këtë objekt prokurimi, rishikimi dhe unifikimi i specifikimeve teknike është bërë me specialist fushe, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

**3)** Në lidhje me objektin e prokurimit "Blerje tonerash" është ngritur grupi i punës për testimin e tregut, me urdhrin e titullarit nr. 1589 prot. datë 28.12.2017. Në informacionin e paraqitur nga grupi i punës titullarit, me memon nr. 1589/1 prot. datë 29.01.2018, (dhe relacion) është miratuar nga ky i fundit unifikimi i çmimeve për njësi, bazuar në specifikimet teknike të unifikuara për këtë objekt prokurimi (gjithësej 540 artikuj).

**4)** Në lidhje me objektin e prokurimit "Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash" është ngritur grupi i punës për testimin e tregut, me urdhrin e titullarit nr. 1587 prot. datë 28.12.2017.

Në informacionin e paraqitur nga grupi i punës titullarit, me memon nr. 1587/3 prot. datë 06.02.2018 (dhe relacion) është miratuar nga ky i fundit unifikimi i çmimeve për njësi, bazuar në specifikimet teknike të unifikuara për këtë objekt prokurimi (gjithësej 74 artikuj).

**5)** Në lidhje me objektin e prokurimit **"**Blerje karburanti, përveç vajgurit Jet A1", me shkresën nr. 295 prot. datë 13.03.2018 i është bërë kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit për standardet e karburantit, të cilat i ka dërguar me shkresën nr. 311/1 prot. datë 27.03.2018.

- Gjatë 6 – mujorit të dytë të vitit 2018, nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, është vepruar si më poshtë:

**1)** Në lidhje me objektin e prokurimit "Blerje materialesh të ndryshme për pastrim", është ngritur grupi i punës për unifikimin e specifikimeve teknike, me urdhrin e titullarit nr. 970 prot. datë 02.10.2018. Në informacionin e paraqitur nga grupi i punës titullarit, me memon nr. 909/3 prot. datë 23.11.2018 (dhe relacion) është miratuar nga ky i fundit unifikimi i specifikimeve teknike. Me tej, me urdhrin e titullarit nr. 970/1 prot. datë 23.11.2018 është ngritur grupi i punës për testimin e tregut, bazuar në specifikimet teknike të unifikuara. Me memon nr. 970/2 prot. datë 17.12.2018 (dhe relacion) paraqitur nga grupi i punës titullarit, ky i fundit ka miratuar unifikimin e çmimeve për njësi, bazuar në specifikimet teknike të unifikuara për këtë objekt prokurimi.
Për këtë objekt prokurimi, unifikimi i specifikimeve teknike është bërë me specialist fushe, nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
Për këtë objekt prokurimi janë organizuar takime me operatorë ekonomikë, për përmirësimin e specifikimeve teknike dhe unifikimin e tyre.

**2)** Në lidhje me objektin e prokurimit "Sigurim automjetesh", është ngritur grupi i punës për unifikimin e specifikimeve teknike, me urdhrin e titullarit nr. 1142 prot. datë 05.11.2018 për unifikimin e specifikimeve teknike dhe hartimin e katalogut. Në informacionin e paraqitur nga grupi i punës titullarit, me memon nr. 1232 prot. datë 26.11.2018 (dhe relacion) është miratuar unifikimi i specifikimeve teknike. Me tej, me urdhrin e titullarit nr. 1142/1 prot. datë 04.12.2018 është ngritur grupi i punës për testimin e tregut, bazuar në specifikimet teknike të unifikuara. Me memon nr. 1142/2 prot. datë 18.12.2018 (dhe relacion) paraqitur nga grupi i punës titullarit, ky i fundit ka miratuar unifikimin e çmimeve për njësi, bazuar në specifikimet teknike të unifikuara për këtë objekt prokurimi.
Për këtë objekt prokurimi, unifikimi i specifikimeve teknike është bërë me specialist fushe, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
Për këtë objekt prokurimi janë organizuar takime me operatorë ekonomikë, për përmirësimin e specifikimeve teknike dhe unifikimin e tyre.

**3)** Në lidhje me objektin e prokurimit "Blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike", është ngritur grupi i punës për unifikimin e specifikimeve teknike, me urdhrin e titullarit nr. 1060 prot. datë 18.10.2018 për unifikimin e specifikimeve teknike dhe hartim katalogu. Në informacionin e paraqitur nga grupi i punës titullarit, me memon nr. 1060/2 prot. datë 27.11.2018 (dhe relacion) është miratuar nga ky i fundit unifikimi i specifikimeve teknike, për këtë objekt prokurimi. Me tej, me urdhrin e titullarit nr. 1060/3 prot. datë 04.12.2018 është ngritur grupi i punës për testimin e tregut, bazuar në specifikimet teknike të unifikuara. Me memon nr. 1060/6 prot. datë 15.02.2019 (dhe relacion) paraqitur nga grupi i punës titullarit, ky i fundit ka miratuar unifikimin e çmimeve për njësi, bazuar në specifikimet teknike të unifikuara për këtë objekt prokurimi.
Për këtë objekt prokurimi, unifikimi i specifikimeve teknike është bërë me specialist fushe (inxhinier mekanik), nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit si dhe janë marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, standardet si më poshtë:

- S SH EN 50342-1: *(Bateritë lëshuese të akumulatorëve me plumb — Pjesa 1: Kërkesa të përgjithshme dhe metodat e provës);*
- S SH ISO 24254: *(Lubrifikantët, vajrat industrial dhe produktet e ngjashme (klasa L) - Familja E (vajrat e motorëve me djegie të brendshme) - Specifikimet e vajrave që përdoren në motorët me cikël katër kohësh të motoçikletave me benzinë dhe të asociuar me kamio (kategoritë EMA dhe EMB).*

Për këtë objekt prokurimi janë organizuar takime me operatorë ekonomikë, për përmirësimin e specifikimeve teknike dhe unifikimin e tyre.

**4)** Në lidhje me objektin e prokurimit "Blerje tonerash": është ngritur grupi i punës për unifikimin e specifikimeve teknike, me urdhrin nr. 1028 prot. datë 12.10.2018 për unifikimin e specifikimeve teknike dhe hartimin e katalogut. Në informacionin e paraqitur nga grupi i punës titullarit, me memon nr. 1028/2 prot. datë 04.12.2018 (dhe relacion) është miratuar nga ky i fundit unifikimi i specifikimeve teknike, për këtë objekt prokurimi. Me tej, me urdhrin e titullarit nr. 1028/4 prot. datë 04.12.2018 është ngritur grupi i punës për testimin e tregut, bazuar në specifikimet teknike të unifikuara. Me memon nr. 1028/8 prot. datë 16.01.2019 (dhe relacion) paraqitur nga grupi i punës titullarit, ky i fundit ka miratuar unifikimin e çmimeve për njësi, bazuar në specifikimet teknike të unifikuara për këtë objekt prokurimi.
Për këtë objekt prokurimi janë organizuar takime me operatorë ekonomikë, për përmirësimin e specifikimeve teknike dhe unifikimin e tyre.

**5)** Në lidhje me objektin e prokurimit "Blerje materialesh kancelarie" është ngritur grupi i punës për unifikimin e specifikimeve teknike, me urdhrin nr. 1053 prot. datë 18.10.2018 për unifikimin e specifikimeve teknike dhe hartimin e katalogut. Në informacionin e paraqitur nga grupi i punës titullarit, me memon nr. 1053/4 prot. datë 24.12.2018 (dhe relacion) janë unifikuar specifikimet teknike për këtë objekt prokurimi dhe është bërë unifikimi i çmimit për njësi (testimi i tregut).
Në lidhje me këtë objekt prokurimi është ngritur urdhri nr. 1053/3 prot. datë 04.12.2018 për testimin e tregut. Më tej, me memon nr. 1053/5 prot. datë 25.01.2019 është bërë unifikimi i çmimit për njësi (testimi i tregut), për Lotin III "Blerje Letër".
Për këtë objekt prokurimi janë organizuar takime me operatorë ekonomikë, për përmirësimin e specifikimeve teknike dhe unifikimin e tyre.

**6)** Në lidhje me objektin e prokurimit "Blerje materialesh të buta dhe veshmbathje": është ngritur grupi i punës për unifikimin e specifikimeve teknike, me urdhrin nr. 663/4 prot. datë 17.07.2018 për unifikimin e specifikimeve teknike. Në informacionin e paraqitur nga grupi i punës titullarit, me memon nr. 663/11 prot. datë 04.10.2018, (dhe relacion) është miratuar nga ky i fundit unifikimi i specifikimeve teknike, për këtë objekt prokurimi. Është ngritur urdhri nr. 663/10 prot. datë 25.09.2018 për testimin e tregut. Më tej me memon nr. 663/12 prot. datë 08.10.2018 (dhe relacion) paraqitur nga grupi i punës titullarit, ky i fundit ka miratuar unifikimin e çmimeve për njësi, bazuar në specifikimet teknike të unifikuara për këtë objekt prokurimi.
Unifikimi i specifikimeve teknike është bërë me specialist fushe, nga Universiteti Politeknik i Tiranës, Departamenti i Tekstilit dhe Modës si dhe janë marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, standardet si më poshtë:

- S SH EN ISO 13688:2013 "Veshje mbrojtëse- kërkesa të përgjithshme".
- S SH EN ISO 22610:2006 "Veshje kirurgjikale, veshje për gra dhe kostume të pastrimit me ajër, që përdoren si pajisje mjekësore për pacientet, stafin klinik dhe pajisjet, metoda e provës për të përcaktuar rezistencën në penetrimin në të lagur të baktereve".
- S SH EN 374-1:2003 "Doreza mbrojtëse kundër kimikateve dhe mikro-organizmave-pjesa 1: terminologjia dhe kërkesat e përformancës".

- S SH EN ISO 22612:2006 "Veshje për mbrojtjen nga agjentët infektues.-është metoda e provës për rezistencën ndaj penetrimit mikrobial në të that".
- S SH ENV 14237:2005 "Tekstilet në sistemin e ruajtjes së shëndetit".

Me memon nr. 663/18 prot. datë 18.02.2019, në vijim të memos nr. 663/17 prot. datë 13.02.2019 dhe sipas porosisë së titullarit, u bë grupimi i artikujve, duke i kategorizuar në objektin e prokurimit "Blerje materialesh të buta dhe veshmbathje" ndarë në 3 (tre) Lote: Loti I: "Blerje materiale të buta", Loti II: "Blerje materiale të buta kirurgjie" dhe Loti III: "Blerje veshmbathje" dhe në objektin e prokurimit *"Blerje uniformash të ndryshme dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre" ku janë përfshirë 15 (pesëmbëdhjetë) artikuj, (uniforma për personelin mjekësor apo veshje për përdorim nga institucione spitalore).*

**7)** Në lidhje me objektin e prokurimit "Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash": është ngritur grupi i punës për unifikimin e specifikimeve teknike, me urdhrin nr. 857/4 prot. datë 24.09.2018 për unifikimin e specifikimeve teknike dhe hartim katalogu. Në informacionin e paraqitur nga grupi i punës titullarit, me memon nr. 593 prot. datë 02.04.2019 (dhe relacion) është miratuar nga ky i fundit unifikimi i specifikimeve teknike, për këtë objekt prokurimi. Më tej me urdhrin nr. 593/1 prot. datë 03.04.2019 është ngritur grupi i punës për testimin e tregut, bazuar në specifikimet teknike të unifikuara. Me memon nr. 593/2 prot. datë 10.04.2019 (dhe relacion) paraqitur nga grupi i punës titullarit, ky i fundit ka miratuar unifikimin e çmimeve për njësi, bazuar në specifikimet teknike të unifikuara për këtë objekt prokurimi.
Unifikimi i specifikimeve teknike është bërë me specialista fushe, nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe janë marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, (DPS), standardet si më poshtë:

- DS CEN/TR 14073-1:2004 *(Mobilje zyrash - Ruajtja e mobiljeve - Pjesa 1: Përmasat)*;
- SSH EN 14073-2:2004 *(Mobileri për zyra - Mobileri për ruajtje - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë);*
- DS CEN/TR 14699:2004 *(Mobilje zyre- Terminologjia);*
- DS CEN/TS 16209:2011 *(Mobilje - Sqarimet për vetitë e sipërfaqeve të mobiljeve);*
- SSH EN 12529:1998 *(Rrotat dhe rrotullimet - Rrotat për mobiljet - Rrotat për karriget rrotulluese – Kërkesat);*
- SSH EN 1335-1:2000/AC:2002 *(Mobilje zyrash - Karige pune për zyrat - Pjesa 1: Dimensionet - Përcaktimi i dimensioneve);*
- SSH EN 1335-2:2009 *(Pajisje për zyrat - Karrike pune për zyrat - Pjesa 2: Kërkesa të sigurisë);*
- SSH EN 14873-1:2005 *(Aktivitetet për lëvizjen e mobiljeve - Ruajtja e mobiljeve dhe sendeve personale për individët privatë - Pjesa 1: Specifikim për ruajtjen e objektit dhe masa në lidhje me ruajtjen);*
- *SSH EN 15338:2007+A1:2010 (Aksesorët metalik për mobiljet - Fortësia dhe jetëgjatësia e elementëve dhe komponentëve të tyre gjatë tërheqjes);*
- SSH EN 15706:2009 *(Aksesorët metalik për mobiljet - Fortësia dhe jetëgjatësia e aksesorëve rrëshqitës të dyerve rrëshqitëse dhe paneleve rrotullues);*
- SSH EN 16014:2011 *(Aksesorët metalik për mobiljet - Fortësia dhe jetëgjatësia e mekanizmave mbyllës);*
- SSH EN 527-1:2011 *(Mobilje zyrash - Tavolinat e punës dhe tryezat - Pjesa 1: Përmasat);*
- SSH EN 527-2:2016 *(Mobilje për zyra - Tavolina pune - Pjesa 2: Kërkesat e sigurisë, fortësisë dhe jetëgjatësisë).*

**8)** Në lidhje me objektin e prokurimit "Blerje karburanti, përveç vajgurit Jet A1", me shkresën nr. 1164 prot. datë 13.11.2018 i është bërë kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit për standardet e karburantit, të cilat i ka dërguar me shkresën nr. 1164/1 prot. datë 19.11.2018.

*Gjatë vitit 2019:*

Referuar VKM-së nr. 82, datë 14.02.2018, i ndryshuar, si dhe udhëzimit të APP-së nr. 8 datë 20.02.2018, i ndryshuar, me memon nr.791 prot. datë 03.05.2019 të DSMC-së i është paraqitur titullarit, mundësia për unifikimin e specifikimeve teknike për disa objekte prokurimi, konkretisht për: Blerje automjetesh; Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh; Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi; Shërbim i ruajtjes dhe i sigurisë fizike; Blerje artikujsh ushqimorë; Blerje pajisjesh kondicionimi; në të cilën, titullari ka shtuar edhe objektin e prokurimit "*Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi*", përveç atyre të propozuara më sipër.

**1)** Në vijim, në lidhje me objektin e prokurimit "Blerje Automjetesh", në informacionin e paraqitur nga grupi i punës titullarit, me memon nr. 1290/3 prot. datë 30.07.2019, (dhe relacion) është miratuar nga ky i fundit unifikimi i specifikimeve teknike, për këtë objekt prokurimi, për 6 (gjashtë) lloje automjetesh. Më tej, me memon nr. 1375/1 prot. datë 26.08.2019, (dhe relacion) paraqitur nga grupi i punës titullarit, ky i fundit ka miratuar unifikimin e çmimeve për njësi, referuar testimit të tregut, bazuar në specifikimet teknike të unifikuara për këtë objekt prokurimi, për 3 (tre) lloje automjetesh.

Unifikimi i specifikimeve teknike është bërë me specialist fushe, inxhinier mekanik, pjesë e strukturës së ABP-së.

Vlen për tu përmendur se grupi i punës ka bërë unifikimi i çmimit për njësi për 3 (tre) lloje automjetesh duke u mbështetur në:

- unifikimin e specifikimeve teknike, të miratuara me memon nr. 1290/3 prot. datë 30.07.2019;
- ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë, gjatë testimit të tregut;
- kërkesat e autoriteteve kontraktore, për vitin 2019.

**2)** Në lidhje me objektin e prokurimit "Blerje karburant, përvec Jet A1", me shkresën nr. 1164 prot. datë 13.11.2018 i është bërë kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit për standardet e karburantit, të cila kjo e fundit i ka dërguar me shkresën nr. 1164/1 prot. datë 19.11.2018. Me shkresën protokolluar me tonën me nr. 1298/1 prot. datë 17.07.2019 nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit është dërguar standardi SSH ISO 8217:2017 "Produkte nafte - Lëndë djegëse (Klasa F) - Specifikimet e lëndës djegëse detare (të marinës)".

Referuar dy shkresave të sipër cituara, të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, në lidhje me objektin e prokurimit "Blerje karburanti, përveç vajgurit Jet A1", me shkresën tonë nr. 2069 prot. datë 19.12.2019, "Kërkesë për standardet në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt "Blerje karburanti, përveç vajgurit Jet A1", me qëllim realizimin e kësaj procedure prokurimi për vitin 2020, i jemi drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, ku i kërkojmë informacion lidhur me statusin aktual në fuqi, të standardeve si më poshtë:

1. SSH EN 590:2013+A1:2017: Lëndë djegëse e lëngët për automjete -Gazoil (Diesel) - Kërkesat dhe metodat e provës.
2. SSH EN 228:2012+A1:2017: Lëndët djegëse për automjete - Benzinë pa plumb - Kërkesat dhe metodat e provës.
3. SSH EN 589:2008+A1:2012: Lëndë djegëse për automjete, për përdorim shtëpiak dhe industrial - GLN (Mishelë) - Kërkesat dhe metodat e provës. (aktualisht i shfuqizuar sipas faqes ëeb të këtij institucioni).
4. SSH UNI 6579:2011: Lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial - Klasifikimi dhe karakteristikat.
5. SSH ISO 8217:2017: Produkte nafte - Lëndë djegëse (klasa F) - Specifikimet e lëndëve djegëse detare (të marines).

Gjithashtu, nga ABP i është kërkuar DPS-së të pajisemi me standardet aktuale të përditësuara për objektin e prokurimit "Blerje karburanti, përveç vajgurit Jet A1", nëse standardet e mësipërme kanë ndryshuar ose në rast se ka standarde të tjera për këtë objekt prokurimi.
Me shkresën nr. 530/1 prot. datë 24.12.2019, "Kthim përgjigje", protokolluar me tonën nr. 2069/1 prot. datë 26.12.2019, nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, (DPS), në vijim të kërkesës sonë nr. 2069 prot. datë 19.12.2019, në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt "Blerje karburanti, përveç vajgurit Jet A1", ABP është bërë me dije se: *Standardet e përcaktuara në shkresën nr. 2069 prot. datë 19.12.2019, janë të gjitha në fuqi, përveç standardit SSH EN 589:2008+A1:2012, i cili është zëvendësuar me standardin SSH EN 589:2018.*
Me qëllim realizimin e kësaj procedure prokurimi për vitin 2020, me shkresë nr. 2069/2 prot. datë 31.12.2019, ABP iu drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, ku i kërkuam standardin në fuqi. Me shkresën nr. 530/6 prot. datë 14.01.2020, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, ka dërguar standardin SSH EN 589:2018, "*Lëndë djegëse për automjete, për përdorim shtëpiak dhe industrial - GLN (Mishelë) - Kërkesat dhe metodat e provës*".

**3)** Në lidhje me objektin e prokurimit "Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh", me memon nr. 1206/1 prot. datë 22.10.2019, grupi i punës, i ngritur me urdhrin nr. 1206 prot. datë 03.07.2019 "*Për unifikimin e specifikimeve teknike dhe hartimin e katalogut për objektin e prokurimit "Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh*", pas trajtimit të 15 (pesëmbëdhjetë) kërkesa të AK-ve, të administruara në dosje, duke vlerësuar faktorët e mëposhtëm si:

- shumëllojshmërine e tipeve dhe llojeve të automjeteve (ku nga shqyrtimi i kërkesave të paraqitura janë 81 (tetëdhjetë e një) tip automjetesh të ndryshme dhe 8 (tetë) lloje automjetesh, por duke vlerësuar dhe vitet e ndryshme të prodhimit shumëllojshmëria është akoma më e madhe),
- llojet e ndryshme të defekteve që mundet të dalin në një automjet (mbi 350 (treqind e pesëdhjetë) defekte të ndryshme),
- shpërndarjen e automjeteve, që kërkojnë shërbim-mirëmbajtje, në gjithë territorin e vendit,
- infrastruktura e ngritur për riparimet e automjeteve, ku një Operator Ekonomik nuk ka aktivitet të shtrirë në gjithë territorin e vendit,
- organizimin e posteve të punës, ku një servis mirëmbajtje-riparimi duhet të kryej të gjitha proceset e punës së defektimit të një automjeti,
- sigurimin e furnizimit, me pjesë ndërrimi origjinale ose prodhues për origjinalin, i ka paraqitur titullarit vlerësimin se nuk mund të bëhet unifikimi i specifikimeve teknike për këtë objekt prokurimi.

Grupi i punës i ka paraqitur një listim të të gjitha defekteve të mundshme, që mundet t'i ndodhin automjetit, gjatë shfrytëzimit të tyre.

**4)** Për objektin e prokurimit "Blerje artikujsh ushqimorë", me urdhrin e titullarit nr. 1533/9 prot. datë 11.10.2019, është ngritur grupi i punës për unifikimin e specifikimeve teknike. Në informacionin e paraqitur nga grupi i punës titullarit, me memon nr. 2003/15 prot. datë 07.02.2020, (dhe relacion) është miratuar nga ky i fundit unifikimi i specifikimeve teknike, për këtë objekt prokurimi. Me tej me memon nr. 2003/18 prot. datë 21.02.2020, (dhe relacion) paraqitur nga grupi i punës titullarit, ky i fundit ka miratuar unifikimin e çmimeve për njësi, referuar testimit të tregut, bazuar në specifikimet teknike të unifikuara për këtë objekt prokurimi.
Unifikimi i specifikimeve teknike është bërë me specialist fushe, nga Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si dhe janë marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, (DPS), standardet SSH në fuqi, ku janë përcaktuar karakteristikat e produktit, përshkrimi i

produktit, kërkesat cilësore, ambalazhimi, etiketimi, verifikimi i kërkesave cilësore, ruajtja dhe transportimi.
Agjencia e Blerjeve të Përqendruara ka unifikuar specifikimet teknike dhe çmimet për njësi, për objektin e prokurimit: "Blerje artikuj ushqimorë", të ndara në 7 kategori kryesore ushqimesh, ku përfshihen 156 artikuj bazë dhe 145 nënkategori artikujsh, bazuar në kërkesat e autoriteteve kontraktore si dhe në bashkëpunim me specialistë të fushës.

**5)** Në lidhje me objektin e prokurimit "Shërbim i ruajtjes dhe i sigurisë fizike", bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 177 datë 04.04.2019 "Për krijimin e shoqërisë "X" sha, dhe për përcaktimin e autoritetit publik, që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të kësaj shoqërie", pika 10, ku përcaktohet se "*Të gjitha institucionet dhe subjektet publike, të cilat kanë në administrim objekte shtetërore, ruajtja dhe sigurimi i të cilave duhet të realizohet nga shërbime të specializuara për këtë qëllim, i drejtohen, me kërkesë, kësaj shoqërie, për të përfituar shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike*", me shkresën nr. 1705/1 prot. datë 10.10.2019, "Mbi ofrimin e shërbimit të ruajtjes me roje private të objekteve shtetërore, të ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrisë e të ministrive të linjës", Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, i është drejtuar shoqërisë "X" SH.A, duke i kërkuar mundësinë e ofrimit të shërbimit të ruajtjes me roje private të objekteve shtetërore të ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrisë e të ministrive të linjës, nga shoqëria "X" SHA, nga data 1 Janar 2020 e në vijim.
Kjo shoqëri, nëpërmjet e-mailit të datës 18.12.2019 dhe shkresës zyrtare, ka konfirmuar mundësinë e ofrimit të shërbimit të ruajtjes me roje private të objekteve shtetërore të ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrisë e të ministrive të linjës nga data 1 Janar 2020 e në vijim.

**6)** Në lidhje me objektin e prokurimit "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi", sektori i standardeve dhe analizës me memon nr. 791 prot. datë 03.05.2019, në lidhje me këtë objekt prokurimi, i është referuar pikës 4 të VKM-së nr. 82/2018, i ndryshuar, me VKM-në nr. 816, datë 31.12.2018, ku përcaktohet se: "*Lidhur me objektet e përmendura në pikat ... 1.11 ("Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi") ..., të këtij vendimi, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara do të qendërzojë /do të fillojë kryerjen e procedurave të prokurimit me paraqitjen e çdo kërkese të paraqitur nga autoritetet kontraktore*", si dhe udhëzimit të APP-së nr. 8 datë 20.02.2018, i ndryshuar, me udhëzimin nr. 1 datë 10.01.2019, pika 9, ku përcaktohet se: "*Për shkak të specifikave të ndryshme që kanë kërkesat e autoriteteve kontraktore për objektet: ... Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi .., etj, këto objekte nuk do të përqendrohen, por do të prokurohen në mënyrë të qendërzuar. Në këtë rast, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, do të fillojë kryerjen e procedurës së prokurimit, menjëherë me paraqitjen e kërkesës/ave nga autoriteti/etet kontraktore, pa qenë e nevojshme grumbullimi i kërkesave dhe shpallja e tyre në një procedurë të vetme prokurimi. Kjo mënyrë, ndikon në efikasitetin e procesit në drejtim të shfrytëzimit të burimeve njerëzore, si dhe në prokurimin e nevojave në kohë reale, sipas kërkesave të autoriteteve kontraktore*".
Agjencia e Prokurimit Publik (APP), me shkresën nr. 4046/5 prot. datë 22.10.2019 "Dërgim vendimi" , ka dërguar vendimin nr. 63 datë 22.10.2019, ku në lidhje me procedurat me objekt prokurimi "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi", sqaron se: "*Referuar në pikën 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 82 datë 14.02.2018, "Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime", shërbimi i kateringut është "i qendërzuar" dhe ABP e fillon kryerjen e procedurave të prokurimit me paraqitjen e çdo kërkese nga autoritetet kontraktore*" .
Ky vendim është deleguar nga titullari, në datë 26.12.2019, për tu mbajtur në konsideratë nga Drejtoria e Standardeve dhe Monitorimit të Cilësisë, për sa i përket specifikimeve teknike të dy

objekteve të prokurimit "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi" dhe "Botime, printime, materiale shtypshkrimi", *të cilat nuk do të unifikohen, pasi janë objekte prokurimi të qendërzuara ("Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi") dhe për "Botime, printime, materiale shtypshkrimi" do të propozohet ndryshimi i VKM-së nr. 82/2018 për tu qendërzuar. Edhe në lidhje me objektin e prokurimit "Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi", aktualisht nuk është ngritur grup pune për unifikimin e specifikimeve teknike dhe testimin e tregut.*

**7)** Në lidhje me objektin e prokurimit "Blerje pajisjesh kondicionimi", aktualisht nuk është ngritur grup pune për unifikimin e specifikimeve teknike dhe testimin e tregut, pasi nuk ka patur kërkesa nga autoritetet kontraktore në lidhje me këtë objekt prokurimi.
Bazuar në pikën 6 të VKM-së nr. 82, datë 14.02.2018, i ndryshuar, si dhe në pikën 4 të udhëzimit nr. 8 datë 20.02.2018, i ndryshuar, ku përcaktohet se: "*Agjencia e Blerjeve të Përqendruara duhet të unifikojë specifikimet teknike për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, në përputhje me standardet e miratuara, në bashkëpunim me specialistët e fushave të institucioneve përgjegjëse ose specialistë të jashtëm, vendas a të huaj, e të hartojë katalogët e standardeve, të cilët miratohen me urdhër të ministrit të Brendshëm*", si dhe faktit që aktualisht në lidhje me këtë objekt prokurimi, nuk ka kërkesa nga autoritetet kontraktore, ABP ka vlerësuar që të priten kërkesat e autoriteteve kontraktore dhe më pas të merren hapa konkrete për unifikimin e specifikimeve teknike për këtë objekt prokurimi.

Përsa më sipër, me urdhër të brendshëm të titullarit, nr. 2123 prot. datë 26.12.2019 "Mbi ngritjen e grupeve të punës për rishikimin e specifikimeve teknike dhe çmimeve të unifikuara", janë ngritur disa grupe pune për rishikimin e specifikimeve teknike për disa objekte prokurimi, për të cilat Agjencia e Blerjeve të Përqendruara ka zhvilluar procedura prokurimi gjatë vitit 2019, për mallra dhe shërbime me specifikime teknike të unifikuara gjatë periudhës 2018 - 2019, konkretisht për objektet e prokurimit:
1. "Blerje automjete";
2. "Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash";
3. "Blerje materialesh të buta dhe veshmbathje";
4. "Blerje uniforma dhe elemente të tjera përbërëse të tyre-uniforma për personelin mjekësor";
5. "Blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike";
6. "Blerje materialesh kancelarie";
7. "Blerje materiale të ndryshme për pastrim";
8. "Blerje tonera";
9. "Sigurim automjete";

Ka përfunduar unifikimi i specifikimeve teknike dhe testimi i tregut për objektin e prokurimit "Sigurim automjete" dhe "Blerje uniforma dhe elemente të tjera përbërëse të tyre-uniforma për personelin mjekësor".
Në lidhje me unifikimin e specifikimeve teknike, për disa mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, objekt të VKM-së 82/2018, i ndryshuar, janë ndjekur disa proçese pune gjatë vitit 2018-2019, e konkretisht:

Prioritet ka qenë ngritja e grupeve të punës për unifikimin e specifikimeve teknike, duke synuar përfshirjen e specialistëve të fushës (aty ku kërkohet), nga institucione të ndryshme, duke qenë se ABP nuk ka patur specialistë fushe për shumicën e objekteve të prokurimit për të cilat është parashikuar unifikimi i specifikimeve teknike. Për këtë janë dërguar e-maile, shkresa dhe janë organizuar takime në institucione të ndryshme, duke kërkuar bashkëpunim dhe vënie në dispozicion nga ana e tyre të specialistëve të fushës, për tu përfshirë në grupet e punës.
Nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, janë kërkuar dhe janë marrë standardet për disa objekte prokurimi, si psh:

- "Blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike";
- "Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash";
- "Blerje materialesh të buta dhe veshmbathje";
- "Blerje karburanti, përveç vajgurit Jet A1";
- "Blerje artikujsh ushqimorë".

Gjithashtu, nga ABP janë organizuar takime të hapura me operatorë ekonomikë, gjatë fazë së unifikimit të specifikimeve teknike për disa objekte prokurimi.
Ndër problematikat kryesore të hasura nga ABP gjatë veprimtarisë për unifikimin e specifikimeve teknike dhe cmimeve për njësi, evidentohen:

- Mungesa e specialistëve të fushës dhe mungesa e bashkëpunimit nga institucione të ndryshme për vënien në dispozicion të specialistëve të fushës për tu përfshirë në grupet e punës në ABP, gjatë fazës së unifikimit të specifikimeve teknike (si psh: Autoriteti Kombëtar i Ushqimit)
- Mungesa e bashkëpunimit nga operatorët ekonomikë në dhënien e informacionit gjatë fazës së unifikimit të specifikimeve teknike dhe fazës së testimit të tregut;
- Pjesëmarrje e vogël nga operatorët ekonomikë gjatë proçeseve të takimeve të hapura përsa i përket unifikimit të specifikimeve teknike dhe testimit të tregut;
- Vënia në dispozicion me vonesë, ose në gjuhën angleze (jo të përkthyrea në gjuhën shqipe), e standardeve nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit.

**4. Zhvillimi i procedurave për prokurimet e përqendruara për mallra dhe shërbimeve deri në shpalljen e fituesit.**

- **<u>Ligjishmëria e procedurave të prokurimiteve publike të zhvilluara gjatë vitit 2017</u>**

Për vitin 2017 Agjencia e Blerjeve të Përqendruara ka zhvilluar gjithsej 96 procedura prokurimi për furnizimin me mallra e shërbime me fond limit në total rreth 6,300,000,000 lekë. Janë anuluar 13 procedura prokurimi me fon limit rreth 280,000,000 lekë. Janë realizuar (përfunduar) 83 procedura prokurimi me fond limit rreth 6,020,000,000 lekë, pa TVSH dhe janë shpallur fitues dhe janë njoftuar Autoritetet Kontraktore për të lidhur kontrata në vlerën e përgjthëshme të pritshme rreth 3,830,000,000 lekë, pa TVSH (*ne këtë vlerë nuk përfshihet fondi limit i karburanteve dhe biletave të udhëtimit sepse llogariten me marzh fitimi*). Si pasojë e realizimit të procedurave të prokurimit, janë kursyer fonde buxhetore rreth 202,000,000 lekë ose 9. % të fonit total të prokuruar.

Auditimi kryer me zgjedhje në disa procedura prokurimi, të cilat po i trajtojmë më poshtë:

**1.** Procedura e prokurimit publik me objekt **"Blerje Karburanti", Loti I "Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)"**:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi nr. 41 datë 01.11.2017<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapur", me mjete elektronike" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>z. X<br>z. X<br>z. X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>z. X<br>znj. X<br>z. X |
| 5.Fondi Limit i lotit I (pa tvsh)<br>**42 824 100** lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>**BOE "X" SHA dhe "X" shpk**<br>**Vlera e ofertës me marzh të fitimit të shprehur në përqindje: 16,7%** | |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 30.11.2017 | 9. Operatoret Ekonomike 2<br>b) Skualifikuar 1<br>c) Kualifikuar 1 | 10. Vlera e kontratës (me tvsh) 51,388,920 lekë |

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë marrë zyrtarisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, pranë Ministrisë së Financës. Në mënyrën e përllogaritjes së vlerës limit, në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në nenin 59, të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit Publik" (i ndryshuar).

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punës, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumente edhe kritere të veçanta kualifikuese përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**

Në tenderin e zhvilluar **Loti I "Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)"** kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | BOE "X" SHA dhe "X" shpk | me marzh të fitimit të shprehur në përqindje: 16,7% | Kualifikuar | Ne vend të I-rë |
| 2 | BOE "X" SHA dhe "Xoil" SHPK | me marzh të fitimit të shprehur në përqindje: 10 % | SKualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme, nga 2 operatorë është kualifikuar 1 operator, nga të cilët është shpallur fitues operatori ekonomike BOE "X" SHA dhe "X" shpk me ofertën ekonomike me marzh të fitimit të shprehur në përqindje: 16,7%. Është skualifikuar 1 operator, i cili ka ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues. Konkretisht: BOE "X" SHA dhe "X oil" SHPK me ofertë ekonomike me marzh të fitimit të shprehur në përqindje: 10 % ose me diference më të ulët se fituesi me marzh të fitimit të shprehur në përqindje 6.7 %.

Ky operator është skualifikuar nga KVO për këto arsye:

1. Operatori BOE "X" SHA dhe "X oil" SHPK

- Nuk plotëson pikën 1/b dhe 1/c), tek kriteret e përgjithshme të pranimit të Shtojcës 8 të DT, pasi rezulton se nuk ka paraqitur shtojcën 9 të dst (vet deklarimin e subjektit).
- Nuk plotëson pikën 1/b të pikës 2, tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT, pasi nuk ka paraqitur deklaratë për përmbushjen e specifikimeve teknike.
- Nuk plotëson pikën 1/c të pikës 2, tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT, pasi nuk ka paraqitur Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7.
- Nuk plotëson pikën 1/d të pikës 2, tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT, pasi nuk ka paraqitur vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.
- Nuk plotëson pikën 1 të pikës 2.3 (Kapacitetit teknik), tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT, pasi nuk ka paraqitur dëshmi konform kritereve të përcaktuara në pikën 1 të pikës 2.3 (Kapacitetit teknik), për të vërtetuar se plotëson vlerën minimale të kërkuar për furnizime të mëparshme të ngjashme.

- Kontrata nr.2868, datë 02.06.2017 me Bankën e Shqipërisë është fotokopje dhe nuk deklarohet sa është vlera e kontratës të realizuar.
- Faturat e paraqitura janë fotokopje, pra nuk janë origjinale ose kopje të noterizuara.

- Nuk plotëson pikën 2 të pikës 2.3 (Kapacitetit teknik), tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT, pasi nuk ka paraqitur leje tregtimi ose licencë për tregtim karburantesh të llojit III/A (Gazoil, Diesel).

- Nuk plotëson pikën 3 të pikës 2.3 (Kapacitetit teknik), tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT, pasi nuk ka paraqitur listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakiceë sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale ose akt pronësie ose të jenë te pasqyruara në ekstraktin e QKR, etj) për këto stacione, detyrimisht që nga 01 janari 2017 e në vazhdim. Këto stacione të jenë të pajisura me leje mjedisore të tipit C, vërtetim teknik nga ISHTI, Akt-Teknik nga PMNZH, dhe Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributoret e shitjes me pakicë.
- Nuk plotëson pikën 6 të pikës 2.3 (Kapacitetit teknik), tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT, pasi Leja mjedisore te tipit B, te lëshuar nga QKL, dhe Polica e Sigurimit lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për depozitat e tregtimit me shumicë janë paraqitur fotokopje dhe jo origjinal ose kopje e noterizuar.
- Nuk plotëson pikën 7 të pikës 2.3 (Kapacitetit teknik), tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT, pasi flete analizat e lëshuara nga ISHTI janë lëshuar me herët se 30 dite nga data e hapjes së ofertave.
- Nuk plotëson pikën 8 të pikës 2.3 (Kapacitetit teknik), tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT, pasi deklaratat e kërkuara janë paraqitur vetëm nga njëri anëtar i bashkimit të grupit dhe jo nga të dy anëtarët e grupit, apo nga lideri sic është përcaktuar në marrëveshjen e bashkimit të operatorëve.
- Nuk është paraqitur dokumentacioni për 2 autobotetet, kërkuar në pikën 8 të pikës 2.3 (Kapacitetit teknik), tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT.
- Nuk plotëson pikën 8 të pikës 2.3 (Kapacitetit teknik), tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT pasi nuk ofron :
  Faqen e menaxhimit te karburanteve në lidhje me shërbimin për krijimin e strukturës piramidale në përputhje me strukturën piramidale të Autoritetit kontraktor, shërbimin e furnizimit me karburant nëpërmjet kartave elektronike stikera (pulla), të cilat ngjiten në xhamin e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet për te eliminuar lëvizjen e mundshme të targave nga mjeti shtetëror drejt mjeteve private, si dhe shërbimin e dërgimit të fotografive me anë të e- mailit për çdo furnizim të kryer të mjetit pranë stacionit te shitjes së karburanteve me pakicë, me qëllim identifikimin e mjetit dhe përdoruesit te saj.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë për skualifikimin e këtij operatori rezultoi se: KVO e ka skualifikuar këtë operator në përputhje me rregullat e prokurimit public, sepse nuk përmbush shumë nga kriteret e vecanta të kërkuara në DT.
Megjithëse, nisur nga ofertat ekonomike të operatorëve të skualifikuar që i kanë paraqitur më të ulëta se fituesit, KVO mund të tregohej edhe më tolerante duke i konsideruar mangësitë e mësipërme si devijime të vogla. Kështu, mund të kishim menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore që shkojnë në vlerën 3,443,057 lekë, me TVSH.

**2.** Procedura e prokurimit publik me objekt: **"Blerje Këpucë për Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore"**:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi Nr. 43 Prot. datë 08.11.2017<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit<br>"E hapur", me mjete elektronike" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Znj. X<br>Znj. X<br>z. X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>z. X<br>z.X<br>z. X |
| 5.Fondi Limit (pa tvsh)<br>3 863 741 lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>"X" PF<br>Vlera e ofertës 3 681 960 Lekë | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 181 781 lekë |

| | | |
|---|---|---|
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 11.12.2017 | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 3<br>b) Skualifikuar 2<br>c) Kualifikuar 1 | 10. Vlera e kontratës (me tvsh) 4 418 352 lekë |

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë hartuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit bazuar në kërkesën e autoritetit kontraktor, Qëndra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore me shkresat protokolluar me tonën nr. 1334 prot. datë 20.10.2017 dhe nr. 1345 prot. datë 25.10.2017. Specifikimet teknike janë hartuar nga vet autoriteti kontraktor. Në lidhje me specifikimet teknike të sjella nga Autoriteti kontraktor anëtari i njësisë Z. X nuk ishte dakort qe ne specifikime teknike të jenë të përfshira standartet: EN ISO 20345:2011, CE UNI EN ISO20345:2011, EN 20345: 2011 kjo pasi këto nuk janë standarte Shqiptare apo standarte të aprovuara nga ndonjë institucion Shqiptar. Këto standarte mund të bëhen shkak abuziviteti në këtë procedurë në momentin e lidhjes së kontratës. Konkretisht ka kërkuar që të hiqen nga specifikimet teknike shprehjet, (të cilat nënkuptojne apo janë ISO), si më poshtë:

1.Në specifikimet teknike faqja e parë: Skeda teknike 1. Këpucë dimërore te ndarja Tipi DPI nuk jam dakort me shprehjen: "sipas normave europiane EN ISO 20345:2011" dhe jam i mendimit që kjo shprehje te hiqet.

2.Te reshti i katërt, Norma e referimit nuk jam dakort me shprehjen: "CE UNI EN ISO20345:2011", dhe jam i mendimit të hiqet kjo.

3.Te reshti i pestë: Kerkesat DPI nuk jam dakort dhe jam i mendimit që të hiqet shprehja: "siç përcaktohet nga standardin En 20345:2011"

Gjithashtu, Z.X ka shprehur mendimin përsa I përket specifikimeve teknike të lartëpërmenduara, në lidhje pyetjet qe jane çuar me email nga dy anëtaret e tjere te njesise te merej përgjigje me shkrim nga institucionet perkatese.

Dy anëtarët e tjerë të Njësisë së Prokurimit Znj. X dhe Znj. X në lidhje me specifikimet teknike të sjella nga autoriteti kontraktor, Qëndra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore përsa i përket standartit të përcaktuar të normave europiane EN ISO 20345:2011 argumentojnë si më poshtë:

Në nenin 23 (Specifikimet teknike) të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar) përcaktohet se:

1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar:

a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;

4. Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime."

Autoriteti kontraktor në specifikimet teknike përcakton: "Këpucë sigurie për përdorim profesional, sipas normave europiane EN ISO 20345:2011", "Norma e referimit CE UNI EN ISO20345:2011 – Këpucë sigurie","Këpuca e punës, e markës X plotëson kërkesat minimale themelore (siç përcaktohet nga standardin EN 20345: 2011) plotësohet…"
Pra autoriteti kontraktor për të përshkruar kërkesat e tij teknike në lidhje me mallin "këpucë" i referohet normave europiane EN ISO 20345:2011".
Në këto kushte dy anëtarët e njësisë vendosën ti kerkojnë informacion me e-mail zyrtar Universitetit Politeknik i Tiranës, (Departamenti i Tekstileve) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Standartizimit në lidhje me specifikimet teknike nëse ISOT e referuar ne to (EN ISO 20345:2011) kanë lidhje me objektin (PRODUKTIN KËPUCE) dhe nëse EN ISO 20345:2011 i korrespondon ndonjë standart shqipetar?
Në përgjigjë të kësaj kërkesë nga ana e këtyre institucioneve u informuam me e- mail se:
Nga Drejtorisa e Përgjithshme të Standartizimit:
"Standardin që keni kërkuar e kemi të adoptuar dhe publikuar si Standard Shqiptar dhe ka emërtimin:
SSH EN ISO 20345:2011 "Pajisje mbrojtëse personale - Këpucë sigurie (ISO 20345:2011)
Qëllimi i Standardit:
Ky Standard Ndërkombëtar përcakton kërkesat themelore dhe shtesë (opsionale) për këpucët e sigurisë të përdorura për qëllime të përgjithshme. Përfshin, për shembull, rreziqet mekanike, rezistencën ndaj rrëshqitjes, rreziqet termike, sjelljen ergonomike.
Rreziqet e veçanta mbulohen nga standardet plotësuese të lidhura me punën (p.sh. këpucët për zjarrfikësit, këpucët izoluese elektrike, mbrojtja nga dëmtimet me zinxhirë, mbrojtja nga kimikatet dhe spërkatja e metalit të shkrirë, mbrojtja për motoçiklistët).
Nga Universitetit Politeknik i Tiranës, (Departamenti i Tekstileve):
EN ISO 20345:2011 eshte standard per kepuce personale mbrojtese (pjese e veshjeve mbrojtese). Ju duhet te theksoni kategorine dmth markimin S3 sepse ka disa lloj kepucesh dhe cizmesh per te cilat jep specifikime ky standard.
Ky standard eshte adoptuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Standardizimit ne Republiken e Shqiperise si standard shqiptar dmth me ermetesen S SH EN ISO 20345:2011. Keshtu qe, ne vend te emrtimeve te ndryshme te perdoruara ne specifikime (psh UNI EN ISO 20345:2011 qe eshte standardi i adoptuar i Republikes Italiane) duhet te vendoset emertesa e organit shqiptar DPS (pra SSH.EN ISO 20345:2011 etj).
Sa më sipër gjykojmë se jo vetëm që ISO ISO 20345:2011 është stardard i cili ka lidhje me objektin e prokurimit por është standard i adoptuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Standardizimit me ermëtesën S SH EN ISO 20345:2011.

Gjykojmë se heqja e këtij standarti nga specifikimet teknike do të sillte ne prokurimin e produktit me cilësi teknike të ndryshme nga ata të kërkuara nga Autoriteti kontraktor, Qëndra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore e cila edhe testimin e tregut e ka realizuar me këto specifikime teknike.

Për gjithë sa më sipër njësia e prokurimit me shumicë votash vendos që ISO 20345:2011 të mos hiqet nga specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor por në to të vendoset edhe standarti shqiptar S SH EN ISO 20345:2011.
Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi.

Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**

Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 3 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" PF | 3 681 960 | Kualifikuar | Ne vend të I-të |
| 2 | "X" SHPK | 2 503 440 | Skualifikuar | |
| 3 | "X" SHPK | 3 751 500 | Skualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme nga 3 operatore është kualifikuar 1 operator nga të cilët është shpallur fitues operatori ekonomike "X" PF me ofertën ekonomike në vlerën 3 681 960 lekë, pa TVSH. Janë skualifikuar 2 operatorë, nga të cilët 1 ka ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues. Konkretisht operatori "X" SHPK me ofertë ekonomike në vlerën 2 503 440 lekë, pa TVSH ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 1,178,520 lekë.

Këta operatorë janë skualifikuar nga KVO për këto arsye:

1. Operatori "X" SHPK

- Nuk përmbush piken 1 (1) te kritereve te pergjithshme te kualifikimit pasi nuk ka paraqitur Ekstrakt nga Qendra Kombetare e Regjistrimit qe vërteton se subjekti eshte aktiv apo pasiv.
- Nuk përmbush piken 1 (3) te kritereve te pergjithshme te kualifikimit pasi nuk ka paraqitur Ekstrakt mbi historikun e subjektit te leshuar nga Qendra Kombetare e Regjistrimit.
- Nuk përmbush piken 2.3 (1) te kritereve te vecanta te kualifikimit, Kapaciteti teknik konkretisht furnizimet e ngjashme nuk kapin vlerën 40 % te fondit limit.
- Mostra (kepuca) nuk eshte sipas specifikimeve teknike pasi nuk ka elementin fosforishent.
- Bilanci i vitit 2015, ndryshe nga ai i vitit 2016, nuk eshte i vulosur nga organet tatimore.

2. Operatori "X" SHPK

- Nuk permubush piken 2 (ç) te kritereve te veçanta te kualifikimit, konkretisht vërtetimi qe konfirmon shlyerjen e detyrimeve te maturuara te energjisë elektrike ka te papaguar muajin Tetor.
- Mostra (kepuca) nuk eshte sipas specifikimeve teknike pasi nuk ka elementin fosforishent.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë e skualifikimit të këtyre operatorëve rezultoi se, KVO i ka skuailifikuar këta operatorë në përputhje me rregullat e prokurimit publik sepse, nuk përmbushin disa nga kriterit e përgjthëshme dhe të vecanta të kërkuara në Dokumentet e Tenderit.
Megjithatë nisur nga ofertat ekonomike e operatorëve të skualifikuar"X" që i ka paraqitur ofertën ekonomike më të ulëta se fituesit, KVO mundë të tregohej edhe më tolerante duke i konsideruar mangësitë e këtij operatori si devijime të vogla. Kështu mundë të kishim menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore që shkojnë në vlerën 1,414,224 lekë, me TVSH.

**3.** Procedura e prokurimit publik me objekt: **"Blerje Pjesësh Ndërrimi Për Automjete, Për Shërbimet Profilaktike", Loti I "Blerje Goma për Automjete"**:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| 1. Urdhër Prokurimi Nr. 13 Prot., datë 27.03.2017 | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave |
|---|---|---|
| 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit<br>"E hapur", me mjete elektronike" | Znj. X<br>Z X<br>z X | z X<br>z. X<br>znj. X<br>z. X |

| | | |
|---|---|---|
| | | z. X |
| 5.Fondi Limit i Lotit I (pa tvsh)<br>43 826 200 lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>BOE "X" shpk dhe "X" shpk<br>Vlera e ofertës 43 335 900 lekë | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 490 300 lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 12.06.2017 | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 3<br>b) Skualifikuar 2<br>c) Kualifikuar 1 | 10. Vlera e kontratës (me tvsh) 52 003 080 lekë |

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë hartuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit bazuar në unifikim e specifikimeve teknike nga Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**

Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 3 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | BOE "X" shpk dhe "X" shpk | 43 335 900 | Kualifikuar | Ne vend të I-të |
| 2 | BOE "X" shpk dhe "X" shpk | 24 953 100 | SKualifikuar | |
| 3 | "X" PF | 25 088 700 | Skualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme nga 3 operatore është kualifikuar 1 operator nga të cilët është shpallur fitues BOE "X" shpk dhe "X" shpk me ofertën ekonomike në vlerën 43 335 900 lekë, pa TVSH. Janë skualifikuar 2 operatorë, nga të cilët 2 kanë ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues. Konkretisht operatori BOE "X" shpk dhe "X" shpk me ofertë ekonomike në vlerën 24,953,100 lekë, pa TVSH ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 18,382,800 lekë; operatori "X" PF me ofertë ekonomike në vlerën 25 088 700 lekë, pa TVSH ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 18,247,200 lekë.

Këta operatorët janë skualifikuar nga KVO për këto arsye:

1. Operatori BOE "X" shpk dhe "X" shpk

- Bashkimi i operatorëve ekonomik "X Kompani shpk & X shpk" nuk plotëson kërkesën për kualifikim lidhur me shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike. Për sa më sipër, mbështetur në kërkesat e Nenit.74/3, të VKM-së, Nr.914, date 29.12.2015, bashkimi i operatorëve ekonomikë "X Kompani shpk & X shpk", nuk konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë, pasi anetari I ketij bashkimi "X Kompani" shpk, duhet të kishte të pasqyruar në vërtetimin e OSSHE-së dhe

faturën e Muajit Prill 2017, meqense data e hapjes se ofertave eshte me date 12.06.2017 atehere detyrimet e maturuar te energjise elektrike jane edhe detyrimet e muajit Prill 2017.

- Ne kontraten e bashkepunimit midis operatoreve ekonomik "X" shpk dhe "X" shpk e noterizuar, nuk percaktohen elementet konkrete qe do te kryeje secili nga anetaret e ketij bashkimi siç kerkohet shprehimisht ne VKM Nr.1 Date 10.01.2017 "Per rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, kreu VII, pika 2, (b). Gjithashtu, ne oferten ekonomike paraqitur nga bashkimi i operatoreve, nuk eshte percaktuar pjesa e furnizimit qe do te kryeje secili nga anetaret a ketij bashkimi siç kerkohet shprehimisht ne VKM Nr. 1 date 10.01.2017 "Per rregullat e prokurimit publik", indryshuar, kreu VII, pika 2, (a).
- Shoqeria "Goma" Shpk nuk ka paraqitur Certifikaten e Akreditimit per ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 18001:2017, çertifikata akredituese e paraqitur nga kjo shoqeri është për kompaninë X dhe i perket vetem Certifikates ISO 28001:2007 ne kundershtim me piken 4 te kapatcitetit Teknik ne DST.
- Shoqeria "X" Shpk nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi nga asnje distributor i autorizuar apo prodhues i gomave, kjo ne kundershtim me Piken 2 tekapaciteti teknik. Sipas kontrates se bashkepunimit ne 60 % e realizimit te saj kjo shoqeri duhet te paraqes autorizimet perkatese.
- Certefikata ISO 9001:2008 e ORNATE RUBBER CO., LTD nuk shfaqet ne sistemin elektronik ëebsite te QualityAustria, shoqerise qe ka leshuar kete certefikate.
- Certefikata ISO 9001:2008 e leshuar me date Mar, 04, 2014 dhe qe skadon ne Mar, 03, 2019 e Shandong Neë Continent Tire CO., LTD nuk eshte e regullt, pasi kjo certefikate leshuar nga shoqeria X, referuar regullave te leshimit te certefikatave nga kjo shoqeri, sipas pikes 5.1.7.1 te regullores CNAS-RI01:2015 faqja 10, nuk mund te kete me shume se tre vjet vlefshmeri, nderkohe qe kjo certefikate ka 5 vjet vlefshmeri.
- Shoqerite kane identifikuar gomat ne Katalogun DUNLOP duke mos e shoqeruar as me autorizim prodhuesi dhe as me Certifikate ISO 9001 : 20008 ne kundershtim me Piken 7 te kapaciteti teknik ne te cilin kerkohet paraqitje e katalogut original te prodhuesit shoqeruar me autorizimin e prodhuesit dhe me certifikaten e menaxhimit te Cilesise ISO 9001 : 2008.
- Katalogu Nexen dhe Seha nuk jane shoqeruar me Autorizim Prodhuesi dhe as me Certifikate ISO 9001:2008 ne kundershtim me Piken 7 te kapaciteti teknik ne te cilin kerkohet paraqitje e katalogut original te prodhuesi te shoqeruar me autorizimin e prodhuesit dhe me çertifikaten e menaxhimit te cilesise ISO 9001 : 2008.
- Shumica e artikujve goma te paraqitur ne oferten teknike nuk shfaqen ne faqen e ëebsiten te çdo prodhuesi. Kataloget e dorezuar nga ana e operatoreve nuk shfaqen ne faqen e ëebit.

2. Operatori "X" PF

- KVO bazuar ne ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar) neni 53 pika 4, ka quajtur devijim te vogël mos paraqitjen ne sistemin elektronik te APP-se te autorizimit te prodhuesit për katalogun e paraqitur.
- Komisioni i Vlerësimit në bazë të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar) neni 56 "Oferta anomalish e ulët", kërkoi informacion të detajuar në lidhje me analizën e kostos së ofertave nga operatorët ekonomikë. Konkretisht operatorit ekonomik "X" shpk ju drejtua me shkresën nr. 804 datë 22.06.2017, ku ky operator ekonomik ktheu përgjigje në lidhje me ofertën anomalish të ulët protokolluar me protokollin tonë nr. 804/1 datë 23.06.2017 duke argumentuar se është bere një gabim ne llogaritje ku oferta e tij nuk ishte reale dhe si rrjedhoje nuk mund te sjelle argumentim duke u tërhequr nga oferta.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë skualifikimit të këtyre operatorëve rezultoi se, KVO i ka skuailifikuar këta operatorë në përputhje me rregullat e prokurimit publik sepse: BOE "X KOMPANI" nuk përmbush dhe ka mangësi te dokumentacionin e kerkuar në Dokumentet e

Tenderit për plotësimin e kërkesave të vecanta, ndërsa Operatori "X" është tërhequr nga oferta e tij.
Megjithatë nisur nga oferta ekonomike e BOE "X që i ka paraqitura më të ulëta se fituesit, KVO mund të tregohej edhe më tolerante duke i konsideruar mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e ofertës teknike si devijime të vogla. Kështu mundë të kishim menaxhim më të mirë dhe përdorim më me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore që shkojnë në vlerën 22,059,360 lekë, me TVSH.

**4.** Procedurën e prokurimit publik me objekt: **"Blerje Pjesësh Ndërrimi Për Automjete, Për Shërbimet Profilaktike", Loti III "Blerje Vajra lubrifikant, alkol frenash dhe pastrues motorri"**:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi Nr. 13 Prot., datë 27.03.2017<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit<br>"E hapur", me mjete elektronike" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Znj. X<br>Z X<br>z X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>z X<br>z. X<br>znj. X<br>z. X<br>z. X |
| 5.Fondi Limit i Lotit III (pa tvsh)<br>39 589 579 lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>"X" sha<br>Vlera e ofertës 33 551 430 lekë | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 6 038 149 lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 12.06.2017 | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 3<br>b) Skualifikuar 1<br>c) Kualifikuar 1 | 10. Vlera e kontratës (me tvsh) 40 261 716 lekë |

Nga auditimi u konstatua:
**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**
Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë hartuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit bazuar në unifikim e specifikimeve teknike nga Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**
Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 3 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" sha | 33 551 430 | Kualifikuar | Ne vend të I-të |
| 2 | "X–OIL" sha | 36 141 380 | Kualifikuar | Ne vend të II-të |
| 3 | "X" sha | 26 643 334 | Skualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme nga 3 operatore janë kualifikuar 2 operator nga të cilët është shpallur fitues operatori ekonomike "X" sha me ofertën ekonomike në vlerën 33 551 430 lekë, pa TVSH. Është skualifikuar 1 operatorë, i cili ka ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues. Konkretisht operatori "X" sha me ofertë ekonomike në vlerën 26 643 334 lekë, pa TVSH ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 6,908,096 lekë

Ky operatorë është skualifikuar nga KVO për këto arsye:

- Nuk ploteson piken 4 te kapacitetit teknik, te kriteret e veçanta te kualifikmit, Çertifikata ISO 9001:2008 e X shpk nuk eshte e rinovuar, sipas kushtit per vlefshmerine me rinovimin vjetor (mungon pulla e mbikqyrjes vjetore).
- Ne kriteret e vecanta te kualifikimit, 2.3 kapaciteti teknik, ne piken 11 ku operatori ekonomik duhet te paraqese mostrat sipas tabeles se pergjithshme te vajrave ne shtojcen 12, jane kerkuar gjithsej 12 mostra vaji ku nga keto mostra rezulton se operatori ekonomik ka sjelle për mostrat: vaj armesh CLP-7 me nr rendor ne tabelen e pergjithshme nr. 47 dhe per; vaj armesh me numer rendor ne tabelen e pergjithshme nr. 21 mostren vaj nycolube 127 ne versionin 1 liter dhe 5 litra qe korenspodondon me specifikimet e vajit nr. 47 ne tabelen ke pergjithshme dhe nuk ka sjelle moster per vajin me nr rendor 21 ne tabelen e pergjithshme.
- Operatori ekonomik nuk ploteson piken 11 ne kriteret e vecanta te kualifikimit, 2.3 kapaciteti teknik, ku operatori ekonomik duhet te paraqese mostrat e kerkuara sipas tabeles se pergjithshme te vajrave ne shtojcen 12, ku eshte kerkuar moster dhe analize per vaj SAE 90 me numer rendor nr. 12 ne tabelen e pergjithshme te vajrave ne Shtojcen 12, dhe operatori ekonomik nuk ka paraqitur flete analize dhe moster per vajin SAE 90 por ka paraqitur flete analize dhe moster per vajin SAE 80 ë 90 qe eshte kerkuar ne tabelen e pergjithshme me numer rendor nr. 11, nderkohe qe ky vaj me nr rendor nr. 11 ne tabelen e pergjithshme nuk eshte kerkuar te sillet moster dhe flete analize sipas pikes 11 kriteret e vecanta te kualifikimit, 2.3 kapaciteti teknik.

Për këtë skualifikim, operatori ekonomik "X" ka depozituar ankesën pranë autoritetit kontraktor e administruar me nr. 845 prot. datë 30.06.2017 dhe me shkresën Nr.845/1 prot. datë 14.07.2016, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit "X" dhe ka vendosur mospranimin e ankesës së paraqitur prej tij. Më pas ky nga operatori ekonomik ka bërë ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik. KPP me Vendimin nr.602/2017 të datës 09.08.2017 ka vendosur, të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik "X" sh.a, si dhe lejimin e autoritetit kontraktor për vazhdimin me hapat e metejshëm të procedurës.
Po kështu edhe Operatori ekonomik X" i kualifikuar dhe ka ofertën ekonomike më të lartë se fituesi ka depozituar ankesën pranë autoritetit kontraktor administruar nr. 856 prot. datë 03.07.2017. AK, me shkresën Nr.856/1 prot. datë 14.07.2016, i ka kthyer përgjigje ankimuesit "X " sh.a dhe ka vendosur mospranimin e ankesës së paraqitur prej tij.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë skualifikimit të operatorit "X" rezultoi se, KVO e ka skuailifikuar këtë operator në përputhje me rregullat e prokurimit publik ashtu sic jka vendosur edhe KPP. Megjithatë nisur nga ofertat ekonomike të këtij operatori që i ka paraqitura më të ulët se fituesit, KVO mundë të tregohej edhe më tolerante duke i konsideruar mangësitë e më sipërme si devijime të vogla. Kështu mundë të kishim menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore që shkojnë në vlerën 8,289,715 lekë, me TVSH.

**5.** Procedurën e prokurimit publik me objekt: "Blerje uniformash, veshmbathjesh dhe elementesh të tjera, përbërëse të tyre", konkretisht për **Lotin II: "Blerje uniformash, veshmbathjesh dhe elementesh të tjera, përbërëse të tyre për Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore"**:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi Nr. 42 prot. datë 03.11.2017<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapur", me mjete elektronike" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Znj. X<br>Znj. X<br>Z. X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>z. X<br>z. X<br>znj. X |
| 5.Fondi Limit (pa tvsh)<br>**43 433 248** lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>**"X**<br>**Vlera e ofertës 37 751 800 lekë** | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 5 681 448 lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 11.01.2018 | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 6<br>b) Skualifikuar 4<br>c) Kualifikuar 2 | 10. Vlera e kontratës (me tvsh)<br>45 302 160 lekë |

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**
Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë hartuar nga autoriteti kontraktor i përfshirë në këtë procedurë prokurimi të dërguara në OQB me shkresën 415 datë 24.10.2007 protokolluar ne MB me nr 1345 datë 25.10.2017. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".
**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.
**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**
Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 6 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" Shpk | 37 751 800 | Kualifikuar | Ne vend të I-të |
| 2 | "X" person fizik | 38 535 960 | Kualifikuar | Ne vend të II-të |
| 3 | "X" shpk | 35 774 840 | Skualifikuar | |
| 4 | "X" sh.p.k | 37 776 800 | Skualifikuar | |
| 6 | "X" Shpk | 28 497 720 | Skualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme nga 6 operatore janë kualifikuar 2 operator nga të cilët është shpallur fitues operatori ekonomike "X" Shpk me ofertën ekonomike në vlerën 37 751 800 lekë pa TVSH. Janë skualifikuar 4 operatorë, nga të cilët 2 ka ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues. Konkretisht operatori "X" shpk me ofertë ekonomike në vlerën 35 774 840 lekë pa TVSH ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 1 976 960 lekë pa TVSH dhe operatori "X" Shpk me ofertë ekonomike në vlerën 28 497 720 lekë pa TVSH ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 9 254 080 lekë pa TVSH. Këta 2 operatorë janë skualifikuar nga KVO për këto arsye:

**1. Operatori "X":**

- Nuk përmbush piken 2.3 (2) te kritereve te vecanta te kualifikimit, Konkretisht certefikata ISO 9001-2008 e paraqitur nga operatori ekonomik "X" Shpk nuk është e lëshuar për objektin e procedurës së prokurimit.
- Mostra e dorëzuar nuk përmbush të gjitha specifikimet teknike të kërkuar a(sipas shkresës nr.02 datë 08.01.2018 të Laboratorit Fiziko-Mekanik dhe Kimik të Tekstilit dhe Lëkurës).

**2. Operatori "X":**

- Mostra e dorëzuar nuk përmbush të gjitha specifikimet teknike të kërkuara(sipas shkresës nr.02 datë 08.01.2018 të Laboratorit Fiziko-Mekanik dhe Kimik të Tekstilit dhe Lëkurës).

Nga auditimi mbi ligjshmërinë skualifikimit të këtyre 2 operatorëve rezultoi se, KVO e ka skuailifikuar këta operatorë në përputhje me rregullat e prokurimit publik sepse, ***nuk përmbushin të gjitha specifikimet teknike të uniformave, veshmbathjesh dhe elementesh të tjera, përbërëse të tyre sipas kërkesave të vendosuara në Dokumentet e Tende***rit.

**6.** Procedurën e prokurimit publik me objekt: **"Blerje Orendish dhe Pajisjesh për Mobilim Zyrash për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për Pikën e Kalimit të Kufirit Morinë-Vermisë, Kukës"**:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi Nr. 38 Prot. datë 30.10.2017<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit<br>"E hapur", me mjete elektronike" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Znj. X<br>Znj. X<br>z. X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>z. X<br>z. X<br>zX |
| 5.Fondi Limit (pa tvsh)<br>15,225,000 lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>"X" SHPK<br>Vlera e ofertës 9 434 400 lekë | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 5 790 600 lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 30.11.2017 | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 11<br>b) Skualifikuar 5<br>c) Kualifikuar 6 | 10. Vlera e kontratës (me tvsh) 11 321 280 lekë |

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë hartuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit bazuar në kërkesën për blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash, me fondin përkatës limit, të dhënat teknike, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën protokolluar me tonën nr. 1158 prot. datë 11.09.2017 si dhe bazuar në unifikimin e specifikimeve teknike nga Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**
Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 11 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" SHPK | 9 434 400 | Kualifikuar | Ne vend të I-të |
| 2 | "X" SHPK | 9 482 500 | Kualifikuar | Ne vend të II-të |
| 3 | "X" SHPK | 14 691 400 | Kualifikuar | Ne vend të III-të |
| 4 | "X" SHPK | 14 977 900 | Kualifikuar | Ne vend të IV-të |
| 5 | "X" SHPK | 15 130 100 | Kualifikuar | Ne vend të V-të |
| 6 | "X" SHPK | 15 163 300 | Kualifikuar | Ne vend të VI-të |
| 7 | "X SHPK | 11 638 100 | Skualifikuar | |
| 8 | "X" SHPK | 10 057 420 | Skualifikuar | |
| 9 | "X" SHPK | 9 040 700 | Skualifikuar | |
| 10 | "X" SHPK | 9 482 500 | Skualifikuar | |
| 11 | "X" SHPK | 8 036 700 | Skualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme nga 11 operatore janë kualifikuar 6 operator nga të cilët është shpallur fitues operatori ekonomike "X" SHPK me ofertën ekonomike në vlerën 9,434,400 lekë, pa TVSH. Janë skualifikuar 5 operatorë, nga të cilët 2 kanë ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues. Konkretisht operatori "X" SHPK me ofertë ekonomike në vlerën 9,040,700 lekë, pa TVSH ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 393,700 lekë; operatori "X" SHPK me ofertë ekonomike në vlerën 8,036,700 lekë, pa TVSH ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 1,397,700 lekë. Këta operatorët janë skualifikuar nga KVO për këto arsye:

1. **Operatori "X" SHPK**

- Në bazë të përllogaritjeve të bëra nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave rezultoi se oferta e operatorit ekonomik "X" SHPK, në këtë procedurë prokurimi të jetë anomalisht e ulët. Bazuar në ligjiin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar), neni 56 "Oferta anomalisht e ulët", Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me shkresën nr. 1503 prot. datë 11.12.2017, i kërkoi informacion të detajuar, në lidhje me analizën e kostos së ofertës të paraqitur në këtë procedurë prokurimi. Operatori ekonomik "X" SHPK nuk ka kthyer përgjigje shkresës nr. 1503 prot. datë 11.12.2017 si dhe kërkesës se dërguar nëpërmjet sistemit elektronik te APP-se në lidhje me analizën e kostos së ofertës të paraqitur në këtë procedurë prokurimi.

**2. Operatori "X" SHPK**

- Në bazë të shqyrtimit të bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave rezultoi se oferta e operatorit ekonomik "X" SHPK, kishte mospërputhje në shprehjen në shifra dhe atë me fjalë sa më sipër bazuar në VKM-në 914 datë 29.12.2014, neni 66, pika 4, paragrafi 2 me shkresën nr. 1505 datë 11.12.2017 i kërkoi pranimin e rregullimit të gabimeve si dhe bazuar në ligjiin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar), neni 56 "Oferta anomalisht e ulët", Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i kërkoi informacion të detajuar, në lidhje me analizën e kostos së ofertës të paraqitur në këtë procedurë prokurimi nëse pranohej rregullimi i ofertës. Operatori ekonomik "X" SHPK ktheu përgjigje në sistemin elektronik të APP-së duke mos e pranuar korrigjimin e ofertës.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë skualifikimit të këtyre operatorëve rezultoi se, KVO e ka skuailifikuar këta operatorë në përputhje me rregullat e prokurimit publik sepse këta operatorë nuk kanë kthyer përgjigje për ofertën anomalisht të ulët dhe për mos korrigjimin e ofertes.

**7.** Procedurën e prokurimit publik me objekt: **"Blerje materialesh pastrimi"**:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi Nr.31 Prot. datë 13.09.2017<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Kërkesë për Propozim", me mjete elektronike" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>z X<br>z X<br>z. X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>z X<br>z X<br>z X |
| 5.Fondi Limit (pa tvsh)<br>**54 073 883** lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>**"X" SHPK**<br>**Vlera e ofertës 27 429 165 lekë** | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 26 644 718 lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data **09.10.2017 ora 12ºº** | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 8<br>b) Skualifikuar 3<br>c) Kualifikuar 5 | 10. Vlera e kontratës (me tvsh)<br>32 914 998 lekë |

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë hartuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit bazuar në unifikim e specifikimeve teknike nga Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara dhe bazuar në memon nr. 1175 prot, datë 12.09.2017 mbi përpunimin e të dhënave mbi procedurën e prokurimit "Blerje materialesh pastrimi". Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**

Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 8 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" SHPK | 27 429 165 | Kualifikuar | Ne vend të I-të |
| 2 | BOE "X" SHPK dhe " X" SHPK; | 32 308 470 | Kualifikuar | Ne vend të II-të |
| 3 | "X 2010" SHPK | 33 190 188 | Kualifikuar | Ne vend të III-të |
| 4 | "X" SHPK | 34 002 115 | Kualifikuar | Ne vend të IV-të |
| 5 | "X" SHPK | 37 865 981 | Kualifikuar | Ne vend të V-të |
| 6 | "X" SHPK | 22 278 832 | Skualifikuar | |
| 7 | - BOE "X" SHPK dhe "X" SHPK | 29 810 987 | Skualifikuar | |
| 8 | "X" SH.P.K | 23 777 761 | Skualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme nga 8 operatore janë kualifikuar 5 operator nga të cilët është shpallur fitues operatori ekonomike "X" SHPK me ofertën ekonomike në vlerën 27 429 165 lekë pa TVSH. Janë skualifikuar 3 operatorët, nga të cilët 2 kanë ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues. Konkretisht operatori "X" SHPK me ofertë ekonomike në vlerën 22 278 832 lekë, pa TVSH ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 5,150,333 lekë dhe operatori "X" SH.P.K me ofertë ekonomike në vlerën 23 777 761 lekë pa TVSH ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 3,651,404 lekë pa TVSH.

Këta operatorë janë skualifikuar nga KVO për këto arsye:

1. Operatori "X" SHPK

- Tërhequr nga procedura e prokurimit me shkresën protokolluar me tonën me nr. 1342 prot. datë 24.10.2017

**2.** "X"

- Nuk plotëson pikën 2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT, pasi rezulton se xhiroja mesatare për vitet 2015-2016 është më e ulët se vlera e fondit limit

Nga auditimi mbi ligjshmërinë skualifikimit të këtyre operatorëve rezultoi se, KVO i ka skuailifikuar BOE "X" në përputhje me rregullat e prokurimit publik sepse nuk plotësojnë kërkesat e veçanta të vendosura në Dokumentet e tenderit. Ndërsa operatori "X" është skualifikuar sepse është tërhequr vetë nga oferta e tij.

Megjithatë nisur nga ofertat ekonomike të operatorit të skualifikuar "X" i cili ka paraqitur në vlerë më të ultë se oferta ekonomike e fituesit, KVO mundë të tregohej edhe më tolerante duke i konsideruar mangësitë e konstatuara në dokumentacioni teknik të këtij operatori si devijime të vogla. Kështu mundë të kishim menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore që shkojnë në vlerën 4,381,684 lekë,me TVSH.

**8.** Procedurën e prokurimit publik me objekt: "Furnizim me karburante në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë" ndarë në katër lote, **përkatësisht Loti II "Furnizim me lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial"**:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi Nr. 09 prot. datë 23.03.2017<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar", me mjete elektronike" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>z. X<br>z. X<br>znj. X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Z. X<br>Z. X<br>Z. X<br>Z. X<br>Znj. X |
| 5.Fondi Limit i Lotit II (pa tvsh)<br>313 543 344 lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>"X" sh.a<br>Vlera e ofertës, marzhi i fitimit i shprehur në përqindje 5.8% | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)....................lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 08.05.2017 | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender Loti II<br>"X" sh.a<br>"X" sh.a<br>"X" sh.a<br>X" sh.a<br>b) Skualifikuar<br>"X" sh.a<br>X" sh.a<br>c) Kualifikuar<br>"X" sh.a<br>"X" sh.a | 10. Vlera e pritshme e kontratës (me tvsh)<br>376,252,012 lekë |

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë marrë zyrtarisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, pranë Ministrisë së Financës. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**
Në tenderin e zhvilluar **Loti II: "Furnizim me lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial"** kanë marrë pjesë 4 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" sh.a | marzhi i fitimit i shprehur në përqindje 5.8% | Kualifikuar | Ne vend të I-të |
| 2 | "X" sh.a | marzhi i fitimit i shprehur në përqindje 23.7 % | Kualifikuar | Ne vend të II-të |
| 3 | "X" sh.a | marzhi i fitimit i shprehur në përqindje 3.7% | Skualifikuar | |
| 4 | "X" sh.a | marzhi i fitimit i shprehur në përqindje 19% | Skualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme nga 4 operatore janë kualifikuar 2 operator nga të cilët është shpallur fitues operatori ekonomike "X" sh.a me ofertën ekonomike me marzh të fitimit i shprehur në përqindje 5.8%. Janë skualifikuar 2 operator nga të cilët 1 ka ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues. Konkretisht operatori "X" sh.a me ofertë ekonomike me marzh të fitimit i shprehur në përqindje 3.7% ose me diference më të ulët se fituesi me marzh fitimi 2.6 %. Ky operator është skualifikuar nga KVO për këto arsye:
-Nuk plotëson pikën 5 të kapacitetit teknik pasi ka paraqitur vetëm një fletë analizë.
Fletë – analiza e paraqitur nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara në DST, nuk plotëson standartin ku distiliati që vlon deri në 350°C % (v/v) duhet të jetë minimumi 85 % v/v është zero.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë skualifikimit të këtyre operatorëve rezultoi se, KVO e ka skuailifikuar këta operatorë në përputhje me rregullat e prokurimit publik sepse nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara në DST.

**9.** Procedura e prokurimit publike me objekt **"BLERJE TONERA"** :

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi nr. 15 prot. datë 06.04.2017 | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Znj. X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave z. X |

| | | |
|---|---|---|
| 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit<br>"E hapur", me mjete elektronike" | Znj. X<br>Z X | z. X<br>z. X<br>znj. X<br>z. X<br>I ngarkuar për shqyrtyimin e ankesave:<br>**z. X** |
| 5.Fondi Limit (pa tvsh)<br>**91,985,132** lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>**BOE "X" shpk dhe "Interlogistik" Shpk**<br>**Vlera e ofertës 91 713 191 lekë** | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)<br>271 941 lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 10.05.2017 | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 2<br>b) Skualifikuar 1<br>c) Kualifikuar 1 | 10. Vlera e kontratës (me tvsh)<br>110 055 829.2 lekë |

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**
Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë hartuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit bazuar në unifikimin e specifikimeve teknike nga Drejtoria e Prokurimeve të Përqendruara. Me memon nr. 532/1 prot. datë 04.04.2017 të Drejtorisë së Prokurimeve të Përqendruara, është përllogaritur fondi limit i procedurës së prokurimit dhe të dhënat sasiore. Çmimet për njësi janë marrë nga testimi i tregut të kryer nga grupi i punës me memon nr. 1443/1 prot. datë 19.01.2017. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".
**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**

Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 2 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | BOE "X" shpk dhe "X" Shpk | 91 713 191 | Kualifikuar | Ne vend të I-të |
| 2 | "X" shpk | 75 888 800 | SKualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme nga 2 operatore është kualifikuar 1 operator nga të cilët është shpallur fitues operatori ekonomike BOE "X" shpk dhe "X" Shpk me ofertën ekonomike në vlerën 91,713,191 lekë pa TVSH. Eshtë skualifikuar operatori tjetër i cili ka ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues. Konkretisht operatori "X" me ofertë ekonomike në vlerën 75,888,800 lekë, pa TVSH ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 15,824,391 lekë.

KVO, fillimisht, ne daten 24.05.2017, ka bërë vlerësimin e ofertave teknike të të dy operatorëve dhe I ka skualifikuar të 2 operatorët ekonomik, për mospërmbushje të kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Konkretish të 2 operatorët janë skualifikuar për këto arsye:

**1. Operatorë"X :**
-Nuk permbush piken 1 te kapacitetit ekonomik dhe financiar, (nuk arrin xhiron e kerkuar ne dst).
-Nuk permbush piken 1 te kapacitetit teknik, (nuk arrin vleren e furnizimeve te ngjashme te kerkuara ne dst).
-Formulari i ofertes nuk eshte plotesuar sipas sasise se percaktuar ne shtojcen 12 "Sasia dhe grafiku i levrimit"

**2. BOE "X" & "X" :**
-Nuk permbush piken 3 te kapacitetit teknik. Konkretsht, operatori Interlogistik nuk ka paraqitur katalogët për pjesët e tonerave qe do të ofrojnë të përcaktuara në marrëveshjen e bashkimit të operatëve.
Duhet theksuar se, kjo pikë e DT percakton se, *''operatorët ekonomik duhet të paraqesin katalog/broshure minimum një faqe, ku të shpreh qartë secilin lloj të tonerit që ofron (sipas tonerave në tabelën e përgjthëshme në shtojcën 12.sasia dhe grafiku"*

Të dy operatorët nuk kanë qënë dakort me skulifikimin e tyre dhe në zbatim të nenit 63, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" dhe kanë paqraqitur ankese në ABP. Konkretisht:
-BOE "X" & "X, në daten 26.05.2017 ka paraqitur ankese e cila është administruar në ABP me nr. 697 datë 26.05.2017,
-Operatori "X", ka paraqitur ankese e cila është administruar në ABP me nr. 712 datë 01.06.2017.

Titullari i ABP me urdherin nr.15/8, datë 29.05.2017 ka pezulluar procedurën dhe ka ngarkuar z. X për shqyrtimin e ankesave. Në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit z. Xka dalë me këtë rezultat se:

BOE "X" & "X", plotëson të gjitha kërkesat e vecanta në DT.Në lidhje me arsyen s skualifikimit që ''nuk permbush piken 3 te kapacitetit teknik, sqaron se, dokumenti katallog teknik është nënshkruar nga autoriteti ligjitim i BOE, përfaqësuesi i BOE ofertues dhe si i tillë ai është plotësisht i vlefshëm për efekt kualifikimi, së bashku me të gjitha dokumentat e tjera si oferta ekonomike deklaratat,etj. Pra ABP ka pranuar ankesën e tij duke e kualifikuar atë dhe me shkresën me shkresë nr. 697/1 datë 30.05.2017 i ka kthyer përgjigje që oferta e tij është kualifikuar.
Ndërsa për operatorin "X" ka marrë vendim që nuk i plotëson kërkesat e vecanta duke e skaulifikuar atë dhe me nr. 712/1 datë 07.06.2017 ABP i ka kthyer përgjigje se kërkesa nuk pranohet.

Në këto kushte, KVO ka bërë rikualifikimin duke rënditur në vend të parë, BOE "X" & "X" e cili është shallur edhe fitues për vlerën e ofertës 91,713,191 lekë, pa TVSH.

Mirëpo, nisur nga ofertat ekonomike të operatorëve të skualifikuar "X"që i ka paraqitura më të ulëta se BOE "X" & "X", jo vetëm KVO por edhe i ngarkuari për shqyrtimin e ankesave mundë të tregoheshin më tolerante duke i konsideruar mangësitë e operatorit "X si devijime të vogla. Kështu mundë të kishim menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore që shkojnë në vlerat nga 18,989,269 lekë, me TVSH.

**10.** Procedura e prokurimit publike me objekt "Furnizim me karburante në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë" ndarë në katër lote, **përkatësisht Loti IV "Furnizim me naftë F-76 (Klasa F)"**:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi Nr. 09 prot. datë 23.03.2017 | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit z. X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Z. XKOPAç |

| | | |
|---|---|---|
| 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar", me mjete elektronike" | z. X<br>znj. X | Z. X<br>Z. X<br>Z. X<br>Znj. X |
| 5.Fondi Limit i Lotit IV (pa tvsh)<br>401 690 316 lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>"X" sh.a,<br>Vlera e ofertës, marzhi i fitimit i shprehur në përqindje 13.7 % | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)....................lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 08.05.2017 | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender Loti IV<br>"X" sh.a<br>"X" sh.a<br>"X" sha<br>b) Skualifikuar<br>"X" sh.a<br>c) Kualifikuar<br>"X" sh.a<br>"X" sha | 10. Vlera e kontratës (me tvsh) 482,028,379 lekë, me TVSH |

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**
Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë marrë zyrtarisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, pranë Ministrisë së Financës. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**
Në tenderin e zhvilluar **Loti IV "Furnizim me naftë F-76 (Klasa F)"** kanë marrë pjesë 3 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" sh.a, | marzhi i fitimit i shprehur në përqindje 13.7 % | Kualifikuar | Ne vend të I-të |
| 2 | "X" sha | marzhi i fitimit i shprehur në përqindje 16.7% | Kualifikuar | Ne vend të II-të |
| 3 | "X" sh.a | marzhi i fitimit i shprehur në përqindje 7.5% | Skualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme nga 3 operatore janë kualifikuar 2 operator nga të cilët është shpallur fitues operatori ekonomike "X" sh.a me ofertën ekonomike me marzh të fitimit i shprehur në përqindje 13.7 %. Është skualifikuar 1 operator i cili ka ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues. Konkretisht operatori "X" sh.a me ofertë ekonomike me marzh të fitimit i shprehur në përqindje 7.5% ose me diference më të ulët se fituesi me marzh të fitimit 6.2 %.
Ky operator është skualifikuar nga KVO për këto arsye:

**Operatori "X":**

- Nuk është paraqitur sigurimi i ofertës i kërkuar në DST.
- Vërtetimi i OSHEE rezulton se ka detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.
- Nuk plotëson pikën 2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar pasi bilanci i vitit 2016 është i pa vulosur nga organet tatimore.
- Nuk plotëson pikën 1 të kapacitetit teknik pasi nuk plotëson vlerën për furnizime të ngjashme.
- Nuk plotëson pikën 5 të kapaciteti teknik pasi polica e sigurimit dhe leje e mjedisit për depozitën janë paraqitur fotokopje.
- Nuk plotëson pikën 7 të kapaciteti teknik pasi fletë analiza e paraqitur është jashtë afatit 30 ditor nga data e hapjes së tenderit.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë skualifikimit të këtyre operatorëve rezultoi se, KVO e ka skuailifikuar këta operatorë në përputhje me rregullat e prokurimit publik sepse, sic tregohet dhe më lartë nuk plotëson kreteret e përgjthëshme (nuk është paraqitur sigurimi i ofertës) dhe disa kërkesa të vecanta të vendosuara ne DT.

**11.** Procedura e prokurimit publike me objekt **"Shërbim Gatimi dhe Shpërndarje Ushqimi (Katering)" ndarë në 4 lote, Loti IV: "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Berat"**:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi Nr. 42 Prot. datë 03.11.2017<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit<br>"E hapur", me mjete elektronike" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Znj. X<br>Znj. X<br>z X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>z X<br>z. X<br>z X |
| 5. Fondi Limit i Lotit III (pa tvsh)<br>2,142,855 lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>"X" shpk<br>Vlera e ofertës 2 136 052.10 lekë | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)<br>6 802.9 lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 16/10/2017 | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender<br>"X" shpk<br>""X" shpk<br>b) Skualifikuar<br>"X" shpk<br>c) Kualifikuar<br>"X" shpk | 10. Vlera e kontratës (me tvsh) 2 563 262.52 lekë |

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**
Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë hartuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit bazuar në kërkesën e autoriteti kontraktor Spitali Berat. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi.

Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**

Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 2 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" shpk | 2 136 052.10 | Kualifikuar | Ne vend të I-rë |
| 2 | "X" shpk | 2 121 256 | Skualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme nga 2 operator është kualifikuar 1 operator, nga të cilët është shpallur fitues operatori ekonomike "X" shpk me ofertën ekonomike në vlerën 2,136,052.10 lekë, pa TVSH. Është skualifikuar 1 operator, i cili ka oferte ekonomike me të ulët se operatori fitues. Konkretisht operatori "X" me ofertë ekonomike në vlerën 2,121,256 lekë, pa TVSH ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 14,796.1 lekë
Ky operator është skualifikuar nga KVO se, nuk plotëson pikën 1, të Kapacitetit Teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim pasi kontratat e paraqitura janë kontrata për furnizimin me mallra ushqimore, nuk janë kontrata shërbim katering.

**12.** Procedura e prokurimit publike me objekt **"Rrjeti I Komunikimit Online I Shërbimit Të Gjendjes Civile"** :

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi Nr. 25 Prot., datë 17.07.2017<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapur", me mjete elektronike" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>ZnjX<br>Z. X<br>z. X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>z. X<br>z. X<br>z. X<br>znj. X XHODAJ |
| 5.Fondi Limit (pa tvsh)<br>**170 762 856.4** lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>**"X" shpk Vlera e ofertës 149 946 210 lekë** | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 20 816 646.4 .lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data **16.08.2017** | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 5<br>b) Skualifikuar 4<br>c) Kualifikuar 1 | 10. Vlera e kontratës (me tvsh)<br>179 935 452 lekë |

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**
Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë hartuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit bazuar në shkresën nr. 1356/8 prot., datë 20.03.2017 nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka kërkuar të kryhet procedura e prokurimit me objekt "Rrjeti i komunikimit online i shërbimit të Gjendjes Civile", me fond limit 170 762 856.4 (njëqind e shtatë dhjetë milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e tetëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë katër) lekë pa TVSH. Në zbatim të neni 61, pika 2 dhe nenit 73, pika 2 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me shkresën nr. 871 prot. datë 05.07.2017 i është kërkuar DPGJC-së përcaktimin e kritereve teknike dhe profesionale të kualifikimit për këtë procedurë prokurimi. Me shkresën nr. 871/1 datë 17.07.2017, Drejtoria e

Përgjithshme e Gjendjes Civile ka dërguar kriteret teknike dhe profesionale të përgatitura nga specialistët e DPGJC-së.
. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**

Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 5 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" shpk | **149 946 210** | Kualifikuar | Ne vend të I-të |
| 2 | "X" sha | 119 982 780 | SKualifikuar | |
| 3 | BOE "X" sha, dhe "X | 115 000 000 | Skualifikuar | |
| 4 | BOE "X" sha dhe "X" Shpk | 105 876 780 | Skualifikuar | |
| 5 | BOE "X" sha dhe "X" Shpk | 122 777 777 | Skualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme nga 5 operatore është kualifikuar 1 operator nga të cilët është shpallur fitues operatori ekonomike "X" shpk me ofertën ekonomike në vlerën 149 946 210 lekë pa TVSH. Janë skualifikuar 4 operatorët të cilët kanë ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues. Konkretisht operatori "X" sha me ofertë ekonomike në vlerën 119 982 780 lekë pa TVSH ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën **29 963 430 lekë**; BOE "X" sha, dhe "X" Sha me ofertë ekonomike në vlerën 115 000 000 lekë pa TVSH ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën **34 946 210 lekë**; BOE "X" sha dhe "X" Shpk me ofertë ekonomike në vlerën 105 876 780 lekë pa TVSH ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën **44 069 430 lekë** pa TVSH dhe BOE "X" sha dhe "X" Shpk me ofertë ekonomike në vlerën 122 777 777 lekë pa TVSH ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën **27 168 433 lekë** pa TVSH.
Këta operatorë janë skualifikuar nga KVO për këto arsye:

**1. Operatori "X" sha;**
-Nuk plotëson kriterin nr. 2 të kapaciteti teknik për kualifikim pasi nuk ka paraqitur bllokskemën totale te sistemit për zgjidhjet e ofruara për te gjithë teknologjitë që përdor dhe për sistemet "backup" qe do të përdorë për te garantuar qëndrueshmëri shërbimi 99,9%.
Nuk ka sqaruar, treguar dhe evidentuar arkitekturen e komunkimit me radio dhe mbulimin e territorit aty ku jane zyrat e gjendjes civile, si do te realizohet ky rrjet kryesor, kur dihet qe Shqiperia ka nje reliev teper te veshtire.
Nuk ka zgjidhje teknike për monitorimin online vizual te punës ne zyrat e gjendjes civile nga ambientet e DPGJC, nuk është treguar, evidentuar dhe pasqyruar ne propozimin teknik. Nuk ka parashikuar vlerën e "Storage" për të siguruar regjistrimin e informacionit për 45 ditë.

Përveç sa me sipër, zgjidhja teknike nuk është e plotë pasi nuk përcakton dhe detajon si do të realizojë dhe funksionojë sistemi "backup" që do të përdorë.
Mosrealizimi i një sistemi "backup" nuk garanton qëndrueshmërinë dhe vë në rrezik të plotë komunikimin online të shërbimit të gjendjes civile.
*Gjithashtu, dihet që sistemi "backup" ka edhe një kosto shumë të lartë, pothuajse të barabartë me koston e sistemit online kryesor, e cila do pasqyrohej dhe do te kishte peshë te madhe ne ofertën ekonomike te operatorit.*
Per sa me siper shoqeria nuk ka paraqitur, shpjeguar dhe detajuar integrimin e teknologjive që perdor, pajisjet kryesore me IP perkatese, duke mos garantuar keshtu qendrueshmeri sherbimi 99,9% dhe duke mos patur sisteme transmetimi të një sigurie shumë të lartë, duke bërë që të mos realizohet objektivi i pergjithshem dhe qellimi i ketij prokurimi.
-Nuk plotëson kriterin nr. 3 të kapaciteti teknik
-Nuk plotëson kriterin nr. 7 të kapacitetit ligjor
-Nuk plotëson kriterin nr. 8 të kapaciteti teknik
-Nuk plotëson kriterin nr. 9 të kapaciteti teknik
-Nuk plotëson kriterin nr. 10 të kapaciteti teknik
-Nuk plotëson kriterin nr. 12 të kapaciteti teknik
-Nuk plotëson kriterin nr. 13 të kapaciteti teknik
-Nuk plotëson kriterin nr. 15 të kapaciteti teknik
-Nuk plotëson kriterin nr. 16 të kapaciteti teknik
-Nuk plotëson kriterin nr. 18 të kapaciteti teknik
-Nuk plotëson kriterin nr. 19 të kapaciteti teknik
-Nuk plotëson kriterin nr. 20 të kapaciteti teknik

**2. BOE ekonomikë "X" sha dhe "X" Sha**
-Në kundërshtim me Legjislacionin e Prokurimit Publik, shoqëria X ka paraqitur në tender dokumenta, të cilat nuk janë origjinale, si dhe nuk përmbajnë informacion të saktë. Kjo pasi, sipas dokumentacionit ka paraqitur kontratat e punës me të gjithë personat e stafit teknik, ku duket qartazi që janë fshirë pjesa e pagës, pra ka ndërhyrje në këto dokumenta, te cilat nuk janë të njëjta me origjinalin.
Gjithashtu, në kundërshtim me dokumentet e tenderit, nuk ka paraqitur ne tender listë pagesat për periudhën e kërkuar, pasi të gjitha këto dokumente nuk janë të sakta, pasi janë fshirë.
Gjithashtu, noteri ka bërë noterizimet e këtyre dokumentave, duke përcaktuar që janë te njëjta me origjinalin, ndërkohë që nuk janë dokumenta të njëjta me origjinalin.
Për sa më sipër, nuk plotëson kriterin nr. 5 dhe 6 të kapaciteti teknik për kualifikim, lidhur me të paktën 20 inxhinierë, pasi nuk ka paraqitur të sakta, kontratat e punës me operatorin ekonomik (5) dhe listëpagesat për muajt e kërkuar (6).
-Shoqeria "X" nuk plotëson kriterin nr. 21 të kapaciteti teknik për kualifikim per rastin e teknologjise 3G/4G te kompanise celulare pasi nuk ka plotesuar kërkesn e mëposhtme
✓ Të dokumentojë sinjalin e mbulimit për çdo zyrë të gjendjes civile
Mosplotesimi i kesaj kerkese e ben te papranueshme zgjidhjen që ka dhene per sistemin "backup" me 2G/3G/4G duke mos garantuar qëndrueshmërinë e shërbimit në 99,9%.
-Nuk plotëson kriterin nr. 2 të kapaciteti teknik për kualifikim pasi nuk ka paraqitur bllokskemën totale të sistemit për zgjidhjet e ofruara për te gjithë teknologjitë që përdor dhe për sistemet "backup" që do të përdorë për te garantuar qëndrueshmëri shërbimi 99,9%.
Përveç sa me sipër, zgjidhja teknike nuk është e pranueshme.
Zgjidhja teknike nuk është e plotë pasi nuk përcakton saktë dhe detajon si do të realizojë dhe funksionojë sistemi "backup" ne gjithe territorin e Shqiperise, aty ku ndodhen zyrat e gjendjes civile. Gjithashtu Shoqëria "X" nuk ploteson kriterin 21 te kapacitetit teknik per teknologjine që do të përdorë, për zgjidhjen "backup". Zgjidhja "backup" eshte e papranueshme pasi teknologjioa 2G ka shpejtesi transmetimi te dhenash shume here me te vogel se ajo e kerkuar dhe kjo teknologji

e ka te pamundur transmetimin video por suporton vetem sherbime voice, data dhe tekst, pra nuk ploteson kerkesat per rrjetin e komunikimit online te gjendjes civile.
Nuk ka sqaruar, treguar dhe evidentuar arkitekturen e komunkimit me radio dhe mbulimin e territorit aty ku jane zyrat e gjendjes civile, si do te realizohet ky rrjet kryesor, kur dihet qe Shqiperia ka nje reliev teper te veshtire.
Per sa me siper bashkimi i operatoreve nuk ka paraqitur, shpjeguar dhe detajuar integrimin e teknologjive që perdor, pajisjet kryesore me IP perkatese, duke mos garantuar keshtu qendrueshmeri sherbimi 99,9% dhe duke mos patur sisteme transmetimi të një sigurie shumë të lartë, duke bërë që të mos realizohet objektivi i pergjithshem dhe qellimi i ketij prokurimi

**3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "X" sha dhe "X Shpk**
-Nuk plotëson kriterin nr. 3 të kapaciteti teknik për kualifikim pasi nuk ka paraqitur ne listën e detajuar për çdo zyre të gjendjes civile:
- ✓ Modelin e pajisjes fundore qe do te vendoset ne çdo zyre per teknologjite qe perdor

Nuk plotëson kriterin nr. 2 të kapaciteti teknik për kualifikim pasi nuk ka paraqitur bllokskemën totale të sistemit për zgjidhjet e ofruara për te gjithë teknologjitë që përdor dhe për sistemet "backup" që do të përdorë për te garantuar qëndrueshmëri shërbimi 99,9%.
Përveç sa me sipër, zgjidhja teknike nuk është e pranueshme.
Zgjidhja teknike nuk është e plotë pasi nuk përcakton saktë dhe detajon si do të realizojë dhe funksionojë sistemi "backup" ne gjithe territorin e Shqiperise, aty ku ndodhen zyrat e gjendjes civile.
Bazuar ne listen e detajuar sipas zyrave te gjendjes civile te deklaruar per sinjalin e mbulimit rezulton se:

a. 27 zyra te gjendjes civile (Labinot Mal, Kukur, Tunje, Stravaj, Pogon, Luftinje, Shishtavec, Topojan, Zapod, Lure, Sllove, Ostren, Martanesh, Cepan, Liqenas, Dardhas, Proptisht, Trebinje, Velcan, Lumas, Shengjergj, Iballe, Gjegjan, Kelmend, Brataj, Hore Vranisht) mbulohen vetem me sinjal GSM dhe jo me 3G apo 4G.
b. 3 zyra te gjendjes civile (Pult, Potom, Gure) nuk mbulohen fare me sinjal, as me GSM.

Nderkohe te zgjidhja teknike qe keni paraqitur, te lista e zyrave te gjendjes civile thuhet se Lidhja fizike "Backup" edhe per keto 30 zyra te gjendjes civile eshte 3G/4G qe bie ndesh me realitetin. Zgjidhja "backup" eshte e papranueshme pasi teknologjia 2G ka shpejtesi transmetimi te dhenash shume here me te vogel se ajo e kerkuar dhe kjo teknologji e ka te pamundur transmetimin video por suporton vetem sherbime voice, data dhe tekst, pra nuk ploteson kerkesat per rrjetin e komunikimit online te gjendjes civile.
Ne faqen nr. 6 te propozimit teknik deklaroni se "X deklaron se rrjeti qe do te perdoret per ofrimin e sherbimit ndaj zyrave te gjendjes civile eshte totalisht prone e X" kurse ne faqen nr. 55 deklaroni rrjetin dhe sherbimin e nje kompanie tjeter, te "X", gje qe tregon per nje deklarate te papergjegjeshme te X se rrjeti qe do te perdoret eshte totalisht prone e tij.
Nuk ka sqaruar, treguar dhe evidentuar arkitekturen e komunkimit me radio dhe mbulimin e territorit aty ku jane zyrat e gjendjes civile, si do te realizohet ky rrjet kryesor, kur dihet qe Shqiperia ka nje reliev teper te veshtire.
Nuk ka zgjidhje teknike për monitorimin online vizual te punës ne zyrat e gjendjes civile nga ambientet e DPGJC, nuk është treguar, evidentuar dhe pasqyruar ne propozimin teknik. Nuk ka parashikuar vlerën e "Storage" për të siguruar regjistrimin e informacionit për 45 ditë. Nuk eshte treguar dhe pasqyruar softëare i menaxhimit te pamjeve, mdouli server, moduli klient, moduli mobile dhe ëeb, por as serverat dhe storage qe jane te nevojshem per monitorimin online. Jane paraqitur vetem katalogет per kamera, monitor, ëorkstation dhe mikrofon.
Per sa me siper bashkimi i operatoreve nuk ka paraqitur, shpjeguar dhe detajuar integrimin e teknologjive që perdor, pajisjet kryesore me IP perkatese, duke mos garantuar keshtu qendrueshmeri sherbimi 99,9% dhe duke mos patur sisteme transmetimi të një sigurie shumë të lartë, duke bërë që të mos realizohet objektivi i pergjithshem dhe qellimi i ketij prokurimi.

**4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "X" sha dhe "X" Shpk**

-Në kundërshtim me Legjislacionin e Prokurimit Publik, shoqëria X ka paraqitur në tender dokumenta, të cilat nuk janë origjinale, si dhe nuk përmbajnë informacion të saktë. Kjo pasi, sipas dokumentacionit ka paraqitur kontratat e punës me të gjithë personat e stafit teknik, ku duket qartazi që janë fshirë pjesa e pagës, pra ka ndërhyrje në këto dokumenta, te cilat nuk janë të njëjta me origjinalin.

Gjithashtu, në kundërshtim me dokumentet e tenderit, nuk ka paraqitur ne tender listë pagesat për periudhën e kërkuar, pasi të gjitha këto dokumente nuk janë të sakta, pasi janë fshirë.

Gjithashtu, noteri ka bërë noterizimet e këtyre dokumentave, duke përcaktuar që janë te njëjta me origjinalin, ndërkohë që nuk janë dokumenta të njëjta me origjinalin.

Sa më sipër, nuk plotëson kriterin nr. 5 dhe 6 të kapaciteti teknik për kualifikim, lidhur me të paktën 20 inxhinierë, pasi nuk ka paraqitur të sakta, kontratat e punës me operatorin ekonomik (5) dhe listëpagesat për muajt e kërkuar (6).

-Në kundërshtim me nenin 74 të VKM Nr. 914, datë 29,12.2014 për miratimin e rregullave te prokurimit publik, Shoqëria "X" nuk plotëson në raport me përqindjen e marrë përsipër, numrin e punonjësve. Konkretisht ka me pak se 35 punonjës, maksimumi 26 punetore, ndërkohë duhej të kishte 35 punonjës, referuar kjo kontratës se bashkëpunimit ku ka marrë përsipër të realizoje 35% të këtij shërbimi. Pra, 35% i 100 punonjësve të kërkuar është 35. Në dispozitën e sipërcituar parashikohet se të gjitha kriteret specifike për kualifikim, duhet të plotësohen në raport me përqindjen e marrë përsipër sipas kontratës së bashkëpunimit. Nuk plotëson kriterin nr. 6 të kapaciteti teknik për kualifikim.

-Nuk plotëson kriterin nr. 3 të kapaciteti teknik për kualifikim pasi nuk ka paraqitur ne listën e detajuar për çdo zyre të gjendjes civile:

- ✓ Modelin e pajisjes fundore qe do te vendoset ne çdo zyre per teknologjite qe perdor
- ✓ Modelin e kamerës se vendosur ne çdo zyre.

-Nuk plotëson kriterin nr. 15 të kapaciteti teknik për kualifikim pasi te gjitha manualet e pajisjeve dhe softëare-ve per sistemin e monitorimit me kamera nga Shoqëria "X" jane te paperkthyera dhe te panoterizuara.

-Nuk plotëson kriterin nr. 21 të kapaciteti teknik për kualifikim per rastin e teknologjise 3G/4G te kompanise celulare "Plus" pasi nuk ka plotesuar kërkesat e mëposhtme :

- ✓ Të dokumentojë zonën e mbulimit te rrjetit ku ka te shtrire aktivitetin e tij .
- ✓ Të dokumentojë sinjalin e mbulimit për çdo zyrë të gjendjes civile

-Nuk plotëson kriterin nr. 2 të kapaciteti teknik për kualifikim pasi nuk ka paraqitur bllokskemën totale të sistemit për zgjidhjet e ofruara për te gjithë teknologjitë që përdor dhe për sistemet "backup" që do të përdorë për te garantuar qëndrueshmëri shërbimi 99,9%.

- ✓ Përveç sa me sipër, zgjidhja teknike nuk është e pranueshme.
- ✓ Zgjidhja teknike nuk është e plotë pasi nuk përcakton saktë dhe detajon si do të realizojë dhe funksionojë sistemi "backup" ( Kompania "X" nuk ploteson kriterin 21 te kapacitetit teknik) që do të përdorë, përfshirë këtu edhe zgjidhja "backup" për dark fiber e kërkuara për DPGJC, AKSHI dhe ALEAT. Nuk evidentohet dhe sqarohet arkitektura e këtij sistemi "backup" me qellim kryesor që të arrihet të kufizohen ndërprerjet dhe te garantoje qëndrueshmërinë. Nuk verteton dhe dokumenton se cilet do te jene gjurmet e lidhjeve me dark fiber ne drejtime te ndryshme ne Tiranë dhe duke mos evidentuar dhe saktësuar venddodhjet e dy sit-eve, primar dhe sekondar.
- ✓ Nuk evidenton dhe provon se rrjeti i "X" ka një shtrirje të gjerë në gjithe Shqipërine. Bazuar ne autorizimin individual te AKEP per "X", "Per caktim dhe perdorim frekuncash per lidhje fikse. Per sisteme pike-pike", zonat e mbulimit jane vetem per Tirane, Elbasan, Lushnje, Berat, Lezhe, Shkoder.
- ✓ Nuk ka zgjidhje teknike për monitorimin online vizual te punës ne zyrat e gjendjes civile nga ambientet e DPGJC, nuk është treguar, evidentuar dhe pasqyruar ne propozimin teknik. Nuk ka parashikuar vlerën e "Storage" për të siguruar regjistrimin e informacionit për 45 ditë. Nuk eshte treguar dhe sqaruar se transmetimit i te dhënave online dhe monitorimi online vizual i

punës ne Zyrat e Gjendjes Civile nga ambientet e DPGJC-se, do te realizohet ne te njëjtin rrjet komunikimi. Gjithashtu te gjitha manualet e pajisjeve dhe softëare-ve per sistemin e monitorimit me kamera jane te paperkthyera dhe te pa noterizuara duke mos plotesuar keshtu edhe kriterin nr. 15 të kapaciteti teknik.

- ✓ Per sa me siper bashkimi i operatoreve nuk ka paraqitur, shpjeguar dhe detajuar integrimin e teknologjive që perdor, pajisjet kryesore me IP perkatese, duke mos garantuar keshtu qendrueshmeri sherbimi 99,9% dhe duke mos patur sisteme transmetimi të një sigurie shumë të lartë, duke bërë qe te mos realizohet objektivi i pergjithshem dhe qellimi i ketij prokurimi.

-Operatori ekonomik nuk permbush piken 7 te kapacitetit teknik pasi ne dokumentacionin e paraqitur ne sistemin elektronik nuk ka paraqitur personel ne lidhje me certefikimet si : ËI-FI NETORK DESIGN Electronic Government, Rrjetat informatike ne Edukim & Kerkim, ADSL Advanced Management, IPV6 for LIRs dhe Training For Video Surveillance Product & Technology

Nga auditimi mbi ligjshmërinë skualifikimit të këtyre operatorëve rezultoi se, KVO e ka skuailifikuar këta operatorë në përputhje me rregullat e prokurimit publik sepse nuk plotësojnë një sërë kërkesash teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Megjithatë nisur nga ofertat ekonomike të operatorëve të skualifikuar që i kanë paraqitura më të ulëta se fituesit, dhe vacanarisht të BOE "X" dhe BOE "X" , KVO mundë të tregohej edhe më tolerante duke i konsideruar mangësitë e konstatuara në ofertat teknike të tyre, si devijime të vogla, sepse të dy këto kompani janë shumë të mirënjohura në fushën e teknologjisë së informacionit si në tregun vendas ashtu dhe në tregun e huaj ndërkombëtar. Kështu mundë të kishim menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore që shkojnë në vlerat nga 41,935,452 lekë në 52,883,316 lekë, me TVSH.

**13**. Gjithashtu, gjatë vitit 2017 auditimi me zgjedhje u vërejt se, në disa procedura prokurimi me fond limit të përgjthshëm **rreth 280,375,000 lekë, pa TVSH**, ka pasur konkurrencë minimale duke marrë pjesë vetëm një operatore ekonomik dhe në disa procedura të tjera nuk kanë marrë pjesë fare operatorë ekonomik apo kanë marrë pjesë operatorë të cilit nuk plotësonin specifikimet teknike të mallrave dhe shërbimeve apo kërkesat e veçanta e për pasojë janë skualifikuar nga procedurat dhe në kushtet e mungesës së konkurrencë në mbështetje te nenit 97 te LPP këto procedura janë anuluar. Më poshtë po trajtojmë disa prej tyre:

**13.1.** Procedura e prokurimit publike me objekt **Loti III "Blerje uniforma, veshmbathje dhe elemente të tjera, përbërëse të tyre për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave"** të realizuar në vitin 2017:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi Nr. 19 datë 13.04.2017<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapur", me mjete elektronike" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>z X<br>z X<br>znj. X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Znj. X<br>z. X<br>z. X<br>z. X<br>znj. X |
| 5.Fondi Limit të Lotit III (pa tvsh)<br>**32 369 409** lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>**"................" Sh.p.k**<br>**Vlera e ofertës ................... lekë** | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)....................lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 08/05/2017 | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender<br>"X" shpk<br>"X" shpk<br>"XI" shpk<br>"X" shpk<br>b) Skualifikuar<br>"X" shpk | 10. Vlera e kontratës (me tvsh) ................ lekë |

| | | |
|---|---|---|
| | "X" shpk<br>"X" shpk<br>"X" shpk<br><br>c) Kualifikuar | |

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**
Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë hartuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".
**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi.

Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**
Në tenderin e zhvilluar **Loti III "Blerje uniforma, veshmbathje dhe elemente të tjera, përbërëse të tyre për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave"** kanë marrë pjesë 4 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" shpk | 0 | Skualifikuar | |
| 2 | "X" shpk | 24 952 000 | Skualifikuar | |
| 3 | "X" shpk | 23 830 200 | Skualifikuar | |
| 4 | "X" shpk | 32 018 000 | Skualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme nga 4 operatore janë skualifikuar të 4 operatorët pjesëmarrërës. Këta operatorët janë skualifikuar nga KVO për këto arsye:

1. Operatori "X" shpk
   - Operatori ekonomik **"X" shpk,** nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

2. Operatori "X" shpk
   - Nuk ka paraqitur flete analizat për artikujt; "këmishë me mëngë te gjata" për te tre veshjet e kërkuara, "rripi pantallonash" për te tre veshjet e kërkuara, "triko golf" për një veshjet, "pulovër" për dy veshjet e kërkuara, "shall" për veshjet ceremoniale për femra dhe "kollare" për një veshje te kërkuar, gjithashtu nuk ka paraqitur flete analize për "pantallona model kombat" dhe "jelek" për veshjen e antikondrabandes.

3. Operatori "X" shpk
   - Nuk plotëson piken 4 te kapacitetit teknik te kriteret e veçanta për kualifikim pasi nuk ka paraqitur ISO 28001 – 2007.

- Nuk ka paraqitur flete analizat për artikujt; "kapele model bejsbolli", "bluze polo" për veshjen antikontrabande meshkuj, "shall" për veshjet ceremoniale për femra dhe "kollare" për një veshje te kërkuar.

4. Operatori "X" shpk
- Nuk plotëson piken 1 (d) te kritereve te veçanta te kualifikimit pasi rezulton se ka detyrime te maturuara te energjisë elektrike për muajin mars.
- Nuk plotëson piken 1 te kapacitetit ekonomik dhe financiar pasi bilanci i paraqitur i vitit 2016 është i pacertefikuar nga autoritetet tatimore
- Nuk ka paraqitur flete analizat për artikujt; "kapele model bejsbolli", "bluze polo" për veshjen antikontrabande meshkuj dhe "shall" për veshjet ceremoniale për femra.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë e skualifikimit të këtyre operatorëve rezultoi se, KVO i ka skuailifikuar këta operatorë në përputhje me rregullat e prokurimit publik dhe në kushtet e mungesës së konkurrencës në mbështetje të nenit 97 "Anulimi i një procedure prokurimi' të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" kjo procedurë është anuluar.

**13.2.** Procedura e prokurimit publike me objekt **"Blerje uniformash, veshmbathjesh dhe elementesh të tjera, përbërëse të tyre", Loti II "Blerje uniforma, veshmbathje dhe elemente të tjera, përbërëse të tyre për Gardën e Republikës"** të realizuar në vitin 2017:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi Nr. 19 datë 13.04.2017<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit<br>"E hapur", me mjete elektronike" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>z X<br>z X<br>znj. X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Znj. X<br>z. X<br>z. X<br>z. X<br>znj. X |
| 5.Fondi Limit për Lotin II (pa tvsh)<br>10 176 543 lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>"................" Sh.p.k<br>Vlera e ofertës ................... lekë | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)....................lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 08.05.2017 | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender<br>"X" shpk<br>"X" shpk<br>b) Skualifikuar<br>"X" shpk<br>"X" shpk<br>c) Kualifikuar | 10. Vlera e kontratës (me tvsh) ................ lekë |

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**
Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë hartuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**
Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 2 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" shpk | 0 | Skualifikuar | |
| 2 | "X" shpk | 10 150 200 | Skualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme nga 2 operatore janë Skualifikuar të 2 operatorët pjesëmarrës. Këta operatorët janë skualifikuar nga KVO për këto arsye:
1. Operatori "X" shpk
- Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

2. Operatori "X" shpk
- Nuk ka paraqitur flete analize për artikullin berete te kostumi për shërbime stërvitje.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë e skualifikimit të këtij operatori rezultoi se, KVO i ka skuailifikuar këtë operatorë në përputhje me rregullat e prokurimit publik dhe në kushtet e mungesës së konkurrencës në mbështetje të nenit 97 "Anulimi i një procedure prokurimi' të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" kjo procedurë është anuluar.

**13.3.** Procedura e prokurimit publike me objekt **"Blerje këpucë", për Lotin II "Blerje këpucë për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave"** të realizuar në vitin 2017:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi Nr. 17 datë 10.04.2017<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit<br>"E hapur", me mjete elektronike" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Znj. X<br>z. X<br>z X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Znj. X<br>z X<br>z X |
| 5.Fondi Limit të Lotit I (pa tvsh)<br>**4 747 578** lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br><br>**"................" Sh.p.k**<br><br>**Vlera e ofertës .................... lekë** | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)....................lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 10.05.2017 | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender<br>"X" PF<br>"X" shpk<br>"X" shpk<br>"X" shpk<br><br>b) Skualifikuar<br>"X" PF<br>"X" shpk<br>"X" shpk<br>"X" shpk<br><br>c) Kualifikuar | 10. Vlera e kontratës (me tvsh) ................ lekë |

Nga auditimi u konstatua:
**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë hartuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**
Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 4 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | “X” PF | 3 382 100 | Skualifikuar | |
| 2 | “X” shpk | 4 012 950 | Skualifikuar | |
| 3 | “X” shpk | 3 378 200 | Skualifikuar | |
| 4 | “X” shpk | 2 574 000 | Skualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme nga 4 operatore nuk është kualifikuar asnjë. Janë skualifikuar 4 operatorët.
Këta operatorët janë skualifikuar nga KVO për këto arsye:
1. Operatori “X” PF

1. Operatori ekonomik “X” person fizik me nr. NIPT K97730102T, me ofertë ekonomike 3 382 100 (tre milion e treqind e tetëdhjetë e dy mijë e njëqind) lekë pa TVSH, nuk përmbush kriteret e mëposhtme:
- Në analizat e paraqitura për lëndën e parë ndërtuese të pjesë së brendshme të këpucës antikondrabande M/F (antikondrabande M/F OXFORD ose KOMBAT sipas specifikimeve teknike) ka sjellë vetëm karakteristikën antistatike, qëndrueshmërinë ndaj abrazionit, 100% poiliester, përcaktimin e trashësisë, qëndrueshmërinë dhe elasticitetin në grisje sipas bazës dhe indit dhe nuk ka sjellë asnjë informacion tjetër sa i përket kërkesave teknike për këtë artikull në DST (shtojca 1) si është kërkuar në specifikimet teknike në DST për këtë lloj mostre të kërkuar në DST pika 5, kapaciteti teknik 2.3, e kritereve të veçanta të kualifikimit.
- Në analizat e paraqitura nuk ka sjelle asnjë analizë për lëndën e parë ndërtuese të pjesë së poshtme të këpucës (sholle gome) si është kërkuar në specifikimet teknike në DST për llojet e mostrave të kërkuara në DST pika 5 e kapacitetit teknik 2.3, kritereve të veçanta të kualifikimit.

2. Operatori “X” shpk
Operatori ekonomik “X” shpk me nr. NIPT K71804001C**,** me ofertë ekonomike 4 012 950 (katër milion e dymbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, nuk përmbush kriteret e mëposhtme:
- Nuk plotëson pikën 1 (d) të kritereve të veçanta të kualifikimit pasi ka detyrime të maturuara të energjisë elektrike të muajit mars.
- Nuk plotëson piken 2 të kapacitetit ekonomiko financiar pasi, bilanci i vitit 2016 është i pa certifikuar nga autoritetet tatimore.

- Në analizat e paraqitura për lëndën e parë ndërtuese të pjesë së brendeshme të këpucës antikondrabande M/F (antikondrabande M/F OXFORD ose KOMBAT sipas specifikimeve teknike) ka sjelle vetëm karakteristikën antistatike antibakteriale, qëndrueshmërisë ndaj abrazionit, 100% poliester, përcaktimin e trashësisë, qëndrueshmërinë dhe elasticitetin në grisje sipas bazës dhe indit dhe nuk ka sjelle asnjë informacion tjetër sa i përket kërkesave teknike për këtë artikull në DST (shtojca 1) si është kërkuar në specifikimet teknike në DST për këtë lloj mostre të kërkuar në DST pika 5 e kapacitetit teknik 2.3, kritereve të veçanta të kualifikimit.
- Në analizat e paraqitura nuk ka sjelle asnjë analize për lendën e parë ndërtuese të pjesës së poshtme të këpucës (sholle gome) si është kërkuar në specifikimet teknike në DST për llojet e mostrave të kërkuara në DST pika 5, kapaciteti teknik 2.3, kritereve të veçanta të kualifikimit.

3. Operatori "X" shpk
   Operatori ekonomik "X" shpk me nr. NIPT L31331006V**,** me ofertë ekonomike 3 378 200 (tre milion e treqind e shtatëdhjetë e tetëmijë e dyqind) lekë pa TVSH, nuk përmbush kriteret e mëposhtme:

- Nuk plotëson pikën 1 (d) të kritereve të veçanta të kualifikimit, pasi ka detyrime të maturuara të energjisë elektrike të muajit mars.
- Nuk plotëson pikën 2 të kapacitetit ekonomiko financiar pasi, bilanci i vitit 2016 është i pa certifikuar nga autoritetet tatimore.
- Në analizat e paraqitura për lendën e parë ndërtuese të pjesës së brendeshme të këpucës antikondrabande M/F (antikondrabande M/F OXFORD ose KOMBAT sipas specifikimeve teknike) ka sjelle vetëm karakteristikën antistatike, antibakteriale, qëndrueshmërisë ndaj abrazionit, 100% poliester, përcaktimin e trashësisë, qëndrueshmërinë dhe elasticitetin në grisje sipas bazës dhe indit dhe nuk ka sjelle asnjë informacion tjetër sa i përket kërkesave teknike për këtë artikull në DST (shtojca 1) si është kërkuar në specifikimet teknike në DST për këtë lloj mostre të kërkuar në DST pika 5 e kapacitetit teknik 2.3, kritereve të veçanta të kualifikimit.
- Në analizat e paraqitura nuk ka sjellë asnjë analizë për lëndën e parë ndërtuese të pjesës së poshtme të këpucës (shollë gome) si është kërkuar në specifikimet teknike në DST për llojet e mostrave të kërkuara në DST pika 5 e kapacitetit teknik 2.3, kritereve të veçanta të kualifikimit.

4. Operatori "X" shpk
   Operatori ekonomik "X" shpk me nr. NIPT K13112202Q**,** me ofertë ekonomike 2 574 000 (dy milion e pesëqind e shtatëdhjetë e katër mijë) lekë pa TVSH, nuk përmbush kriteret e mëposhtme:

- Në analizat e paraqitura për lëndën e parë ndërtuese të pjesë së brendëshme të këpucës antikondrabande M/F (antikondrabande M/F OXFORD ose KOMBAT sipas specifikimeve teknike) ka sjelle vetëm karakteristikën antistatike, antibakteriale, poliester, PH=3.2, përcaktimi i trashësisë, qëndrueshmëria e plasjes së faqes, qëndrueshmëria e këputjes së faqes dhe nuk ka sjelle asnjë informacion tjetër sa i përket kërkesave teknike për këtë artikull në DST (shtojca 1) si është kërkuar në specifikimet teknike në DST për këtë lloj mostre të kërkuar në DST pika 5 e kapacitetit teknik 2.3, kritereve të veçanta të kualifikimit.
- Në mostrën e paraqitur për artikullin këpucë antikondrabande M/F (antikondrabande M/F OXFORD ose KOMBAT sipas specifikimeve teknike) pranë Ministrisë se Punëve të Brendshme, në pjesën e brendshme të saj duket me sy të lirë që nuk është poliester.
- Në analizat e paraqitura nuk ka sjelle asnjë analizë për lendën e parë ndërtuese të pjesës së poshtme te këpucës (shollë gome) si është kërkuar në specifikimet teknike në DST për llojet

e mostrave të kërkuara ne DST pika 5 e kapacitetit teknik 2.3, kritereve të veçanta të kualifikimit.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë e skualifikimit të këtyre operatorëve rezultoi se, KVO i ka skuailifikuar këta operatorë në përputhje me rregullat e prokurimit publik dhe në kushtet e mungesës së konkurrencës në mbështetje të nenit 97 "Anulimi i një procedure prokurimi' të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" kjo procedurë është anuluar.

**4.** Procedura e prokurimit publike me objekt **Blerje këpucë", Loti I "Blerje këpucë për Gardën e Republikës"** të realizuar në vitin 2017:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi Nr. 17 datë 10.04.2017<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit<br>"E hapur", me mjete elektronike" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Znj. X<br>z. X<br>z X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>ZnjX<br>z X<br>z X |
| 5.Fondi Limit të Lotit I (pa tvsh)<br>**3 753 287** lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>**"................" Sh.p.k**<br>**Vlera e ofertës .................. lekë** | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)....................lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 10.05.2017 | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender<br>"X" PF<br>"X" shpk<br>b) Skualifikuar<br>"X" PF<br>"X" shpk<br>c) Kualifikuar | 10. Vlera e kontratës (me tvsh) ................ lekë |

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë hartuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**

Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 2 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" PF | 3 375 400 | Skualifikuar | |
| 2 | "X" shpk | 3 458 350 | Skualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme nga 2 operatore nuk është kualifikuar asnjë. Janë skualifikuar 2 operatorët.

Këta operatorët janë skualifikuar nga KVO për këto arsye:
1. Operatori "X" PF
-Operatori ekonomik "X" person fizik me nr. NIPT K97730102T, me ofertë ekonomike 3 375 400 (tre milion e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e katërqind) lekë pa TVSH, nuk përmbush kriterin e mëposhtëm:
Në analizat e paraqitura nuk ka sjelle asnjë analizë për lëndën e parë ndërtuese të pjesë së poshtme të këpucës (sholle gome) si është kërkuar në specifikimet teknike në DST për të katër llojet e mostrave të kërkuara në DST pika 5 e kapacitetit teknik 2.3, kritereve të veçanta të kualifikimit.
2. Operatori "X" shpk
-Operatori ekonomik "X" shpk me nr. NIPT K13112202Q, me ofertë ekonomike 3 458 350 (tre milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, nuk përmbush kriterin e mëposhtëm:
Në analizat e paraqitura nuk ka sjellë asnjë analizë për lëndën e parë ndërtuese të pjesë së poshtme të këpucës (sholle gome) si është kërkuar në specifikimet teknike në DST për të katër llojet e mostrave të kërkuara në DST pika 5 e kapacitetit teknik 2.3, kritereve të veçanta të kualifikimit.
Nga auditimi mbi ligjshmërinë skualifikimit të këtyre operatorëve rezultoi se, KVO i ka skuailifikuar këta operatorë në përputhje me rregullat e prokurimit publik dhe në kushtet e mungesës së konkurrencës në mbështetje të nenit 97 "Anulimi i një procedure prokurimi' të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" kjo procedurë është anuluar.

5. Procedura e prokurimit publike me objekt **"Blerje Automjete" ndarë në 2 lote, Loti I "Blerje automjete për Autoritetin e Mbikqyerjes së Lojrave të Fatit"** të realizuar në vitin 2017:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi nr. 36 datë 25.10.2017<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapur", me mjete elektronike" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>z X<br>znj. X<br>znj. X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>z. X<br>z. X<br>z. X |
| 5.Fondi Limit i Lotit I (pa tvsh)<br>2 083 333 lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>"................"<br>Vlera e ofertës ................... lekë | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)....................lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 22.11.2017 | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender<br>"X" shpk<br>"X" Shpk<br>b) Skualifikuar<br>"X" shpk<br>"X" Shpk<br>c) Kualifikuar | 10. Vlera e kontratës (me tvsh)<br>................ lekë |

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**
Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë hartuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi.

Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**
Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 2 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" shpk | 1 800 000 | SKualifikuar | |
| 2 | "X" Shpk | 0 | Skualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme nga 2 operatore janë skualifikuar të 2 operatorët pjesëmarrës. Këta operatorë janë skualifikuar nga KVO për këto arsye:
1. Operatori "X" shpk
- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument, përveç ofertës ekonomike, ekstraktit tregtar dhe atij historik.

2. Operatori "X" Shpk
- Operatori ekonomik "X" Shpk, nuk ka paraqitur ofertë ekonomike dhe asnjë dokument.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë e skualifikimit të këti operatori rezultoi se, KVO i ka skuailifikuar këtë operatorë në përputhje me rregullat e prokurimit publik dhe në kushtet e mungesës së konkurrencës në mbështetje të nenit 97 "Anulimi i një procedure prokurimi' të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" kjo procedurë është anuluar.

**6.** Procedura e prokurimit publike me objekt **"Shërbim Gatimi dhe Shpërndarje Ushqimi" ndarë në 4 lote, Loti II: "Reparti Ushtarak 4001 Kukës"** të realizuar në vitin 2017:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi Nr. 42 Prot. datë 03.11.2017<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit<br>"E hapur", me mjete elektronike" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Znj. X<br>Znj. X<br>z X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>z X<br>zX<br>z X |
| 5.Fondi Limit i Lotit II (pa tvsh)<br>**7,729,216** lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>Vlera e ofertës lekë | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 16/10/2017 | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender<br>"X" shpk<br>b) Skualifikuar<br>"X" shpk<br>c) Kualifikuar | 10. Vlera e kontratës (me tvsh) lekë |

Nga auditimi u konstatua:
**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**
Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë hartuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**
Në tenderin e zhvilluar ka marrë pjesë 1 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" shpk | 7 670 836 | Skualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme nga 1 operator nuk është kualifikuar asnjë operator. Është skualifikuar 1 operator.
Ky operator është skualifikuar nga KVO për këto arsye:

1. Operatori "X" :
Operatori ekonomik "X" shpk me nr. NIPT-i K11507003S me ofertë ekonomike 7 670 836 (shtatë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, nuk plotëson pikën 1, të Kapacitetit Teknik, te Kriteret e Veçanta për Kualifikim pasi kontratat e paraqitura janë kontrata për furnizimin me mallra ushqimore, nuk janë kontrata shërbim katering. Nga auditimi mbi ligjshmërinë e skualifikimit të këtij operatori rezultoi se, KVO i ka skuailifikuar këta operatorë në përputhje me rregullat e prokurimit publik dhe në kushtet e mungesës së konkurrencës në mbështetje të nenit 97 "Anulimi i një procedure prokurimi' të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" kjo procedurë është anuluar.

Sa sipër duket qartë se, nuk ka pasur interes nga operatorët ekonomik për të marrë pjesë në këto procedura, ndërkohë që mallrat dhe shërbimet si, blerja: uniformave, veshmbathjeve, këpucëve, karburanteve, autoveturave, shërbimit kateringut, etj, janë artikuj të bollshëm dhe veprimtari shumtë të mirënjohura në tregun vendas. Pra për furnizimin e këtyre mallrave dhe shërbimeve ka mjaftueshëm tregtar të vegjël dhe të mëdhenj që operojnë në tregun vendas, për pasoje duhet të kishte konkurrencë më të madhe në këto procedura prokurimi. Anulimi i një pjesë të madhe të procedurave të prokurimit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve të domosdoshme për ushtrimin normal të veprimtarive të Autoriteteve Kontraktore ka bërë që, për një pjesë të konsiderueshme të fondeve buxhetore nuk është arritur efiçenca dhe efikasiteti i procedurave të prokurimit, duke mos përmbushur kështu, qëllimin e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "për prokurimin Publik", i sanksionuar ne pikën "a, të nenit 1 te tij, në të cilin përcaktohet se: *"Qëllimi i këtij ligji është: të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore"*

- <u>**Ligjishmëria e procedurave të prokurimiteve publike të zhvilluara gjatë vitit 2018**</u>

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB) në MPB, si për vitin 2018 ka kryer auditim të hollësishëm në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara, me objekt äuditim përputhshmërie dhe financiar" per vitin 2018. Në këtë auditim ka konstatuar disa shkelje ligjore që lidhen kryesisht me ligjishmërine prokurimeve publike të realizuara gjatë këtij viti, të cilat i ka trajtuar hollësisht në raportin përfundimtarë të auditimit të përcjell në ABP, me shkresë nr.10357, datë09.04.2019. Për shkeljet e konstatuara në këtë dy auditimin, janë rekomanduar një sërë masash për zbatim nga

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara. Meqenëse, procedurat e prokurimit për vitin 2018 janë audituar nga vetë MB, me qëllim shmangien e mbivendosjes së auditiveve dhe respektimin e integritetit institucional të Auditimit të Brendshme, KLSH, në referim dhe bazuar në Standardin Ndërkombëtar të Auditimit "ISSAI 1610" e cili lejon: ***"Audituesin e jashtëm që të përdorë punën e auditimit të brendshëm për të modifikuar natyrën ose kohën, ose për të zvogëluar shkallën e procedurave të auditimit që duhet të kryhen drejtpërdrejt nga audituesi i jashtëm",*** merr të mirëqenë dhe mbështet konkluzionet e auditimit të kryera nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm.

Nisur sa sipër, auditimi u përqëndrua vetëm në procedurën e prokurimi me objekt "Blerje Karburanti, Përveç Jet A1" ndarë në 3 (Tre) Lote, si më poshtë:

**1.** Procedura e prokurimit publike me objekt: **Loti I, "Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)"** të realizuar në vitin 2018:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi 14/4 prot., datë 14.05.2018<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapur", me mjete elektronike" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>z. X<br>z X<br>z. X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Znj, X<br>Znj X<br>Znj. X |
| 5.Fondi Limit i Lotit I (pa tvsh)<br>**30 176 892** lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br><br>**BOE X**<br>**Vlera e ofertës (marzhi i fitimit 16.4 %)** | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)....................lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 14.05.2018 | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 1<br>b) Skualifikuar<br>ska<br>c) Kualifikuar 1 | 10. Vlera e kontratës (me tvsh) ................ lekë |

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**
Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë hartuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar ne baze te standardeve të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve dhe në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**
Në tenderin e zhvilluar ka marrë pjesë 1 operator ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e Ofertës (Marzh të fitimit të shprehur në përqindje) | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | BOE X | 16.4% | Kualifikuar | Ne vend të I-të |

Siç shihet në tabelën e mësipërme nga 1 operator pjesëmarrës është kualifikuar 1 operator nga të cilët është shpallur fitues operatori ekonomike BOE X me ofertën ekonomike (Marzh të fitimit të shprehur në përqindje) në vlerën 16.4% lekë, pa TVSH.
Nga auditimi mbi ligjshmërinë kualifikimit të këtyre operatorëve rezultoi se, KVO e ka kuailifikuar këta operatorë në përputhje me rregullat e prokurimit publik.

**2.** Procedura e prokurimit publike me objekt: **"Loti II "Furnizim me lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial"**:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi 14/4 prot., datë 14.05.2018<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapur", me mjete elektronike" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>z. X<br>z X<br>z. X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Znj, X<br>Znj X<br>Znj. X |
| 5.Fondi Limit i Lotit II (pa tvsh)<br>**3,879,721** lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>**"X" SHA**<br>**Vlera e ofertës (marzhi i fitimit) 15%** | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)....................lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 14.05.2018 | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 1<br>b) Skualifikuar<br>ska<br>c) Kualifikuar 1 | 10. Vlera e kontratës (me tvsh) ................ lekë |

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**
Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë hartuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar ne baze te standardeve të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve prane Ministrisë së Financave dhe në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**
Në tenderin e zhvilluar ka marrë pjesë 1 operator ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e Ofertës (Marzh të fitimit të shprehur në përqindje) | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" SHA | 15% | Kualifikuar | Ne vend të I-të |

Siç shihet në tabelën e mësipërme nga 1 operator pjesëmarrës është kualifikuar 1 operator nga të cilët është shpallur fitues operatori ekonomike "X" SHA me ofertën ekonomike (Marzh të fitimit të shprehur në përqindje) në vlerën 15% lekë, pa TVSH.
Nga auditimi mbi ligjshmërinë kualifikimit të këtyre operatorëve rezultoi se, KVO e ka kuailifikuar këtë operatorë në përputhje me rregullat e prokurimit publik.

**3.** Procedura e prokurimit publike me objekt: **Loti III "Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)"** të realizuar në vitin 2018:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi 14/4 prot., datë 14.05.2018<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit "E hapur", me mjete elektronike" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>z. X<br>z X<br>z. X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Znj, X<br>Znj X<br>Znj. X |
| 5.Fondi Limit i Lotit III (pa tvsh)<br>**10,341,341** lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>**(BOE) "X" SHPK**<br>**Vlera e ofertës (marzhi i fitimit) 17.4%** | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)....................lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 14.05.2018 | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender<br>(BOE) "X dhe "X" SHPK<br>b) Skualifikuar<br>ska<br>c) Kualifikuar<br>(BOE) "X" SHA dhe "X" SHPK | 10. Vlera e kontratës (me tvsh) ................ lekë |

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**
Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë hartuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit. Në përgjithësi specifikimet teknike janë hartuar ne baze te standardeve të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve dhe në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 27 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e punëve, ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**
Në tenderin e zhvilluar ka marrë pjesë 1 operator ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e Ofertës (Marzh të fitimit të shprehur në përqindje) | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | (BOE) "X | 17.4% | Kualifikuar | Ne vend të I-të |

Siç shihet në tabelën e mësipërme nga 1 operator pjesëmarrës është kualifikuar 1 operator nga të cilët është shpallur fitues BOE "X dhe "X" SHPK me ofertën ekonomike (Marzh të fitimit të shprehur në përqindje) në vlerën 17.4% lekë, pa TVSH.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë kualifikimit të këtyre operatorëve rezultoi se, KVO e ka kuailifikuar këtë operatorë në përputhje me rregullat e prokurimit publik.

*Në lidhje me problemet e trajtuara më sipër për të gjitha procedurat e prokurimeve të zhvilluara ne vitin 2017 dhe 2018, probleme këto të pasqyruara edhe në Projekt Raportin e Auditimit, nga ish-punonjës të larguar dhe punonjës aktual të ABP kane paraqitur disa observacione te cilat në mënyrë të përmbledhur konsistojnë, si me poshtë:*

*Në lidhje me këto gjetje, sikurse është konsatuar edhe nga ana juaj, rastet e skualifikimit të ofertuesve pjesëmarrës në këto procedura prokurimi, kanë qenë të argumentuara me mosparaqitjen e dokumentacionit ose mospërmbushjen e kritereve të përgjithshme ose kritereve minimale teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit të secilës procedurë, pra vlerësimi është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.*
*Në lidhje me "devijimet e vogla", sqarojmë se legjislacioni në fuqi për prokurimin publik ka vetëm një parashikim në pikën 4 të nenit 53 të LPP-së, e konkretisht: "4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.".*
*Pra, në lidhje me konsiderimin e mangësive të ofertave si devijime të vogla dhe shfaqjen tolerant ndaj këtyre mangësive gjatë vlerësimit të ofertave, për shkak të vlerës së ulët të ofertës, nuk ekzistojnë akte nënligjore apo akte të tjera rekomanduese, për rastet konkrete të mangësive të ofertave të cilat mund të konsiderohen "devijime të vogla" nga komisionet e vlerësimit të ofertave.*
*Për më tepër, sic rezulton edhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit të përcjellë me shkresën nr.10357, datë 09.04.2019, të Drejtorisë së Përgjithshme të Auditit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme, si dhe në Vendimin nr.63 datë 22.10.2019 të Agjencisë së Prokurimit Publik, për auditimin e zhvilluar në ABP për vitin 2018, janë konsideruar si kundërvajtje administrative dhe shkelje të pikës 4 të nenit 53 të LPP-së, rastet kur komisionet e vlerësimit të ofertave kanë konsideruar si devijime të vogla mangësi të ofertave, mosparaqitje dokumentacioni apo mospërmbushje të kritereve, me qëllim realizimin e procedurës dhe kualifikimin e ofertave me vlerën më të ulët.*

*Nga shqyrtimi i observacioneve dolem me konkluzionin se, këto observacione qendrojne pjesërisht dhe merren ne konsiderate vetëm në lidhje me përgjegjësitë, ndërsa si fenomen këto gjetje qëndrojnë. ABP dhe APP duhej te hartonin dhe unifikonin disa kritere minimale të kualifikimit per kontratat e mallra dhe shërbime që janë të njejta apo te ngjashme, me qellim minimizimin e skualifikimeve te operatorëve për mos plotesimin të disa kritereve te vecanta të cilat nuk ndikojne ne ekzekutimin e ketyre kontratave, kështu do të kishim një perdorim dhe menaxhim me efektivetiet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore.*

- **Ligjishmëria e procedurave të prokurimiteve publike të zhvilluara gjatë vitit 2019**

Për vitin 2019 Agjencia e Blerjeve të Përqendruara ka realizuar gjithsej 93 procedura prokurimi për furnizimin me mallra e shërbime me fond limit në total rreth 5,892,763,876 lekë dhe janë shpallur fitues dhe janë njoftuar Autoritetet Kontraktore për të lidhur kontrata në vlerën e përgjthëshme të pritshme rreth 5,650,324,240 lekë pa TVSH. Si pasojë e realizimit të procedurave të prokurimit, janë kursyer fonde buxhetore rreth 242,4239,936 lekë ose 4.2% të fondit total të prokuruar. Po kështu, gjate vitit, janë anuluar 43 procedura prokurimi të tjera të shpallur me fond limit rreth 1,073,942,016 lekë, që përbëjnë rreth 27% të 155 procedurave të publikuara (19 procedura janë publikuar por ofertat janë hapur në 2020). Nga 43 procedurat e anuluara, 26 prej tyre janë rishpallur dhe realizuar po gjatë vitit 2019, ndërsa 17 procedura prokurimi nuk janë realizuar që përbëjnë e 11% e procedurave të publikuara gjatë vitit 2019.

Auditimi kryer me zgjedhje u krye me zgjedhje vetëm për disa procedura prokurimi, konkretisht:

**Mbi procedurat e prokurimit të realizuara nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër:**

Auditimi ne lidhje me procedurat e prokurimit të realizuara nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër u krye me zgjedhje dhe u përqëndruar vetëm ne inpaktet negative që kanë ardhur nga zbatimi i udhëzimeve të APP për disa procedurat prokurimi që ofertimi i operatorëve ekonomikë është bërë me shumatoren e çmimeve për njësi si, më poshtë:

-Neni 35 "Marrëveshjet kuadër" i Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikon që, për kontratat publike, autoritetet kontraktore mund të lidhin një marrëveshje kuadër pas kryerjes së një procedure të hapur, të kufizuar, kërkesë për propozim, shërbim konsulence apo me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës. ***Palët në marrëveshjen kuadër zgjidhen duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.*** Neni 55 i ligjit ka të bëjë me "Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese" dhe shprehimisht përcakton se, *"oferta fituese duhet të jetë: a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit **me çmimin më të ulët**; ose b) oferta ekonomikisht më e favorshme......."*
-Neni 45 "Prokurimi i marrëveshjes kuadër"' i VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikon: **"***Marrëveshja kuadër prokurohet sipas këtyre rregullave. Ajo mund të lidhet vetëm pasi autoritetet kontraktore të kenë kryer një procedurë të hapur, të kufizuar, kërkesë për propozim, shërbim konsulence ose me negocim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës. Operatorët ekonomikë përzgjidhen si palë të marrëveshjes kuadër duke* ***zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, sipas përcaktimeve të nenit 55, të LPP-së****. Në çdo rast, autoriteti kontraktor mund të vendosë të vlerësojë ofertën/ofertat fituese* ***duke u bazuar në çmimin për njësi.*** *Autoriteti kontraktor harton dhe publikon* ***njoftimin e fituesit për një marrëveshje kuadër në përputhje me LPP-në dhe këto rregulla***.
Në zbatim të kësaj baze ligjore, Agjencia e Prokurimit Publik (APP) ka nxjerrë, Udhëzimin Nr.6 datë 16.01.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kudër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike". Në pikën 7.3 të këtij udhëzimi përcaktohet se: "*Në rastin kur vlerësimi i ofertës/ofertave fituese bëhet bazuar në çmimin për njësi, fondi limit do të jetë çmimi i përllogaritur për njësi për çdo artikull apo shërbim. Autoriteti kontraktor do të shpallë dhe zhvillojë procedurën e prokurimit me çmimin e përllogaritur për njësi dhe jo me një fond limit në total.* Kjo pike është ndryshuar me Udhëzim nr.15 datë 26.11.2018 "Për një ndryshim në Udhëzimin e APP nr.6 datë 16.01.2018", me këtë përmbajtje:
*"Në çdo rast autoriteti kontraktor planifikon më përafërsi sasinë dhe vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër, bazuar në eksperiencat e mëparshme me qëllim jo vetëm orientimin e operatorëve ekonomikë por edhe hartimin e kritereve për kualifikimin apo kërkesave të tjera të cilat lidhen përpjesëtimisht me fondin limit.* ***Fondi limit,*** *me të cilin autoriteti kontraktor do të shpallë procedurën e prokurimit është vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër. Hartimi i kritereve të veçanta për kualifikim si; kapacitetet teknike, ekonomike apo kritere të tjera të cilat lidhen me fondin do të përllogariten mbi vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen".*
*"Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj autoriteti kontraktor përveç vlerës së pritshme të kontratave do të përllogarisë* ***edhe shumatoren e çmimeve për njësi,*** *e cila duhet të publikohet së bashku me vlerën e pritshme të kontratave (fondi limit) në njoftimin e kontratës".*
*"Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj,* ***ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi. Për efekt krahasimi vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi të përllogaritur për çdo artikull apo shërbim nga autoriteti kontraktor".***

Siç duket, APP me Udhëzim nr.15 datë 26.11.2018 "Për një ndryshim në Udhëzimin e APP nr.6 datë 16.01.2018, ka urdhëruar dhe ka orientuar Autoritetet Kontraktore që, kur objekti i prokurimit (i marrëveshjes kuadër) përbëhet nga disa artikuj, ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me ***shumatoren e çmimeve për njësi dhe për efekt krahasimi vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi të përllogaritur për çdo artikull apo shërbim nga Autoriteti Kontraktor***. Mirëpo, përmbajtja e pikës 7.3 të udhëzimit bie në kundërshtim:

**1.** Me nenin 55 të Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i cili përcakton se: **"***Oferta fituese duhet të jetë: a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit* ***me çmimin më të ulët;***

**2.** Me nenin 45 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i cili përcakton se: **"***Operatorët ekonomikë përzgjidhen si palë të marrëveshjes kuadër duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, sipas përcaktimeve* ***të nenit 55, të LPP-së****. Në çdo rast, autoriteti kontraktor mund të vendosë të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar* ***në çmimin për njësi****. Autoriteti kontraktor harton dhe publikon njoftimin e fituesit për një marrëveshje kuadër në përputhje me LPP-në dhe këto rregulla.*

Pra, rregullat e prokurimit nuk përcaktojnë se, oferta fituese përzgjidhet apo mund të përzgjidhet për ***shumatoren e çmimeve për njësi më të ulët***, si kundër është përcaktuar në pikën 7.3 të Udhëzim nr.6 datë 16.01.2018, i ndryshuar, por përcaktojnë se, oferta fituese përzgjidhet apo mund të përzgjidhet për ***çmimin për njësi më të ulët***.

Përcaktimi i ofertës fitues bazuar në shumatoren e çmimeve për njësi, përveç se nga njëra anë rrit koston e blerjes se mallrave dhe shërbimeve të Autoriteteve Kontraktore në dëm të buxhetit të shtetit, por nga ana tjetër denatyron dhe bën të pa zbatueshme pothuajse një pjesë të mirë të procedurës dhe përmbajtjes së rregullave të prokurimit publik të sanksionuar në Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 dhe në VKM nr.914 datë 29.12.2014. Këto shkelje janë konstatuar rëndom, madje dhe janë reflektuar **me dëm ekonomik rreth 200 milion lekë për buxhetin e shtetit**, si pasojë e procedurave të prokurimit për marrëveshjet kuadër që, ABP ka realizuar gjatë vitit 2019, për blerjen e mallrave pasi, ofertat fituese në këto procedura janë përzgjedhur në zbatim të udhëzimit të sipërcituar, pra në bazë të shumatores së çmimit për njësi më të ulët. Konkretisht:

Neni 7 i VKM nr.82, datë 14.02.2018 "Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive, institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime", i ndryshuar me VKM nr.816, datë 31.12.2018, përcakton:

"Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP) duhet të prokurojë, nëpërmjet marrëveshjes kuadër, mallrat dhe shërbimet e vazhdueshme dhe /ose të unifikuara. *Kategoritë konkrete të mallrave dhe shërbimeve, të cilat do të prokurohen nëpërmjet marrëveshjes kuadër, përcaktohen sipas udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik"*. Në zbatim të këtij neni, APP ka nxjerrë Udhëzimin Nr. 8, datë 20.02.2018 "Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrave dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime" i cili më vonë është ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 10.01.2019. Në pikën 5 dhe 5.1, të këtij udhëzimi përcaktohet se:

- ABP prokuron nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, mallrat dhe shërbimet e vazhdueshme dhe/ose unifikuara, të cilat janë si më poshtë vijon:

1. Blerje karburanti, përveç vajgurit Jet A1;
2. Blerje materialesh kancelarie;
3. Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash;
4. Blerje materialesh të ndryshme për pastrim;
5. Blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike;
6. Blerje tonerësh;
7. Blerje artikuj ushqimorë;
8. Sigurim automjetesh;

9. Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi;
10. Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh;
11. Riparim, mirëmbajtje sistem ngrohje-ftohje;
12. Shërbime dezinfektimi;
13. Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike;
14. Mirëmbajtje impiante elektrikë.
15. Blerje uniforma dhe elemente të tjera përbërëse të tyre;
16. Blerje këpucë;
17. Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi;
18. Shërbim pastrimi;
19. Shërbim lyerjeje dhe mirëmbajtjeje ndërtesa.

-Në këtë rast, ABP duhet të përllogarisë fondin limit për mallrat dhe shërbimet që do të prokurojë për të gjitha autoritetet kontraktore.
Në çdo rast, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara planifikon me përafërsi sasinë dhe vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër bazuar në eksperiencat e mëparshme, me qëllim jo vetëm orientimin e operatorëve ekonomikë, por edhe hartimin e kritereve për kualifikimin apo kërkesave të tjera, të cilat lidhen përpjesëtimisht me fondin limit.
Fondi limit, me të cilin do të shpallet procedura e prokurimit është vlera e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër. Hartimi i kritereve të veçanta për kualifikim, si kapacitetet teknike ekonomike apo kritere të tjera, të cilat lidhen me fondin do të përllogariten mbi vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen.
Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, përveç vlerës së pritshme të kontratave ***do të përllogaritet edhe shumatorja e çmimeve për njësi***, e cila duhet të publikohet së bashku me vlerën e pritshme të kontratave (fondi limit) në njoftimin e kontratës.
Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, ***ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi. Për efekt krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi të përllogaritur për çdo artikull apo shërbim, nga autoriteti kontraktor.***
Siç duket edhe ne këtë udhëzim të veçantë që APP e ka nxjerrë vetëm për ABP, ka përsëritur dha ka përcaktuar të njëjtën përmbajtje si përmbajtja e pikës 7.3 të Udhëzim nr.6 datë 16.01.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes ..." (të trajtua më sipër).

Në zbatim të kësaj baze ligjore, ABP gjatë vitit 2019 ka realizuar 85 procedura prokurimi nëpërmjet marrëveshjes kuadër për blerjen e mallrave dhe shërbimeve për llogari të Autoriteteve Kontraktore me vlerë 5,817,567,129 lekë duke përdorur. Nga 85 procedurat 48 procedura (të ndara në Lote, shih tabelën bashkëlidhur) me vlerën totale **1,126,967,454** lekë janë për blerje mallrash, për të cilat fituesit janë përzgjedhur ***mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi,*** në zbatim të pikës 5 dhe 5.1 të Udhëzimin të APP Nr. 8, datë 20.02.2018, si:
Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash; blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike; blerje tonera; botime, printime dhe materiale shtypshkrimi; blerje uniforma dhe elemente të tjera përbërëse të tyre; blerje këpucë.
Ndërsa në rastet e procedurave të prokurimit të zhvilluara nëpërmjet marrëveshjes kuadër, për prokurimin e shërbimeve ABP, nuk ka aplikuar shumatoren e çmimeve për njësi si kriter vlerësimi.
Pavarësisht nga përcaktimet në udhëzimet e APP-së për aplikimin e shumatores së çmimeve për njësi, nga vetë ABP janë ngritur shqetësime dhe janë parashtruar problematikat që hasen gjatë ofertimit nga operatorët ekonomikë si dhe gjatë vlerësimit të ofertave, në rast se kriteri i vlerësimit të ofertave në dokumentet e tenderit do të përcaktohej nga ***"shumatorja e çmimeve për njësi më e ulët e ofruar"***. Kështu, në përputhje me Udhëzimin Nr.9 datë 29.03.2018 të APP "Për koordinimin e veprimtarisë së prokurimit publik me personin përgjegjës" si dhe ne mbështetje të pikës 2 të neni 61 të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014, që me fillimin e procedurës së parë të prokurimit me objekt "Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi" me datë 21.02.2019, përpara publikimit të njoftimit

të kontratës, ABP ka kërkuar asistencë nga APP. Konkretisht, i ka parashtruar se: nga ABP u gjykua që kjo procedurë prokurimi të realizohet nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër me të gjitha kushtet e përcaktuara dhe ***me kriter vlerësimi çmimin me të ulet të ofertave të dorëzuara dhe jo me shumatoren e çmimit për njësi*** për arsye se: në procedurën e prokurimit të realizuar nëpërmjet marrëveshjes kuadër ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, pra ku nuk ka një faze të dyte për minikonkurse, ***vendosja si kriter vlerësimi shumatoren e çmimeve për njësi nuk do te çonte në çdo rast në përzgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulet"***. Ndërsa APP i ka kthyer përgjigje në datë 21.02.2019, si më poshtë:

"Në lidhje me argumentimin Tuaj për vlerësimin e ofertave ekonomike, jo mbi shumatoren e çmimeve për njësi por mbi fondin limit total (çmim njësi x sasinë e pritshme të mallrave). Në rastin se APB-ës, si rrjedhim i informacionit që disponon, i rezulton se sasia e parashikuar e mallrave (për çdo rast/lot/institucion) do të lëvrohet plotësisht për çdo rast, atëherë vlerësimi i ofertave mbi çmimin total të ofruar (çmim njësi x sasinë e pritshme të mallrave) do të konsiderohej i saktë. Ndërkohë në rastin se sasitë e mallrave, janë sasitë e pritshme dhe janë vetëm sasi orientuese dhe nuk e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t'i blerë ato si dhe Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato te parashikuara (por ne çdo rast brenda vlerës se përllogaritur te marrëveshjes kuadër), si dhe përshkruhet në DT, atëherë sugjerojmë që AK ti referohet përcaktimeve të Rekomandimit nr.10419, datë 26.11.2018 të APP "Mbi përdorimin e marrëveshjes kuadër", **që ofertimi nga OE pjesëmarrës të behet mbi shumatoren e çmimeve për njësi dhe vlerësimi, për efekt krahasimi, do të bëhet mbi shumatoren e çmimeve për njësi.**"

Për sa më sipër, ABP ka zbatuar udhëzimet dhe rekomandimet e APP-së në lidhje me aplikimin e kriterit të vlerësimit bazuar në ***"shumatoren e çmimeve për njësi më të ulët të ofruar"*** për të gjitha blerjet e mallrave.

Nga ky veprim i APP:

-Nuk është zbatuar neni në 55 i Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 dhe neni 45 i VKM nr.914 datë 29.12.2014, për pasoje është rritur kosto e blerjes se mallrave në dëm të buxhetit të shtetit për **rreth 123,600 mijë lekë**;

-Është shkelur pika "d" e nenit 24 e LPP sepse disa oferta te paraqitura kanë tejkaluar fondin limit dhe nuk janë skualifikuar;

-Është shkelur dhe është bërë i pa zbatueshme neni 56 i LPP dhe neni 66 i VKM nr.914 datë 29.12.2014 për llogaritjen e ofertës anomalish e ulët, për pasoje është rritur kosto e blerjes së mallrave në dëm të buxhetit të shtetit **për rreth 72,388 mijë lekë**;

-Është shkelur dhe është bërë i pa zbatueshëm neni 63 i LPP dhe neni 78 i VKM pasi është denatyruar gjithë procesi i ankimit administrativ dhe i shqyrtimit të ankesave si dhe është bërë i pa zbatueshëm korrigjimin e gabimeve aritmetikore sipas përcaktimeve të nenit 53 të LPP dhe nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014.

Më poshtë pa trajtojmë më radhë shkeljet e sipërcituara të konstatuara nga auditimi:

**1.** Në tabelën e më poshtme tregohen prokurimet e realizuara për mallra nëpërmjet marrëveshjeve kuadër, ku pasqyrohen: **rastet e shpalljes së fituesve me vlera me të larta se operatoret e tjerë të kualifikuar dhe rastet ku fituesit apo operatorët e kualifikuar kanë paraqitur ofertat në vlerë më të larta se fondi limit**:

**Tabela 1.**

| Nr. | Objekti i prokurimit (mallra ose shërbime) | Fondi Limit | Vlera e Ofertës Fituese | Ofertuesi Fitues | Ofertues të tjerë të kualifikuar | Vlerat e Ofertave të tjera të kualifikuara | Vlerat totale te Ofertave të tjera të kualifikuara ( | Diferenca ndermjet fituesit dhe ofertes me te ulet te kualifikuar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Blerje Uniforma për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve - MK me afat 1 vit - shumatorja limit e cmimeve / njësi = 84,708 | **88,776,700** | **88,769,960** | **1. BOE "X" + "X" SRL - 51,600 (shumatorja e çmimeve / njësi)** | 1. X<br>2. BOE "X | 1) 54.750<br>2) 59.600 | 1) 87,979,850<br>2) 71,411,050 | 17,358,910.00 |
| 2 | Loti I. "Blerje dokumentacioni për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë" - MK 1 VIT , shumatorja e cmimeve per njesi= 2,500.83 lekë pa TVSH | **4,853,449** | **4,898,599** | **X<br>- 1,877.9 shumatorja e cmimeve/ njësi** | 1) X<br>2) X<br>3) X<br>4) X<br>5) X<br>6) X | 1) 2,395.4<br>2) 2,313.5<br>3) 2,483<br>4) 2,438.5<br>5) 2,007<br>6) 2,445.3 | 1) 9,367,780.1<br>2) 4,313,524<br>3) 4,493,107.8<br>4) 4,732,178<br>5) 10,181,249<br>6) 4,290,103.3 | 608,495.70 |
| 3 | Loti II. "Blerje dokumentacioni, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve" - MK 2 VJET, shumatorja e cmimeve per njesi =11,595.40 lekë pa TVSH | **3,049,809** | **3,044,701** | **X<br>- 8,539.98 shumatorja e cmimeve/ njësi** | 1) X<br>2) X<br>3) X<br>4) X<br>5) X<br>6)X<br>7) X | 1) 9,908.18<br>2) 11,530<br>3) 9,995<br>4) 11,216<br>5) 9,779<br>6) 10,922.5<br>7) 9,756 | 1) 2,114,230<br>2) 2,824,200<br>3) 2,217,235<br>4) 1,604,000<br>5) 2,831,018<br>6) 2,302,760<br>7) 2,979,850 | 1,440,701.00 |
| 4 | Loti III "Botime, printime dhe materiale shtypshkrimesh për Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" - MK 2 Vjet - shumatore limit e cmimeve / njësi - 7,918.80 | **12,698,122** | **12,698,122** | **X - 6,698 shumatorja e cmimeve/ njësi** | 1) X<br>2) X<br>3) X | 1) 7,540.6<br>2) 6,718.5<br>3) 7,766.9 | 1) 8,376,445<br>2) 7,783,570<br>3) 10,203,421 | 4,914,552.00 |
| 5 | Lotit IV "Blerje shtypshkrimesh" për Spitalin Universitarë Obstetrik - Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldina" - MK 2 VJET, shumatorja e cmimeve per njesi = 6,734.50 lekë pa TVSH | **1,637,000** | **1,636,621** | **X<br>- 5,003.13 shumatorja e cmimeve/ njësi** | 1) X<br>2) X<br>3) X<br>4) X<br>5) X | 1) 5.216,45<br>2) 6.382,8<br>3) 6.622<br>4) 5.734<br>5) 6.544,4 | 1) 1,616,964<br>2) 1,055,815<br>3) 511,650<br>4) 1,715,990<br>5) 1,284,177 | 1,124,971.00 |
| 6 | Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi per Spitalin Universitar të Traumës - MK me afat 1 vit - Kërkesë për Propozim - Shumatore e cmimeve / njësi = 6,705,.07 lekë pa TVSH | **4,163,734** | **4,094,400** | **X - 2.869 shumatorja e cmimeve për njësi.** | 1) X<br>2) X | 1) 4.427,05<br>2) 5.698,3 | 1) 2.676,180<br>2) 3,306,270 | 1,418,220.00 |
| 7 | Loti I - Blerje detergjent, dizinfektant dhe aromatizues - 28,067.99 shumatorja limit e cmimeve/ njësi. | **103,263,609** | **136,397,826** | **1) X - 15,309 (136,397,826)<br>2) X 2010 - 16,955 (71,153,414)<br>3) X- 17,169 (70,676,368)<br>(shumatorja e cmimeve/ njësi)** | BOE - X | 17,495 | 72,384,896 | 64,012,930.00 |
| 8 | Loti II - Blerje materiale të ndryshme për pastrim - Marrëveshje Kuadër me afat 2 vjet - shumatorja limit e cmimeve/ njësi - 35,974.7 | **2,646,651** | **5,034,707** | **1) X - 9.435 (1,934,450)<br>2X + X - 12.004 (2,284,486)<br>3) X - 14.159 (5,034,707)<br>(shumatorja e cmimeve/ njësi)** | 1) X<br>2) X | 1) 14.805<br>2) 17.900 | 1) 1,797,450<br>2) 2,588,815 | 3,237,257.00 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | Blerje pjese kembimi për automjete për shërbime profilaktike - Loti II "Blerje bateri për automjete" - MK me afat 2 vjet - shumatore limit e cmimeve / njesi = 418,198.31 lekë pa TVSH | **10,405,536** | **9,923,000** | **X - shumatore e cmimeve/ njësi = 325,800** | "X" | 1) 334775 | 1) 6,780,000 | 3,143,000.00 |
| 10 | Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash -Tender I Hapur - Marrëveshje kuadër me afat 12 muaj - Shumatorja limit e çmimeve/ njësi është 4,008,257 Lekë pa Tvsh | **81,041,227** | **77,718,100** | **X -shumatore limit e cmimeve / njesi =2,347,620** | 1) "X"<br>2) X"<br>3) "X"<br>4) "X | 1) 2,648,300<br>2) 3,860,180<br>3) 4,006,160<br>4) 3,899,170 | 1) 68,803,200<br>2) 79,266,450<br>3) 79,177,400<br>4) 78,712,030 | 8,914,900.00 |
| 11 | Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit -Kërkesë për Propozim - Marrëveshje kuadër me afat 12 muaj - Shumatorja limit e çmimeve/ njësi është 44.061,5 lekë pa TVSH | **940.082,5** | **701,900** | **X - shumatore e cmimeve / njesi = 22.900** | 1) "X<br>2) "X"<br>3) "X"<br>4) "X"<br>5) "X | 1) 33,300<br>2) 43,500<br>3) 39,000<br>4) 26,200<br>5) 30,800 | 1) 725,500<br>2) 864,500<br>3) 845,000<br>4) 599,400<br>5) 658,000 | 102,500.00 |
| 12 | Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash për Agjencinë e Prokurimit Publik - Kerkese per Propozim - Marreveshje kuader me afat 12 muaj - shumatore e cmimeve per njesi = 260,815 lekë pa TVSH | **802,617** | **624,400** | **X - shumatore e cmimeve / njesi =216,500** | 1) "X"<br>2) "X" | 1) 234900<br>2) 193,100 | 1) 707,800<br>2) 569,100 | 55,300.00 |
| **Totali :** | | **313,338,454** | **345,542,336** | | | | | **106,331,736.70** |

Siç shikohet nga tabelën e mësipërme janë konstatuar 12 raste që janë shpallur fitues operatorë që kanë paraqitur ofertat me të larta se operatorët e tjerë të kualifikuar.

Ky fenomen ka ndodhur sepse vlerësimi i ofertave dhe shpallje e ofertës fituese është bazuar në shumatoren e çmimeve për njësi. Për ta bërë më të qartë dhe më të kuptueshëm po analizojmë njërën nga procedurat e prokurimit të listuar më sipër, atë me numër rendor 1 (një):

Procedura e prokurimit me objekt: **"Blerje Uniforma për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve"** , nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, me afat 1 vit, me shumatore limit e çmimeve për njësi 84,708 lekë, me fondi limit në total 88,776,700 lekë.

Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomik. KVO në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës teknike i ka kualifikuar të tre këta operatorë. Në vijim të procedurës ka bërë vlerësimin e ofertave ekonomike bazuar në shumatoren e çmimeve për njësi të paraqitur nga te tre operatorët dhe ka bërë këtë klasifikim:

-Në vend te parë është renditur BOE "X" me shumatoren e çmimeve për njësi më të ulët, **në vlerën 51,600 lekë**;

-Në vend të dytë, operatori "X" me shumatoren e çmimeve për njësi **me vlerë 54,750 lekë**;

-Në vend te tretë BOE "X" me shumatoren e çmimeve për njësi **me vlerë 59,600 lekë**.

Kuptohet që, fitues në këtë procedurë është shpallur BOE "X" me shumatoren e çmimeve për njësi më të ulët se, dy operatorët e tjerë.

Nga llogaritjet që i bëmë ofertave të tre operatorëve në zbatim dhe sipas përcaktimeve të nenit 55 të LPP dhe nenit 45 të VKM nr.914, datë 29.12.2014, duke shumëzuar sasitë e çdo artikulli me

çmimet për njësi dhe vlerat e tyre i mblodhëm për të gjithë artikujt rezultoi tjetër klasifikim si më poshtë:
Në vend te parë renditet BOE "X" me ofertë ekonomike më të ulët se dy të tjerët, **në vlerë totale 71,411,050 lekë**, ndërkohë ky operatorë ishte renditur i treti;
Në vend te dytë renditet përsëri operatori "X" me ofertë ekonomike në vlerë totale 87,979,850 lekë;
Në vend te tretë renditet BOE "D&E" + "X" SRL me ofertë ekonomike në vlerë totale 88,769,960 lekë, ndërkohë që ky operatorë ishte renditur i pari dhe është shpallur edhe fitues i prokurimit.
Pra, në këtë procedurë në zbatim të nenit 55 të LPP dhe nenit 45 të VKM nr.914 datë 29.12.2014, nuk duhej të shpallej fitues BOE "X" + "X" SRL, por duhej të shpallej fitues operatori BOE "X" që ka paraqitur ofertë ekonomike më të ulët me diference **në vlerën 17,358,910 lekë** (88,769,960 - 71,411,050), pavarësisht se, shumatoren e çmimit për njësi e ka më të lartë se të dy operatorët e tjerë të kualifikuar.
Sa sipër duket qartë që, si pasojë e vlerësimit të ofertave sipas përcaktimeve në udhëzimet e APP ***"bazuar në shumatoren e çmimit për njësi"*** dhe jo për çmimin më të ulët, kemi denatyrim të gjithë procesit të vlerësimit, siç tregohet në 12 rastet e mësipërme sepse janë shpallur fitues operatorë ekonomik që kanë paraqitur ofertat me vlera me të larta se operatorët e tjerë të kualifikuar, ***duke i shkaktuar kështu, buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 106,331,736.70 pa TVSH dhe me 127,598,000 lekë.***
Gjithashtu në tabelën e mësipërme, si pasojë e vlerësimit të ofertave sipas përcaktimeve në udhëzimet e APP ***"bazuar në shumatoren e çmimit për njësi"*** dhe jo për çmimin më të ulët, janë konstatuar edhe disa raste, kur ofertat fituesit apo oferta të kualifikuara janë në vlerë më të lartë se fondi limit dhe në zbatim të pikës "d" të nenit 24 e LPP këto oferta duhet të skualifikoheshin.
Për ta bërë më të qartë dhe më të kuptueshëm po analizojmë dy nga procedurat e listuar më sipër, atë me numër rendor 2 (dy) dhe 7 (shtatë):
**1.** Procedura e prokurimit "Blerje dokumentacioni për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë Loti I", nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, me afat 1 vit, me shumatore limit e çmimeve për njësi 2,500.83 lekë, me fondi limit në total 4,853,449 lekë. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë dhe janë kualifikuar 7 operatorë ekonomik. Fitues është shpallur operatori "X" me shumatoren e çmimeve njësi në vlerën 1,877.9 lekë, pra me të ulët se 6 operatorët e tjerë.
Nga llogaritjet që i bëmë ofertave të 7 operatorëve në zbatim dhe sipas përcaktimeve të nenit 55 të LPP dhe nenit 45 të VKM nr.914, datë 29.12.2014, duke shumëzuar sasitë e çdo artikulli me çmimet për njësi dhe vlerat e tyre i mblodhëm për të gjithë artikujt rezultoi se, ***tre nga këto oferta ishin në vlerë më të larta se fondi limit.*** Konkretisht:
-Oferta e operatorit fitues "X" është në vlerën 4,898,599 lekë, ose më të lartë në vlerën 45,150 lekë se, fondi limit që është 4,853,449 lekë, pra ky ofertues duhej te skualifikohej dhe jo te shpallej fitues:
-Oferta e operatorit të kualifikuar "X" është në vlerën 9,367,780.1 lekë, ose më të lartë në vlerën 4,514,331 lekë se, fondi limit që është 4,853,449 lekë , pra ky ofertues nuk duhej te kualifikohej;
-Oferta e operatorit të kualifikuar "X" është në vlerën 10,181,249 lekë, ose më të lartë në vlerën 5,327,800 lekë se, fondi limit që është 4,853,449 lekë , pra ky ofertues nuk duhej te kualifikohej.

**2.** Procedura e prokurimit "Loti I - Blerje detergjent, dizinfektant dhe aromatizues, Loti I", nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, me afat 2 vit, me tre operator fitues, me shumatore limit e çmimeve për njësi 28,067.99 lekë, me fondi limit në total 103,263,609 lekë. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë dhe janë kualifikuar 4 operatorë ekonomik. Janë shpallur fitues 3 operator: "X " me shumatoren e çmimeve njësi në vlerën 15,309 lekë; " X " me shumatoren e çmimeve njësi në vlerën 16,955 lekë;" X" me shumatoren e çmimeve njësi në vlerën 17,169 lekë. Është kualifikuar BOE - X + X me shumatoren e çmimeve njësi në vlerën 17,495 lekë.
Nga llogaritjet që i bëmë ofertave të 4 operatorëve në zbatim të nenit 55 të LPP dhe nenit 45 të VKM nr.914, datë 29.12.2014, rezultoi se, ***një nga katër ofertat ishte në vlerë më të lartë se fondi limit.*** Konkretisht:

-Oferta e operatorit fitues ": "X " është në vlerën **136,397,826** lekë, ose më të lartë në vlerën ***33,134,217 lekë*** se, fondi limit që është 103,263,609 lekë, pra ky ofertues duhej te skualifikohej dhe jo te shpallej fitues.

Në lidhje me këtë fenomen, duhet theksuar dhe vlerësuar faktin se, ABP që ne momentet e para të konstatimin e këtij fenomeni, në të gjitha rastet e tjera të procedurave vijuese, ka vendosur, në seksionin "Kriteret e përzgjedhjes së fituesit" dhe në Shtojcën 1 "Formulari i Ofertës Ekonomike" të DT, kushtin që: *"në çdo rast, operatorët ekonomik nuk duhet të tejkalojnë fondin e marrëveshjes kuadër të parashikuar nga autoriteti kontraktor referuar sasive të pritshme përkatëse dhe për të provuar këtë fakt, operatorët ekonomik duhet të paraqesin edhe formularin e ofertës me çmimin total të ofertës referuar sasive të pritshme të përcaktuara në shtojcën "Sasia e mallrave dhe kushtet e lëvrimit".*

**2.** Tabela e mëposhtme tregon, prokurimet e realizuara për mallra me marrëveshje kuadër, ku pasqyrohen rastet e shkualifikimit te operatorëve që kanë oferta me të ulta se fituesit. Këto oferta sipas llogaritjeve mbi ***bazën e shumatores së çmimeve për njësi kanë dalë*** anomalish të ulët, dhe për pasojë janë skualifikuar në zbatim të nenit 56 të LPP-së sepse nuk kanë paraqitur dokumentacion provues për ofertën ekonomike anomalish të ulët.

**Tabela 2:**

| Nr. | Objekti i prokurimit (mallra) | Fondi Limit | Vlera e Ofertës Fituese me larta (Lekë pa TVSH) | Ofertuesit Fitues Me shumatore e cmimeve/ njësi dhe Vlera totale | Ofertues të skualifikuar | Vlera Ofertave (shumatorja e cmimeve/ njësi) | Vlera totale e TVSH) | Diferenca ndermjet fituesit dhe vleres totale me te ulet te skualifikuar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Loti II - Blerje Materiale Kancelarie të tjera zyre - 300.555 shumatorja e cmimeve/ njësi) lekë pa TVSH | 30,136,825 | 29,792,354 | 1. X - 210,968.77 (28,786,029.9)<br>2. X - 263,305.61 (29,208,152.4)<br>3. X KOMPJUTER - 268,571.71 (29,792,354.4) | 1) X<br>2) X | 1) 0<br>2) 135,406.1 | 1) 0<br>2) 23,739,677.1 | 6,052,676.90 |
| 2 | Loti III - Blerje letër, shumatorja e çmimeve për njësi është: 15,735.94 lekë pa TVSH | 62,180,006 | 61,404,788 | 1. X - 12,760.45 ( 61,021,285.75)<br>2. X - 12,828.2 (61,066,832)<br>3.X KOMPJUTER - 13,097.08 (61,404,787.7) | X | 9,954 | 57,013,571.00 | 4,391,217.00 |
| 3 | Blerje materiale kancelarie me bazë letre ,Shumatorja e çmimeve për njësi është si më poshtë: 33,940 lekë pa TVSH | 26,356,371 | 25,677,641 | 1. X - 26,107.95 (25,345,971.05)<br>2. X - 26,538.88 (25,415,642.5)<br>3. X KOMPJUTER - 28,234.09 (25,677,641.2) | X | 11,322.72 | 23,903,775.40 | 1,773,885.60 |
| 4 | Loti I - Blerje Materiale Kancelarie me bazë letre, shumatorja e çmimeve për njësi është: 14,722.6(katërmbëdhjet ë mijë e shtatëqind e njëzet e tre pikë gjashtë) lekë pa TVSH | 2,592,766 | 2,487,050 | 1. X - 8.098 (2,487,050)<br>2X - 8.118 (2,495,650)<br>3. X KOMPJUTER - 12.067 (2,419,483) | 1) X Print<br>2) X | 1) 0<br>2) 11.047 | 1) 0<br>2) 2,237,592 | 249,458.00 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | Loti II - Blerje Materiale Kancelarie të tjera zyre, shumatorja e çmimeve për njësi është: 31,154.8(tridhjetë e një mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër pikë tetë) lekë pa TVSH | 1,427,265 | 1,423,449 | 1. X - 9.211,6 (1,423,369)<br>2X - 9.251,6 (1,423,449)<br>3. X - 23.367,11 (1,380,497) | 1) X | 29.695,36 | 1,061,954.70 | 361,494.30 |
| 6 | Loti III - Blerje letër, shumatorja e çmimeve për njësi është 8,410.7(tetë mijë e katërqind e dhjetë pikë shtatë) lekë pa TVSH; | 4,133,083 | 4,110,357 | 1.X - 2.778,76 (4,093,253.38)<br>2. X - 2.756,04 (4,110,352.7)<br>3. X - 3.147,77 (4,012,466.2) | 1) X | 6.399,17 | 3,227,880.20 | 882,476.80 |
| 7 | Blerje materiale kancelarie me bazë letre për Gardën e Republikës - MK me afat 2 vjet - (shumatorja limit e cmimeve/ njësi) = 7.650 | 1,333,200 | 1,201,020 | 1)X - 4.477,2 (662,532)<br>2) X - 5.180 (1,201,020)<br>3) X - 5.999,98 (1,007,170.7) | X | 6,363 | 1,038,435 | 162,585.00 |
| 8 | Loti I - "Blerje tonera për Kryeministrinë dhe institucionet e varësisë" - Marrëveshje Kuadër me afat 2 vjet - shumatorja limit e cmimeve / njësi = 891,527 | 26,533,437 | 26,036,160 | BOE - X - 882,947 | 1) X<br>2) X | 1) 0<br>2) 452,442 | 1) 0<br>2) 21,147,053 | 4,889,107.00 |
| 9 | Loti II. "Blerje tonera për Ministrinë e Brendshme dhe institucionet e varësisë" - Marrëveshje Kuadër me afat 2 vjet - shumatorja limit e cmimeve / njësi = 1,433,917 | 52,943,371 | 52,607,846 | BOE – X 1,293,084 | 1) X<br>2) X | 1) 0<br>2) 563,503 | 1) 0<br>2) 43,178,331 | 9,429,515.00 |
| 10 | Loti III. "Blerje tonera për Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet e varësisë" - Marrëveshje Kuadër me afat 2 vjet - shumatorja limit e cmimeve / njësi = 1,541,429 | 31,905,179 | 31,539,903 | X - 1,502,448 | 1) X<br>2) X<br>3) X | 1) 0<br>2) 735,102<br>3) 1,370,030 | 1) 0<br>2) 21,381,673<br>3) 28,191,020 | 10,158,230.00 |
| 11 | Loti IV. "Blerje tonera për Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet e varësisë" - Marrëveshje Kuadër me afat 2 vjet - shumatorja limit e cmimeve / njësi = 1,153,599 | 24,534,242 | 23,950,754 | X - 1,066,785) | 1) X<br>2) X | 1) 0<br>2) 600,453 | 1) 0<br>2) 19,559,297 | 4,391,457.00 |
| 12 | Loti V. "Blerje tonera për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e varësisë" - Marrëveshje Kuadër me afat 2 vjet - shumatorja limit e cmimeve / njësi = 1,694,849 | 61,981,655 | 61,552,937 | X 1,623,549.17 | 1) X<br>2) X | 1) 0<br>2) 934,478 | 1) 0<br>2) 48,165,512 | 13,387,425.00 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 13 | Loti VII. "Blerje tonera për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e varësisë" - Marrëveshje Kuadër me afat 2 vjet - shumatorja limit e cmimeve / njësi = 1,022,704 | 21,231,216 | 21,095,321 | X - 955,109 | 1) X<br>2) X | 1) 0<br>2) 489,510 | 1) 0<br>2) 16,900,823 | 4,194,498.00 |
| Totali : | | 367,881,718 | 361,832,696 | | | | | 60,324,025.60 |

Siç tregon tabela e mësipërme të 13 operatorët janë skualifikuar sepse nuk kanë paraqitur dokumentacion provues për elementet e veçanta të ofertës ekonomike anomalish të ulët sipas nenit 56 të LPP-së. Nga llogaritje mbi bazën shumatores së çmimeve për njësi ofertat të këtyre operatorëve kanë dalë anomalish të ulët, por në fakt po të shumëzojmë sasitë e çdo artikulli me çmimet njësi dhe të bëjmë mbledhjen e tyre, ofertat totale të këtyre operatorëve nuk dalin anomalish të ulta, por janë oferta me të ulta se oferta e fituesit, pra duheshin shpallur fitues.

Për ta bërë më të qartë dhe më të kuptueshëm po trajtojmë duke analizuar njërën nga procedurat e prokurimit të listuar më sipër me numër rendor 1 (një):
- Procedura e prokurimit me objekt **"Blerje Materiale Kancelarie të tjera zyre, Loti II"**, me shumatore të çmimeve për njësi në vlerën 300.555 lekë dhe me fond limit total me vlerë 30,136,825 lekë.
Kjo procedura është zhvilluar me marrëveshje kuadër me 3 operatorë fitues. Janë shpallur fitues 3 operatorët e mëposhtëm:
**1.** "X", me shumatoren e çmimit për njësi në vlerën 210,968.77 lekë dhe me vlerë totale te ofertës 28,786,029.9 lekë;
**2.** "X", me shumatoren e çmimit për njësi në vlerën 263,305.61 lekë dhe me vlerë totale të ofertës 29,208,152.4 lekë;
**3.** "X" me shumatoren e çmimit për njësi 268,571.71 lekë dhe me vlerë totale te ofertës 29,792,354.4 lek**ë**

Në këtë procedurë është skualifikuar operatori "X" i cili ka paraqitur shumatoren e çmimit për njësi në vlerën 135,406.1 lekë dhe nga llogaritjet vlera totale e ofertës i del në vlerën 23,739,677.1 lekë. Ky operator është skualifikuar sepse nuk ka paraqitur dokumentacion për të argumentuar elementet e veçanta të ofertës ekonomike anomalish të ulët sipas nenit 56 të LPP-së. Konkretisht, neni 56 i LPP dhe neni 66 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014, përcaktojnë se, përllogaritja e ofertës anomalish të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:
- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, oferta vlerësohet anomalish e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur.
- Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, oferta vlerësohet anomalish e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalish të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës.
Në këtë procedurë kanë marrë pjesë më shumë se tre oferta dhe oferta vlerësohet anomalish e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Kështu, mesatarja e shumatores së çmimeve për njësi është 219,563 lekë (210,968.77 +263,305.61+268,571.71+135,406.1: 4 ) *85% =186,628.5 lekë, pra oferta që të jetë anomalish e ulët duhet të jetë nën vlerën e **186,628.5 lekëve**.
Oferta "X" = 210,968.77 > 186,628.5, oferta nuk është anomalish e ulët.
Oferta "X" SHPK= 263,305.61 > 186,628.5, oferta nuk është anomalish e ulët
Oferta "X" SHPK = 268,571.71 > 186,628.5, oferta nuk është anomalish e ulët

Oferta "X" SHPK = 135,406.1 < 186,628.5, **oferta është anomalish e ulët**.
Në vijim me anë të shkresës nr.744, datë 24.04.2019 është njoftuar ofertuesit "X" SHPK, të paraqesin me shkrim brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës së tij, pasi oferta e tij ka dalë anomalish e ulët. Dhe duke qenë se, ofertuesi nuk u përgjigj kërkesës për argumentimin e ofertës anomalish të ulët, në bazë të nenit 56 të LPP, ky operator është skualifikuar nga procedura.
Mirëpo, po të llogarisim ofertën në zbatim të nenit 56 të LPP dhe nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 mbi bazën e vlerës totale të ofertës (çmimit më të ulët) dhe jo të ***shumatorës së çmimit për njësi*** siç përcaktojnë udhëzimet e APP, atëherë oferta e këtij operatori nuk del anomalish e ulet.
Konkretisht:
Mesatarja e vlerës së 4 ofertave të vlefshme është 27,881,553.45 lekë (28,786,029.9+29,208,152.+ 29,792,354.4+23,739,677. 1:4)*85% **= 23,699,320.43 lekë,** pra oferta që të jetë anomalish e ulët duhet të jetë nën vlerën e **23,699,320.43 lekë.**
Oferta "X" = 28,786,029.9 > 23,699,320.43 lekë, oferta nuk është anomalish e ulët;
Oferta "X" = 29,208,152.4 > 23,699,320.43 lekë, oferta nuk është anomalish e ulët;
Oferta "X" = 29,792,354 > 23,699,320.43 lekë, oferta nuk është anomalish e ulët;
Oferta "X" = 23,739,677 > 23,699,320.43 lekë, **oferta nuk është anomalish e ulët.**
**Si konkluzion,** oferta e operatorit "X" nuk del anomalish e ulët dhe në zbatim të në zbatim të nenit 55 të LPP oferta e tij duhej të kualifikohej dhe duhej të shpallej fitues. Pra duket qarte se, në këtë rast i është shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit në vlerën 6,052,677 lekë pa TVSH dhe 7,263,212 lekë me TVSH, e cila llogaritet si diferencë e vlerës së ofertës së operatorit "X"' (29,792,354.4 lek**ë) me vlerën e** ofertës së operatorit "X" (23,739,677 lekë). Kështu me radhë janë llogaritur të gjitha verat e dëmit ekonomik në të 13 procedurat e listuar në tabelën e mësipërme që, në total dëmi ekonomik i shkaktuar buxhetit të shtetit llogaritet rreth **60,324,025.60 lekë pa TVSH dhe 72,388,830 lekë**.

**3.** Në tabelën e mëposhtme po pasqyrojmë rastet të procedurave të prokurimit ku janë skualifikuar operatore të ndryshëm, të cilat mundë të paraqisnin ankese pranë ABP duke pretenduar që kanë ofertat me të ulta se fituesi bazuar ne shumatoren e çmimit për njësi por që në fakt ofertën në total e kane me të lartë se fituesi.

**Tabela 3:**

| Nr. | Objekti i prokurimit (mallra ose shërbime) | Fondi Limit | Vlera e Ofertës Fituese (Lekë pa TVSH) | Ofertuesi Fitues dhe vlera sipas shumatores | Ofertues të skualifikuar | Vlerat e Ofertave të skualifikuara (Lekë pa TVSH) shumatorja e cmimeve/ njësi | Vlera totale e ofertave te skualifikuara (Lekë pa TVSH) | Diferenca ndermjet fituesit dhe vleres totale me te ulet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Blerje Uniforma Verore për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit - MK me afat 1 vit - shumatorja limit e cmimeve / njësi = 55,383 | 150,013,333 | 121,997,000 | BOE - X - 47.200 | 1) X<br>2) X | 1) 39.350<br>2) 48.730 | 1) 127,960,250<br>2) 133,146,750 | 5,963,250.00 |
| 2 | Blerje Uniforma për personel mjekësor - Marrëveshje Kuadër me afat 1 vit - shumatorja limit e cmimeve / njësi = 24.862,5 | 3,067,000 | 2,954,420 | X PF - 14.260 | X | 13.200 | 3,064,400 | 109,980.00 |
| 3 | Blerje Këpucë për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve - MK 1 vit - Tender i Hapur - shumatorja limit e çmimeve për njësi = 19,282 lekë pa TVSH | 27,807,583 | 20,245,000 | X LTD - 9.550 leke | 1) "X<br>2) "X | 1) 9.250<br>2) 11.610 | 1) 27,805,000<br>2)17,564,500 | 2,680,500.00 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Blerje pjese kembimi për automjete për shërbime profilaktike për Komandën Mbështetëse - Lotit II "Blerje bateri për automjete" - Tender i Hapur - MK me afat 2 vjet - shumatore limit e cmimeve / njesi = 355,370.83 lekë pa TVSH | 22,543,765 | 15,070,100 | X PF - 218,600 | 1) X sha<br>2) X sha<br>3) X sha | 1) 229,400<br>2) 241,417<br>3) 217.700 | 1) 15,316,700<br>2) 14,327,981<br>3) 20,125,600 | 742,119.00 |
| Totali : | | | | | | | | |

Sa sipër, u konstatuan se janë skualifikuar operatore të ndryshëm, të cilat kanë paraqitur apo mund të praqësnin në ankesë ABP apo dhe pranë Autoriteteve Kontraktore , duke pretenduar që kanë ofertat me të ulta se fituesi të llogaritura dhe bazuar ne shumatoren e çmimit për njësi. Por në fakt, po të llogaritet ofertat e tyre duke shumëzuar sasitë e çdo artikulli me çmimet për njësi dhe vlerat e tyre të mblidhen për të gjithë artikujt ofertat në total dalin më të larta se fituesi. Pra nga vlerësimi që i bëhet ofertave në bazë të shumatorës së çmimit për njësi, sipas kërkesave të udhëzimeve të APP, është shkelur dhe është bërë i pa zbatueshëm neni 63 i LPP dhe neni 78 i VKM pasi është denatyruar gjithë procesi i ankimit administrativ dhe i shqyrtimit të ankesave. Nëse, do të zbatohej neni 55 i LPP dhe nenit 45 i VKM nr.914, datë 29.12.2014, operatorët nuk do të pretendonte se, kishin paraqitur ofertën më të ulët se operatori tjetër, kështu që nuk do të ankohej sepse edhe nëse do të kualifikohej oferta e tyre nuk do të dilte fituese se ishte në vlerë më të lartë se operatori tjetër i kualifikuar.

Për ta bërë më të qartë dhe më të kuptueshëm po trajtojmë ankesat e bëra në një nga procedurat e sipërcituara atë me objekt "Blerje uniforma verore për Policinë e Shtetit". Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 3 (tre) operatorë ekonomik të cilët janë skualifikuar nga KVO për arsye te ndryshme, kryesisht se nuk kanë plotësuar kriteret e veçanta. Dy nga tre operatorët e skualifikuar kanë kundërshtuar skualifikimet duke paraqitur ankesë në ABP, konkretisht: operatori "X– Konfeksion" dhe BOE "X". Në përfundim të shqyrtimit të ankesave ABO ka vendosur pranimi i ankesës së BOE "X", ndërsa për OE X – Konfeksion" ka vendosur pranimi pjesërisht të ankesës.Pas marrjes së këtij vendimi, është bërë edhe njëherë rivlerësimi duke kualifikuar BOE "X Oil", dhe skualifikuar OE "X". Për këtë rivlerësim dhe skualifikimin OE "X" në zbatim të nenit 63, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik" dhe nenit 78, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ka paraqitur përsëri ankesë në ABP. Me këtë ankesë ky operatorë përveç të tjerave pretendon se:

*"'Të gjitha këto shkelje sjellin si pasojë një dëm të konsiderueshëm pasi, nëse do të ndiqej i njëjti standard dhe do të kualifikohej OE "X" atëherë buxhetit të shtetit do ti kursehej një vlerë potenciale prej 25 milion lekë".*

Por nga auditimi u konstatua se, pretendimi i këtij operatori se, ka paraqitur ofertën më të ulët se operatori fitues dhe i kursen buxhetit të shtetit 25 milion lekë nuk qëndron sepse, nga llogaritjet që i bëmë ofertës së tij dhe ofertës së operatorit fitues, në zbatim të nenit 55 të LPP dhe nenit 45 të VKM nr.914, datë 29.12.2014, duke shumëzuar sasitë e çdo artikulli me çmimet për njësi dhe vlerat e tyre i mblodhëm për të gjithë artikujt rezultoi tjetër pamje dhe tjetër klasifikim, si më poshtë:

- Në vend të parë, BOE "X" me shumatorën për njësi në vlerën **47,200** lekë, por ka ofertën totale më të ulët, në vlerën **121,997,000 lekë**, pa TVSH.
- Në vend të dytë, OE "X"' me shumatorën për njësi në vlerën **39,35**0 lekë ose më të ulët se, BOE "X" me diference të çmimit për njësi 7,850 lekë (**47,200 - 39,35**0), por ka ofertën totale më të lartë, në vlerë **127,960,250** lekë, ose më të lartë se fituesi në vlerën 5,963,250 lekë, pa TVSH (**127,960,250-**121,997,000) dhe ***7,155,900 lekë, me TVSH***.

**Si konkluzion:** Nga vlerësimi që i është bërë ofertave në bazë të shumatorës së çmimit për njësi, sipas kërkesave të udhëzimeve të APP, është shkelur dhe është bërë i pa zbatueshëm neni 63 i LPP dhe neni 78 i VKM pasi është denatyruar gjithë procesi i ankimit administrativ dhe i shqyrtimit të ankesave. Pra nëse, do të zbatohej neni 55 i LPP dhe nenit 45 i VKM nr.914, datë 29.12.2014,

operatori "X"' nuk do të pretendonte se, kishte paraqitur ofertën më të ulët se operatori tjetër, kështu që nuk do të ankohej sepse edhe nëse do të kualifikohej oferta e tij nuk do të dilte fituese se ishte në vlerë më të lartë se operatori tjetër i kualifikuar BOE "X".

*Në lidhje me problemet e trajtuara më sipër për të gjtha procedurat e prokurimeve të zhvilluara nëpërmjet marrveshjes kuadër gjatë vitit 2019, të cilat janë pasqyruar edhe në Projekt Raportin e Auditimit, ABP ka paraqitur observacione te cilat në mënyrë të përmbledhur konsistojnë, si me poshtë:*

| |
|---|
| *Rastet e konstatuara nga ana juaj, janë pasojë e zbatimit të detyrueshëm të udhëzimeve, rekomandimeve dhe asistencës së APP-së, si institucioni i ngarkuar me ligj për të udhëzuar dhe asistuar autoritetet kontraktore.*<br>*Ligji 9643/2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, në nenin 13, ka përcaktuar qartë detyrimin e APP-së për: paraqitjen e propozimeve për rregullat e prokurimit, në Këshillin e Ministrave; hartimin e dokumenteve standarde të tenderit, që do të përdoren në procedurat e prokurimit, sipas rregullave të prokurimit publik; dhënien e këshillave dhe asistencës teknike për autoritetet kontraktore, që ndërmarrin një procedurë prokurimi.*<br>*VKM 914/2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në nenin 83, pika 1, ka përcaktuar qartë detyrimin e APP-së për hartimin e udhëzimeve dhe manualeve shpjeguese, për t'u ardhur në ndihmë autoriteteve kontraktore gjatë kryerjes së veprimtarive të prokurimit.*<br>*Përsa më sipër, sqarojmë se ABP si autoritet kontraktor që zhvillon procedura prokurimi në emër e për llogari të autoriteteve të tjera kontraktore, në cilësinë e organit qendror blerës sic përcaktohet në VKM 82/2018, i ndryshuar, ka detyrimin njëlloj si autoritetet e tjera kontraktore, që të zbatojë udhëzimet e rekomandimet e APP-së, si autoriteti më i lartë rregullator në fushën e prokurimeve, i përcaktuar si i tillë me ligj.*<br>*Duke mbajtur në konsideratë konstatimet e grupit të auditimit të KLSH-së, organi qendror blerës ABP ka filluar publikimin e procedurave të prokurimit nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër për vitin 2020, në të cilat nuk po aplikohet kriteri i vlerësimit "shumatore me e ulët e cmimeve për njësi", por po aplikohet kriteri i vlerësimit "cmimi më i ulët i ofruar" bazuar në sasitë e pritshme të mallrave dhe shërbimeve. Edhe në këtë rast, përpara publikimit të procedurave, i jemi drejtuar me kërkesë për asistencë APP-së, nëpërmjet së cilës kemi bërë me dije konstatimet tuaja si dhe faktin që procedurat në vijim do të publikohen me kriter vlerësimi "cmimin më të ulët të ofruar". Nga ana e APP-së, në këtë rast nuk është kundërshtuar apo refuzuar publikimi i procedurave të prokurimit me kriter vlerësimi "cmimi më i ulët i ofruar" bazuar në sasitë e pritshme të mallrave dhe shërbimeve.* |

*Nga shyrtimi dhe vlerësimi i këtyre observacioneve ashtu si ç`eshte trajtuar dhe në shqyrtimin e e observacioneve të dërguara nga ABP për aktkonstatimin e mbajtur, KLSH del në konkluzionin se, këto observacione qëndrojnë dhe merren në konsideratë vetëm në lidhje me përgjegjësinë e ABP e cila nuk mbane përgjegjësi për këto shkelje sepse ka zbatuar udhëzimet e APP, por këto udhëzime detyrimisht nuk duhet të zbatohen nga ABP në vijim, deri sa APP të bëjë shfuqizimin e tyre.*

**2.** Procedura e prokurimit me objekt: **"Blerje Karburanti, përveç Jet A1", ndarë në 4 (katër) lote, nëpërmjet marrëveshjes kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara dhe REF-11143-02-28-2019**:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi nr. 10 prot. Datë 25.02.2019<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar - me mjete elektronike" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit:<br>Znj. X<br>Znj. X<br>Z. X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:<br>Z. X<br>Znj. X<br>Z. X |

| | | |
|---|---|---|
| 5. Fondi i marrëveshjes kuadër: 366,977,406 Lekë pa TVSH, e ndarë në 4 (katër) lote:<br>Loti I. - 271,043,290 lekë pa TVSH;<br>Loti II. - 23,949,112 lekë pa TVSH;<br>Loti III. - 26,786,982 lekë pa TVSH.<br>Loti IV. - 45,198,022 lekë pa TVSH. | 6. Operatori fitues.<br>Vlera e Ofertës fituese (marzhi i fitimit i shprehur në %):<br>Loti I - BOE "X + "X" SHA<br>Vlera e ofertës: 16.4 %<br>Loti II - BOE "X + "X" SHA<br>Vlera e ofertës: 16.4 %<br>Loti III - BOE "X + "X" SHA<br>Vlera e ofertës: 17.4 %<br>Loti IV - "X" SHA<br>Vlera e ofertës: 19 % | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) |
| 8. Data e hapjes së tenderit: 18.09.2019 | 9. Operatoret Ekonomike pjesëmarrës:<br>**Loti I:**<br>a) Pjesëmarrës në tender 2<br>b) Skualifikuar 1<br>c) Kualifikuar 1<br>**Loti II:**<br>a) Pjesëmarrës në tender 2<br>b) Skualifikuar 1<br>c) Kualifikuar 1<br>**Loti III:**<br>a) Pjesëmarrës në tender 2<br>b) Skualifikuar 1<br>c) Kualifikuar 2<br>**Loti IV:**<br>Pjesëmarrës në tender 3<br>b) Skualifikuar 2<br>c) Kualifikuar 1 | 10. Vlera e kontratave të pritshme (me tvsh):<br><br>Loti I. - 325,251,948 lekë;<br>Loti II. - 28,738,934 lekë;<br>Loti III. - 32,144,378 lekë.<br>Loti IV. - 54,237,626 lekë. |

Nga auditimi u konstatua:

**-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**
Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave janë marrë zyrtarisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit pranë MF. Në mënyrën e përllogaritjes së vlerës limit në janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 59, të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit Publik" (i ndryshuar).

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të neneve 45 dhe 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar), të nenit 27 "Kontratat e mallrave" të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, të Vendimit nr. 659 datë 03.10.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik me mjete elektronike" u hartuan kriteret e veçanta të kualifikimit për këtë procedurë prokurimi. Nga Agjencia e Prokurimit Publik më datë 26.03.2019, nga adresa "Koordinimi APP" nëpërmjet e-mail pas monitorimit të bërë nga kjo strukturë janë sjelle disa rekomandime në lidhje me procedurën elektronike të prokurimit. Rekomandimet e APP-së janë pasqyruar në kriteret e veçanta të kualifikimit në dokumentet e tenderit.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues për secilin Lot:**

**I. Loti I. "Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)"**
Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomikë. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, (marzhi më i ulët i shprehur në %) | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X & "X" SHA | 16.4 % | Kualifikuar | Renditet i pari |
| 2 | "X | **10 %** | Skualifikuar | |

- Siç shihet në tabelën e mësipërme është shpallur fitues bashkimi i operatorëve ekonomikë BOE "X" SHPK dhe "X" SHA me ofertën ekonomike me marzhi fitimi i shprehur 16.4 %. Është skualifikuar, BOE "X" i cili ka paraqitur marzhi fitimi 10 % ose më të ulët se fituesi 6%. Ky BOE, është skualifikuar nga KVO për këto arsye:

1- *Anëtari i BOE "X" SHPK nuk ka paraqitur shtojcën nr 8 "Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme" sipas ndryshimeve të bëra nga ana e APP –së dhe të publikuara në mënyrë elektronike në faqen e saj me vendimin nr. 1 datë 01.02.2018.*

2- *Anëtari i BOE "X" SHPK nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën nr.2 të Kapicitetit ekonomik dhe financiar pasi bilanci i vitit 2018 nuk është i certefikuar nga ana e autoriteteve përkatëse tatimore.*

3- *Bashkimi i operatorëve ekonomik "X" SHPK + "X" SHA nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 3 të pikës 2.3 (Kapacitetit teknik), tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT, pasi nuk janë paraqitur në listën e stacioneve të shitjes se karburanteve me pakice dhe njëkohësisht nuk është paraqitur asnjë documentacion provues conform këtij kriteri për këto pika, për adresat e kërkuara në DT nga Autoriteti Kontraktor, konkretisht për autoritetet kontraktore:*
   - *Drejtorinë e Sherbimit Spitalor "Shejnta Mari" Mirditë;*
   - *Drejtorinë e Sherbimit Spitalor Peqin.*

   3.1 *Bashkimi i operatorëve ekonomikë "X" SHPK + "X" SHA nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 3 të pikës 2.3 (Kapacitetit teknik), tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT, pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin provues të kërkuar në këtë kriter për stacionet e shitjes se karburanteve me pakice sipas adresave te kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, vertetuar me nje nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate qeraje ose akt pronesie ose te jene te pasqyruara ne ekstraktin e rregjistrimit tregtar leshuar nga QKB,), të cilat detyrimisht duhet të jenë të pajisura me Leje mjedisore te tipit C leshuar nga QKL, Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Certifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH, dhe Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, konkretisht si më poshtë:*

   - ***Për pikën e shitjes me pakicë në Gramsh****, nuk është paraqitur kontrate qiraje ose akt pronësie ose te jete e pasqyruar ne ekstraktin e QKR, Leje mjedisore te tipit C leshuar nga QKL, Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Certifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH, dhe Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi;*
   - ***Për pikën e shitjes me pakicë në Has****, nuk është paraqitur kontrate qiraje ose akt pronësie ose te jete e pasqyruar ne ekstraktin e QKR, Leje mjedisore te tipit C leshuar nga QKL, Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Certifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH, dhe Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi;*
   - ***Për pikën e shitjes me pakicë në Përmet,*** *nuk është paraqitur kontrate qiraje ose akt pronësie ose te jete e pasqyruar ne ekstraktin e QKR, Leje mjedisore te tipit C leshuar nga QKL, Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Certifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH, dhe Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi;*
   - ***Për pikën e shitjes me pakicë në Tepelenë****, nuk është paraqitur kontrate qiraje ose akt pronësie ose te jete e pasqyruar ne ekstraktin e QKR, Leje mjedisore te tipit C leshuar nga QKL, Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Certifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH, dhe Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi;*
   - ***Për pikën e shitjes me pakicë në Peqin****, nuk është paraqitur kontrate qiraje ose akt pronësie ose te jete e pasqyruar ne ekstraktin e QKR, Leje mjedisore te tipit C leshuar nga QKL, Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK),*

*Certifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH, dhe Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi.*

3.2 *Bashkimi i operatorëve ekonomik "X" SHPK + "X" SHA nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 3 të pikës 2.3 (Kapacitetit teknik), tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT, pasi për stacionet e mëposhtme me pakicë të paraqitura dhe konkretisht;*

- *Për pikën e shitjes me pakicë në Devoll, të deklaruar në ekstraktin e QKR-së, leja e mjedisit rezulton në emër të subjektit X G;*
- *Për piken së shitjes me pakicë në Gjirokastër, të deklaruar në ekstraktin e QKR-së leja e mjedisit është e subjektit "X";*
- *Për pikën e shitjes me pakicë në Vlorë, të deklaruar në ekstraktin e QKR-së leja e mjedisit është e subjektit X;*
- *Për pikën e shitjes me pakicë në Diber, Burrel, të deklaruar në ekstraktin e QKR-së, leja e mjedisit është e subjektit A.Z. Distribution;*
- *Për pikën e shitjes me pakicë në Kukës, të deklaruar në ekstraktin e QKR-së, leja e mjedisit është e subjektit X;*
- *Për pikën e shitjes me pakicë në Fier, të deklaruar në ekstraktin e QKR-së i mungon Çertifikata e mbrojtjes nga zjarri nga MZSH;*
- *Për pikën e shitjes me pakicë në Sarandë, të deklaruar në ekstraktin e QKR-së i mungon, Leje mjedisore te tipit C leshuar nga QKL, Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Certifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH, dhe Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi;*
- *Për pikën e shitjes me pakicë në **Tropojë**, të deklaruar në ekstraktin e QKR-së i mungon, Leje mjedisore te tipit C leshuar nga QKL, Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Certifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH, dhe Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi;*
- ***Për pikën e shitjes me pakicë në Kurbin (Lac)**, të deklaruar në ekstraktin e QKR-së, i mungon Leje mjedisore te tipit C leshuar nga QKL, Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Certifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH, dhe Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi;*

*Kontratat e bashkëpunimit të lidhura ndëmjet ofertuesit dhe palëve të treta të cilët tregtojnë karburante me pakicë si përsa i përket fomës dhe përmbajtjes nuk janë sipas fomës së kërkuar në pikën 3 të Kapacitetit Teknik pra nuk janë kontrata qiraje dhe për më tepër as akte pronësie.*

1. *Bashkimi i operatorëve ekonomik "X" SHPK + "X" SHA nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 7 të pikës 2.3 (Kapacitetit teknik), tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT, në lidhje me mjetet e kërkuara pasi nga 5 Autobote te transportit te lendeve te rrezikshme me kapacitet mbajtes nga 3000 – 20,000 litra të kërkuara në këtë kriter është paraqitur dokumentacioni i plotë për 2(dy) prej tyre, ndërsa për mjetet e mëposhtme rezulton se:*

- *Autobotit me targë X i mungon pasaporta e mjetit;*
- *Autobotit me targë X është në pronësi të X Sha dhe nuk arrihet të provohet disponimi i tij nga ana e ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomik ofertues.*

*5. Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 7 të seksionit 2.3 Kapaciteti teknik" të kritereve të vecanta për kualifikim të DT, sepse nga verifikimi dhe deklarimi i vet përfaqësuesit të ofertuesit, rezultoi se faqja e menaxhimit të karburanteve nuk ofron shërbimin e furnizimit me karburant nëpërmjet kartave elektronike dhe stikera (pulla), të cilat ngjiten në xhamin e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet, për të eliminuar lëvizjen e mundshme të targave nga mjetit shtetëror drejt mjeteve private, faqe ëeb e cila nuk mbulon të gjitha stacionet sipas adresave e përcaktura në Dokumentet e Tenderit.*

**II. Loti II. Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)"**

Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomikë. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, (marzhi më i ulët i shprehur në %) | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | BOE "X" SHPK + "X" SHA | 16.4% | Kualifikuar | Renditet i pari |
| 2 | BOE "X | 7% | | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme është shpallur fitues bashkimi i operatorëve ekonomikë BOE "X" SHA me ofertën ekonomike në vlerën (marzhi më i ulët i shprehur në %) 16.4%. Është skualifikuar, operatori tjetër, BOE "X" SHPK + "X" ) i cili ka paraqitur marzhi fitimi 7 % ose më të ulët se fituesi 9.4%. Ky BOE është skualifikuar nga KVO për këto arsye:

1. *Anëtari i BOE "X" SHPK nuk ka paraqitur shtojcën nr 8 "Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme" sipas ndryshimeve të bëra nga ana e APP –së dhe të publikuara në mënyrë elektronike në faqen e saj me vendimin nr. 1 datë 01.02.2018.*
2. *Anëtari i BOE "X" SHA nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 1(b) të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit pasi deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas shtojcës 6 është plotësuar në emër të administratorit të "X" SHPK.*
3. *Anëtari i BOE "X" SHA nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 1(c) të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit pasi deklarata mbi konfliktin e interesit, sipas shtojcës 7 është plotësuar në emër të administratorit të "X" SHPK dhe jo në emër të administratorit të shoqërisë "X" SHA.*
4. *Anëtari i BOE "X" SHPK nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën nr.2 të Kapacitetit ekonomik dhe financiar pasi bilanci i vitit 2018 nuk është i certifikuar nga ana e autoriteteve përkatëse tatimore.*

**III. Loti III. "Furnizim me lëndë djegëse për automjete Benzine pa plumb"**
Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomikë. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, (marzhi më i ulët i shprehur në %) | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | BOE "X | 17.4 % | Kualifikuar | Renditet i pari |
| 2 | BOE "X | 7% | | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme është shpallur fitues bashkimi i operatorëve ekonomikë BOE "X" & "X" SHA me ofertën ekonomike në vlerën (marzhi më i ulët i shprehur në %) 17.4%. Është skualifikuar, operatori tjetër, BOE "X" SHPK + "X" ) i cili ka paraqitur marzhi fitimi 7 % ose më të ulët se fituesi 10.4%. Ky BOE është skualifikuar nga KVO për këto arsye:

1. *Anëtari i BOE "X" SHPK nuk ka paraqitur shtojcën nr 8 "Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme" sipas ndryshimeve të bëra nga ana e APP –së dhe të publikuara në mënyrë elektronike në faqen e saj me vendimin nr. 1 datë 01.02.2018.*
2. *Anëtari i BOE "X" SHA nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.1 të Kapacitetit ligjor i operatorëve ekonomikë pasi nuk ka paraqitur asnjë nga ISO-t e kërkuara në DST.*
3. *Anëtari i BOE "X" SHPK nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën nr.2 të Kapacitetit ekonomik dhe financiar pasi bilanci i vitit 2018 nuk është i certifikuar nga ana e autoriteteve përkatëse tatimore.*
4. *Anëtari i BOE "X" SHA nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 4 të pikës 2.3 (Kapacitetit teknik), tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT, fletë analiza e paraqitur nga ana e tij është jashtë afatit 30 ditor nga hapja e ofertave.*

5. *Bashkimi i operatorëve ekonomik "X" SHPK dhe "X" SHA nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 3 të pikës 2.3 (Kapacitetit teknik), tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT, pasi për stacionet e mëposhtme me pakicë të paraqitura dhe konkretisht;*
- *Për piken së shitjes me pakicë në Gjirokastër, të deklaruar në ekstraktin e QKR-së leja e mjedisit është e subjektit "Sherife Rabi";*
- *Për pikën e shitjes me pakicë në Vlorë, të deklaruar në ekstraktin e QKR-së leja e mjedisit është e subjektit X;*
- *Për pikën e shitjes me pakicë në Diber, Burrel, të deklaruar në ekstraktin e QKR-së, leja e mjedisit është e subjektit A.Z. Distribution;*
- *Për pikën e shitjes me pakicë në Kukës, të deklaruar në ekstraktin e QKR-së, leja e mjedisit është e subjektit X;*

6. *Bashkimi i operatorëve ekonomik "X" SHPK dhe "X" SHA nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 7 të pikës 2.3 (Kapacitetit teknik), tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT, në lidhje me mjetet e kërkuara pasi nga 5 Autobote te transportit te lendeve te rrezikshme me kapacitet mbajtes nga 3000 – 20,000 litra të kërkuara në këtë kriter është paraqitur dokumentacioni i plotë për 2(dy) prej tyre, ndërsa për mjetet e mëposhtme rezulton se:*
- *Autobotit me targë X i mungon pasaporta e mjetit;*
- *Autobotit me targë X është në pronësi të X Sha dhe nuk arrihet të provohet disponimi i tij nga ana e ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomik ofertues.*

**7.** *Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 7 të seksionit 2.3 Kapaciteti teknik" të kritereve të veçanta për kualifikim të DT, sepse nga verifikimi dhe deklarimi i vet përfaqësuesit të ofertuesit, rezultoi se faqja e menaxhimit të karburanteve nuk ofron shërbimin e furnizimit me karburant nëpërmjet kartave elektronike dhe stikera (pulla), të cilat ngjiten në xhamin e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet, për të eliminuar lëvizjen e mundshme të targave nga mjetit shtetëror drejt mjeteve private, faqe ëeb e cila nuk mbulon të gjitha stacionet sipas adresave e përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.*

**<u>Loti IV. "Furnizim me lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial"</u>**

Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomikë. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, (marzhi më i ulët i shprehur në %) | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" SHA | 19% | Kualifikuar | Renditet i pari |
| 2 | "X" SHA | 10.93% | Skualifikuar | |
| 3 | "X SHA | 5% | Skualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme është shpallur fitues operatori ekonomik "X" SHA me ofertën ekonomike në vlerën (marzhi më i ulët i shprehur në %) 19 %. Janë skualifikuar 2 operatorë ekonomikë të cilët kanë paraqitur marzhin e fitimit më të ulët se fituesi, respektivisht operatori"X", me diferencë 9.93% dhe operatori "X" me diferencë 14%. Këta operatorë janë skualifikuar nga KVO për këto arsye:

**1. Operatorit ekonomik "X" :**
- *Ofertuesi "X" SHA nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 4 të pikës 2.3 (Kapacitetit teknik), tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT, pasi fletë analizat e paraqitura nga ana e tij janë jashtë afatit 30 ditor nga hapja e ofertave*

**2. Operatorit ekonomik "X" :**
- *Ofertuesi "X" SHA nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 4 të pikës 2.3 (Kapacitetit teknik), tek Kriteret e Veçanta për Kualifikim të Shtojcës 8 të DT, pasi nga flet analizat e paraqitura mungon fletë analizë për lëndën djegëse të lëngët për përdorim termik civil dhe industrial solar pjesë Standardit SSH UNI 6579:2011*

Për Lotin IV është paraqitur ankesë nga operatorët ekonomikë të skualifikuar si më poshtë;
-"X" SHPK me shkresën nr. 844 datë 13.05.2019 kundërshtoi skualifikimin e ofertës së tij në lidhje me gjetjet e bëra nga ana e KVO-së. Komisioni i shqyrtimit të ankesës me vendimin nr. 844/1 datë 20.05.2019 ka vendosur të mos pranojë ankimin e ofertuesit.
-"X" SHPK me shkresën nr. 853 datë 14.05.2019 kundërshtoi skualifikimin e ofertës së tij në lidhje me gjetjet e bëra nga ana e KVO-së. Komisioni i shqyrtimit të ankesës me vendimin nr. 853/1 datë 21.05.2019 ka vendosur të mos pranojë ankimin e ofertuesit.
Të dy këta operatorë nuk kanë vijuar me akesat në Komisionin e Prokurimit Publik.
Nga auditimi mbi ligjshmërinë skualifikimit të këtyre operatorëve në të katër lotet e sipërtrajtuara rezultoi se, KVO ka skuailifikuar BOE "X", nga Loti I, Loti II dhe Loi III dhe operatorët "X" dhe "X" nga Loti IV, në përputhje me rregullat e prokurimit publik sepse këta opertorë nuk plotësonin disa kërkesa të vecanta të vendosura në Dokumentet e Tenderave respektivisht të Lotit I, Lotit II, Lotit III dhe Lotit IV.

Megjithatë nisur nga ofertat ekonomike të operatorëve të skualifikuar që i kanë paraqitura më të me marzh fitimi më të ulët se fituesit, KVO mundë të tregohej edhe më tolerante duke i konsideruar mangësitë e më sipërme si devijime të vogla. Kështu mundë të kishim menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore afërsisht në total 32 milion lekë, me TVSH, respektivisht: për Lotin I, afërsisht në vlerën 19,515,116 leke, për Lotin II, afërsisht në vlerën 2,701,459 leke, për Lotin III, afërsisht në vlerën 2,250,105 leke dhe për Lotin IV afërsisht, në vlerën 7,593,267 lekë.

**3.** Procedura e prokurimit publike me objekt "**Shërbim Gatimi dhe Shpërndarje Ushqimi për "Repartin e Ndërhyrjes së Shpejtë, Tiranë"**:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi nr.56/2 prot. datë 14.01.2019<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit<br>"E hapur", me mjete elektronike" Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat të marrëveshjes kuadër me afat 36 muaj | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Znj. X<br>Znj X<br>znj. X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Z. X<br>Znj X<br>Znj. X |
| 5. Fondi Limit (pa tvsh)<br>**59,598,569** lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>**"X" Shpk**<br>**Vlera e ofertës 44,617,908.6 lekë** | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 14,980,660.4 lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 16.01.2019 | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 6<br>b) Skualifikuar 4<br>c) Kualifikuar 2 | 10. Vlera e kontratës (me tvsh) 53,541,490.32 lekë |

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**
Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave dhe termat e referencës janë hartuar nga autoriteti kontraktor – Reparti i Ndërhyrjes së Shpejtë Tiranë. Me shkresën nr.4113/1 prot., datë 11.12.2018, protokolluar me nr. 1275 prot., datë 11.12.2018 dhe shkresën nr.4113/3 prot., datë 14.12.2018, protokolluar me nr. 1275/1 prot., datë 14.12.2018, Reparti i Ndërhyrjes së Shpejtë Tiranë ka dërguar dokumentacionin teknik për prokurimin e shërbimit të gatimit dhe të shpërndarjes së ushqimit, me afat të shërbimit 3(tre) vite.
Dokumentacionin teknik si dietat, sasitë e pritshme, përllogaritja e fondit limit, specifikimet teknike, termat e referencës, kërkesat për automjetet, llojet dhe sasitë minimale të pajisjeve të kuzhinës dhe të materialeve të imëta të domosdoshme të cilat janë të nevojshme për realizimin me

sukses të kësaj marrëveshje kuadër janë përgatitur nga grupi i punës i Repartit të Ndërhyrjes së Shpejtë Tiranë.
Kërkesa është verifikuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit. Në përgjithësi specifikimet teknike dhe termat e referencës janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e shërbimeve ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**
Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 6 operatore ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" Shpk | 44,617,908.6 | Kualifikuar | Ne vend të I-të |
| 2 | "X – AL" SHPK | 58,996,104.6 | Kualifikuar | Ne vend të II-të |
| 3 | "X" SHPK | 46,289,180 | Skualifikuar | |
| 4 | "X" SHPK | 42,239,400 | Skualifikuar | |
| 5 | Bashkimi i Operatorëve "X" sh.p.k + X Katering" P.F | 50,937,781 | Skualifikuar | |
| 6 | "X SHPK | 50,108,160 | Skualifikuar | |

Megjithatë nisur nga ofertat ekonomike që i ka më të ulët se fituesit, KVO mundë të tregohej edhe më tolerante duke i konsideruar mangësitë e më sipërme si devijime të vogla. Kështu mundë të kishim menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore që shkojnë në vlerat nga 1,324,051 lekë në 5,089,252 lekë, me TVSH.

**8.** Procedura e prokurimit me objekt: **"Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë", ", marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara dhe REF-26378-06-13-2019,** realizuar në vitin 2019:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi nr. 43 prot. datë 11.06.2019<br><br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit:"Kërkesë për propozim - me mjete elektronike" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit:<br>• Znj. X<br>• Znj. X<br>• Znj. X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave:<br>• Z. X<br>• Znj. X<br>• Z. X |
| 5. Fondi i marrëveshjes kuadër: 7,499,732.15 lekë pa TVSH. | 6. Operatori fitues.<br>Vlera e Ofertës fituese (lekë (pa TVSH):<br>"X"SHPK Vlera: 7,219,170 (pa TVSH) | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh): 280,562.15 Lekë pa TVSH |
| 8. Data e hapjes së tenderit: 01.07.2019 | 9. Operatoret Ekonomike pjesëmarrës:<br>a) Pjesëmarrës në tender 3<br>b) Skualifikuar 2<br>c) Kualifikuar 1 | 10. Vlera e kontratave të pritshme (me tvsh): 8,999,678.58 Lekë |

Nga auditimi u konstatua:
**-Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**
Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave dhe termat e referencës janë hartuar nga autoriteti kontraktor – Drejtoria Vendore të Policisë Tiranë. Me shkresën nr. 3720 prot., datë 07.06.2019 protokolluar me tonën me nr. 1033 prot., datë 07.06.2019, autoriteti kontraktor – Drejtoria Vendore të Policisë Tiranë, ka dërguar dokumentacionin teknik për prokurimin e shërbimit të gatimit dhe të shpërndarjes së ushqimit, nëpërmjet marrëveshjes kuadër, me afat të shërbimit 1 (një) vit.
Dokumentacionin teknik si dietat, sasitë e pritshme, përllogaritja e fondit limit, specifikimet teknike, termat e referencës, llojet dhe sasitë minimale të pajisjeve të kuzhinës dhe të materialeve të imëta të domosdoshme të cilat janë të nevojshme për realizimin me sukses të kësaj marrëveshje kuadër janë përgatitur nga grupi i punës në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë.
Kërkesa është verifikuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit. Në përgjithësi specifikimet teknike dhe termat e referencës janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643,datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës

limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e shërbimeve ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**
Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomikë. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, (lekë pa tvsh) | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" SHPK | 7,219,170 lekë | Kualifikuar | Ne vend të I-të |
| | "X | 6,861,649 | Skualifikuar | |
| | "X | 6,142,024 | Skualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme është shpallur fitues operatori ekonomik "X" SHPK me ofertën ekonomike në vlerën 7,219,170 lekë (pa TVSH). Janë skualifikuar 2 operatorë ekonomikë të cilët kanë ofertat ekonomike më të ulta se operaori i kualifikuar dhe shpllur fitues. Konkretsht operatori "X" me ofertë 6,861,649 lekë ose me diferencë në vlerën 357,521 lekë, pa TVSH dhe "X" me ofertë 6,142,024 lekë, ose me diferencë 1, 077,146 lekë, pa TVSH. KVO i ka skualifikuar këta operatorë për këto arsye:
**1. Operatori "X"**
*Duke u bazuar në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik, për të provuar pasjen e numrit të punonjësve të kualifikuar, sipas profesioneve në tabelën e pikës 4.1, të kapacitetit Teknik në DT, ekzistencën e tyre në listëpagesat për periudhën e kërkuar mars-maj 2019 dhe pasjen e dokumentacionit përkatës për secilin punonjës sipas pikës së lartpërmendur, (kontrate pune, libreze pune, librezë shëndetësorë, diplomë ose certifikatë kualifikimi), pas shqyrtimit e vlerësimit të përputhshmërisë së dokumenteve të dorëzuara me ato të kërkuara në dokumentet e tenderit, rezulton se ato nuk përputhen me kodet e profesioneve në listëpagesat për periudhën e kërkuar, bazuar në VKM nr.514 datë 20.09.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve", pra ofertuesi nuk e përmbush kapacitetin teknik të kërkuar në DT. Konkretisht nga 10 persona të kërkuar si ndihmës kuzhinier/shërbyes gatimi, kuzhinier, mercelog/kimist/teknolog dhe shofer, të rregullt sipas listëpagesës (kodit) janë vetëm 8 persona.*

**2. Operatori "X"**
*Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 4 të seksionit 2.3 "Kapaciteti teknik" të shtojcës 7 të DT-së pasi nga dokumentacioni i dorëzuar në mënyrë elektronike nuk ka paraqitur listë pagesat (E-SIG 025) të konfirmuara nga administrata tatimore për periudhën prill dhe maj 2019.*
Të dy operatorët e skualifikuar kanë kundërshtuar skualifikimet duke paraqitur ankesë në ABP konkretisht: Operatori "X" me shkresë nr.1283 prot. datë11.07.2019 dhe operatori "X" me shkresën nr.1272 date 10.07.2019. Për shqyrtimin e ankesave ABP ka ngritur komisionin përkatës i cili në përfundimit të shqyrtimit të ankesave ka kalë me rezultatitn se, ankesat nuk pranohet dhe nuk meret parasysh. ABP me shkresen nr.1298/1 prot. datë 15.07.2019 ka njoftuar operatorin "X" për mos pranimin e ankesës dhe me shkresën nr.1272/2 datë 12.07.2019 ka njoftuar operatorin "X". për mos pranimin e ankesës.

Nga auditimi mbi ligjshmërinë skualifikimit të këtyre operatorëve rezultoi se, KVO e ka skuailifikuar këta operatorë në përputhje me rregullat e prokurimit publik sepse, nuk plotësonin disa kërkesa të vecanta të vendosuar në DT. Por, nisur nga ofertat ekonomike të dy operatorëve të skualifikuar që i kanë më të ulëta se operatori fituesit, KVO mundë të tregohej edhe më tolerante duke i konsideruar mangësitë e konstatuara në dokumentacionin teknik, si devijime të vogla. Kështu mundë të kishim menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore që shkojnë në vlerat nga 429,025 lekë , me TVSH në 1,292,575 lekë, me TVSH .

**9.** Procedura e prokurimit publike me objekt **"Shërbim Gatimi dhe Shpërndarje Ushqim", Loti I "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Universitar Obstetrikë-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë"** e realizuar në vitin 2019:

Të dhënat për procedurën e Prokurimit:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi nr. 3/6 prot. datë 22.02.2019<br>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit<br>Procedurë e Hapur - Prokurim Elektronik, Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Znj.X<br>Znj. X<br>Znj. X | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Z . X<br>Znj X<br>Znj X |
| 5.Fondi Limit i Marreveshjes kuadër për Lotin I (pa tvsh)<br>**38,090,037.9** lekë | 6. Operatori fitues. Vlera e Ofertës fituese (pa tvsh)<br>**"X" SHPK**<br>**Vlera e ofertës 37,715,906.8 lekë** | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 374,131.1 lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Data 25.02.2019 | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 4<br>b) Skualifikuar 3<br>c) Kualifikuar 1 | 10. Vlera e pritshme e kontratave (me tvsh)<br>45 259 088.16 lekë |

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**

Për këtë procedure prokurimi, specifikimet teknike të mallrave dhe termat e referencës janë hartuar nga autoriteti kontraktor – Spitali Universitar Obstetrikë -Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë" me shkresën nr.59 prot., datë 15.01.2019, protokolluar me tonën nr. 105 prot., datë 16.01.2019, ka dërguar dokumentacionin teknik për prokurimin e shërbimit të gatimit dhe të shpërndarjes së ushqimit, nëpërmjet marrëveshjes kuadër, me afat të shërbimit 3 (tre) vite.

Dokumentacionin teknik si dietat, sasitë e pritshme, përllogaritja e fondit limit, specifikimet teknike, termat e referencës, kërkesat për automjetet, llojet dhe sasitë minimale të pajisjeve të kuzhinës dhe të materialeve të imëta të domosdoshme të cilat janë të nevojshme për realizimin me sukses të kësaj marrëveshje kuadër janë përgatitur nga grupi i punës nga Spitali Universitar Obstetrikë -Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë".

Kërkesa është verifikuar nga njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit. Në përgjithësi specifikimet teknike dhe termat e referencës janë hartuar në zbatim të nenin 23 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" si dhe nenin 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Po kështu edhe për llogaritjen e vlerës limit të kontratës në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e përcaktuar në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**

Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" , të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e shërbimeve ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues:**

Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 4 operator ekonomik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe ka bërë këtë klasifikim:

| Nr. | Subjekti | Vlera e ofertës, në lekë pa, TVSH | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" SHPK | 37,715,906.8 | Kualifikuar | Ne vend të I-të |
| 2 | "X" PF | 36,433,990 | Skualifikuar | |
| 3 | "X" SHPK | 31,699,133 | Skualifikuar | |
| 4 | "X" SHPK | 32,347,706 | Skualifikuar | |

Siç shihet në tabelën e mësipërme kanë marrë pjesë 4 (katër) operator ekonomik nga të cilët është kualifikuar dhe renditur i pari operatori ekonomik "X" SHPK me ofertë ekonomike në vlerën 37,715,906.8 lekë pa TVSH. Janë skualifikuar 3 operatorë ekonomik nga të cilët 3 operatorë kishin ofertë më të ulët se operatori fitues, konkretisht: operatori ekonomik "X" PF me ofertë 36,433,990 lekë pa TVSH ose me diferencë nga fituesi me vlerë 1,281,916.8 lekë pa TVSH; operatori ekonomik "X" SHPK me ofertë 31,699,133 lekë pa TVSH ose me diferencë nga fituesi me vlerë 6,016,773.8 lekë pa TVSH; operatori ekonomik "X" SHPK me ofertë 32,347,706 lekë pa TVSH ose me diferencë nga fituesi me vlerë 5,368,200.8 lekë pa TVSH;
Këta operatorë u s'kualifikuan nga KVO për arsyet si më poshtë:

**1. Operatori X"**

-Bazuar dokumentacionit të dorëzuar ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2(c) te seksionit 3.3 "Kapaciteti Teknik", pasi Leja e Mjedisit tipi C, kodi III.1.A e paraqitur nga ky operator rezulton qe te jete jo ne përputhje me adresën e ambienti te paraqitur ne kontratën e qerase ku ky operator do te zhvilloje aktivitetin.

**2. Operatori "X" Pf**

-Ofertuesi nuk plotëson pikën 1, 2, 3, 4 të seksionit 3.1 "kapaciteti ligjor/profesional" të kritereve të vecanta për kualifikim, sepse ka paraqitur certifikata për sistemin e menaxhimit te cilësisë (ISO 9001), sisteme e menaxhimit të sigurisë ushqimore (ISO 22000), sistemin e menaxhimit te shëndetit dhe sigurimit ne pune (OHSAS-18001) dhe sisteme të menaxhimit të mjedisit (ISO 14001) të lëshuara nga organ i vlerësimit të konformitetit i pa akredituar nga ndonjë organizëm kombëtar i akreditimit ose organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. Nga verifikimet e kryera në zbatim të Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe DPA-së në fuqi nga data 20.03.2018, në organizmat akreditues nënshkrues të marrëveshjes së njohjes reciproke me EA, ILAC dhe IAF, sipas Rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe DPA-së, EAS International nuk rezulton i akredituar për ISO 9001, ISO 22000, OHSAS 18001, ISO 14001.
-Duke u bazuar në dokumentet e dorëzuara nga operatori "X"pf, për të provuar pasjen e numrit të punonjësve të kualifikuar, sipas profesioneve në tabelën e pikës 6, të kapacitetit Teknik në DT, ekzistencën e tyre në liste pagesat për periudhën e kërkuar janar-dhjetor 2018 dhe pasjen e dokumentacionit përkatës për secilin punonjës sipas pikës 5, të kapacitetit Teknik në DT (kontrate pune, libreze pune, librezë shëndetësorë, diplomë ose certifikate kualifikimi), pas shqyrtimit e vlerësimit të përputhshmërisë së dokumenteve të dorëzuar me kërkuar në dokumentet e tenderit, rezulton se ato nuk përputhen me kodet e profesioneve në liste pagesat për periudhën e kërkuar, bazuar në VKM nr.514 datë 20.09.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve", pra ofertuesi nuk e përmbush kapacitetin teknik të kërkuar në DT. Konkretisht nga 13 persona të kërkuar si ndihmës kuzhinier, te rregullt sipas liste pagesës (kodit) janë vetëm 12 persona.

**3. X**

-Bazuar dokumentacionit të dorëzuar nga ofertuesi për të provuar pasjen e numrit të punonjësve të kualifikuar, sipas profesioneve në tabelën e pikës 6, të kapacitetit Teknik në DT, ekzistencën e tyre në listëpagesat për periudhën e kërkuar janar-dhjetor 2018 dhe pasjen e dokumentacionit përkatës

për secilin punonjës sipas pikës 5, të kapacitetit Teknik në DT (kontrate pune, libreze pune, librezë shëndetësorë, diplomë ose certifikate kualifikimi), pas shqyrtimit e vlerësimit të përputhshmërisë së dokumenteve të dorëzuar me kërkuar në dokumentet e tenderit, rezulton se ato nuk përputhen me kodet e profesioneve në liste pagesat për periudhën e kërkuar, bazuar në VKM nr.514 datë 20.09.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve", pra ofertuesi nuk e përmbush kapacitetin teknik të kërkuar në DT. Konkretisht nga 13 persona të kerkuar si ndihmës kuzhinier, te rregullt sipas liste pagesës (kodit) janë vetëm 6 persona.
Dy nga tre operatorët e skualifikuar kanë kundërshtuar skualifikimet duke paraqitur ankesë në ABP konkretisht: operatori "X" me shkresë nr.511 date 18.03.2019 dhe operatori "X me shkresën nr.511 date 18.03.2019.
Për shqyrtimin e ankesve ABP ka ngritur komisionin përkatës i cili në përfundimit të shqyrtimit të ankesve ka kalë me rezultatitn se, ankesat nuk pranohet dhe nuk meret parasysh. Dhe me shkresen nr.498/1 prot. datë 21.03.2019 ka njoftuar operatorin "X" për mos pranimin e ankesës dhe me shkresën nr.511/1 datë 26.03.2019 ka njoftuar operatorin "X" për mos pranimin e ankesës.
Operatori "X" nuk është dokordësuar më vendimin e ABP dhe ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik i cili me vendimin nr. 210, datë 12.04.2019 ka refuzoi ankesën për shkak se ankesa e dorëzuar është jashtë afatit te parashikuar nga ligji.
Nga auditimi mbi ligjshmërinë skualifikimit të këtyre operatorëve rezultoi se, KVO e ka skuailifikuar këta operatorë në përputhje me rregullat e prokurimit publik sepse, nuk plotësonin disa kërkesa të vecanta të vendosuar në DT. Por, nisur nga ofertat ekonomike të tre operatorëve të skualifikuar që i kanë më të ulëta se operatori fituesit, KVO mundë të tregohej edhe më tolerante duke i konsideruar mangësitë e konstatuara në dokumentacionin teknik, si devijime të vogla. Kështu mundë të kishim menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore që shkojnë në vlerat nga 1,338,299 lekë, me TVSH në 7,220,127 lekë, me TVSH .

*Në lidhje me problemet e trajtuara më sipër për të gjitha procedurat e prokurimeve të zhvilluara ne vitin 2019, probleme të cilat janë pasqyruar edhe në Projekt Raportin e Auditimit, nga ABP janë paraqitur observacione te cilat në mënyrë të përmbledhur konsistojnë, si me poshtë:*

*Në lidhje me këtë gjetje, ju sjellim në vëmendje se sikurse është konsatuar edhe nga ana juaj, rastet e skualifikimit të ofertuesve pjesëmarrës në këto procedura prokurimi, kanë qenë të argumentuara me mosparaqitjen e dokumentacionit ose mospërmbushjen e kritereve të përgjithshme ose kritereve minimale teknike, të përcaktuara në dokumentat e tenderit të secilës procedurë, pra vlerësimi është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.*
*Në lidhje me "devijimet e vogla", sqarojmë se legjislacioni në fuqi për prokurimin publik ka vetëm një parashikim në pikën 4 të nenit 53 të LPP-së, e konkretisht: "4. Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.".*
*Pra, në lidhje me konsiderimin e mangësive të ofertave si devijime të vogla dhe shfaqjen tolerant ndaj këtyre mangësive gjatë vlerësimit të ofertave, për shkak të vlerës së ulët të ofertës, nuk ekzistojnë akte nënligjore apo akte të tjera rekomanduese, për rastet konkrete të mangësive të ofertave të cilat mund të konsiderohen devijime të vogla nga komisionet e vlerësimit të ofertave.*
*Për më tepër, sic rezulton edhe në Raportin Përfundimtar të Auditimit të përcjellë me shkresën nr.10357, datë 09.04.2019, të Drejtorisë së Përgjithshme të Auditit të Brendshëm, në Ministrinë e Brendshme, si dhe në Vendimin nr.63 datë 22.10.2019 të Agjencisë së Prokurimit Publik, për auditimin e zhvilluar në ABP për vitin 2018, janë konsideruar si kundërvajtje administrative dhe shkelje të pikës 4 të nenit 53 të LPP-së, rastet kur komisionet e vlerësimit të ofertave kanë konsideruar si devijime të vogla mangësi të ofertave, mosparaqitje dokumentacioni apo mospërmbushje të kritereve, me qëllim realizimin e procedurës dhe kualifikimin e ofertave me vlerën më të ulët.*

*Nga shqyrtimi i këtyre observacioneve dolem me konkluzionin se, ashtu si u trajtua më lartë për observacinet e bëra për procedurat e zhvilluara gjatë vitit 2017 dhe 2018 edhe këto observacione qendrojne pjesërisht dhe merren ne konsiderate vetëm në lidhje me përgjegjësitë, ndërsa si fenomen këto gjetje qëndrojnë, sepse: ABP dhe APP duhej te hartonin dhe unifikonin disa kritere minimale të kualifikimit per kontratat e mallra dhe shërbime që janë të njejta apo te ngjashme, me qellim minimizimin e skualifikimeve te operatorëve për mos plotesimin të disa kritereve te vecanta të cilat nuk ndikojne ne ekzekutimin e ketyre kontratave, kështu do të kishim një perdorim dhe menaxhim me efektivetiet dhe ekonomicitet të fondeve buxhetore.*

**10.** Gjithashtu, gjatë viti 2019 u vërejt se, në disa procedura prokurimi ka pasur konkurrencë minimale duke marrë pjesë vetëm një operatore ekonomik. Po kështu, në disa procedura të tjera me fond limit të përgjthshëm 1,073,942,016 lekë lekë, pa TVSH nuk kanë marrë pjesë fare operatorë ekonomik apo kanë marrë pjesë operatorë të cilit nuk plotësonin specifikimet teknike të mallrave dhe shërbimeve apo kërkesat e veçanta e për pasojë janë skualifikuar nga procedurat dhe në kushtet e mungesës së konkurrencë në mbështetje te nenit 97 te LPP këto procedura janë anuluar.
Më poshtë po trajtojmë disa prej tyre:

**10.1. Procedura e prokurimit me objekt "Blerje automjete, e ndarë në 9 (nëntë) lote" me fond limit të përgjithshm në vlerën 104,764,120 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

- Loti I "Blerje Autovetura me kalueshmëri të ulët" me fond limit: 6,527,940 lekë;
- Loti II "Blerje Autovetura me kalueshmëri të lartë" me fond limit: 32,174,196 lekë;
- Loti III "Blerje Mikrobuz (vende te ulura 8+1)" me fond limit: 2,980,963 lekë;
- Loti IV "Blerje Autoburg për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve "me fond limit: 11,581,478 lekë;
- Loti V "Blerje Autoambulanca Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve " me fond limit: 19,916,667 lekë;
- Loti VI" Blerje Kamionçinë për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare" me fond limit: 4,476,550 lekë;
- Loti VII " Blerje Automjete për aparatin e Ministrisë së Brendshme" me fond limit: 13,189,659 lekë;
- Loti VIII "Blerje Automjete për Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në miniera" me fond limit: 11,250,000 lekë;
-Loti IX " Blerje Automjete për Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural " me fond limit: 2,666,667 lekë.

Nga auditimi u konstatua:

**- Hartimi i specifikimeve teknike dhe llogaritja e vlerës limit te kontratave:**

Bazuar në nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, dhe *në* VKM- së nr. 82, datë 14.02.2018, i ndryshuar, është ngritur grupi i punës për unifikimin e specifikimeve teknike dhe hartimin e katalogut për këtë objekt prokurimi me urdhërin nr. 1205 prot. datë 03.07.2019. Në përfundim grupi i punës ka unifikuar specifikimet teknike dhe çmimet për njësi, duke i ndarë për 3 lloje automjetesh, si:

1. Autoveturë me kalueshmëri të ulët, me cilindratë minimumi 1.4 $cm^3$ ;
2. Autoveturë me kalueshmëri të lartë, me cilindratë minimumi 2.0 $cm^3$ ;
3. Mikrobuz (8+1 vende të ulura), me cilindratë minimumi 2.0 $cm^3$.

Pas unifikimit të specifikimeve teknike dhe çmimeve për njësi, ABP ka njoftuar AK të cilat kanë paraqitur kërkesa për këto lloje automjetesh, në lidhje me specifikimet teknike dhe cmimet për njësi të unifikuara për 3 llojet e automjeteve duke u kërkuar dhe njëherë ri-dërgimin e kërkesave për prokurim në referim të këtyre specifikimeve teknike dhe çmimeve për njësi të unifikuara për 3 llojet e automjeteve me qëllim publikimin dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit.

**-Hartimi i dokumenteve të tenderit:**
Njësia e hartimit të dokumenteve të tenderit në zbatim të ligjit nr. 9643,date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" dhe dokumenteve standarde për kontratat e mallrave ka hartuar dokumentet e këtij tenderi. Po kështu, ka hartuar dhe vendosur në këto dokumentet përveç kritereve ligjore të përgjithshme të pranim kualifikimit edhe kriteret te veçanta kualifikuese.
Më datë 08.10.2019 ABP ka shpallur në sistemin e prokurimit elektronik proçedurën e prokurimit me objekt: "Blerje automjete" ndarë në 9 (nëntë) lote, "Procedurë e hapur", mefond limit të përgjithshëm:104,764,120 Lekë pa TVSH, i cili është publikuar në datë 09.10.2019.

**-Përzgjedhja e operatorit fitues për secilin Lot:**

**1.** "Blerje Autovetura me kalueshmëri të ulët Loti I" për Shërbimi Informativ i Shtetit me fond limit, 6,527,940 lekë. Në tenderin e zvilluar në datën 12.11.2019, mori pjesë vetëm operatori "X" me ofertë ekonomike në vlerën 6,680,000 lekë i cili është skualifikuar nga procedura e prokurimit sepse, o*ferta ekonomike e paraqitur nga ofertuesi, përmban çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për lidhjen e kontratës për Lotin I si dhe nuk përmbush pikën 3 të kritereve të veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik pasi nga katalogu i paraqitur ka mospërputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DT konkretisht: konsumimi lënda djegëse kombinuar (l/100 km), kërkohet max 4.4 ndërsa në katalogun e paraqitur rezulton 4.6; gjerësia, pa pasqyra (mm), kërkohet min: 1748 ndërsa në katalogun e paraqitur rezulton 1700*; *të gjitha opsionalitetet e kërkuara në specifikimet teknike nuk janë të pasqyruara në katalogun e paraqitur.*
Në kushtet e mungesës së konkurrencë kjo procedurë është anuluar.
**2.** "Blerje Autovetura me kalueshmëri të lartë, Loti II" për: shërbimi Informativ i Shtetit me fond limit 13,405,915 lekë; Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes se Tregut me fond limit 5,362,366 lekë; Kontrollin e Lartë të Shtetit me fond limit 8,043,549 lekë; Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Sigurimeve Shoqërore me fond limit 5,362,366 lekë. Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomikë dhe KVO ka shqyrtuar dokumentacionin e operatorëve pjesëmarrës dhe më datë 21.11.2019 ka mbyllur procesin e vlerësimit të ofertave duke bërë këtë vlerësim:

| Nr. | Emri i Operatorëve Ekonomik | Vlera e Ofertës (pa TVSH) | Kualifikuar ose Skualifikuar | Klasifikuar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" SHPK | 35,760,000 | Skualifikuar | |
| 2 | "X" SH.P.K | 12,600,000 | Skualifikuar | |

Siç shihet, të 2 operatorët ekonomik janë skualifikuar nga KVO për këto arsye:
-Operatori "X" është skualifikuar sepse, oferta ekonomike, përmban çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktor, të parashikuar për lidhjen e kontratës për Lotin II;
-Operatori "X" sepse ka ofertuar me autoveturë me kalueshmëri të ulët në kundershtim me specifikimet teknike të kërkuara në DT në të cilat është kërkuar autoveturë me kalueshmëri të lartë.
Për skualifikimin e tij operatori "X" me shkresën nr. 1915 date 25.11.2019 ka paraqitur në ABP. Komisioni i ngritur për shqyrtimit të ankesës me vendimin nr. 1915/2 datë 02.12.2019 ka vendosur të refuzojë ankesën. Ky operatorë nuk ka vijuar më tej me ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik. Në kushtet e mungesës së konkurrencës procedura e prokurimit për Lotin II u anulua.
**3.** "Blerje Mikrobus (vende te ulura 8+1), Loti III" për Ministrinë e Brendshme me fond limit: 2,980,963 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar në datën 21.11.2019, nuk u paraqit asnjë ofertë

dhe në kushtet e mungesës së konkurrencës, në mbështetje të nenit 24 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" kjo procedurë u anulua.

**4.** "Blerje Autoburg për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Lotin IV", për Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me fond limit 11,581,478 lekë. Në tenderin e zhvilluar në datën 12.11.2019, morën pjesë dy operatorë si më poshtë:

| Nr. | Emri i Operatorëve Ekonomik | Vlera e Ofertës (pa TVSH) | Kualifikuar/ skualifikuar | Renditja |
|---|---|---|---|---|
| 1 | "X" SHPK | 11.380.000 | kualifikuar | I pari |
| 2 | "X" SHPK | 11.500.000 | kualifikuar | I dyti |

Të dy operatorët janë kualifikuar dhe është shpallur fitues operatori "X" i cili kishte paraqitur ofertë në vlerë më të vogël.

**5.** "Blerje Autoambulanca për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Loti V " për Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me fond limit:19,916,667 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar në datën 12.11.2019, mori pjesë vetëm operatori "X" i cili u kualifikua dhe u shpall fitues me me ofertë 19.800.000 lekë.

**6.** " Blerje Kamionçinë për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, Loti VI" për Drejtoria e Sherbimeve Qeveritareme fond limit: 4,476,550 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar në datën 12.11.2019, mori pjesë vetëm operatori "X" me me ofertë në vlerën 4,350,000 lekë. KVO e ka skualifikuar këtë operatore për arsye se: *nuk përmbush pikën 3 të kritereve të veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik pasi nga katalogu i paraqitur nuk evidentohet specifikimet teknike konkretisht, përmasat e karrocerisë, viti i prodhimit si dhe konsumi i karburantit për ciklin e kombinuar.*
Për këtë skualifikim operatori ka paraqitur ankesë në ABP me shkresën nr. 1909 date 25.11.2019 Komisioni i ngritur për shqyrtimin e ankesës me vendimin nr. 1909/2 datë 02.12.2019 ka vendosur të refuzojë ankesën. Operatori nuk vijoi me paraqitjen e ankesës në Komisionin e Prokurimit Publik Për mungesë të konkurrencë kjo procedura është anuluar.

**7. "** Blerje automjete për aparatin e Ministrisë së Brendshme, Loti VII" për Ministria e Brendshme me fond limit: 13,189,659 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar në datën 12.11.2019, mori pjesë vetëm operatori "X" me me ofertë në vlerën 12,600,000 lekë. KVO e ka skualifikuar këtë operatore për arsye se: *nuk përmbush pikën 3 të kritereve të veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik pasi nga katalogu i paraqitur nuk evidentohen të gjitha opsionalitetet e kërkuara në specifikimet teknike.*
*Për këtë skualifikim operatori ka paraqitur ankesë në ABP* me shkresën nr. 1915 date 25.11.2019 Komisioni i ngritur për shqyrtimin e ankesës me vendimin nr. 1915/2 datë 02.12.2019 ka vendosur të refuzojë ankesën. Operatori nuk vijoi me paraqitjen e ankesës në Komisionin e Prokurimit Publik Për mungesë të konkurrencë kjo procedura është anuluar.

**8.** "Blerje Automjete për Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, Loti VIII" me fond limit:11,250,000 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar në datën 12.11.2019, mori pjesën dy operatorë si më poshtë:

| Nr. | Emri i Operatorëve Ekonomik | Vlera e Ofertës (pa TVSH) | Kualifikuar/ skualifikuar |
|---|---|---|---|
| 1 | "X" SH.P.K | 11,700,000 | Skualifikuar |
| 2 | "X" SH.A | 11,100,000 | Skualifikuar |

Të dy operatorët janë skualifikuar nga KVO për këto arsye:
Operatori "X" sepse, *si nuk përmbush pikën 3 të kritereve të veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik pasi nga katalogu i paraqitur nuk evidentohet viti i prodhimit të automjetit në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara në DT dhe në katalogun e paraqitur nuk evidentohen të gjitha opsionalitetet e kërkuara në specifikimet teknike*
Operatori "X" sepse, *nuk përmbush pikën 3 të kritereve të veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik pasi nga katalogu i paraqitur viti i prodhimit të automjetit nuk është sipas specifikimeve teknike të*

*kërkuara në DT dhe në katalogun e paraqitur nuk evidentohen të gjitha opsionalitetet e kërkuara në specifikimet teknike*

Të dy operatorët për këto skualifikime kanë paraqitur ankesa në ABP. Konkretisht: operatori "X" paraqiti ankesë me shkresën nr. 1918 date 26.11.2019 të cilën Komisioni i shqyrtimit të ankesës e ka refuzuar me vendimin nr. 1918/2 datë 03.12.2019 dhe operatori "X" paraqiti ankesë me shkresën nr. 1933 date 02.12.2019 të cilën Komisioni i shqyrtimit të ankesës e ka refuzuar me vendimin nr. 1933/2 datë 04.12.2019.

Nga të dy operatorët nuk paraqitën ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik dhe për mungesë konkurrencë kjo procedura është anuluar.

**9.** " Blerje Autovetura për Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, Loti IX"' me fond limit:2,666,667 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar në datën 12.11.2019, mori pjesën vetëm operatori "X" me ofertë ekonomike në vlerën 2,660,000 lekë. Ky operatorë është skualifikuar nga KVO sepse, *nuk përmbush pikën 3 të kritereve të veçanta të kualifikimit, kapaciteti teknik pasi nga katalogu i paraqitur nuk evidentohen të gjitha opsionalitetet e kërkuara në specifikimet teknike.*

Për këtë skualifikim ky operator me shkresë nr. 1919 date 26.11.2019 ka paraqitur ankesë të cilën. Komisioni i ngritur për shqyrtimit e ankesës me vendimin nr. 1919/2 datë 03.12.2019 nuk e ka marrë në konsideratë.

Në kushtet e mungesës së konkurrencës kjo procedurë është anuluar.

Sa sipër duket qartë se, sic është trajtuar edhe në procedurat e anuluara gjatë vitit 2017, nuk ka pasur interes nga operatorët ekonomik për të marrë pjesë në këto procedura, ndërkohë që shit-blerja e automjeteve është veprimtari shumtë të mirënjohura në tregun vendas. Anulimi i një pjesë të madhe të procedurave të prokurimit për blerjen e autoveturave apo mallrave dhe shërbimeve të tjera të domosdoshme për ushtrimin normal të veprimtarive të Autoriteteve Kontraktore ka bërë që, për një pjesë të konsiderueshme të fondeve buxhetore në vlerën nuk është arritur efiçenca dhe efikasiteti i procedurave të prokurimit, duke mos përmbushur kështu, edhe në këtë vit qëllimin e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "për prokurimin Publik", i sanksionuar ne pikën "a, të nenit 1 te tij.

*Në lidhje me problemet e trajtuara më sipër të cilat janë pasqyruar edhe në Projekt Raportin e Auditimit, nga ABP janë paraqitur observacione te cilat në mënyrë të përmbledhur konsistojnë, si me poshtë:*

*Në lidhje me këtë gjetje, ju sjellim në vëmendje se në 93 procedura prokurimi të realizuara me fitues gjatë vitit 2019 (85 marrëveshje kuadër dhe 8 kontrata publike), rezultojnë pjesëmarrës gjithësej 355 operatorë ekonomik, duke konkluduar në një pjesëmarrje mesatarisht 3,8 operator ekonomik për procedurë prokurimi (tabela bashkëngjitur).*
*Në lidhje me procedurat e prokurimit të cilat janë anuluar gjatë vitit 2019, ju sqarojmë se kanë qenë gjithësej 43 procedura (27 % e procedurave të publikuara), nga të cilat 26 procedura janë rishpallur dhe realizuar me sukses gjatë vitit 2019. Përfundimisht, nuk janë realizuar me sukses gjatë vitit 2019 vetëm 17 procedura prokurimi (11% e procedurave të publikuara) dhe vetëm për 26 kërkesa të autoriteteve kontraktore si dhe për 2% të fondeve të parashikuara për prokurim në ABP.*

*Nga shqyrtimi i këtyre observacioneve dolem me konkluzionin se, ashtu sic është shprehur edhe vete në këto observacione, në shumë raste shume raste procedura të anuluara dhe të rishpalluar përsëri, cka tregon që konstatimi KLSH qendron. Per eleminimin e ketij fenomeni dhe me qëllim rritjen e konkurrences dhe te eficences së procedurave te prokurimeve, kerkohet domosdoshmerisht që të bashkëpunomhet me APP për permiresim te kuadrit ligjor që lidhet pikërisht me këto probleme.*

***Shenim:***

Auditimi mbi ligjishmërinë e procedurave të prokurimit të zvilluara dhe që janë objekt auditimi janë kryer me zgjedhje, bazuar ne metotdologjine e riskut dhe materialitetit. Procedurat e tjera që nuk janë audituara do të auditohen ne një periudhë tjetër të më vonshme.

**5. Shqyrtimi i ankesave të operatorëve ekonomikë deri në shpalljen e njoftimit të fituesit.**

Për vitin 2017 në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara janë paraqitur në total 46 ankesa, të cilat ndahen, 16 ankesa mbi kriteret/ specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit në ABP dhe 30 ankesa për procedura të ankimuara për vlerësimin e ofertave ne ABP.
Për vitin 2018 në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara janë paraqitur në total 71 ankesa, të cilat ndahen, 33 ankesa mbi kriteret/ specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit në ABP dhe 38 ankesa për procedura të ankimuara për vlerësimin e ofertave ne ABP.
Për vitin 2019 në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara janë paraqitur në total 95 ankesa, të cilat ndahen, 37 ankesa mbi kriteret/ specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit në ABP ku 15 ankesa janë pranuar pjesërisht, 4 ankesa janë pranuar tërësisht, 4 ankesa janë sqaruar kriteret dhe 14 ankesa të cilat janë rrëzuar nga ABP; 8 ankesa mbi procedurat e ankimuara për kriteret/specifikimet teknike të tenderit në KPP nga ku 5 ankesa janë pranuar pjesërisht, 1 ankesa është në shqyrtim nga KPP dhe 2 ankesa janë rrëzuar nga ABP si dhe 50 procedura të ankimuara për vlerësimin e ofertave ne ABP nga ku 11 ankesa janë pranuar pjesërisht, 4 ankesa janë pranuar tërësisht dhe 35 ankesa janë rrëzuar nga ABP.

Nga auditimi u konstatua se , për cdo ankesë si për dokumentat e tenderit dhe per shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, nga ABP janë ngritur komisione apo grupe nune të posaçme per shqyrtimin e ankesave duke i dhënë dhenë përgjigje operatorëve ekonomik të anikimuar, në përputhje me afetet e përcaktuara në rregullat e prokurimit publik.

**6. Monitorimi i zbatimit të kontratave nga Autoritetet Kontraktore. Hartimi i raporteve të monitorimit nga DPPP, për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës.**

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës, në zbatim të VKM-së nr. 82, datë 14.02.2018, "*Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime*", i ndryshuar, ngarkohet të zhvillojë prokurimin e fondeve buxhetore, me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrisë e të ministrive të linjës, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.
Në zbatim të pikës 11, të VKM-së nr. 82/2018, i ndryshuar, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara ka të drejtë të monitorojë në çdo kohë zbatimin e kontratave nga autoritetet kontraktore. Në përfundim të monitorimit harton një raport për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
Gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2019 janë kryer 61 monitorime, në 41 autoritete kontraktore, me vlerë totale të kontratave të monitoruara 500.211.386 LEK (pa tvsh).
Bashkëlidhur do të gjeni tabelën përmbledhëse të monitorimeve të kryera për periudhën Janar-Dhjetor 2019.

| Nr | Autoriteti Kontraktor | Objekti i prokurimit | Vlera e kontratës së realizuar (pa TVSH) | Fondi i marrëveshjes kuadër (pa TVSH) | Data e monitorimit |
|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA) | "Blerje dokumentacioni, shtypshkrime të ndryshme (kuti, dosje, formularë etj.) dhe botimin e revistës Arkivore për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave" Loti IV MK (2018) | 2.679.295 | 3.458.334 | 28.01.2019 |
| 2 | Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve | Blerje materialesh të ndryshme për pastrim Loti I "Blerje detergjentë, dizinfektant dhe aromatizues" MK (2018) | 10.910.000 | 34.092.025 | 31.01.2019 |
| 3 | Ministria e Mbrojtjes | Blerje materialesh të ndryshme për pastrim Loti I : "Blerje detergjentë, dizinfektant dhe aromatizues" Loti II "Blerje materialesh të ndryshme për pastrim" MK (2018) | 5.765.180 | 60.990.943 | 01.02.2019 |
| 4 | Drejtoria Rajonale Shëndetësisë Shkodër | Blerje materialesh të ndryshme për pastrim Loti I "Blerje detergjentë, dizinfektant dhe aromatizues" Loti II "Blerje materialesh të ndryshme për pastrim" (2018) | 566.287 | 60.990.943 | 05.02.2019 |
| 5 | Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit | Blerje goma për automjete MK Loti I (2018) | 874.000 | 876.000 | 18.02.2019 |
| 6 | Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit | Blerje bateri për automjete MK Loti II (2018) | 343.100 | 473.941 | 18.02.2019 |
| 7 | Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit | Blerje vajra e lubrifikant MK Loti III (2018) | 570.500 | 570.000 | 18.02.2019 |
| 8 | Garda e Republikës | Blerje automjetesh ( Kontratë) Loti IV (2018) | 5.880.000 | Kontratë | 22.02.2019 |
| 9 | Komanda e Forcës Tokësore (Reparti 1001) | Blerje tonera MK (2018) | 1.582.643 | 1.665.493 | 05.03.2019 |
| 10 | Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial | Blerje tonera MK (2018) | 1.268.093 | 1.283.333 | 06.03.2019 |
| 11 | Qendra e Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit | Sigurim i detyrueshëm TPL Loti I (2018) | 1.265.091 | 1.269.820 | 08.03.2019 |
| 12 | Batalioni i Mbështetjes (Reparti 6630) | Sigurim automjetesh TPL + KASKO Loti I dhe Loti II (2018) | 2.892.480 | 41.670.413 | 11.03.2019 |
| 13 | Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë | Blerje tonera MK (2018) | 4.969.663 | 4.998.867 | 29.03.2019 |
| 14 | Agjencia e Trajtimit të Pronave | Blerje tonera MK (2018) | 3.749.400 | 3.750.000 | 02.04.2019 |
| 15 | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit | Blerje automjet fuoristradë Loti XII (Kontratë) (2018) | 4.441.667 | Kontratë | 12.04.2019 |
| 16 | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit | Blerje automjete fuoristrada Loti XIII (Kontratë) (2018) | 36.137.507 | Kontratë | 12.04.2019 |
| 17 | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit | Blerje automjete Loti XIV (Kontratë) (2018) | 49.795.821 | Kontratë | 12.04.2019 |
| 18 | Instituti i Statistikës | Blerje Tonera MK (2018) | 1.802.531 | 1.803.259,15 | 18.04.2019 |
| 19 | Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | Blerje Tonera MK (2018) | 1.979.251 | 1.979.649 | 26.04.2019 |
| 20 | Komanda Mbështetëse (Reparti 4001) | Blerje goma për automjete MK Loti I (2018) | 13.120.500 | 22.801.940 | 08.05.2019 |
| 21 | Komanda Mbështetëse (Reparti 4001) | Blerje bateri për automjete MK Loti II (2018) | 7.086.733 | 7.195.291 | 08.05.2019 |
| 22 | Komanda Mbështetëse (Reparti 4001) | Blerje vajra e lubrifikant MK Loti III (2018) | 10.661.950 | 15.928.233 | 08.05.2019 |
| 23 | Drejtoria e Përgjithshme e Doganave | Blerje Tonera MK (2018) | 3.918.503 | 3.918.617 | 10.05.2019 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 24 | Drejtoria e Përgjithshme e Doganave | Blerje bateri për automjete MK Loti II (2018) | 440.361 | 565.848 | 10.05.2019 |
| 25 | Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve | Blerje minibus Loti V (Kontratë) (2018) | 19.333.333 | Kontratë | 14.05.2019 |
| 26 | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale | Blerje Tonera MK (2018) | 1.663.990 | 1.664.075 | 27.05.2019 |
| 27 | Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve | Blerje goma për automjete MK Loti I (2018) | 811.000 | 41.563.646 | 28.05.2019 |
| 28 | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës | Blerje orendish dhe pajisjesh për zyra (2018) | 1.533.200 | 1.533.000 | 29.05.2019 |
| 29 | Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit | Blerje orendish dhe pajisjesh për zyra (2018) | 2.288.400 | 2.291.025 | 29.05.2019 |
| 30 | Drejtoria e Përgjithshme e Doganave | Blerje orendish dhe pajisjesh për zyra (2018) | 2.560.550 | 5.123.885 | 30.05.2019 |
| 31 | Instituti i Shëndetit Publik | Sigurim automjetesh TPL + KASKO Loti I dhe Loti II (2018) | 1.131.381 | 2.199.739 | 07.06.2019 |
| 32 | Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (Reparti 5001) | Blerje Tonera MK (2018) | 2.997.122 | 3.000.000 | 13.06.2019 |
| 33 | Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" | Blerje Tonera MK (2018) | 4.401.175 | 4.407.043 | 14.06.2019 |
| 34 | Prefekti i Qarkut Tiranë | Blerje automjete per prefektet (Kontratë ) (2018) | 5.256.000 | Kontratë | 13.06.2019 |
| 35 | Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore | Blerje autoambulance Model A dhe C (Kontratë) (2018) | 198.640.011 | Kontratë | 01.07.2019 |
| 36 | Inspektoriati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut | Blerje automjet Fuoristradë (Kontratë) (2018) | 2.394.000 | Kontratë | 08.07.2019 |
| 37 | Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë | Blerje automjeti (Kontratë) (2018) | 3.000.000 | Kontratë | 04.07.2019 |
| 38 | Policia Ushtarake (Reparti 6620) | Sigurim i detyrueshëm TPL Loti 1 (2018) | 1.667.070 | 1.668.213 | 16.07.2019 |
| 39 | Autoriteti Kombëtar i Ushqimit | Blerje automjete frigoriferike Loti 15 (2018) | 30.000.000 | Kontratë | 17.07.2019 |
| 40 | Qendra e Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit | Blerje goma për automjete MK Loti I (2018) | 809.500 | 41.563.646 | 26.07.2019 |
| 41 | Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi" | Blerje materialesh të ndryshme për pastrim Loti I : "Blerje detergjentë, dizinfektant dhe aromatizues" Loti II "Blerje materialesh të ndryshme për pastrim" MK (2019) | 1.481.248 | 3.666.150 | 27.08.2019 |
| 42 | Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve | Blerje dokumentacioni Loti 2 (2019) | 2.082.711 | 3.049.809 | 28.08.2019 |
| 43 | Ministria e Mbrojtjes | Blerje tonera MK (2019) | 4.979.090 | 9.999.348 | 09.09.2019 |
| 44 | Ministria e Mbrojtjes | Loti II: Materiale kancelarie të tjera zyre Loti III: Blerje letre (2019) | 3.415.627 | 7.852.401 | 09.09.2019 |
| 45 | Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit | Botime, printime, materiale shtypshkrimi (2019) | 3.899.750 | 9.821.074,96 | 17.09.2019 |
| 46 | Spitali Universitar "Mbretëresha Geraldina " | Blerje materialesh të ndryshme për pastrim Loti I : "Blerje detergjentë, dizinfektant dhe aromatizues" Loti II "Blerje materialesh të ndryshme për pastrim" MK (2019) | 1.408.797 | 7.229.100 | 20.09.2019 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 47 | Garda e Republikës | Blerje tonera MK (2019) | 1.580.627 | 3.333.333 | 23.09.2019 |
| 48 | Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit | Blerje dokumentacioni Loti 1 (2019) | 4.849.598.8 | 4.853.449 | 01.10.2019 |
| 49 | Spitali Universitar "Koco Glozheni" | Blerje materialesh të ndryshme për pastrim Loti I : "Blerje detergjentë, dizinfektant dhe aromatizues" Loti II "Blerje materialesh të ndryshme për pastrim" MK (2019) | 2.152.131 | 5.111.416 | 11.10.2019 |
| 50 | Reparti Special RENEA | Sigurim i detyrueshëm TPL Loti 1 (2019) | 67.500 | | 21.10.2019 |
| 51 | Qendra e Botimeve Zyrtare | Loti II: Materiale kancelarie të tjera zyre Loti III: Blerje letre (2019) | 212.200 | 1.828.357 | 22.10.2019 |
| 52 | Shërbimi Informativ i Shtetit | Blerje goma për automjete MK Loti I (2019) | 1.632.000 | 3.859.257,5 | 01.11.2019 |
| 53 | Shërbimi Informativ i Shtetit | Blerje tonera MK (2019) | 5.609.666 | 11.664.620 | 01.11.2019 |
| 54 | Spitali Rajonal Fier | Loti IV "Shërbim i lyrjeve për Spitalin Rajonal Fier, godinën e poliklinikës dhe godinën e pediatrisë | 2.117.840 | 2.684.526 | 11.11.2019 |
| 55 | Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural | Blerje tonera MK (2019) | 1.168.350 | 1.299.140 | 25.11.2019 |
| 56 | Agjencia Shtetërore e Kadastrës | Blerje tonera MK (2019) | 1.898.763 | 3.782.656 | 02.12.2019 |
| 57 | Qendra e Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit | Blerje vajra e lubrifikant MK Loti III (2019) | 708.250 | 1.238.993 | 17.12.2019 |
| 58 | Ministria e Drejtësisë | Blerje tonera MK (2019) | 1.237.902 | 7.164.600 | 18.12.2019 |
| 59 | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme | Blerje tonera MK (2019) | 4.380.980,38 | 14.519.082 | 19.12.2019 |
| 60 | Spitali Universitar "Mbretëresha Geraldina " | Blerje shtypshkrime | 136.067 | 1.637.000 | 24.12.2019 |
| 61 | Garda e Republikës | Blerje goma për automjete | 4.006.000 | 10.604.671 | 26.12.2019 |

## IV. GJETJE REKOMANDIME:

## A. MASA PËR PËRMIRËSIME LIGJORE:

***1.* Gjetje:** Në zbatim të nenit 35 "Marrëveshjet kuadër" të Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" dhe nenit 45 "Prokurimi i marrëveshjes kuadër" i VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim APP) ka nxjerrë Udhëzimin Nr.6 datë 16.01.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kudër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike". Në pikën 7.3 të këtij udhëzimi përcaktohet:

- "Në rastin kur vlerësimi i ofertës/ofertave fituese bëhet bazuar në çmimin për njësi, fondi limit do të jetë çmimi i përllogaritur për njësi për çdo artikull apo shërbim. Autoriteti kontraktor do të shpallë dhe zhvillojë procedurën e prokurimit me çmimin e përllogaritur për njësi dhe jo me një fond limit në total". Kjo pikë është ndryshuar me Udhëzim nr.15 datë 26.11.2018 "Për një ndryshim në Udhëzimin e APP nr.6 datë 16.01.2018", me këtë përmbajtje:

-"Në çdo rast autoriteti kontraktor planifikon më përafërsi sasinë dhe vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër, bazuar në eksperiencat e mëparshme me qëllim jo vetëm orientimin e operatorëve ekonomikë por edhe hartimin e kritereve për kualifikimin apo kërkesave të tjera të cilat lidhen përpjesëtimisht me fondin limit. Fondi limit, me të cilin autoriteti kontraktor do të shpallë procedurën e prokurimit është vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër. Hartimi i kritereve të veçanta për kualifikim si; kapacitetet teknike, ekonomike apo kritere të tjera të cilat lidhen me fondin do të përllogariten mbi vlerën e pritshme të kontratave që mund të lidhen".

-"Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj autoriteti kontraktor përveç vlerës së pritshme të kontratave do të përllogarisë edhe shumatoren e çmimeve për njësi, e cila duhet të publikohet së bashku me vlerën e pritshme të kontratave (fondi limit) në njoftimin e kontratës".
"Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi. Për efekt krahasimi vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi të përllogaritur për çdo artikull apo shërbim nga autoriteti kontraktor".

Nga sa më lart, APP me Udhëzim nr.15 datë 26.11.2018 "Për një ndryshim në Udhëzimin e APP nr.6 datë 16.01.2018, ka urdhëruar dhe ka orientuar të gjitha Autoritetet Kontraktore që, kur objekti i prokurimit (i marrëveshjes kuadër) përbëhet nga disa artikuj, ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi dhe për efekt krahasimi vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi të përllogaritur për çdo artikull apo shërbim nga Autoriteti Kontraktor. Mirëpo, përmbajtja e pikës 7.3 të udhëzimit bie në kundërshtim me:

-Nenin 55 të Ligji nr.9643 datë 20.11.2006, i cili përcakton se: "Oferta fituese duhet të jetë: a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët;
-Nenin 45 të VKM nr.914 datë 29.12.2014, i cili përcakton se: "Operatorët ekonomikë përzgjidhen si palë të marrëveshjes kuadër duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, sipas përcaktimeve të nenit 55, të LPP-së. Në çdo rast, autoriteti kontraktor mund të vendosë të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar në çmimin për njësi. Autoriteti kontraktor harton dhe publikon njoftimin e fituesit për një marrëveshje kuadër në përputhje me LPP-në dhe këto rregulla.
Pra, rregullat e prokurimit nuk përcaktojnë se, oferta fituese përzgjidhet apo mund të përzgjidhet për shumatoren e çmimeve për njësi më të ulët, si kundër është përcaktuar në pikën 7.3 të Udhëzim nr. 6 datë 16.01.2018, i ndryshuar, por përcaktojnë se, oferta fituese përzgjidhet për çmimin për njësi më të ulët.
Po kështu, APP ka vepruar edhe për zbatimin e VKM nr.82, datë 14.02.2018 "Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive, institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime", i ndryshuar. Në neni 7 të kësaj VKM përcaktohet se: "Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP) duhet të prokurojë, nëpërmjet marrëveshjes kuadër, mallrat dhe shërbimet e vazhdueshme dhe /ose të unifikuara. Kategoritë konkrete të mallrave dhe shërbimeve, të cilat do të prokurohen nëpërmjet marrëveshjes kuadër, përcaktohen sipas udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik". Në zbatim të këtij neni, APP ka nxjerrë Udhëzimin Nr. 8, datë 20.02.2018 "Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, ..." i cili më vonë është ndryshuar me Udhëzimin nr. 1, datë 10.01.2019. Në pikën 5 dhe 5.1, të këtij udhëzimi përcaktohen rastet e kontratave të mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme që do të prokurohen nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër. Po në këtë pikë përcaktohet se: "Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, përveç vlerës së pritshme të kontratave *do të përllogaritet edhe shumatorja e çmimeve për njësi*, e cila duhet të publikohet së bashku me vlerën e pritshme të kontratave (fondi limit) në njoftimin e kontratës. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga

disa artikuj, ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi. Për efekt krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi të përllogaritur për çdo artikull apo shërbim, nga autoriteti kontraktor".

Siç duket edhe ne këtë udhëzim të veçantë që APP e ka nxjerrë vetëm për ABP, ka përsëritur dha ka përcaktuar të njëjtën përmbajtje si përmbajtja e pikës 7.3 të Udhëzim nr. 6 datë 16.01.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kuadër...".

Sa sipër, përcaktimi i ofertës fitues bazuar në shumatoren e çmimeve për njësi, përveç se rrit koston e blerjes se mallrave dhe shërbimeve të Autoriteteve Kontraktore në dëm të buxhetit të shtetit, por denatyron, shmang dhe bën të pa zbatueshme pothuajse një pjesë të mirë të procedurës dhe përmbajtjes së rregullave të prokurimit publik të parashikuara në Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 dhe në VKM nr.914 datë 29.12.2014. Ky fenomen mundë të shfaqet rëndom në të gjitha Autoritet Kontraktore të ndryshme që, kanë realizuar apo mundë të realizojnë procedura prokurimi nëpërmjet marrëveshjes kuadër për kontratat e mallrave dhe shërbimeve sipas përcaktimeve pikës 7.3 të Udhëzim nr. 6 datë 16.01.2018.

Në kontekst të këtij konstatimi, ky fenomen është vërejtur edhe në këtë auditim të ABP, e cila ka realizuar procedura prokurimi nëpërmjet marrëveshjes kuadër për blerjen e mallrave dhe shërbimeve sipas pikës, 5 dhe 5.1, të Udhëzimit Nr. 8, datë 20.02.2018, për pasojë i është shkaktuar ***buxhetit të shtetit dëm ekonomik që shkon rreth 200 milion lekë, me TVSH***, si më poshtë:

ABP gjatë vitit 2019 ka realizuar 85 procedura prokurimi nëpërmjet marrëveshjes kuadër për blerjen e mallrave dhe shërbimeve me vlerë të përgjithshme 5,817,567,129 lekë. Nga 85 procedurat 48 procedura (të ndara në Lote) me vlerën të përgjithshme 1,126,967,454 lekë janë realizuar vetëm për blerje mallrash, në të cilat ofertat fituese janë përzgjedhur *mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi*, sipas përcaktimeve të pikës 5 dhe 5.1 të Udhëzimin të APP me nr. 8, datë 20.02.2018. Nga zbatimi i udhëzimit të APP (pikës 5 dhe 5.1), është shmangur nga zbatimi, nenin 55 të Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 dhe nenin 45 të VKM nr.914 datë 29.12.2014, të cilët përcaktojnë se, autoriteti kontraktor vendosë të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar **në çmimin për njësi më të ulët** dhe jo siç përcaktohet në udhëzimin e sipërcituar që fituesit janë përzgjedhur mbi bazën **e shumatores së çmimeve për njësi më të ulët**.

Për sa më sipër, në zbatim të pikës 5 dhe 5.1 të Udhëzimit nr. 8, datë 20.02.2018: është rritur kosto e blerjes së mallrave në dëm të buxhetit të shtetit për 127,598,084 lekë, me TVSH; është shkelur pika "d" e nenit 24 e Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 sepse disa oferta te paraqitura kanë tejkaluar fondin limit dhe nuk janë skualifikuar; është shkelur dhe është bërë i pa zbatueshëm neni 56 i Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 dhe neni 66 i VKM nr.914 datë 29.12.2014 që, bën fjalë për llogaritjen e ofertës anomalish e ulët duke rritur koston e blerjeve të mallrave në dëm të buxhetit të shtetit për 72,388,830 lekë, me TVSH; është shkelur dhe është bërë i pa zbatueshëm neni 63 i LPP dhe neni 78 i VKM për rregullat e prokurimit publik, sepse është denatyruar gjithë procesi i ankimit administrativ dhe i shqyrtimit të ankesave *(shih më poshtë pikën "D" ku janë trajtuar rastet konkrete të këtij dëmi).*

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 65-78, të Raportit të Auditimit)*

**1.1 Rekomandimi:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara ti kërkoj Agjencisë së Prokurimit Publik:
- Shfuqizimin apo ndryshimin e pikës 5 dhe 5.1 të Udhëzimin Nr. 8, datë 20.02.2018 "Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra e shërbime";
- Shfuqizimin apo ndryshimin e pikës 7.3 Udhëzimin Nr.6 datë 16.01.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kudër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

***Menjëherë***

**2. Gjetje:** Gjatë periudhës objekt auditimi u vërejt se, në disa procedura prokurimi për blerje mallra dhe shërbime ka pasur konkurrencë minimale duke marrë pjesë vetëm një operator ekonomik. Ndërsa në disa procedura të tjera, (në vitin 2017 me fond limit në total rreth 280,000,000 lekë dhe në vitin 2019 me fond limit në total rreth 1,073,942,016 lekë) nuk kanë marrë pjesë operatorë

ekonomik apo kanë marrë pjesë operatorë të cilit nuk plotësonin specifikimet teknike të mallrave dhe shërbimeve apo kriteret e veçanta të kualifikimit duke u skualifikuar nga procedurat e prokurimit, dhe në kushtet e mungesës së konkurrencës, në mbështetje të nenit 24 të LPP, këto procedura janë anuluar (Ndërkohë është e njohur që, tregu i shit-blerjes së këtyre mallrave dhe ofrimit të këtyre shërbimeve është mjaft i përhapur, pasi për këto veprimtari operojnë shumë sipërmarrje të mesme e të mëdha, duke krijuar një treg konkurrues dhe rrjedhimisht interesi për të marrë pjesë në tendera publik duhej të ishte tepër i lartë). Më poshtë po përmendim disa prej procedurave të anuluara:

- Procedura e prokurimit publike me objekt: "Blerje uniforma, veshmbathje dhe elemente të tjera, përbërëse të tyre për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave Loti III", me fond limit 32,369,409 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar 08.05.2017 morën pjesë 3 operatore të cilët janë skualifikuar nga procedura për arsye se nuk plotësonin specifikimet teknike të mallrave apo disa kërkesa të veçanta të kërkuara në DT;
- Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje uniforma, veshmbathje dhe elemente të tjera, përbërëse të tyre për Gardën e Republikës, Loti II", me fond limit 10,176,543 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar 08.05.2017 mori pjesë vetëm operatori "X", me ofertë10,150,200 lekë i cili është skualifikuar sepse nuk ka paraqitur flete analize për artikullin berete të kostumit për shërbime stërvitje;
- Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje këpucë për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave Lotin II" me fond limit 4,747, 578 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar 10.05.2017 morën pjesë 4 operatore të cilët janë skualifikuar nga procedura për arsye se nuk plotësonin specifikimet teknike të mallrave apo disa kërkesa të veçanta të kërkuara në DT;
- Procedura e prokurimit me objekt : " Blerje këpucë", Loti I "Blerje këpucë për Gardën e Republikës Lotin I" me fond limit 2,083, 333 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar 10.05.2017 morën pjesë 2 operatore të cilët janë skualifikuar nga procedura për arsye se nuk plotësonin specifikimet teknike të mallrave apo disa kërkesa të veçanta të kërkuara në DT;
- Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje automjete për Autoritetin e Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit, Loti I" me fond limit 3,753, 287 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar 22.11.2017 mori pjesë vetëm operatori "X" , me ofertë 1,800,000 lekë i cili është skualifikuar sepse nuk ka paraqitur asnjë dokument, përveç ofertës ekonomike, ekstraktit tregtar dhe atij historik;
- Procedura e prokurimit me objekt: "Shërbim Gatimi dhe Shpërndarje Ushqimi (Katering) për Repartin Ushtarak 4001 Kukës Loti II" me fond limit 7,729,216 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar 16.10.2017 mori pjesë vetëm operatori "X", me ofertë 7,670,836 lekë i cili është skualifikuar sepse nuk plotësoni disa kërkesa të veçanta të kërkuara në DT;
- Procedura e prokurimit me objekt : "Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil), Loti I" me fond limit në vlerën 30,176,892 lekë. Ne tenderin e zhvilluar në datën 14.05.2018, mori pjesë vetëm BOE "X" me ofertë, marzhë fitimi 16.4%, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues;
- Procedura e prokurimit me objekt: "Furnizim me lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial Loti II". Ne tenderin e zhvilluar në datën 14.05.2018, morën pjesë vetëm operatori "X" me ofertë, marzhë fitimi 15%, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues;
- Procedura e prokurimit me objekt :"Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil), Loti III", me fond limit në vlerën 10,341,341 lekë. Në tenderin e zhvilluar në datën 14.05.2018, mori pjesë vetëm BOE "X" me ofertë, marzhë fitimi 17.4%, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues;
- Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje automjete, e ndarë në 9 lote" me fond limit të përgjithshëm në vlerën 104,764,120 lekë pa TVSH, e zhvilluar në datën 12.11.2019. Nga 9 lotet, 7 prej tyre janë anuluar për mungesë konkurrence si:
- Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje Autovetura me kalueshmëri të ulët, Loti I" për Shërbimi Informativ i Shtetit me fond limit, 6,527,940 lekë. Në tenderin e zhvilluar mori pjesë vetëm një operator i cili është skualifikuar nga procedura e prokurimit sepse, nuk plotëson specifikimet teknike të automjeteve sipas kërkesave të DT;

- Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje Autovetura me kalueshmëri të lartë, Loti II" për shërbimi Informativ i Shtetit me fond limit 13,405,915 lekë; Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes se Tregut me fond limit 5,362,366 lekë; Kontrollin e Lartë të Shtetit me fond limit 8,043,549 lekë; Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Sigurimeve Shoqërore me fond limit 5,362,366 lekë. Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomikë të cilët janë skualifikuar sepse nuk plotësonin specifikimet teknike të automjeteve;
- Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje Mikrobus (vende te ulura 8+1), Loti III" për Ministrinë e Brendshme me fond limit: 2,980,963 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar nuk u paraqit asnjë operator;
- Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje Kamionçinë për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, Loti VI" për Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare me fond limit: 4,476,550 lekë. Në tenderin e zhvilluar mori pjesë vetëm një operator i cili është skualifikuar sepse, nuk plotëson specifikimet teknike të automjeteve;
- Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje automjete për aparatin e Ministrisë së Brendshme, Loti VII" për Ministria e Brendshme me fond limit: 13,189,659 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar në datën, mori pjesë vetëm një operator i cili është skualifikuar nga procedura e prokurimit sepse, nuk plotëson specifikimet teknike të automjeteve;
- Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje Automjete për Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, Loti VIII" me fond limit:11,250,000 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar morën pjesën dy të cilët janë skualifikuar sepse, nuk plotëson specifikimet teknike të automjeteve ;
- Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje Autovetura për Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, Loti IX"' me fond limit:2,666,667 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar, mori pjesën vetëm një operator i cili është skualifikuar nga procedura e prokurimit sepse, nuk plotëson specifikimet teknike të automjeteve.

Sa sipër duket qartë se, nuk ka pasur interes të mjaftueshëm nga operatorët ekonomik për të marrë pjesë në këto procedura, ndërkohë që mallrat dhe shërbimet si, blerja: uniformave, veshmbathjeve, këpucëve, karburanteve, autoveturave, shërbimit kateringut, etj, janë artikuj të bollshëm dhe veprimtari shumtë të mirënjohura në tregun vendas. Pra për furnizimin e këtyre mallrave dhe shërbimeve ka mjaftueshëm tregtar të vegjël dhe të mëdhenj që operojnë në tregun vendas, për pasoje duhet të kishte konkurrencë më të madhe në këto procedura prokurimi. Anulimi i një pjesë të madhe të procedurave të prokurimit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve të domosdoshme për ushtrimin normal të veprimtarive të Autoriteteve Kontraktore ka bërë që, për një pjesë të konsiderueshme të fondeve buxhetore nuk është arritur efiçenca dhe efikasiteti i procedurave të prokurimit, duke mos përmbushur kështu, qëllimin e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "për prokurimin Publik", i sanksionuar ne pikën "a, të nenit 1 te tij, në të cilin përcaktohet se: *"Qëllimi i këtij ligji është, të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore"*

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 51-64 dhe 103-107, të Raportit të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me cilësinë e organit qendror blerës ti kërkoj Agjencisë së Prokurimit Publik të marri iniciativën ligjore për përmirësimin e kuadrit ligjor të prokurimeve publike në lidhje me zgjerimin e konkurrencës në procedurat e prokurimit që ka të bëjë me vlefshmërinë në jo më pak se, dy operatorë ekonomik pjesëmarrës që plotësojnë kriteret e kualifikimit (ky është rekomandim i përsëritur i KLSH përcjell APP, Qeverisë dhe Kuvendit).

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**3. Gjetje:** ABP është krijuar, organizohet dhe funksionon sipas VKM nr.81 datë 14.02.2018 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara". Referuar pikës 1 të këtij vendimi, Agjencia organizohet dhe funksionon si institucion qendror, person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit të Brendshëm, si dhe referuar pikës 3, Agjencia ka buxhetin e vet, i cili është pjesë e buxhetit të Ministrisë së Brendshme (MB). Mirëpo, rezultoi se, MB ka parashikuar për ABP si institucion varësie, vetëm fonde për pagat dhe kontributet e sigurimeve

shoqërore e shëndetësore të punonjësve të Agjencisë (artikulli 600 dhe 601) dhe në asnjë nga vitet e audituara 2018, 2019, dhe as për vitet 2020, 2021 dhe 2022 (PBA), nuk janë parashikuar fonde nga buxheti i shtetit, për shpenzime operative apo për investime (referuar shkresës të Sekretarit të Përgjithshëm nr.10502 prot. datë 31.12.2019 "Për detajimin e buxhetit për vitet 2020-2022"). Në këtë aspekt, nuk është zbatuar pika 1 e VKM nr.81 datë 14.02.2018, që Agjencia të organizohet dhe të funksionoj si institucion i pavarur dhe me buxhet më vete. Ndërkohë që, ABP është krijuar rishtazi në vitin 2018, si nevojë e reformimit dhe kalimit në një nivel më të lartë organizimi institucional sesa ish-Drejtoria e Përgjithshme e Prokurimeve të Përqendruara, e cila ishte pjesë e strukturës organizative të MB. Në këtë fokus, duhet theksojmë edhe faktin se, ky institucion, përveç kryerjes së procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive, institucioneve të varësisë, ka prokuruar dhe mund të prokuroj edhe fondet buxhetore të institucioneve të pavarura.
Për sa më sipër del e domosdoshme që, ABP nuk duhet të vazhdojë të funksionojë si një drejtori pjesë e strukturës së Ministrisë se Brendshme, por duhet të funksionojë si institucion qendror buxhetor më vete (ose në varësi të Kryeministrit).
*(Trajtuar më hollësisht në faqet 6-14, të Raportit të Auditimit)*
**3.1 Rekomandimi:** ABP të marrë iniciativën ligjore për t'i kërkuar Këshillit të Ministrave që kjo Agjenci të organizohet dhe të funksionoi si institucion qendror, person juridik publik, buxhetor më vete, ose në varësi të Kryeministrit.

***Menjëherë***

**4. Gjetje:** Gjithashtu, ndryshe nga ish-Drejtoria e Përgjithshme e Prokurimeve të Përqendruara që marrëdhëniet e punës së punonjësve i rregulloheshin në përputhje me ligjin 152/2013 "Për nëpunësin civil", marrëdhëniet e punës së punonjësve të ABP, rregullohen sipas dispozitave të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar. Ndërkohë, Agjencia si organ qendror blerës, ka si mision kryerjen e procedurave të prokurimit, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve, duke menaxhuar kështu, një pjesë të konsiderueshme të fondeve buxhetore të institucioneve kryesore shtetërore, me zyrtarë marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me Kodin e punës. Zyrtarët publik pa statusin e nëpunësit civil janë më vulnerabël dhe më të dobët se nëpunësit që përfshihen në shërbimin civil, për shkak të nivelit më të ulët të ulët të sigurisë së vazhdimësisë së marrëdhënieve të punës. Pra, nisur nga detyrat dhe përgjegjësitë që i janë ngarkuar Agjencisë dhe punonjësve të saj, marrëdhëniet e punës të Drejtorit të Përgjithshëm dhe stafit të agjencisë duhet të rregullohen në bazë të ligji 152/2013 "Për nëpunësin civil", i cili ndër të tjera garanton, qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil, vazhdimësinë profesionale, rekrutimin e punonjësve bazuar në meritë dhe integritet moral dhe garanton paanësi politike.
*(Trajtuar më hollësisht në faqet 6-14, të Raportit të Auditimit).*
**4.1 Rekomandimi:** ABP, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të ndjekin të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për të bërë ndryshimin e statusit të punonjësve, nga punonjës që marrëdhëniet e punës u rregullohen me dispozitat e Kodit të Punës, në punonjës që marrëdhëniet e punës u rregullohen me Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil".
**4.2. Rekomandimi:** Të gjithë nëpunësit që, për shkak të riorganizimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Prokurimeve të Përqendruara kanë humbur statusin e nëpunësit civil, duhet të rikthehet automatikisht në shërbimin civil dhe të mbajnë statusin e nëpunësit civil .

***Menjëherë***

**B. MASA ORGANIZATIVE:**

**1. Gjetje:** Gjatë periudhës objekt auditimi u vërejt se, në disa procedura prokurimi për blerje mallra dhe shërbime ka pasur konkurrencë minimale duke marrë pjesë vetëm një operatore ekonomik. Ndërsa në disa procedura të tjera, (në vitin 2017 me fond limit në total rreth 280,000,000 lekë dhe në vitin 2019 me fond limit në total rreth 1,073,942,016 lekë) nuk kanë marrë pjesë operatorë

ekonomik apo kanë marrë pjesë operatorë të cilit nuk plotësonin specifikimet teknike të mallrave dhe shërbimeve apo kërkesat e veçanta të kualifikimit duke u skualifikuar nga procedurat e prokurimit, dhe në kushtet e mungesës së konkurrencë, në mbështetje të nenit 24 të LPP, këto procedura janë anuluar. Ndërkohë dihet që, tregu i shit-blerjes së këtyre mallrave dhe shërbimeve është treg mjaft i mirënjohur sepse për këto veprimtari operojnë shumë tregtarë të mesëm e të mëdhenj duke krijuar një treg mjaft konkurrentë dhe rrjedhimisht interesi për të marrë pjesë në tendera publik duhet të ishte tepër i lartë.
Më poshtë po përmendim disa prej procedurave të anuluara:
- Procedura e prokurimit publike me objekt: "Blerje uniforma, veshmbathje dhe elemente të tjera, përbërëse të tyre për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave Loti III", me fond limit 32,369,409 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar 08.05.2017 morën pjesë 3 operatore të cilët janë skualifikuar nga procedura për arsye se nuk plotësonin specifikimet teknike të mallrave apo disa kërkesa të veçanta të kërkuara në DT;
- Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje uniforma, veshmbathje dhe elemente të tjera, përbërëse të tyre për Gardën e Republikës, Loti II", me fond limit 10,176,543 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar 08.05.2017 mori pjesë vetëm operatori "X" , me ofertë10,150,200 lekë i cili është skualifikuar sepse nuk ka paraqitur flete analize për artikullin berete të kostumit për shërbime stërvitje;
- Procedura e prokurimit me objekt : "Blerje këpucë për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave Lotin II" me fond limit 4,747, 578 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar 10.05.2017 morën pjesë 4 operatore të cilët janë skualifikuar nga procedura për arsye se nuk plotësonin specifikimet teknike të mallrave apo disa kërkesa të veçanta të kërkuara në DT;
- Procedura e prokurimit me objekt : " Blerje këpucë", Loti I "Blerje këpucë për Gardën e Republikës Lotin I" me fond limit 2,083, 333 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar 10.05.2017 morën pjesë 2 operatore të cilët janë skualifikuar nga procedura për arsye se nuk plotësonin specifikimet teknike të mallrave apo disa kërkesa të veçanta të kërkuara në DT;
- Procedura e prokurimit me objekt : "Blerje automjete për Autoritetin e Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit, Loti I" me fond limit 3,753, 287 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar 22.11.2017 mori pjesë vetëm operatori "X" , me ofertë 1,800,000 lekë i cili është skualifikuar sepse nuk ka paraqitur asnjë dokument, përveç ofertës ekonomike, ekstraktit tregtar dhe atij historik;
- Procedura e prokurimit me objekt: "Shërbim Gatimi dhe Shpërndarje Ushqimi (Katering) p[ër Repartin Ushtarak 4001 Kukës Loti II" me fond limit 7,729,216 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar 16.10.2017 mori pjesë vetëm operatori "X", me ofertë 7,670,836 lekë i cili është skualifikuar sepse nuk plotësoni disa kërkesa të veçanta të kërkuara në DT;
- Procedura e prokurimit me objekt : "Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil), Loti I" me fond limit në vlerën 30,176,892 lekë. Ne tenderin e zhvilluar në datën 14.05.2018, mori pjesë vetëm BOE "X sh.a" me ofertë, marzhë fitimi 16.4%, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues;
- Procedura e prokurimit me objekt: "Furnizim me lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial Loti II". Ne tenderin e zhvilluar në datën 14.05.2018, morën pjesë vetëm operatori "X" me ofertë, marzhë fitimi 15%, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues;
- Procedura e prokurimit me objekt :"Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil), Loti III", me fond limit në vlerën 10,341,341 lekë. Në tenderin e zhvilluar në datën 14.05.2018, mori pjesë vetëm BOE "X" me ofertë, marzhë fitimi 17.4%, i cili është kualifikuar dhe shpallur fitues;
- Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje automjete, e ndarë në 9 lote" me fond limit të përgjithshëm në vlerën 104,764,120 lekë pa TVSH, e zhvilluar në datën 12.11.2019. Nga 9 lotet, 7 prej tyre janë anuluar për mungesë konkurrence si:
- Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje Autovetura me kalueshmëri të ulët, Loti I" për Shërbimi Informativ i Shtetit me fond limit, 6,527,940 lekë. Në tenderin e zhvilluar mori pjesë vetëm një operator i cili është skualifikuar nga procedura e prokurimit sepse, nuk plotëson specifikimet teknike të automjeteve sipas kërkesave të DT;

- Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje Autovetura me kalueshmëri të lartë, Loti II" për shërbimi Informativ i Shtetit me fond limit 13,405,915 lekë; Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes se Tregut me fond limit 5,362,366 lekë; Kontrollin e Lartë të Shtetit me fond limit 8,043,549 lekë; Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Sigurimeve Shoqërore me fond limit 5,362,366 lekë. Në tenderin e zhvilluar kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomikë të cilët janë skualifikuar sepse nuk plotësonin specifikimet teknike të automjeteve;
- Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje Mikrobus (vende te ulura 8+1), Loti III" për Ministrinë e Brendshme me fond limit: 2,980,963 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar nuk u paraqit asnjë operator;
- Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje Kamionçinë për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, Loti VI" për Drejtoria e Sherbimeve Qeveritare me fond limit: 4,476,550 lekë. Në tenderin e zhvilluar mori pjesë vetëm një operator i cili është skualifikuar sepse, nuk plotëson specifikimet teknike të automjeteve;
- Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje automjete për aparatin e Ministrisë së Brendshme, Loti VII" për Ministria e Brendshme me fond limit: 13,189,659 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar në datën, mori pjesë vetëm një operator i cili është skualifikuar nga procedura e prokurimit sepse, nuk plotëson specifikimet teknike të automjeteve;
- Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje Automjete për Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, Loti VIII" me fond limit:11,250,000 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar morën pjesën dy të cilët janë skualifikuar sepse, nuk plotëson specifikimet teknike të automjeteve ;
- Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje Autovetura për Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, Loti IX"" me fond limit:2,666,667 lekë pa TVSH. Në tenderin e zhvilluar, mori pjesën vetëm një operator i cili është skualifikuar nga procedura e prokurimit sepse, nuk plotëson specifikimet teknike të automjeteve.

Sa sipër duket qartë se, nuk ka pasur interes të mjaftueshëm nga operatorët ekonomik për të marrë pjesë në këto procedura, ndërkohë që mallrat dhe shërbimet si, blerja: uniformave, veshmbathjeve, këpucëve, karburanteve, autoveturave, shërbimit kateringut, etj, janë artikuj të bollshëm dhe veprimtari shumtë të mirënjohura në tregun vendas. Pra për furnizimin e këtyre mallrave dhe shërbimeve ka mjaftueshëm tregtar të vegjël dhe të mëdhenj që operojnë në tregun vendas, për pasoje duhet të kishte konkurrencë më të madhe në këto procedura prokurimi.

Anulimi i një pjesë të madhe të procedurave të prokurimit për blerjen e mallrave dhe shërbimeve të domosdoshme për ushtrimin normal të veprimtarive të Autoriteteve Kontraktore ka bërë që, për një pjesë të konsiderueshme të fondeve buxhetore nuk është arritur efiçenca dhe efikasiteti i procedurave të prokurimit, duke mos përmbushur kështu, qëllimin e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i sanksionuar ne pikën "a, të nenit 1 të tij, në të cilin përcaktohet se: *"Qëllimi i këtij ligji është: të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore"*

Po kështu përveç mungesës së efiçencës dhe efikasiteti të procedurave të prokurimit, djegia e fondeve me pasojë mos realizimi i fondeve për investime për shkak të veprimeve apo mosveprimeve të ABP, ndikon negativisht në arritjen e objektivave të institucioneve dhe veçanërisht në përformancën e aktiviteteve të institucioneve të pavarura kushtetuese.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 51-64 dhe 103-107, të Raportit të Auditimit)*

**1.1 Rekomandimi:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me cilësinë e organit qendror blerës, të ngrejë grup pune të veçantë për të analizuar arsyet dhe shkaqet e mungesës së konkurrencës në prokurimit e këtyre mallrave dhe shërbimeve. Në çdo procedurë prokurimi kriteret e veçanta dhe specifikimet teknike të mallrave dhe shërbimeve të hartohen të tilla që të nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë me qellim rritjen e konkurrencës.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**1.2 Rekomandimi:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me cilësinë e organit qendror blerës, për çdo rast kur prokuron fonde për investime (pajisje, makineri, automjete, etj.) duhet të bashkëpunoj ngushtë me Autoritetet Kontraktore për të filluar procedurat e prokurimeve që me fillimin e vitit

dhe përfundimin e tyre brenda muajit shtator, me qëllim që fondet e planifikuara për investime të institucioneve përfituese të mos digjen por të përdoren me eficencë, efektivitet dhe ekonomicitet.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**2. Gjetje:** Për vitin 2018 dhe 2019 disa Autoritet Kontraktore nuk kanë respektuar afatin e dërgimit të kërkesave në ABP për prokurimin e kontratave për mallra e shërbime, të përcaktuar në VKM nr.82, datë 14.02.2018 "Për ngarkimin e ABP për kryerjen e procedurave te prokurimit publik…".
*(Trajtuar më hollësisht në faqet 13-15, të Raportit të Auditimit)*
**2. 1 Rekomandim:** ABP të marrë masa, që dërgimi e kërkesave për prokurimi nga Autoritete Kontraktore, të vijnë brenda afateve të përcaktuara në VKM nr.82, datë 14.02.2018. Për Autoritetet Kontraktore që nuk respektojnë afatet dërgimit të kërkesave, ABP duhet ti propozojë Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe APP, masa administrative e disiplinore për punonjësit përgjegjës.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**3. Gjetje:** ABP në muajin janar 2019, ka krijuar një data-basë ne forme e një regjistri elektronik për regjistrimin e të gjitha kërkesat e ardhura nga Autoritetet Kontraktore. Por në këtë data-basë nuk janë regjistruar dhe evidentuar plotësisht të gjitha detajet dhe statistikat e prokurimit si, referencat e shkresave të ardhura nga AK, objektin e prokurimit, fondin limit, formën e prokurimit, etj.
*(Trajtuar më hollësisht në faqet 15-16, të Raportit të Auditimit)*
**3.1 Rekomandim:** ABP, të marrë masat, për të regjistruar të gjitha detajet e prokurimit duke filluar me referencat e shkresave të ardhura nga Autoritetet Kontraktore, objektin e prokurimit, fondin limit, formën e prokurimit dhe deri te referencat e njoftimit të shpalljes se kontratës fituese.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**C. MASA PËR ELEMINIMIN E DËMEVE EKONOMIKE:**
**1. Gjetje:** Siç u trajtua dhe më lartë (në pikën B. "masa për përmirësime ligjore"'), në zbatim të nenit 7 i VKM nr.82, datë 14.02.2018 "Për ngarkimin e ABP për kryerjen e procedurave të prokurimit publik...", i ndryshuar, APP ka nxjerrë Udhëzimin Nr. 8, datë 20.02.2018, i ndryshuar. Në pikën 5 dhe 5.1, të këtij udhëzimi parashikohen kontratat e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme që do të prokurohen nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, si dhe përcaktohet se: "Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, përveç vlerës së pritshme të kontratave do të përllogaritet edhe shumatorja e çmimeve për njësi, e cila duhet të publikohet së bashku me vlerën e pritshme të kontratave (fondi limit) në njoftimin e kontratës. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, ofertimi nga operatorët ekonomikë do të bëhet me shumatoren e çmimeve për njësi. Për efekt krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi të përllogaritur për çdo artikull apo shërbim, nga autoriteti kontraktor". Në zbatim të kësaj baze ligjore, ABP gjatë vitit 2019 ka realizuar 85 procedura prokurimi nëpërmjet marrëveshjes kuadër për blerjen e mallrave dhe shërbimeve me vlerë të përgjithshme 5,817,567,129 lekë. Nga 85 procedurat 48 procedura (të ndara në Lote) me vlerën të përgjithshme 1,126,967,454 lekë janë realizuar vetëm për blerje mallrash, në të cilat ofertat fituese janë përzgjedhur *mbi bazën e shumatores së çmimeve për njësi*, sipas përcaktimeve të pikës 5 dhe 5.1 të Udhëzimin të APP me nr. 8, datë 20.02.2018. Nga zbatimi i udhëzimit të APP (pikës 5 dhe 5.1), është shmangur nga zbatimi, nenin 55 të Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 dhe nenin 45 të VKM nr.914 datë 29.12.2014, të cilët përcaktojnë se, autoriteti kontraktor vendosë të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar *në çmimin për njësi më të ulët* dhe jo siç përcaktohet në udhëzimin e sipërcituar që fituesit janë përzgjedhur mbi bazën *e shumatores së çmimeve për njësi më të ulët*.
Për sa më sipër, nga zbatim të pikës 5 dhe 5.1 të Udhëzimit nr. 8, datë 20.02.2018: është rritur kosto e blerjes së mallrave në dëm të buxhetit të shtetit për 127,598,084 lekë; është shkelur pika "d" e nenit 24 e Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 sepse disa oferta te paraqitura kanë tejkaluar fondin limit dhe nuk janë skualifikuar; është shkelur dhe është bërë i pa zbatueshëm neni 56 i Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 dhe neni 66 i VKM nr.914 datë 29.12.2014 që, bën fjalë për llogaritjen e ofertës

anomalish e ulët duke rritur koston e blerjeve të mallrave në dëm të buxhetit të shtetit për 72,388,830 lekë; është shkelur dhe është bërë i pa zbatueshëm neni 63 i LPP dhe neni 78 i VKM sepse është denatyruar gjithë procesi i ankimit administrativ dhe i shqyrtimit të ankesave.

**Konkluzion,** nga zbatimi i pikën 7.3 të Udhëzimit nr.6 datë 16.01.2018 dhe pikës 5 dhe 5.1 të Udhëzimit nr. 8, datë 20.02.2018, përmbi dhe në shkelje të nenit 56 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 dhe nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014, i është shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik rreth **200 milion lekë,** me TVSH.

***Në vijim këto shkelje argumentohen me raste konkrete të rezultuara nga auditimi:***

**1. Gjetje:** Janë konstatuar, në 12 procedura raste kur janë shpallur fitues operatorë që kanë paraqitur ofertat me të larta se operatorët e tjerë të kualifikuar. Ky fenomen ka ndodhur sepse vlerësimi i ofertave dhe shpallje e ofertës fituese është bazuar në shumatoren e çmimeve për njësi.

Për ta bërë më të qartë dhe më të kuptueshëm po analizojmë njërën prej këtyre procedurave:

-Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje Uniforma për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve", nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, me afat 1 vit, me shumatore limit e çmimeve për njësi 84,708 lekë, me fondi limit në total 88,776,700 lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomik. KVO në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës teknike i ka kualifikuar të tre këta operatorë. Në vijim të procedurës ka bërë vlerësimin e ofertave ekonomike bazuar në shumatoren e çmimeve për njësi të paraqitur nga te tre operatorët dhe ka bërë këtë klasifikim: në vend te parë është renditur BOE "X" me shumatoren e çmimeve për njësi më të ulët, në vlerën 51,600 lekë; në vend të dytë, operatori "X" me shumatoren e çmimeve për njësi me vlerë 54,750 lekë; në vend te tretë BOE "X" me shumatoren e çmimeve për njësi me vlerë 59,600 lekë. Kuptohet që, fitues në këtë procedurë është shpallur BOE "X" me shumatoren e çmimeve për njësi më të ulët se, dy operatorët e tjerë.

Mirëpo, nga llogaritjet që i bëmë ofertave të tre operatorëve në zbatim dhe sipas përcaktimeve të nenit 55 të LPP dhe nenit 45 të VKM nr.914, datë 29.12.2014, duke shumëzuar sasitë e çdo artikulli me çmimet për njësi dhe vlerat e tyre i mblodhëm për të gjithë artikujt rezultoi tjetër klasifikim si më poshtë:

Në vend te parë renditet BOE "X" me ofertë ekonomike më të ulët se dy të tjerët, në vlerë totale 71,411,050 lekë, ndërkohë ky operatorë ishte renditur i treti; në vend te dytë renditet përsëri operatori "X" me ofertë ekonomike në vlerë totale 87,979,850 lekë; në vend te tretë renditet BOE "X" me ofertë ekonomike në vlerë totale 88,769,960 lekë, ndërkohë që ky operatorë ishte renditur i pari dhe është shpallur edhe fitues i prokurimit. Pra, në zbatim të nenit 55 të LPP dhe nenit 45 të VKM nr.914 datë 29.12.2014, nuk duhej të shpallej fitues BOE "X", por duhej të shpallej fitues operatori BOE "X" që ka paraqitur ofertë ekonomike më të ulët me diference në vlerën 17,358,910 lekë (88,769,960 -71,411,050), pavarësisht se, shumatoren e çmimit për njësi e ka më të lartë se, të dy operatorët e tjerë të kualifikuar.

Sa sipër duket qartë që, si pasojë e vlerësimit të ofertave sipas përcaktimeve në udhëzimet e APP *"bazuar në shumatoren e çmimit për njësi"* dhe jo për çmimin më të ulët, kemi denatyrim të gjithë procesit të vlerësimit, duke shpallur fitues operatorë ekonomik që kanë paraqitur ofertat me vlera me të larta se operatorët e tjerë të kualifikuar. Ky fenomen është konstatuar në 12 procedura prokurimi të listuara më poshtë, ***duke i shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 106,331,736, pa TVSH dhe 127,598,000 lekë me TVSH:***

**1.** Blerje Uniforma për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve me shumatoren për njësi 84,708 lekë me fond limit ne total 88,776,700 lekë. Dëmi i konstatuar **17,358,910 lekë**;

**2.** Loti I. "Blerje dokumentacioni për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë", me shumatoren për njësi 2,500.83 lekë, me fond limit ne total 4,898,599 lekë. Dëmi i konstatuar **608,495.70 lekë**, pa TVSH;

**3.** Loti II. "Blerje dokumentacioni, për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve", me shumatoren për njësi11,595.40 lekë, me fond limit ne total 3,049,809 lekë. Dëmi i konstatuar **1,440,701 lekë**, pa TVSH;

**4.** Loti III "Botime, printime dhe materiale shtypshkrimesh për Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", me shumatoren për njësi 7,918.80 lekë me fond limit ne total 12,698,122 lekë. Dëmi i konstatuar **4,914,552** lekë, pa TVSH;
**5.** Lotit IV "Blerje shtypshkrimesh" për Spitalin Universitarë Obstetrik-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldina", me shumatoren për njësi 734.50 lekë, me fond limit ne total 1,637,000 lekë. Dëmi i konstatuar **1,124,971 lekë**, pa TVSH;
**6.** Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi per Spitalin Universitar të Traumës, me shumatoren për njësi 6,705.07 lekë, me fond limit ne total 4,163,734 lekë. Dëmi i konstatuar **1,418,220 lekë**, pa TVSH;
**7.** Loti I - Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues, me shumatoren për njësi 28,067.99 lekë me fond limit ne total 103,263,609 lekë. Dëmi i konstatuar **64,012,930 lekë**, pa TVSH;
**8.** Loti II - Blerje materiale të ndryshme për pastrim, me shumatoren për njësi 35,974.7 lekë, me fond limit ne total 2,646,651 lekë. Dëmi i konstatuar **3,237,257 lekë**, pa TVSH;
**9.** Blerje pjesë këmbimi për automjete për shërbime profilaktike - Loti II "Blerje bateri për automjete", me shumatoren për njësi 418,198.31 lekë me fond limit ne total 10,405,536 lekë. Dëmi i konstatuar **3,143,000 lekë**, pa TVSH.
**10.** Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash, me shumatoren për njësi 4,008,257 lekë me fond limit ne total 81,041,227 lekë. Dëmi i konstatuar **8,914,900 lekë**, pa TVSH;
**11.** Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, me shumatoren për njësi 44.061,5 lekë me fond limit ne total 940.082,5 lekë. Dëmi i konstatuar **102,500 lekë**, pa TVSH;
**12.** Blerje orendi dhe pajisje për mobilim zyrash për Agjencinë e Prokurimit Publik, me shumatoren për njësi 260,815 lekë, me fond limit ne total 802,617 lekë. Dëmi i konstatuar **55,300 lekë**, pa TVSH.
**2. Gjetje:** Gjithashtu, si pasojë e vlerësimit të ofertave sipas përcaktimeve në udhëzimet e APP *"bazuar në shumatoren e çmimit për njësi"* dhe jo për çmimin më të ulët, janë konstatuar edhe dy raste, ku ofertat e fituesit apo oferta të kualifikuara janë në vlerë më të lartë se fondi limit dhe në zbatim të pikës "d" të nenit 24 e LPP këto oferta duhet të skualifikoheshin. Konkretisht po analizojmë këto procedura:
**a.** Procedura e prokurimit "Blerje dokumentacioni për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë Loti I", nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, me afat 1 vit, me shumatore limit e çmimeve për njësi 2,500.83 lekë, me fondi limit në total 4,853,449 lekë. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë dhe janë kualifikuar 7 operatorë ekonomik. Fitues është shpallur operatori "X" me shumatoren e çmimeve njësi në vlerën 1,877.9 lekë, pra me të ulët se 6 operatorët e tjerë.
Nga llogaritjet që i bëmë ofertave të 7 operatorëve në zbatim dhe sipas përcaktimeve të nenit 55 të LPP dhe nenit 45 të VKM nr.914, datë 29.12.2014, duke shumëzuar sasitë e çdo artikulli me çmimet për njësi dhe vlerat e tyre i mblodhëm për të gjithë artikujt rezultoi se, **tre nga këto oferta ishin në vlerë më të larta se fondi limit,** si më poshtë:
-Oferta e operatorit fitues "X" është në vlerën 4,898,599 lekë, ose më të lartë në vlerën 45,150 lekë se, fondi limit që është 4,853,449 lekë, pra ky ofertues duhej te skualifikohej dhe jo te shpallej fitues;
-Oferta e operatorit të kualifikuar "X" është në vlerën 9,367,780.1 lekë, ose më të lartë në vlerën 4,514,331 lekë se, fondi limit që është 4,853,449 lekë , pra ky ofertues nuk duhej te kualifikohej;
-Oferta e operatorit të kualifikuar "X" është në vlerën 10,181,249 lekë, ose më të lartë në vlerën 5,327,800 lekë se, fondi limit që është 4,853,449 lekë , pra ky ofertues nuk duhej te kualifikohej.
**b.** Procedura e prokurimit "Loti I - Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues, Loti I", nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, me afat 2 vit, me tre operator fitues, me shumatore limit e çmimeve për njësi 28,067.99 lekë, me fondi limit në total 103,263,609 lekë. Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë dhe janë kualifikuar 4 operatorë ekonomik. Janë shpallur fitues 3 operator: "X " me shumatoren e çmimeve njësi në vlerën 15,309 lekë; "X" me shumatoren e çmimeve njësi në vlerën 16,955 lekë;" X" me shumatoren e çmimeve njësi në vlerën 17,169 lekë. Është kualifikuar BOE - X me shumatoren e çmimeve njësi në vlerën 17,495 lekë.

Nga llogaritjet që i bëmë ofertave të 4 operatorëve në zbatim të nenit 55 të LPP dhe nenit 45 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 rezultoi se, **një nga katër ofertat ishte në vlerë më të lartë se fondi limit,** si më poshtë:
-Oferta e operatorit fitues "X " është në vlerën 136,397,826 lekë, ose më të lartë në vlerën ***33,134,217 lekë*** se, fondi limit që është 103,263,609 lekë, pra ky ofertues duhej te skualifikohej dhe jo të shpallej fitues.
**3. Gjetje:** U konstatua se, në 13 procedura janë skualifikuar operatorë sepse, sipas nenit 56 të LPP-së nuk kanë paraqitur dokumentacion provues për elementet e veçanta të ofertës ekonomike të dalë anomalish e ulët. Nga llogaritje *mbi bazën shumatores së çmimeve për njësi*, ofertat të këtyre operatorëve kanë dalë anomalish të ulët, por në fakt po të shumëzojmë sasitë e çdo artikulli me çmimet njësi dhe të bëjmë mbledhjen e tyre, ofertat totale të këtyre operatorëve nuk dalin anomalish të ulta, por janë oferta me të ulta se oferta e fituesit, pra duheshin shpallur fitues. Për ta bërë më të qartë dhe më të kuptueshëm po analizojmë njërën prej këtyre procedurave:
- Procedura e prokurimit me objekt "Blerje Materiale Kancelarie të tjera zyre, Loti II", me shumatore të çmimeve për njësi në vlerën 300.555 lekë dhe me fond limit total me vlerë 30,136,825 lekë. Kjo procedura është zhvilluar me marrëveshje kuadër me 3 operatorë fitues. Janë shpallur fitues 3 operatorët e mëposhtëm: "X", me shumatoren e çmimit për njësi në vlerën 210,968.77 lekë dhe me vlerë totale te ofertës 28,786,029.9 lekë; "X", me shumatoren e çmimit për njësi në vlerën 263,305.61 lekë dhe me vlerë totale të ofertës 29,208,152.4 lekë; "X" me shumatoren e çmimit për njësi 268,571.71 lekë dhe me vlerë totale te ofertës 29,792,354.4 lek**ë.**
Në këtë procedurë është skualifikuar operatori "X" i cili ka paraqitur shumatoren e çmimit për njësi në vlerën 135,406.1 lekë dhe nga llogaritjet vlera totale e ofertës i del në vlerën 23,739,677.1 lekë. Ky operator është skualifikuar sepse nuk ka paraqitur dokumentacion për të argumentuar elementet e veçanta të ofertës ekonomike anomalish të ulët sipas nenit 56 të LPP-së. Konkretisht, oferta e këtij operatori ka dalë anomalish e ulët si më poshtë:
Në procedurë kanë marrë pjesë më shumë se tre oferta dhe oferta vlerësohet anomalish e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Kështu, mesatarja e shumatores së çmimeve për njësi është 219,563 lekë *85% =186,628.5 lekë, pra oferta që të jetë anomalish e ulët duhet të jetë nën vlerën e **186,628.5 lekëve**.
Oferta "X" = 210,968.77 >186,628.5, nuk është anomalish e ulët; oferta "X" = 263,305.61 >186,628.5, nuk është anomalish e ulët; oferta "X" = 268,571.71 >186,628.5, nuk është anomalish e ulët; oferta "X" = 135,406.1< 186,628.5, **është anomalish e ulët**.
Me shkresë nr.744, datë 24.04.2019 është njoftuar ofertuesit "X", të paraqesin me shkrim brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës së tij, pasi oferta e tij ka dalë anomalish e ulët. Dhe duke qenë se, ofertuesi nuk u përgjigj kërkesës për argumentimin e ofertës anomalish të ulët, në bazë të nenit 56 të LPP, ky operator është skualifikuar nga procedura. Mirëpo, po të llogarisim ofertën në zbatim të nenit 56 të LPP dhe nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 mbi bazën e vlerës totale të ofertës (çmimit më të ulët) dhe jo të ***shumatorës së çmimit për njësi*** siç përcaktojnë udhëzimet e APP, atëherë oferta e këtij operatori nuk del anomalish e ulet. Konkretisht:
Mesatarja e vlerës së 4 ofertave të vlefshme është 27,881,553.45 lekë *85% **= 23,699,320.43 lekë,** pra oferta që të jetë anomalish e ulët duhet të jetë nën vlerën e **23,699,320.43 lekë.**
Oferta "X"= 28,786,029.9 >23,699,320.43 lekë, nuk është anomalish e ulët; oferta "X" = 29,208,152.4 >23,699,320.43 lekë, nuk është anomalish e ulët; oferta "X" =29,792,354>23,699,320.43 lekë, nuk është anomalish e ulët; oferta "X = 23,739,677 >23,699,320.43 lekë, nuk është anomalish e ulët.
**Si konkluzion,** oferta e operatorit "X" nuk del anomalish e ulët dhe në zbatim të në zbatim të nenit 55 të LPP oferta e tij duhej të kualifikohej dhe duhej të shpallej fitues. Pra duket qarte se, në këtë rast i është shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit në vlerën 6,052,677 lekë pa TVSH dhe 7,263,212 lekë me TVSH, e cila llogaritet si diferencë e vlerës së ofertës së operatorit "X"' (29,792,354.4 lek**ë)** me vlerën e ofertës së operatorit "X" (23,739,677 lekë). Kështu me radhë janë llogaritur të gjitha verat e dëmit ekonomik në të 13 procedurat e listuar më poshtë, ***duke i shkaktuar***

***buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 60,324,025 lekë, pa TVSH dhe 72,388,830 lekë me TVSH*:**
**1.** Loti II - Blerje Materiale Kancelarie të tjera zyre, me shumatore e çmimeve për njësi 300.555 lekë , me fond limit 30,136,825 lekë. Dëmi i konstatuar **6,052,676.90 lekë**, pa TVSH;
**2.** Loti III - Blerje letër, me shumatore e çmimeve për njësi 15,735.94 lekë, me fond limit 62,180,006 lekë. Dëmi i konstatuar **4,391,217 lekë**, pa TVSH;
**3.** Blerje materiale kancelarie me bazë letre , me shumatore e çmimeve për njësi 33,940 lekë, me fond limit 26,356,371 lekë. Dëmi i konstatuar **1,773,885.60 lekë** pa TVSH;
**4.** Loti I - Blerje Materiale Kancelarie me bazë letre, me shumatore e çmimeve për njësi 14,722.6 lekë, me fond limit 2,592,766 lekë. Dëmi i konstatuar **249,458 lekë**, pa TVSH;
**5.** Loti II - Blerje Materiale Kancelarie të tjera zyre, me shumatore e cmimeve për njësi 31,154.8 lekë, me fond limit 1,427,265 lekë. Dëmi i konstatuar **361,494.30 lekë**, pa TVSH;
**6.** Loti III - Blerje letër, me shumatore e çmimeve për njësi 8,410.7 lekë, me fond limit 4,133,083 lekë. Dëmi i konstatuar **882,476.80 lekë**, pa TVSH;
**7.** Blerje materiale kancelarie me bazë letre për Gardën e Republikës me shumatore e çmimeve për njësi 7.650 lekë, me fond limit 1,333,200 lekë. Dëmi i konstatuar **162,585 lekë**, pa TVSH;
**8.** Loti I - "Blerje tonera për Kryeministrinë dhe institucionet e varësisë" me shumatore e çmimeve për njësi 891,527 lekë me fond limit 26,533,437 lekë. Dëmi i konstatuar **4,889,107 lekë**, pa TVSH;
**9.** Loti II. "Blerje tonera për Ministrinë e Brendshme dhe institucionet e varësisë" me shumatore e çmimeve për njësi 1,433,917 lekë, me fond limit 52,943,371 lekë. Dëmi i konstatuar **9,429,515 lekë**;
**10.** Loti III. "Blerje tonera për Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet e varësisë" me shumatore e cmimeve për njësi 1,541,429 lekë, me fond limit 31,905,179 lekë. Dëmi i konstatuar **10,158,230 lekë**, pa TVSH;
**11.** Loti V. "Blerje tonera për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e varësisë" me shumatore e çmimeve për njësi 1,694,849 lekë, me fond limit 24,534,242 lekë. Dëmi i konstatuar **4,391,457 lekë**, pa TVSH;
**12.** Loti V. "Blerje tonera për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e varësisë" me shumatore e çmimeve për njësi 1,694,849 lekë, me fond limit 61,981,655 lekë. Dëmi i konstatuar **13,387,425 lekë**, pa TVSH;
**13.** Loti VII. "Blerje tonera për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e varësisë" me shumatore e çmimeve për njësi 1,022,704 lekë, me fond limit 21,231,216 lekë. Dëmi i konstatuar **4,194,498 lekë**, pa TVSH.
**4. Gjetje:** U konstatuan raste të procedurave të prokurimit ku janë skualifikuar operatorë të ndryshëm, të cilat kanë paraqitur ankesë në ABP për oferta me të ulta se fituesi të llogaritura dhe bazuara në shumatoren e çmimit për njësi. Por në fakt, në se ofertat llogariten duke shumëzuar sasitë e çdo artikulli me çmimet për njësi të ofertuara, mbledhja e vlerës së të gjithë artikujve, pra vlerat e ofertës së ankimuesve rezultojnë në total më të larta se fituesi. Pra nga vlerësimi që i është bërë ofertave në bazë të shumatores së çmimit për njësi, sipas kërkesave të udhëzimeve të APP, është shkelur dhe është bërë i pa zbatueshëm neni 63 i LPP dhe neni 78 i VKM, pasi është denatyruar gjithë procesi i ankimit administrativ dhe i shqyrtimit të ankesave. Zbatimi me përpikmëri i nenit 55 të LPP dhe nenit 45 të VKM nr.914, datë 29.12.2014, do të shmangte pretendimet e operatorëve se, kishin paraqitur ofertën më të ulët se operatori tjetër, dhe për pasojë dhe procedurën e ankimit të tyre.
*(Trajtuar më hollësisht në faqet 65-78, të Raportit të Auditimit)*
**2. Rekomandimi:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, deri në shfuqizimin nga APP të pikës 7.3 të UAPP, nr.6 datë 16.01.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kudër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar dhe të pikës 5 dhe 5.1 të UAPP nr. 8, datë 20.02.2018 "Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, ...", në të gjitha procedurat e prokurimeve që do të zhvillojë në vijim, për kontratat e mallrave dhe të shërbimeve nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, ofertat fituese të përzgjidhen sipas kërkesave të nenit

55 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006, të ndryshuar dhe nenit 45 të VKM nr.914, datë 29.12.2014, të ndryshuar dhe jo në bazë të shumatores së çmimeve për njësi, të konsideruar në kundërshtim me kuadrin ligjor përkatës.

***Në vijimësi***

**2. Rekomandimi:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, të njoftojë Agjencinë e Prokurimit Publik, që të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet, arsyet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit në vlerën **200 milion lekë,** si pasojë e zbatimit të pikës 7.3 të Udhëzimit të APP nr.6 datë 16.01.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kudër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", i ndryshuar dhe të pikës 5 dhe 5.1 të Udhëzimit të APP nr. 8, datë 20.02.2018 "Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, ..."

***Menjëherë***

## D. MASA PËR MENAXHIMIN ME EFEKTIVITET DHE EKONOMICITET TË FONDEVE BUXHETORE:

Në disa procedura prokurimi u konstatuan skualifikime të operatorë që kanë pasur ofertat ekonomike në vlerë me të ulët se vlera e ofertave të operatorëve të shpallur fitues. Skualifikimi i këtyre operatorëve është bërë për mos përmbushjen e disa kritereve të veçanta të cilat mund të konsideroheshin si devijime te vogla sepse nuk janë thelbësorë dhe nuk ndikonin në realizimin me sukses të kontratave të mallrave dhe shërbimeve. Ky problem ka ndodhur për shkak të mungesës së një pakete për të unifikuar kriteret e veçanta të kualifikimit për çdo grup mallrash dhe shërbimesh (p.sh, për tonerët, shërbimi i katereingut,etj.), për pasojë janë përdorur **207,191,000 lekë** fonde buxhetore pa efektivitet dhe ekonomicitet. Konkretisht, këto probleme janë konstatuar në këto procedura:
**1. Gjetje:** Procedura e prokurimit me objekt "Rrjeti i Komunikimit Online I Shërbimit Të Gjendjes Civile" e realizuar në datën 16.08.2017, me fond limit 170,762,856.4 lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 5 operatore ekonomik, është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori ekonomike "X" me ofertën ekonomike në vlerën 149 946 210 lekë. Janë skualifikuar 4 operatorët të cilët kanë ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues. Konkretisht operatori "X" me ofertë ekonomike në vlerën 119 982 780 lekë ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 35,956,116 lekë me TVSH; BOE "X" me ofertë ekonomike në vlerën 115,000,000 lekë ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 41,935,452 lekë me TVSH; BOE "X" me ofertë ekonomike në vlerën 105,876,780 lekë ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 52,883,316 lekë me TVSH, me TVSH; BOE "X" me ofertë ekonomike në vlerën 122,777,777 lekë ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 32,602,119 lekë, me TVSH. Këta operatorë janë skualifikuar sepse nuk plotësojnë një sërë kërkesash të kërkuara në dokumentet e tenderit. Por për një menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të këtyre fondeve buxhetore që shkojnë deri **në vlerë 52,883,316 lekë**, ABP mund të tregohej më tolerante duke i konsideruar këto mangësi si devijime të vogla sepse ato nuk ndikojnë në realizimin me sukses të kësaj kontrate.
(Trajtuar më hollësisht në faqet 46-51, të Raportit të Auditimit)
**1. Rekomandimi:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me cilësinë e organit qendror blerës të marri iniciativën ligjore dhe në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik dhe me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për :

**1.1. Rekomandimi:** Unifikimin dhe hartimin e një pakete kriteresh minimale të kualifikimit për procedura të prokurimeve të të njëjta ose të ngjashme me kontratat për shërbimet e rrjeteve të komunikimit online dhe të shërbimeve të tjera që lidhen me teknologjinë e informacionit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**1.2. Rekomandimi:** Hartimin e një komentari apo udhëzuesi, për të shpjeguar rastet kur mosplotësimi i dokumentacionit apo i mangësive të ndryshme në përmbushjen e kritereve të

veçanta për kontratat e shërbimeve të rrjeteve të komunikimit online dhe të shërbimeve të tjera të teknologjisë së informacionit, do të konsiderohen devijime të vogla.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**2.1. Gjetje:** Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje Pjesësh Ndërrimi Për Automjete, Për Shërbimet Profilaktike", Loti I "Blerje Goma për Automjete" e realizuar në datën 12.06.2017, me fond limit 43,826,200 lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 3 operatore ekonomik dhe është kualifikuar dhe është shpallur fitues BOE "X" me ofertën ekonomike në vlerën 43 335 900 lekë. Janë skualifikuar 2 operatorë, të cilët kanë ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues. Konkretisht operatori BOE "X" me ofertë ekonomike në vlerën 24,953,100 lekë, ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 18,382,800 lekë dhe operatori "X" PF me ofertë ekonomike në vlerën 25,088,700 lekë, ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 22,059,360 lekë, me TVSH. Operatori "X" është skualifikuar sepse është tërhequr nga oferta e tij, ndërsa BOE "X" nuk përmbush disa kërkesave të veçanta vendosura ne DT. Por për një menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të këtyre fondeve buxhetore në vlerë **18,382,800 lekë**, ABP mund të tregohej më tolerante duke i konsideruar mangësitë e operatorit "X" si devijime të vogla sepse ato nuk ndikojnë në realizimin me sukses të kontratës.
*(Trajtuar më hollësisht në faqet 31-34, të Raportit të Auditimit)*

**2.2. Gjetje:** Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje Vajra lubrifikant, alkol frenash dhe pastrues motorri, Loti III" e realizuar në datën 12.06.2017, me fond limit 39,589,579 lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 3 operatore ekonomik janë kualifikuar 2 operator nga të cilët është shpallur fitues operatori ekonomike "X" me ofertën ekonomike në vlerën 33,551,430 lekë dhe është skualifikuar operatori "X" me ofertë ekonomike në vlerën 26,643,334 lekë, ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 6,908,096 lekë. Ky operatorë është skualifikuar sepse, nuk përmbush disa kërkesave të veçanta vendosura ne DT. Por për një menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të këtyre fondeve buxhetore në vlerë **6,908,096 lekë**, ABP mund të tregohej më tolerante duke i konsideruar këto mangësi si devijime të vogla sepse ato nuk ndikojnë në realizimin me sukses të kontratës.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 31-34, të Raportit të Auditimit)*

**2. Rekomandimi:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me cilësinë e organit qendror blerës të marri iniciativën ligjore dhe në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik duke angazhuar edhe ekspert dhe specialistë të fushës përkatëse për :
**2.1. Rekomandimi:** Unifikimin dhe hartimin e një pakete kriteresh minimale të kualifikimit për procedura të prokurimeve të të njëjta ose të ngjashme për blerjen e pjesëve të ndërrimit, gomave, baterive dhe shërbimeve profilaktike për automjetet.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**2.2. Rekomandimi:** Hartimin e një komentari apo udhëzuesi, për të shpjeguar rastet kur mosplotësimi i dokumentacionit apo i mangësive të ndryshme në përmbushjen e kritereve të veçanta për blerjen e pjesëve të ndërrimit, gomave, baterive dhe shërbimeve profilaktike për automjetet do të konsiderohen devijime të vogla.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje:.** Procedura e prokurimit me objekt **"Blerje Tonera "** e realizuar në datën 10.05.2017, me fond limit **91,985,132** lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 operatore ekonomik, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "X" me ofertën ekonomike në vlerën 91,713,191 lekë. Është skualifikuar operatori "X" i cili ka ofertën ekonomike në vlerën 75,888,800 lekë, ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 18,989,269 lekë, me TVSH. Ky operatorë është skualifikuar sepse nuk plotësojnë disa kërkesa të veçanta të vendosura në DT. Por për një menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të këtyre fondeve buxhetore **në vlerë 18,989,269 lekë**, ABP

mund të tregohej më tolerante duke i konsideruar këto mangësi si devijime të vogla sepse ato nuk ndikojnë në realizimin me sukses të kontratës.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 41-43, të Raportit të Auditimit)*

**3. Rekomandimi:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me cilësinë e organit qendror blerës të marri iniciativën ligjore dhe në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik duke angazhuar edhe ekspert dhe specialistë të fushës përkatëse për :

**3.1. Rekomandimi:** Unifikimin dhe hartimin e një pakete kriteresh minimale të kualifikimit për procedura të prokurimeve të të njëjta ose të ngjashme me kontratat për blerjen e materialeve kancelarie dhe të tjera për zyra.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**3.2. Rekomandimi:** Hartimin e një komentari apo udhëzuesi, për të shpjeguar rastet kur mosplotësimi i dokumentacionit apo i mangësive të ndryshme në përmbushjen e kritereve të veçanta për kontratat e blerjeve të materialeve kancelarie dhe të tjera për zyra, do të konsiderohen devijime të vogla.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**4.1. Gjetje:** Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje uniformash, veshmbathjesh dhe elementesh të tjera, përbërëse të tyre për Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore, Loti II" e realizuar në datën 11.01.2018, me fond limit 43,433,248 lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 6 operatore ekonomik janë kualifikuar 2 operator, është shpallur fitues operatori ekonomike "X" me ofertën ekonomike në vlerën 37 751 800 lekë. Janë skualifikuar 4 operatorë, nga të cilët 2 operatorë kane ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues. Konkretisht, operatori "X" me ofertë ekonomike në vlerën 35,774,840 lekë ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 2,372,352 lekë, me TVSH dhe operatori "X" me ofertë ekonomike në vlerën 28,497,720 lekë ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 11,104,896 lekë, me TVSH. Këta 2 operatorë janë skualifikuar, sepse nuk përmbushin disa kërkesa të veçanta të vendosura në DT. Por për një menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të këtyre fondeve buxhetore në vlerë **11,104,896 lekë**, ABP mund të tregohej më tolerante duke i konsideruar këto mangësi si devijime të vogla sepse ato nuk ndikojnë në realizimin me sukses të kontratës.

**4.2. Gjetje:** Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje Këpucë për Qendrën Kombëtare të Urgjencës Mjekësore" e realizuar në datën 11.12.2017, me fond limit 3,863,741 lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 3 operatore ekonomik dhe është kualifikuar dhe është shpallur fitues operatori ekonomike "X" me ofertën ekonomike në vlerën 3 681 960 lekë, pa TVSH. Janë skualifikuar 2 operatorë, nga të cilët edhe operatori "X" me ofertë ekonomike në vlerën 2,503,440 lekë, ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 1,414,224 lekë, me TVSH. Ky operatorë është skualifikuar sepse nuk përmbushin disa nga kriterit të veçanta të kërkuara në Dokumentet e Tenderit . Por për një menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të këtyre fondeve buxhetore në vlerë **1,414,224 lekë**, ABP mund të tregohej më tolerante duke i konsideruar këto mangësi si devijime të vogla sepse ato nuk ndikojnë dhe nuk pengojnë realizimin me sukses të kontratës.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet, 28-31, 35-36 dhe 51-57 të Raportit të Auditimit)*

**4. Rekomandimi:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me cilësinë e organit qendror blerës të marri iniciativën ligjore dhe në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik duke angazhuar edhe ekspert dhe specialistë të fushës përkatëse për :

**4.1. Rekomandimi:** Unifikimin dhe hartimin e një pakete kriteresh minimale të kualifikimit për procedura të prokurimeve të të njëjta ose të ngjashme për blerjen e uniformave, veshmbathjeve dhe elementeve të tjera, përbërëse të tyre dhe për blerjen e Këpucëve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**4.2. Rekomandimi:** Hartimin e një komentari apo udhëzuesi, për të shpjeguar rastet kur mosplotësimi i dokumentacionit apo i mangësive të ndryshme në përmbushjen e kritereve të veçanta për blerjen e uniformave, veshmbathjeve dhe elementeve të tjera, përbërëse të tyre dhe për blerjen e Këpucëve, do të konsiderohen devijime të vogla.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**5.1. Gjetje:** Procedura e prokurimit me objekt "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Rajonal Lezhë, Loti I" e realizuar në datën 21.01.2019, me fond limit **60,708,488** lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 7 operatore ekonomik dhe janë kualifikuar 2 operator dhe është shpallur fitues operatori ekonomike "X me ofertën ekonomike në vlerën 56,767,571 lekë. Janë skualifikuar 5 operatorë ekonomik nga të cilët 3 operatorë kishin ofertë më të ulët se operatori fitues, konkretisht: operatori ekonomik "X" SHPK me ofertë 43,960,396 lekë ose me diferencë në vlerën 15,368,610 lekë, me TVSH; operatori ekonomik "X" me ofertë 47,489,082 lekë ose me diferencë në vlerën 11,134,186 lekë; operatori ekonomik BOE "X" me ofertë 50,983,225 lekë ose me diferencë në vlerën 6,941,215 lekë. Këta operatorë janë skualifikuar sepse, nuk plotësojnë disa kërkesa të veçanta të vendosura në DT. Por për një menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të këtyre fondeve buxhetore që shkojnë deri **në vlerë 15,368,610 lekë**, ABP mund të tregohej më tolerante duke i konsideruar këto mangësi si devijime të vogla sepse ato nuk ndikojnë në realizimin me sukses të kontratës.

**5.2. Gjetje:** Procedura e prokurimit me objekt "Shërbim Gatimi dhe Shpërndarje Ushqimi për Spitalin Rajonal Berat, Loti II" e realizuar në datën 25.02.2019, me fond limit **64,470,878** lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 4 operator ekonomik është shpallur fitues operatori ekonomik "X" me ofertë ekonomike në vlerën 63,809,928.37 lekë. Janë skualifikuar 3 operatorë të cilët kishin ofertë më të ulët se operatori fitues, konkretisht: operatori "X" me ofertë 62,037,592 lekë ose me diferencë në vlerën 2,126,803 lekë me TVSH; operatori "X" SHPK me ofertë 56,921,700 lekë ose me diferencë në vlerën 8,265,873 lekë; operatori ekonomik "X" me ofertë 54,714,825.55 lekë ose me diferencë në vlerën 10,914,122 lekë. Këta operatorë janë skualifikuar sepse, nuk plotësojnë disa kërkesa të veçanta të vendosura në DT. Por për një menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të këtyre fondeve buxhetore që shkojnë deri **në vlerë 10,914,122 lekë**, ABP mund të tregohej më tolerante duke i konsideruar këto mangësi si devijime të vogla, sepse ato nuk ndikojnë në realizimin me sukses të kontratës.

**5.3. Gjetje:** Procedura e prokurimit me objekt "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Universitar Obstetrikë-Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë, Loti I", e realizuar në datën 25.02.2019, me fond limit 38,090,037.9 lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 4 operator ekonomik, është shpallur fitues operatori "X" me ofertë ekonomike në vlerën 37,715,906.8 lekë. Janë skualifikuar 3 operatorë të cilët kishin ofertat më të ulët se operatori fitues, konkretisht: operatori "X" me ofertë 36,433,990 lekë ose me diferencë në vlerën 1,338,299 lekë me TVSH ; operatori "X" me ofertë 31,699,133 lekë ose me diferencë në vlerën 7,220,127 lekë; operatori "X" me ofertë 32,347,706 lekë ose me diferencë në vlerën 6,441,840 lekë. Këta operatorë janë skualifikuar sepse, nuk plotësonin disa kërkesa të veçanta të vendosura në DT. Por për një menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të këtyre fondeve buxhetore që shkojnë deri **në vlerë 7,220,127 lekë**, ABP mund të tregohej më tolerante duke i konsideruar këto mangësi si devijime të vogla sepse ato nuk ndikojnë në realizimin me sukses të kontratës.

**5.4. Gjetje:** Procedura e prokurimit me objekt " Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Repartin e Ndërhyrjes së Shpejtë Shkodër Loti II" e realizuar në datën 21.01.2019, me fond limit **29,612,366** lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 6 operatore ekonomik është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori ekonomike "X" me ofertë vlerën 27,738 183,6 lekë. Janë skualifikuar 5 operatorë ekonomik nga të cilët 3 operatorë kishin ofertë më të ulët se operatori fitues, konkretisht:

operatori "X" me ofertë 27,072,215 lekë ose me diferencë në vlerë 799,161 lekë, me TVSH; operatori ekonomik "X" me ofertë 23 197 530 lekë ose me diferencë në vlerën 5,448,783 lekë; operatori ekonomik BOE "X" me ofertë 24,339,447 lekë ose me diferencë në vlerën 4,078,483 lekë. Këta operatorë janë skualifikuan sepse, nuk plotësojnë disa kërkesa të veçanta të vendosura në DT. Por për një menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të këtyre fondeve buxhetore që shkojnë deri **në vlerë 5,448,783 lekë**, ABP mund të tregohej më tolerante duke i konsideruar këto mangësi si devijime të vogla sepse ato nuk ndikojnë në realizimin me sukses të kontratës.

**5.5. Gjetje:** Procedura e prokurimit me objekt "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Drejtorinë Vendore të Policisë, Loti III" e realizuar në datën 25.02.2019, me fond limit **18,043,256** lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 4 operator ekonomik, nga të cilët është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori "X" me ofertë ekonomike në vlerën 17,690,436.75 lekë. Janë skualifikuar 3 operatorë ekonomik nga të cilët kishin ofertë më të ulët se operatori fitues, konkretisht: operatori "X" me ofertë 13,449,392 lekë ose me diferencë në vlerën 5,089,252 lekë me TVSH; operatori "X" me ofertë 14,735,963 lekë, ose me diferencë në vlerën 3,545,367 lekë; operatori ekonomik "X" SHPK me ofertë 16,587,060 lekë ose me diferencë në vlerën 1,324,051 lekë. Këta operatorë janë s'kualifikuar sepse, nuk plotësojnë disa kërkesa të vecanta të vendosura në DT. Por për një menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të këtyre fondeve buxhetore që shkojnë deri **në vlerë 5,089,252 lekë**, ABP mund të tregohej më tolerante duke i konsideruar këto mangësi si devijime të vogla sepse ato nuk ndikojnë në realizimin me sukses të kontratës.

**5.6. Gjetje:** Procedura e prokurimit me objekt "Shërbim Gatimi dhe Shpërndarje Ushqimi për "Repartin e Ndërhyrjes së Shpejtë, Tiranë" e realizuar në datën 16.01.2019, me fond limit 59,598,569 lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 6 operatore ekonomik dhe janë kualifikuar 2 operator nga të cilët është shpallur fitues operatori ekonomike "X" me ofertën ekonomike në vlerën 44,617,908.6 lekë pa TVSH. Janë skualifikuar 4 operatorë ekonomik nga të cilët operatori "X" kishte ofertë në vlerën 42,239,400 lekë, me diferencë nga fituesi me për 2,854,210 lekë, me TVSH. Këto operatorë janë s'kualifikuar sepse, nuk plotëson disa kërkesa të veçanta të vendosura në DT. Por për një menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të këtyre fondeve buxhetore **në vlerë 2,854,210 lekë**, ABP mund të tregohej më tolerante duke i konsideruar këto mangësi si devijime të vogla.

**5.7. Gjetje:** Procedura e prokurimit me objekt: "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë", e realizuar në datën 01.07.2019, me fond limit 7,499,732.15 lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomikë dhe është shpallur fitues operatori "X" me ofertën ekonomike në vlerën 7,219,170 lekë. Janë skualifikuar 2 operatorë të cilët kanë ofertat ekonomike më të ulta se operaori fitues, konkretisht: operatori "X" me ofertë 6,861,649 lekë ose me diferencë në vlerën 429,052 lekë me TVSH; operatori "X" me ofertë 6,142,024 lekë, ose me diferencë 1,292,575 lekë. Këta operatorë janë s'kualifikuar sepse, nuk plotësojnë disa kërkesa të veçanta të vendosura në DT. Për një menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të këtyre fondeve buxhetore që shkojnë deri **në vlerë 1,292,575 lekë**, ABP mund të tregohej më tolerante duke i konsideruar këto mangësi si devijime të vogla sepse ato nuk ndikojnë në realizimin me sukses të kontratës.

**5.8. Gjetje:** Procedura e prokurimit me objekt: "Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Berat, Loti IV" e realizuar në datën 16.10.2017, me fond limit 2,142,855 lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 operatore ekonomik dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori "X" me ofertën ekonomike në vlerën 2,136,052.10 lekë. Është skualifikuar operatori "X" me ofertë ekonomike në vlerën 2,121,256 lekë, ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 17,755 lekë. Ky operator është skualifikuar nga KVO se, nuk plotëson kriteret e Veçanta për kualifikim pasi kontratat e paraqitura janë kontrata për furnizimin me mallra ushqimore dhe nuk janë kontrata shërbim katering. Por për një menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe

ekonomicitet të këtyre fondeve buxhetore **në vlerë 17,755 lekë**, ABP mund të tregohej më tolerante duke i konsideruar këto mangësi si devijime të vogla sepse ato nuk ndikojnë në realizimin me sukses të kontratës.
*(Trajtuar më hollësisht në faqet 45-46 dhe 86-102, të Raportit të Auditimit)*

**5. Rekomandimi:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me cilësinë e organit qendror blerës të marri iniciativën ligjore dhe në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik duke angazhuar edhe ekspert dhe specialistë të fushës përkatëse për :
**5.1. Rekomandimi:** Unifikimin dhe hartimin e një pakete kriteresh minimale të kualifikimit për procedura të prokurimeve të të njëjta ose të ngjashme me kontratat e shërbimit të gatimit dhe të shpërndarjes së ushqimit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**5.2. Rekomandimi:** Hartimin e një komentari apo udhëzuesi, për të shpjeguar rastet kur mosplotësimi i dokumentacionit apo i mangësive të ndryshme në përmbushjen e kritereve të veçanta për kontratat e shërbimit të gatimit dhe të shpërndarjes së ushqimit, do të konsiderohen devijime të vogla.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**6.1. Gjetje:** Procedura e prokurimit me objekt Loti IV "Furnizim me naftë F-76 (Klasa F), Loti IV", e realizuar në datën 08.05.2017, me fond limit 401,690,316 lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 3 operatore ekonomik dhe janë kualifikuar 2 operator nga të cilët është shpallur fitues operatori ekonomike "X" me marzhë fitimi 13.7 %. Është skualifikuar operatori "X" me marzhë fitimi 7.5% ose me diference më të ulët se fituesi për 6.2 % dhe në vlerën **29,885,759 lekë**, me TVSH. Ky operator është skualifikuar sepse, nuk plotëson kreteret e përgjithshme (nuk është paraqitur sigurimi i ofertës), por edhe për disa kërkesa të veçanta të vendosura ne DT.

**6.2. Gjetje:** Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje Karburanti, përveç Jet A1", ndarë në 4 (katër) lote, të realizuar në datën 18.09.2019. Në Lotin e I, me fond limit 271,043,290 lekë, kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomikë, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "X" me marzhë fitimi 16.4 % dhe është skualifikuar, BOE "X" me marzhë fitimi 10 % ose më të ulët se fituesi për 6% dhe në vlerën **19,515,116 lekë ,** me TVSH. Në Lotin e II me fond limit 23,949,112 lekë, kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomikë, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "X" me marzhë fitimi 16.4 % dhe është skualifikuar BOE "X" me marzhë fitimi 7 % ose më të ulët se fituesi për 9.4% dhe në vlerën **2,701,459 lekë**. Në Lotin e III me fond limit 26,786,982 lekë, kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomikë, është kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "X" & "X" me marzhë fitimi 17.4 % dhe është skualifikuar BOE "X" me marzhë fitimi 7 % ose më të ulët se fituesi për 10.4% dhe në **vlerën 3,343,015 lekë.** Në Loti e IV me fond limit 45,198,022 lekë, kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomikë, është kualifikuar dhe shpallur fitues operatori ekonomik "X" me marzhë fitimi 19% dhe janë skualifikuar 2 operatorë ekonomikë të cilët kanë paraqitur marzhën e fitimit më të ulët se fituesi, respektivisht operatori "X", me marzhë fitimi 10.93% me diferencë 9.93% dhe në vlerën 5,385,796 lekë, dhe operatori "X" me marzhë fitimi 5%, me diferencë 14% dhe në vlerën **7,593,267 lekë**. Këta operatorë (në të katër lotët) janë skualifikuar sepse nuk plotësonin disa kërkesa të veçanta të vendosura në DT.
Sa sipër, për një menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të këtyre fondeve buxhetore **në vlerë 33,152,857 lekë** (katër lotët), ABP mund të tregohej më tolerante duke i konsideruar këto mangësi të këtyre operatorëve, si devijime të vogla sepse këto mangësi nuk ndikojnë dhe nuk pengojnë realizimin me sukses të kontratës.
**6.3. Gjetje:** Procedura e prokurimit me objekt: "Furnizim me lëndë djegëse të lëngëta për përdorim termik civil dhe industrial, Loti II", e realizuar në datën 08.05.2017, me fond limit 313,543,344 lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 4 operatore ekonomik, janë kualifikuar 2 operator nga të cilët është shpallur fitues operatori ekonomike "X" me marzhë të fitimit 5.8%. Janë skualifikuar 2 operator e tjerë nga të cilët operatori "X" ka ofertën më të ulët se operatori fitues, me marzhë fitimi

3.7%, ose me diferencë më të ulët për 2.6 % dhe në vlerën 9,782,552 lekë , me TVSH. Ky operator është skualifikuar sepse fletë – analiza e paraqitur nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara në DST. Por për një menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të këtyre fondeve buxhetore **në vlerë 9,782,552 lekë**, ABP mund të tregohej më tolerante duke i konsideruar këto mangësi si devijime të vogla sepse ato nuk ndikojnë dhe nuk pengojnë realizimin me sukses të kontratës.

**6.4. Gjetje:** Procedura e prokurimit me objekt "Blerje Karburanti", Loti i "Furnizim me lëndë djegëse për automjete Diesel (Gazoil)" e realizuar në datën 30.11.2017, me fond limit, 42,824,100 lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomik, është kualifikuar është shpallur fitues BOE "X" me marzhë fitimi 16,7% (oferta ekonomike) dhe është skualifikuar BOE "X" me marzhë fitimi 10 % ose me diferencë më të ulët se fituesi për 6.7 % ose në vlerë 3,443,057 lekë, me TVSH. Ky operator është skualifikuar sepse nuk përmbush disa nga kriteret e veçanta të kërkuara në DT. Por për një menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të këtyre fondeve buxhetore **në vlerë 3,443,057 lekë**, ABP mund të tregohej më tolerante duke i konsideruar këto mangësi si devijime të vogla sepse ato nuk ndikojnë në realizimin me sukses të kontratës.
*(Trajtuar më hollësisht në faqet 26-28, 41-45 dhe 78-84, të Raportit të Auditimit)*
**6. Rekomandimi:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me cilësinë e organit qendror blerës të marri iniciativën ligjore dhe në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik duke angazhuar edhe ekspert dhe specialistë të fushës përkatëse për :
**6.1. Rekomandimi:** Unifikimin dhe hartimin e një pakete kriteresh minimale të kualifikimit për procedura të prokurimeve të të njëjta ose të ngjashme me kontratat e furnizimit të karburanteve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**6.2. Rekomandimi:** Hartimin e një komentari apo udhëzuesi, për të shpjeguar rastet kur mosplotësimi i dokumentacionit apo i mangësive të ndryshme në përmbushjen e kritereve të veçanta për kontratat e furnizimit me karburante do të konsiderohen devijime të vogla.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**7. Gjetje:** Procedura e prokurimit me objekt "Blerje materialesh pastrimi" e realizuar në datën 09.10.2017, me fond limit 54,073,883 lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 8 operatore ekonomik dhe janë kualifikuar 5 operator nga të cilët është shpallur fitues operatori ekonomike "X" me ofertën ekonomike në vlerën 27,429,165 lekë. Janë skualifikuar 3 operatorët, nga të cilët 2 kanë ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues. Konkretisht operatori "X" me ofertë ekonomike në vlerën 22,278,832 lekë i cili është tërhequr nga oferta dhe dhe operatori "X" me ofertë ekonomike në vlerën 23,777,761 lekë ose me diferencë më të ulët se fituesi në vlerën 4,381,684 lekë. Ky operatorë është skualifikuar sepse nuk plotësojnë kërkesat e veçanta të vendosura në DT. Por për një menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të këtyre fondeve buxhetore **në vlerë 4,381,684 lekë**, ABP mund të tregohej më tolerante duke i konsideruar këto mangësi si devijime të vogla sepse ato nuk ndikojnë në realizimin me sukses të kontratës.
*(Trajtuar më hollësisht në faqet 39-41, të Raportit të Auditimit)*
**7. Rekomandimi**: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me cilësinë e organit qendror blerës të marri iniciativën ligjore dhe në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik duke angazhuar edhe ekspert dhe specialistë të fushës përkatëse për:
**7.1. Rekomandimi:** Unifikimin dhe hartimin e një pakete kriteresh minimale të kualifikimit për procedura të prokurimeve të të njëjta ose të ngjashme me kontratat për blerjen e materialeve të pastrimit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**7.2. Rekomandimi:** Hartimin e një komentari apo udhëzuesi, për të shpjeguar rastet kur mosplotësimi i dokumentacionit apo i mangësive të ndryshme në përmbushjen e kritereve të veçanta për kontratat e blerjes së materialeve të pastrimit, do të konsiderohen devijime të vogla.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**8. Gjetje:** Procedura e prokurimit me objekt: "Blerje Orendish dhe Pajisjesh për Mobilim Zyrash për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për Pikën e Kalimit të Kufirit Morinë- Vermisë, Kukës" e realizuar në datën 30.11.2017, me fond limit 15,225,000 lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 11 operatore ekonomik dhe janë kualifikuar 6 operator nga të cilët është shpallur fitues operatori ekonomike "X" me ofertën ekonomike në vlerën 9,434,400 lekë. Janë skualifikuar 5 operatorë, nga të cilët 2 kanë ofertën ekonomike më të ulët se operatori fitues. Konkretisht operatori "X" me ofertë ekonomike në vlerën 9,040,700 lekë, ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 393,700 lekë dhe operatori "X" me ofertë ekonomike në vlerën 8,036,700 lekë, ose me diference më të ulët se fituesi në vlerën 1,397,700 lekë. Këta operatorët janë skualifikuar sepse këta operatorë nuk kanë kthyer përgjigje për ofertën anomalisht të ulët dhe për mos korrigjimin e ofertes. Por për një menaxhim më të mirë dhe më me efektivitet dhe ekonomicitet të këtyre fondeve buxhetore që shkojnë deri **në vlerë 1,397,700 lekë**, ABP mund të tregohej më tolerante duke i konsideruar këto mangësi si devijime të vogla sepse ato nuk ndikojnë në realizimin me sukses të kontratës.
*(Trajtuar më hollësisht në faqet 37-39, të Raportit të Auditimit)*

**8. Rekomandimi:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me cilësinë e organit qendror blerës të marri iniciativën ligjore dhe në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik duke angazhuar edhe ekspert dhe specialistë të fushës përkatëse për:

**8.1. Rekomandimi:** Unifikimin dhe hartimin e një pakete kriteresh minimale të kualifikimit për procedura të prokurimeve të të njëjta ose të ngjashme me kontratat për blerjen e Orendive dhe Pajisjeve për mobilim zyra.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**8.2. Rekomandimi:** Hartimin e një komentari apo udhëzuesi, për të shpjeguar rastet kur mosplotësimi i dokumentacionit apo i mangësive të ndryshme në përmbushjen e kritereve të veçanta për kontratat e blerjeve të Orendive dhe Pajisjeve për mobilim zyra, do të konsiderohen devijime të vogla.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

## V. OPINIONI I AUDITIMIT:

**<u>Për drejtimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara (në vijim ABP)</u>**
Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së ABP, sa i takon shkallës së zbatimit të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion realizon procedura prokurimi të përqendruara, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë). Gjatë auditimit në terren janë të marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.
***<u>Opinion i kualifikuar:</u>***
Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë[2], i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin "Agjencia e

[2] Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së"

Blerjeve të Përqendruara", rezultuan devijime materiale sasiore dhe cilësore nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***një opinioni të kualifikuar*** (me rezervë) ***të përputhshmërisë***[3]

***Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000[4]):***

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë". Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në INTOSAI - P10, "Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t", si dhe ISSAI 130 "Kodi Etik". Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

***Nga evidencat e marra për veprimtarinë e* ABP**, rezultoi se, janë konstatuar disa mangësi dhe parregullsi të cilat kryesisht konsistojnë:

- APP, në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimit Publik" ka nxjerr Udhëzimin nr.6 datë 16.01.2018 "Për përdorimin e marrëveshjes kuadër dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" për t'u zbatuar nga të gjitha Autoritetet Kontraktore dhe Udhëzimin nr. 8, datë 20.02.2018 "Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive, institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime" për t'u zbatuar nga ABP. Nga zbatimi i këtyre udhëzimeve i është shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik **200 milion lekë**;
- Në mos përgatitjen dhe hartimin e një pakete për unifikimin e kritereve minimale të veçanta të kualifikimit për të gjitha kontratat e mallrave dhe të shërbimeve që janë prokuruar për llogari të Autoriteteve Kontraktore. Në disa procedura prokurimi janë skualifikuar operatorë, të cilët kanë pasur ofertat ekonomike në vlerë me të ulët se, vlera e ofertave të operatorëve të shpallur fitues. Skualifikimi i këtyre operatorëve është bërë pikërisht për mos përmbushjen e disa prej kritereve të veçanta dhe për pasojë janë përdorur **207,191,000 lekë** fonde buxhetore pa efektivitet dhe ekonomicitet, duke i humbur efektet që kërkon ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.

-Për një pjesë të konsiderueshme të fondeve buxhetore nuk është arritur efiçenca dhe efikasiteti në procedurat e prokurimit, duke mos përmbushur kështu, qëllimin e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006;

- Në mosrespektimin e akteve ligjore e nënligjore për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara nga MB.

**KONTROLLI I LARTE I SHTETIT**

[2] **ISSAI 4000** – Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë

[3] Sipas ***Manualit të Auditimit Përputhshmërisë*** të KLSH-së, kapitulli V, pika 5.4, ***Konkluzionet/ opinionet e kualifikuara:*** Audituesi shpreh një konkluzion me rezervë kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit. Kur auditimi i përputhshmërisë kryhet së bashku me pasqyrat financiare, *audituesi mund të shpreh një opinion me rezervë kur devijimet janë materiale por jo të përhapura,* ose n.q.s. audituesi nuk është në gjendje të sigurojë evidencë auditimit të përshtatshme dhe të mjaftueshme dhe, efektet e mundshme, janë materiale por jo të përhapura.

| GRUPI I AUDITIMIT: | DREJTOR I DEPARTAMENTIT |
|---|---|
| B.A. | B. A. |
| P. R. | |